



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29, 30. MARS DHE 5 E 6 PRILL 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29, 30. MARTA, 5. I 6. APRILA 2012. GODINE**

**PRILL – APRIL
2012**

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndërtim,
7. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012.
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
13. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike,
14. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”.

D n e v n i r e d

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje N/zakona br. 04/L-46 o javnom prenosu na Kosovu,
5. Prvo razmatranje Narta zakona o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima,
6. Prvo razmatranje Narta zakona o izgradnji,
7. Informacija ministra unutrašnjih poslova o dogadjaju nga granici sa Srbijom, 31.marta 2012,
8. Drugo razmatranje N/zakona o bibliotekama Republike Kosova,
9. Drugo razmatranje N/zakona o registrovanju i evidenciji nezaposlenih i onih koji traže posao,
10. Drugo razmatranje N/zakona o igrama na sreću ,
11. Drugo razmatranje N/zakona o penzijskim fondovima na Kosovu ,
12. Drugo razmatranje N/zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i ne bankarskim finansijskim institucijama,
13. Zahtev Vlade Republike Kosova , za povlačenje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-168 o turizmu i turističkim uslugama ,
14. Razmatranje Prostornog plana Zone od psoebnog interesa “Generalni štab OVK-a u Kleçkë i Divjakë”.

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare.

Prezentë janë 62 deputetë.

Mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutim është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të kryetarëve të grupeve parlamentare zgjatin deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Fillimisht është mirë të lajmërohen deputetët që janë në emër të grupeve parlamentare.

A ka të lajmëruar në emër të grupeve parlamentare? Nuk ka. Mirë, fjalën e ka në emër të Vetëvendosjes, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më 24 mars ne mbajtëm një Konferencë për media në lidhje me propozimet tona për reformën zgjedhore dhe informuam qytetarët se cila ka qenë puna e Komisionit për ndryshimin e ligjit të zgjedhjeve, ndërsa sot në emër të Lëvizjes Vetëvendosje do të doja t'ju informoja mbi çfarë po ndodh më komisionin në fjalë.

Në vendin tonë pothuajse asnjëherë që nga viti 2000 nuk kemi pasur zgjedhje të mirëfillta. Kulmi i degradimit të vullnetit të qytetarëve i shprehur përmes votës ishte në zgjedhjet e fundit ku vota e qytetarëve nuk u numërua, por u vodh, duke shtrembëruar thelbesisht rezultatin. Si pasojë u vodhën mandatet për në Kuvendin e Kosovës. Shumë prej individëve këtu sot, janë produkt i këtyre vjedhjeve. Ata janë po të njëjtët që ngrenë dorën në mënyrë automatike sa i herë që i kërkohet nga ai i cili orkestroj masivizimin e vjedhjes së votave.

Siç e keni vënë re shpesh këta nuk ndjejnë kurrfarë nevojë të dëgjojnë apo shohin ndonjë nga kërkesat, peticionet apo interesat e qytetarëve.

Këto vota të vjedhura po vjedhin çdo projekt të së ardhmes së Kosovës, prej negociatave e fusnotave, Ligji i veteranëve, i pensionistëve, e deri tek Ligji për Prizrenin e Hoqën e Madhe.

Vjedhja e votave ishte edhe shqetësim në Raportin e Progresit të vitit 2011. Njëjtë u fol dhe dje në debatin për Kosovën në Parlamentin Evropian nga europarlamentarët. Ata vazhdimisht theksojnë se ne duhet të punojmë në reforma zgjedhore duke iu përshtatur standardeve ndërkombëtare për administrimin e zgjedhjeve.

Në vend që ta pësonin përgjegjësit për këtë çështje, ajo çfarë ndodhi ishte një marrëveshje e bërë brenda natës, e cila ishte shenja e parë që reforma zgjedhore ishte nënshtruar pazareve konjunkturale, jashtë institucioneve. Rezoluta që rrodhi nga marrëveshja as që e adresoi çështjen e vjedhjes së votave dhe dhunimit të procesit.

Përqendrimi u bë në çështjet e ndryshimit të sistemit zgjedhor, pikërisht për të na treguar vetëm pak muaj më vonë se shqetësimi i tyre është si të shpikin një formulë të re për të aranzhuar vjedhje të reja.

Deri më tani një ndër të arriturat e pakta që ka bërë Komisioni për reformën zgjedhore është sjellja e 150 amendamenteve teknike. Për hir të transparencës, unë do t'i përmend vetëm disa për t'ju bërë me dije se çka përmbajnë ato amendamente, pasi që po tentohet t'ju hidhet hi syve qytetarëve dhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian.

Amendamentet e këtij Komisioni për garantimin e votës së popullit janë si për shembull:

- Fshihet fjala “mbajtjen” dhe shtohet “organizimin”,
- “Ditë” do të thotë “ditë kalendarike”,
- Posteret hiqen 10 ditë pas certifikimit të rezultateve,
- Fushata zgjedhore zgjat 20 ditë,
- Vëzhguesit nga media t'i akreditojë KQZ-ja,
- Të ketë trajnim të shtuar për vëzhguesit,

Atëherë, a më tregoni se cili prej këtyre amendamenteve lidhet në mënyrë direkt apo indirekt me mbrojtjen e votës? Unë them që asnjëra.

Këto amendamente nuk kanë për qëllim të përmirësojnë procesin zgjedhor, disa prej tyre, madje krijojnë paqartësi të reja.

Vetë Komisioni për Reformën Zgjedhore gradualisht është shndërruar në një vend ku ngulfaten diskutimet dhe propozimet. Ky komision është tanimë një mekanizëm votimi për konkluzione që vinë nga ” të famshmet -takimet e darkës” që të ashtuquajturit liderë partiakë i bëjnë jashtë institucioneve. Le ta themi pra hapur.

Programi i vërtetë i reformës zgjedhore nuk është çfarë duket në media, por ajo të cilën propozuesit e kësaj reforme e bëjnë fshehurazi për qëllime tanimë të ditura, për të na kërcënuar pastaj haptazi më dhunën e numrave të votave që pretendojnë se i kanë.

Të njëjtët na kanë propozuar për institucione, restorantet, takime- për të cilat askush s'ka dijeni, përveç kuptohet krejt rastësisht, RTK-së.

I bëj thirrje si anëtare e Komisionit, si deputete, si aktiviste e lëvizjes “Vetëvendosje” secilës organizatë të shoqërisë civile, secilit gazetar e gazetare, secilit specialist, çdo qytetari të angazhuar që të ndjekë nga afër punën e këtij Komisioni dhe rezultatet që do të dalin prej tij. Po ashtu i bëj thirrje çdo deputeti që beson se është dhe gjithnjë duhet të jetë përfaqësues i votës së qytetarëve, që të mos i nënshtrohet konjunkturës që po përgatit planin e ri të vjedhjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Duda Balje, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Krajem ove godine očekuje se završetak procesa nadgledanje nezavisnosti Kosova, o tome smo glasali u skupštini podržali aktivnost.

Završavanje procesa nadgledanje nezavisnosti između ostalog znači ispunjavanja svih uslove za Ahtisarijevog paketa, međutim jedna od obaveza se preskočili ili propustila a tiče se konkretno Bošnačkih zajednici pitanja decentralizacije koja mnogo puta potignuto uz običajno i prividnu podršku ali bez vidljivih aktivnosti od strane Vlade i odgovorno ministarstva.

To Konkretno znači da jedna tačka i spomenutog paketa njenih načeta a odnosi se na dužnost Vlade da stupi u pregovore za drugim zajednicama ne srpskim koji ispunjava uslove iz Ahtisarijevog paketa i iz drugih zakona koji se na snazi u našoj državi a tiče se stvari na novih opština.

Pitam se ja, i pita se cela moja zajednica šta će biti, šta će se desiti sa našim zahtevam kada proces nadgledanja nezavisnosti završi? A isto pitanje postavljam i stranim institucijama koji se ovde prisutni i koji su vrši uticajne.

Rečeno nam da čekamo rezultate potpisa stanovništva, pa se ja opet pitam koji se popis stanovništva uzima na obzir sa sve nove opštine koji su dobijane nedavno ili ne tako davno pa što se ne bih uzeli za nas. Preliminarne rezultati popisa samo potvrđuje naše konstatacije po pitanju brojnost Bošnjaka i naravno da idu u prilog ispunjavanju uslova za dobijanja bošnjačkih opština. ... na dobru volju Vlade i ministarstva da će uzeti u obzir našu brigu oko ovog pitanja i naše dugogodišnje traženje iste stvari opštine sa punim pravom i nadamo se da će se potruditi da ne izdvaje drugih zajednica koji sad imaju nove opštine.

Ovim putem apelujem i na međunarodnu upravljačku grupu koja nagleda sa sprovođenje Ahtisarijevog plana da obrati pažnju na moguće propuste ispunjavanju ovih obaveza koji prističu iz pomenutog paketa a tiču se drugih manjinskih zajednica kao što je moja u ovoj finalnoj fazi implementacije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDK-së deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryetar!

Në kutitë tona të deputetëve, më 22.3 ka ardhur një shkresë ku thuhet që tema apo subjekti është marrëveshja për përfaqësim dhe bashkëpunimi rajonal të arritur në dialogun teknik, më 24 shkurt 2012 në Bruksel. Këto i kemi marrë me një muaj vonesë dhe e kemi marrë një shkresë e cila në asnjë mënyrë nuk mund të quhet as si marrëveshje, as si dokument zyrtar. Në fakt këto fjalë, këto paragrafë i kemi lexuar shumë herët nëpër gazeta, po ky në fakt nuk përngjan me dokument.

Çfarëdo kontrate më e thjeshtë, kontratë për qira, kontratë për blerjen e diçka të vogël e ka një memorandum, i ka palët, i ka nënshkrimet, e ka datën, i ka obligimet. Në këto fleta

të cilat përngjajnë në çfarëdo fleta të zakonshme që mund të shërbejnë për të bërë fishekë për fara, nuk duket që është kurrfarë marrëveshje.

Në anën tjetër mendoj që kjo mënyrë e komunikimit me Kuvendin, mënyra kur çfarëdo ”dokumenti” sjellët në Kuvend me një muaj vonesë, apo sjellët në këtë formë, që nuk përngjan me asgjë zyrtare, ku sillet me çfarëdo mënyrë nënçmuese, mendoj që është vetëm një nënçmim i Kuvendit edhe një mungesë respekti për institucionet tona edhe për Kosovën.

Përveç anës procedurale, të mos hyj edhe nga ana substanciale, ku vetë heqja dorë dhe neutraliteti i statusit të Kosovës, në fakt shihet nga reagimet edhe prej Parlamentit të EU-s e cila kërkon që kjo të mos jetë vetëm rajonal, po të jetë edhe një përfaqësim me vetë dëshirë të Kosovës me këtë fusnotë.

Mendoj, që në Kuvend nuk duhet të sillen shkresa se s’mund ta quaj dokument, nuk mund të sillen shkresa të tilla, të cilat nuk përngjajnë me dokumente, po duhet të kihet respekt për Kuvendin, përmes Kuvendit respekt edhe për institucionet e Qeverisë, për vetveten edhe për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot para jush paraqes një shqetësim të shoqatave dhe familjarëve të zhdukur, në veçanti shqetësimin e tyre për mos ekzaminimin e 55 mbetjeve mortore të gjetura na lagjen Bair të Mitrovicës, si dhe shqetësimin e familjeve të personave të zhdukur të Izbicës, të cilët dje shënuan 13 vjetorin e rënies së dëshmorëve dhe martirëve të asaj ane. Pa eshtrat e 39 personave të vrarë nga forcat serbe, ashtu si shumë familje tjera në Kosovë edhe familjet e Izbicës presin identifikimin e 39 mbetjeve mortore, që ankthi i tyre të përfundojë një herë e përgjithmonë.

Më 15 tetor 2011, gjatë punimeve në lagjen Bair të Mitrovicës, në ish vendin e kazermës së armatës jugosllave, janë gjetur mbetjet mortore të 55 personave.

Shoqatat e familjarëve të zhdukur dhe institucionet tjera, kanë kërkuar që këto mbetje mortore të ekzaminohen dhe identifikohen përmes analizës së ADN-së, pasi që prej 9 dhjetorit 2008, EULEX-si ka marrë funksionet monitoruese, udhëheqëse, këshilluese dhe ekzekutive në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, është kërkuar nga ekspertët e EULEX-sit dhe Departamentit të Mjekësisë Ligjore, që t’i ekzaminojnë dhe identifikojnë mbetjet mortore që gjetura në lagjen Bair të Mitrovicës. Mirëpo, Departamenti i Mjekësisë Ligjore i EULEX-sit, më 20 tetor 2011 ka njoftuar se këto mbetje mortore nuk janë interes i forenzikës, me arsyetimin se mbetjet mortore nuk i përkasin luftës së fundit, por janë të një kohe të mëhershme.

Gjatë punimeve në këtë lokacion janë gjetur eshtrat e mbetjeve mortore që nuk janë të një ngjyre, andaj dyshohet se disa nga këto mbetje mortore mund t’i takojnë edhe luftës së fundit. Kështu që është në interes të përgjithshëm ekzaminimi i tyre nga ekspertët e

Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pavarësisht se cilës periudhë kohore i takojnë, sepse bëhet fjalë për 55 persona të vrarë, të zhdukur, andaj është njerëzore, është humane që të bëhet ekzaminimi i atyre eshtrave të njerëzve të vrarë, që ne sot i quajmë mbetje mortore, por në një periudhë kohore ishin njerëz të cilët u vranë barbarisht.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore ka obligim ligjor dhe profesional që t'i ekzaminojë këto mbetje mortore edhe pse deri më sot nuk është përgjigjur kërkesës së Shoqatës së Familjeve për Persona të Zhdukur dhe Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, se këto mbetje të vendosen në Morgun e Departamentit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë dhe të ekzaminohen nga ekspertët sipas legjislacionit në fuqi.

Rikujtoj se sipas ligjit numër 03/L-137, Departamenti i Mjekësisë Ligjore ka këto obligime: të zbardhë fatin e personave të zhdukur, të vlerësojë dhe rihapë varrezat e dyshuara, t'i kryejë autopsitë e mbetjeve të pidentifikuara për të përcaktuar shkakun e vdekjes pasi kjo është e mundur dhe të kryejë identifikimin në mënyrë profesionale duke përdorur analizën e ADN kur është e nevojshme, punë të cilën Departamenti i Mjekësisë Ligjore në këtë rast nuk e ka bërë edhe pse ka pasur obligim ligjor.

Fal angazhimit të Kuvendit Komunal të Mitrovicës dhe kryetarit Avni Kastrati, është kontraktuar Kompania "Loti" nga Mitrovica, e cila ka bërë ekshumimi dhe zhvarrosjen

....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të Grupit deputeti, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qeveria aktuale e Kosovës ka ardhur në pushtet me premtimin se do ta përmirësojë gjendjen e rëndë sociale, do të thotë do ta zbusë gjendjen sociale në të cilin gjendet populli i Kosovës. Kështu ka qenë edhe me Qeverinë paraprake, e cila është praktikisht e njëjta, i njëjti sistem qeverisës.

Në vitin 2010, para zgjedhjeve kryeministri iu ka premtuar punëtorëve rritje të pagave, punëtorëve në administratë, nëpër shkolla, me pretekstin se po tenton ta zbutë gjendjen e rëndë sociale e cila ekziston në Kosovë. E kemi ditur atëherë dhe po e dimë tash që ajo çka ka ndodhur në vërtetë ka qenë për t'ua blerë qytetarëve të varfër të Kosovës me nga 100 euro, votat.

Mirëpo, ajo blerje e votave është përcjell me diçka krejt tjetër. Pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës, të cilët nuk punojnë në administratë, të cilët janë ose pa punë ose në skema pensionale, me nga 80 euro, ose punojnë nëpër ndërmarrje private, kanë pësuar. Ajo që po ndodh tani është se kjo Qeveri e Kosovës po i shtrydh si limonin edhe këta të cilëve iu ka rritur pagat.

Qeveria e Kosovës i ka vendosur arkat fiskale në Kosovë, me pretekstin se do ta zbusë evazionin fiskal, me pretekstin se gjithë do të paguajnë barabarësisht taksa, po ajo çka ka ndodhur në vërtetë është se arkat fiskale janë vendosur për të bërë biznes njerëzit e caktuar, që janë të lidhur me Qeverinë e Kosovës.

E tani në fund, përkundër dështimit me paga, përkundër dështimit me arka fiskale, Qeveria e Kosovës, ka sjell në Kuvend të Kosovës, projektligje dhe propozime përmes të cilave do ta rritë tatimin në pronë. Do të thotë, qytetarëve të Kosovës, do t'iu merr edhe më tepër mjete nga xhepat, gjithashtu të varfër, do ta rrisë edhe çmimin e rrymës, e cila, po ashtu, do t'i varfëroj njerëzit të cilët janë të ndërgjegjshëm dhe paguajnë dhe do t'i shpërblejë ata që nuk kanë paguar. Qeveria e Kosovës na thotë se çmimin e rrymës e rrit Bordin, jo Qeveria, po mos harroni se Qeveria e zgjedh edhe Rregullatorin edhe Bordin. Është Qeveria ajo që po kërkon ta rritë çmimin e rrymës, është Qeveria ajo që po kërkon t' i rritë taksat, është Qeveria ajo që po kërkon për t' ua marrë qytetarëve të Kosovës edhe ato mjete që ju kanë mbet nëpër xhepa, sikur që ju kujtohet me heqjen e akcizës për vetura të vjetra, e cila ka dalë të jetë ashtu siç u ka thënë Aleanca, vitin e kaluar.

Tani ne prej kësaj foltore po dom ta pyesim Qeverinë e Kosovës- A ju ka mbetur edhe diçka të bëni për t' i varfëruar deri në skaj qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarë të cilëve për t' ju marrë votat, u ka premtuar mirëqenie, u ka premtuar paga më të larta, u ka premtuar liri të lëvizjes, u ka premtuar liberalizim të vizave e çka mos?

Ne po kërkojmë para se me ardhë që të gjitha propozimet dhe ligjet të cilat do ta rëndojnë jetën e qytetarëve të Kosovës, të tërhiqen nga procedurat në Kuvend të Kosovës. Jo vetëm që nuk do t' i votojmë në të ardhmen, por ne do të llojmë që të gjithë ta kuptojnë se këto janë politika të mbrapshta.

Po ju tregoj edhe diçka, kryeministri i Kosovës, në vitin 2010 i ka thënë popullit të Kosovës, që nuk e pyet askënd kur është në pyetje përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Nuk e pyet as Fondin Monetar, Ndërkombëtar, nuk e pyet as Bankën Botërore, ama bash askënd, ka thënë se unë punoj në të mirë të qytetarëve të Kosovës, ndërsa, tani krejt çka na sjell në Kuvend të Kosovës, na thotë se janë për shkak të marrëdhënieve me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore e me institucione tjera prej të cilave, realisht varet.

Kam dal sot t' ju tregoj që këto farsa do të ndërpriten një ditë, dhe këta njerëz që e kanë varfëruar popullin e Kosovës, do ta gjejnë përgjigjen e merituar. Po kam dalë edhe me ju thirr - kenë kujdes se te ne thonë: “zullumi këputet prej së trashi”. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të Rregullores së këtij Kuvendi, neni 69 dhe 71, kërkoj themelimin e një komisioni parlamentar që do të ishte marrë me hetimin e veprimtarisë së Shërbimit Informativ të Kosovës, të njohur si SHIK. Kjo kërkesë assesi nuk e amnistion shërbimet tjera informative, sa për sqarim. Kërkoj që ky hetim t' i sqarojë disa gjëra themelore lidhur me Shërbimin Informativ të Kosovës.

Mbi cilën bazë legale veproji ky shërbim? Cili ishte organogrami i këtij shërbimi, cila ishte struktura dhe hierarkia e këtij shërbimi? Kush ishin punëtorët e këtij shërbimi, sa punëtorë kishte ky shërbim? Si financohej ky shërbim, kush e financoi këtë shërbim, pse

e financoj këtë shërbim? Sa para morën këta njerëz, çka bënë me ato para? Kujt i raportoi ky shërbim dhe si i raportoj, kush e mbikëqyri këtë shërbim dhe si e mbikëqyri? A krijoi dosje ky shërbim, për kë krijoi dosje ky shërbim, ku janë ato dosje, a u shua ky shërbim, në qoftë se u shua dhe si u shua ky shërbim? Mendoj se këto janë pyetje themelore tepër të rëndësishme për shtetin e Kosovës, për popullin e Kosovës. Andaj, parlamentarë dhe grupet e parlamentarëve kanë thënë sa herë publikisht se do ta mbështesin një iniciativë të tillë, me qëllimin më të mirë për rendin e ligjin, zhvillimin ekonomik të këtij vendi, kërkoj mbështetje. Unë kam filluar me mbledhjen e nënshkrimeve, ju lus që të mbështetni këtë iniciativë, duhet së paku 40 nënshkrime, për fillimin e kësaj hetuesie tepër të rëndësishme për popullin dhe Republikën e Kosovës. Edhe një herë, assesi kjo iniciativë nuk i amnistion shërbimet tjera informative. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Njazi Idrizi.

NJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj ta shpreh shqetësimin e qytetarëve të regjionit të Gjilanit, mbi të cilët muajve të fundit janë duke u bërë veprime të rënda kriminale. Krimet po bëhen kundër pasurisë së tyre, monumenteve të kulturës dhe jetës së qytetarëve, të cilat kanë pasur pasoja, madje edhe raste të vdekjes së tyre dhe plagosjes.

Janë përdhosur bustet e dëshmorëve, Pajazit Ahmeti dhe Alban Ajeti, është sulmuar shtëpia e familjes Kçiku, me ç'rast ka mbetur i vrarë një pjesëtar i kësaj familje, ndërsa një tjetër është plagosur rëndë dhe po vuan pasojat në spital. Po bëhen grabitje në kohën e frekuentimeve të mëdha të qytetarëve, madje edhe ditën, për diell. Për më keq edhe zbulimi i rasteve të krimeve gjatë kësaj kohe është ulur dukshëm. Këto veprime janë shndërruar në dukuri të cilat kanë shkaktuar shqetësim te njerëzit. Kërkesa e qytetarëve të kësaj ane është që policia të jetë më efektive në punën e vet, ata kërkojnë policia të jetë pra aktive duke qenë në terren, sa më afër qytetarëve me qëllim që të parandalohet dhe dekurajohet krimi.

Po ashtu është kërkesa e njerëzve që gjykatat të jenë më të impenjuara në trajtimin e këtyre rasteve me prioritet, sidomos për krime që cenojnë vatrat e familjeve. Njerëzit përtej shtëpive të tyre nuk kanë se ku të shkojnë, ndërsa taksapaguesit i paguajnë taksat shtetit që të jenë rahat në vatrat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Në kohën kur vërtet po mendojmë se po krijohen rrethana për një raport tjetër ekonomik me Shqipërinë, përkatësisht për krijimin e tregut unik, po ndodhin disa probleme që më bëjnë të dyshoj në seriozitetin e atyre që duhet t'i bartin këto procese.

Bllokimi i eksportit të patates në Shqipëri, përkatësisht caktimi i çmimit nga lista referente, 24 cent për një kilogram, dëshmon se kur flasim për tregun e hapur ka plot demagogji.

Nuk është kjo hera e para që aplikohen masa e këtilla ndaj mallrave kosovare, me qenë se më parë njësor ka ndodhur edhe me qumështin edhe me verërat. Madje, çmimi referent është i aplikuar edhe pas qershorit të vitit të kaluar, kur ministresha Mimoza Kusari-Lila, nga Tirana kishte dhënë lajmin se është arritur një pëlqim i plotë me mallra ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë për qarkullim pa asnjë pengesë doganore.

Ajo me këtë dëshmoi edhe gatishmërinë e Qeverisë shqiptare që t'i korrigjojë gabimet që i ka bërë, kur duke aplikuar çmimet e referencës ka pamundësuar depërtimin e mallrave kosovare në këtë vend. Në fakt nuk ka pas ndalesë apo bllokim të importit nga Kosova, por me këtë çmim patatet nuk ishin konkurrent në tregun e Shqipërisë.

Tash sërish prodhuesit, përkatësisht eksportuesit ballafaqohen me këtë problem, nga 14 cent sa pranohej çmimi për një kilogram patate, ai u ngrit në 24 cent, edhe me këtë tejkalohet dukshëm çmimi aktual që është në tregun shqiptar.

Masat e këtilla kanë shqetësuar edhe prodhuesit vendorë të cilët përmes protestave kërkojnë zgjidhje, me qenë se ata kanë stoke edhe rreth 20 mijë tonë patate. Madje, ky problem erdhi në kohën kur ka filluar mbjellja e patates, përkatësisht në kohën kur realisht vjeljet nga viti i kaluar do të duhej të ishin shitur kaheerë.

Mirëpo, kam edhe një përshtypje se disa prodhues duket sa kanë ruajtur stoqet me qëllim që ndoshta mos të arrijnë çmim më të volitshëm, si ndodhi para dy vjetësh kur në Serbi, u eksportuan patate 40 cent për një kilogram. Megjithatë këto janë çështje që ndodhin me qenë se tregu ynë nuk reagon njësor në secilin vit.

Në të vërtetë mua më shumë më shqetëson fakti se sikur është bllokuar edhe dialogu, përkatësisht kontakti ndërmjet Qeverisë së Kosovës me Qeverinë e Shqipërisë, me qëllim që të tejkalojnë këtë problem, i cili dëshiroj që të jetë aksidental, përkatësisht i momentit e jo koncept strategjik i Shqipërisë rreth marrëdhënieve ekonomike me Kosovën. Ndërkaq, problemet e këtilla, veçanërisht me patatën po ndodhin shpesh posaçërisht, vjet edhe sivjet, kurse vitet e tjera nuk ishin të pranishëm. Çka është më keq me masat e këtilla, përkatësisht me aplikimin e çmimit të referencës, Shqipëria sikur po ua imponon prodhuesve kosovar që të orientohen kah tregjet e tjera e në këtë rast kah Serbia. Këto zhvillime do të ishin në rregull sikur të ndodhnin rrethana....

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem predsedniče!

Gospodo, Vladin kabinet,

Kolege zastupnici,

11. februara 2012. godine, velika lavina zatrpala je 20 kuća u selu Restelici, u opštini Dragaš i u trenoka dve celje familije su nestale u ruševinama njihovih kuća po tonama bjelog snijega.

Mjesec ipo dana nakon ovog događaja, meštani sela Restelice očekuju ispunjavanje konkretnih zahteva od svih relevantnih, domaćih i međunarodnih faktora.

Zahvaljujemo se ujedno svima onima koji su u ti teškim truncima bili uz Restelicu i pojedincima i našim institucijama koji su pomogli u traganju za žrtvama ove tragedije. Odgovorne institucije, međutim još uvek nisu u dovoljnoj mjeri preuzele svoje zakonske obaveze. Naime, od opštinskih organa u Dragašu zahtevamo da se što prije oforme komisije za procenu materijalne štete koja će biti sačinjena od eksperata i odmah izađe na teren čim se za to stvore uslovi. Da izrade sve obuhvatni plan zaštite preostalog stanovništva od potencijalnih opasnosti, od lavina, odrana kamena, uključujući i privremenu zabranu gradnje u opasnim tim zonama, sve dok se te zone ne zaštite.

Od Vlade Republike Kosova očekujemo ispunjenje svojih obećanja u smislu pružanja pomoći porodici nasradalih kao i pomoć u punoj izgradnji porušenih i oštećenih kuća. Od zastupnika Parlamenta Republike Kosova, tražim da se stalno potencira ovo pitanje i ne dozvoli da se ono preusmeri i gurne u drugi plan, a onima koji žele da od ove tragedije izvuku politički profit, savjetujem da se toga okanu, jer se politički profit ne s tiče na nesreće ljudi, nego na stvaranje uslova za zajedničku sreću i blagostanje sviju nas. Zahvaljujem!

KRYETARI: E fundit që e ka fjalën për sot është deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një ndër komunat që me plot të drejtë synojnë zhvillimin ekonomik përmes zhvillimit të turizmit, pa dyshim është edhe komuna e Junikut. Natyrshëm kjo komunën synon zhvillimin e kësaj dege të ekonomisë duke parë këtë si të vetmen alternativë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Më shumë se për asgjë tjetër Juniku ka nevojë për zhvillimin e turizmit dhe energjisë alternative, sektorë këta që nga banorët e këtushëm dhe udhëheqja komunale shihen edhe si mundësi të vetme për zhvillim.

Juniku, disponon me një ofertë turistike mjaft të favorshme, me kushte dhe mundësi jashtëzakonisht të mëdha. Me qenë se Bjeshkët e Junikut kufizohen me Shqipërinë, Malin e Zi, në funksion të zhvillimit të turizmit, pa dyshim është edhe klima e mirë politike e krijuar në rajon, ku janë krijuar edhe kushte të favorshme për qarkullimin e njerëzve, informatave dhe kapitalit në këto hapësira jashtëzakonisht alternative.

Studimet ndërkombëtare të punuara në vitet e 70-ta tregojnë se në këtë rajon turistik mund të ndërtohen shumë qendra për zhvillimin e turizmit dimërorë sportiv, Plaqica e Junikut, Qershizat, Gropa e Junikut, Rrasa e Zogut, janë vetëm disa nga mundësitë me nivelim mesatar të shtigjeve prej 880 metra me kapacitet rreth 30 mijë skiatorë.

Përpjekjet e vazhdueshme të komunës së Junikut për të bërë diç në këtë drejtim po thuaj se po bien në vesh të shurdhër nga Qeveria e Kosovës, e cila në këtë rast do të ishte përfituesja më e madhe, sepse me zhvillimin e turizmit në Junik, por edhe në komuna të

tjera si janë: Deçani, Peja, Istogu, Gjakova e të tjerë, më së shumti do të përfitonte vetë Kosova. Për fat të keq deri më tash çdo gjë ka mbetur në letër apo në ëndrrat e atyre që vetën duhet ta ndiejnë keq se përse deri më sot nuk është bërë asgjë në këtë drejtim?

Ditë më parë nga Radiotelevizioni i Kosovës, patëm rastin të njoftohemi me potencialet e pashterueshme të kësaj komune për zhvillimin e turizmit. Nuk e di nëse eventualisht dikush nga Qeveria e ka pasur rastin që së paku përmes ekranit televiziv ta shohë këtë begati që fatkeqësisht rri e fjetur për vite të tëra. Po cila do të ishte përpjekja e parë serioze e kësaj Qeverie? Deri më sot nuk është bërë së paku një hap për fillimin e ndërtimit të rrugës për në Bjeshkët e Junikut, të cilën komuna e kërkon me ngulm të madh e që për fat të keq, paraqet bazën kryesore për nxitjen e zhvillimit të turizmit, qoftë atij veror apo atij dimëror, me një fjalë në këtë komunë ekzistojnë potencialet për turizëm gjatë 12 muajve të vitit.

Si mund të shpjegohet fati i mosshfrytëzimit të resurseve kaq të mëdha natyrore e me larushi vlerash të trashëgimisë kulturore, zhvillimi i të cilave do të shndërrohej në një traditë dhe ekonomi të qëndrueshme.

Me ndërtimin e këtyre kapaciteteve, Juniku do të jetë komunë e mundësive të mëdha. Në të vërtetë, mosshfrytëzimi i këtyre kapaciteteve natyrore edhe sot pas kaq shumë vitesh nga ana e institucioneve tona, është i pajustificueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Koha është harxhuar. Janë disa kërkesa me shkrim për ndryshim të rendit të ditës dhe, ata mund ta kërkojnë fjalën. Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ka bërë një kërkesë kryetarit të Kuvendit, që të plotësohet rendi i ditës së mbledhjes së sotme, me një pikë të rendit të ditës- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare. Arsyeja pse kemi kërkuar që të plotësohet ky rend i ditës është se ky projektligj është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar ku parashihet që ky ligj të miratohet deri në fund të këtij muaji.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka punuar shumë kujdesshëm në këtë projektligj, ka angazhuar ekspertë që njohin shumë mirë fushën e bankave. Po ashtu, Komisioni ka pasur përkrahjen edhe të Departamentit të Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Çdo ndryshim e kemi harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, kemi inkorporuar edhe disa rekomandime të Zyrës së EULEX-it si dhe kemi pasur konsulta me përfaqësues të Zyrës së Komisionit Evropian, ku kemi harmonizuar me qëndrimet.

Amendamentet e propozuara janë votuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Rekomandimet tona kanë kaluar edhe në Komisionin për Integritet Evropian dhe në Komisionin për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kërkoj nga të gjithë deputetët, mirëkuptim, që të futet si pikë e rendit të ditës sot, për shqyrtim të dytë- Projektligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Faleminderit, nëse keni mirëkuptim!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet Arben Gashi, për çka e keni kërkuar fjalën?

Në emër të Grupit Hykmetja, ti në emër tëndin! Mirë! Debat nuk ka, veç tash mund ta marrësh fjalën në emër të Komisionit.

Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Që ky ligj është një ligj i rëndësishëm, nuk ka dyshim, që duhet të punohet me kujdes ky ligj, po ashtu, nuk ka dyshim, por që ka edhe shumë probleme si ligj, po ashtu, nuk ka dyshim.

Problemet që lindin janë këto, kryetarja e Komisionit na tha se duhet të përkrahet ky ligj, sepse është në kuadër të marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të kthehemi atje ku kemi qenë para dy vitesh, domethënë, në marrëveshjen, marrëdhënie kontraktuale dhe jo të mbetemi në “stand by” marrëveshjen ose në pritje.

Problemi qëndron këtu, ky ligj ka disa pjesë. Pjesa e parë, sa i përket organizimit të bankave, ne mendojmë se do të duhej të kalonte, po pjesa e dytë, sa i përket organizimit të funksionimit të organizatave mikrofinanciare dhe institucioneve jofinanciare bankare, ka probleme shumë të mëdha. Problemet qëndrojnë në faktin se me këtë ligj synohet që t’u jepet mundësia që institucionet mikrofinanciare, të shndërrohen në aksionarë ose në banka. Problemi lind në faktin se kush është aksionari, kur dihet se këto janë themeluar dhe kanë funksionuar si organizata joqeveritare. Dhe, problemet që dalin këtu janë disa.

Problemi i parë kryesor, në aspektin e konceptit kushtetues. Kushtetuta e Republikës Kosovës, neni 10, thotë: “Ekonomia e tregut, me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik në Republikën e Kosovës”. Këto institucione mikrofinanciare për dhjetë vitet e fundit kanë akumuluar një kapital mbi 120.000.000 euro, kapital i akumuluar në emër të organizatave joqeveritare, që i bie këto institucione mikrofinanciare nuk kanë paguar tatime dhe taksa në Republikën e Kosovës, që i bie se është shkelur neni 10, në qoftë se ky ligj kalon dhe shndërrohen në institucione financiare ose shndërrohen në institucione, agjenci aksionare.

Ky problem, po ashtu lind edhe me lirinë e asociimit, që është një nen tjetër në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që e parasheh lirinë e asociimit dhe në bazë të saj funksionojnë organizatat joqeveritare në Republikën e Kosovës. Dhe, ky disbalancim mund të shkaktojë një krizë shumë të madhe. E para, kush janë aksionarët, që do të marrin aksione në këto kompani, sepse dihet që janë themeluar me donacione, që janë dhënë nga organizata ose shtete të ndryshme partnere dhe mike të Kosovës dhe elementi tjetër i menaxhimit dhe funksionimit të këtyre organizatave mikrofinanciare?

Këto organizata, e thashë edhe njëherë, kanë akumuluar një kapital mbi 120.000.000 euro dhe nuk kanë paguar asnjë taksë, asnjë cent taksa dhe tatime Republikës së Kosovës.

Këto kanë paguar mëditje të mira, mbi 200.000 euro në vit, kanë paguar paga mbi 15.000 euro në muaj dhe asnjë formë tjetër. Këto paga janë bërë për anëtarë të bordit, të jemi të qartë, dhe jo për njerëzit të cilët janë pjesë e institucioneve, për njerëzit tjerë të cilët janë të përfshirë në këtë skemë, e as për institucionet e Kosovës.

Prandaj, mendoj se ky ligj, pjesë të ligjit që merren me institucionet mikrofinanciare dhe me institucionet financiare jobankare, janë në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mendoj se duhet të ndalet kjo pjesë dhe nëse është e rëndësishme për Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne si shoqëri duhet patjetër që t'i bëjmë këto ligje, t'i kalojmë por, të kalojmë vetëm pjesën për bankat, se informacionet që kam, edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar edhe nga partnerët tanë ndërkombëtar, pjesa e rëndësishme për Fondin Monetar Ndërkombëtar, që të kthehemi atje ku kemi qenë para dy vitesh, në marrëdhënie kontraktuale me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është në lidhje me bankat, jo me institucionet mikrofinanciare, që e rregullon një ligj tjetër.

Prandaj ky ligj, përveç përplasjes me Kushtetutën, përplasjet edhe me Ligjin për asociimin dhe i rekomandoj seancës, që të mos e shtijë në rend të ditës ose të paktën, nëse e shtien në rend të ditës, duhet patjetër që kjo pjesa e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jo financiare bankare, të hiqet. Faleminderit!

KRYETARI: Për Qeverinë si sponzorues, ministri Bedri Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kabinet Qeveritar,

Fillimisht dua t'i falënderoj deputetët për punën dhe angazhimin e tyre në komisione gjatë punës së këtij ligji. Me punët dhe angazhimin e tyre kanë kontribuar në përmirësimin e ligjit në raport me materialin, që ka qenë i prezantuar në leximin e parë.

E tha kryetarja e Komisionit, me shumë të drejtë, se pjesë e punës gjatë hartimit të këtij ligji, aktivisht kanë qenë: Thesari Amerikan, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komisioni Evropian. Është diskutuar këtu në lexim të parë, ka punuar në komisione, ka pasur debat publik për këtë ligj, ku të gjithë të interesuarit kanë mund t'i japin komentet e tyre. Është një ligj që e rregullon një sferë mjaftë të rëndësishme, nuk është ligj që është në kundërshtim me Kushtetutën, nuk është ligj që është në kundërshtim me parimet e ekonomisë së lirë të tregut, nuk është qëllimi, që ta prekë atë pjesën e OJQ-ve, të cilat nuk merren me mikrofinanca.

Qëllimi është që institucionet mikrofinanciare kanë zhvilluar aktivitete financiare të karakterit bankar, që kanë realizuar profit dhe që realisht qëllimi është që këto institucione të futen në sistem, të rregullohen, të regjistrohen sipas procedurave, të mbikëqyren, t'i paguajnë tatimet dhe mos të vazhdojë situata aktuale, ku ka vend për të menduar edhe për shpëlarjen e parave, se duhet të kemi kujdes edhe për shpëlarjen e parave.

Prandaj, ne sot e lusim Kuvendin, që këtë ligj ta fusë në seancë dhe të njëjtin ta votojë, pasi që i njëjti është edhe pjesë e marrëveshjes dhe është veprim paraprak, të cilin institucionet e Kosovës duhet ta përmbushin brenda muajit mars, me qëllim që marrëveshje e re me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të krijohet mundësia që të shqyrtohet në bordin e këtij institucioni, në muajin prill.

Prandaj nuk është ligj në kundërshtim me Kushtetutën, nuk është ligj në kundërshtim me ligjet tjera. Unë jam shumë i sigurtë, që të gjithë ne kemi interes për rend, rregull dhe disiplinë në këtë punë, kemi nevojë që të vendoset një mbikëqyrje dhe një kontroll i të gjitha institucioneve.

Në Kosovë janë të regjistruara, ndoshta mbi 5.000 OJQ. Ky ligj nuk i trajton ato. Ky ligj i trajton vetëm ato organizata joqeveritare, edhe ato biznese të cilat merren me aktivitete financiare dhe me kredidhënie. Prandaj, me qëllim të mbikëqyrjes, të kontrollit, të pagesës së tatimeve, është sjell ky ligj, është ligj i harmonizuar me të gjithë faktorët relevantë dhe unë e lus seancën, që ta fusë në agjendë për seancën e sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dua ta zgjas, po në bazë të asaj që dëgjuam edhe sqarimet që i dha kryetarja e Komisionit përkatës për Buxhet dhe Financa, te ministrit që i dha sqarimet e nevojshme dhe po shihet qartë se këtu kanë marrë pjesë në hartimin e këtij ligji, apo të amendamenteve edhe ekspertët vendorë dhe ata ndërkombëtarë, po ashtu, si pjesë përbërëse edhe e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ne si Grup Parlamentar, u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve, që ta mbështesin futjen në rend të ditës dhe aprovimin e këtij ligji brenda kësaj seance. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami, e ka fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Neve na vjen keq kur gjendemi para situatave dhe ligjet e ndryshme, do të thotë, arsyetohen me faktin se janë pjesë të marrëveshjeve, qoftë për integritet evropian, qoftë për Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Lidhja Demokratike e Kosovës është parti institucionale dhe ky Kuvend ka pasur votën e LDK-së, sa herë që është kërkuar, për të mirën e qytetarëve të saj dhe për të mirën e Republikës së Kosovës. Mirëpo, ne kemi filluar të shohim se kjo disi po keqpërdoret nga ana e Qeverisë. Ne, LDK-ja nuk është përgjegjëse për nxjerrjen nga binarët e marrëveshjes së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe si të tillë, nuk e ndajmë veten përgjegjës do të thotë për të kontribuar në kthimin e asaj marrëveshjeje, edhe pse ne dëshirojmë shumë të kthehemi në gjendjen kontraktuale, që ishim dy vite më parë.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka analizuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe me keqardhje themi se nuk jemi në përkrahje të këtij projektligji dhe rrjedhimisht nuk mund të përkrahim edhe futjen e tij në rend të ditës, për arsye se me këtë ligj kapitali i OJQ-ve, institucioneve mikrofinanciare, shndërrohet në kapital privat, shoqëri aksionare. Ne sa herë e kemi bërë pyetjen, pyetjen e bëri edhe deputeti Arben Gashi se, nëse mikrofinancat shndërrohen në shoqëri aksionare, kush janë personat? Ne duam emrat, iksi, ipsiloni, zeti, kush janë aksionarët? Sepse, shoqëria aksionare ka individë, të cilët mbajnë aksionet, neve na intereson se kush janë këta individë, të cilët do të bëhen pronarë të një kapitali, që vjen nga donatorët dhe vjen nga djersa e qytetarëve, që kanë paguar kredi, mos të themi më mirë fajde, sepse kanë paguar kamata prej 24% deri në 40%, ku është arritur domethënë akumulimi i një kapitali prej rreth 140.000.000? Këtë pyetje e kemi shtruar disa herë- Kush janë aksionarët?

Ne e kemi marrë edhe një reagim nga asociacioni i organizatave joqeveritare në Kosovë, që janë rreth 6.000. Edhe ato i bëjnë thirrje Kuvendit të Kosovës, që të mos kalohet një ligj i tillë, sepse ky ligj po krijon një precedent të keq, sepse, mandej shumë organizata joqeveritare do të kërkojnë të kthehen në kompani private ose shoqëri aksionare.

Do të thotë, ne përkrahim pjesën e bankave, siç tha edhe Arbeni, mirëpo ne kërkojmë që të jetë, do të thotë, mikrofinancat të trajtohen me një ligj, por të ketë një ligj të veçantë për mikrofinancat, e jo të futen mikrofinancat të kontrabandohen në Ligjin për bankat. Rrjedhimisht ne do të thotë jemi kundër kësaj edhe hyrjes në rend të ditës, mirëpo edhe nëse hyn në rend të ditës, ne do të votojmë kundër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Vetëvendosjes, kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky ligj për bankat i cili është sjell tash ose po tenton të futet tash në seancë për t'u kaluar në lexim të dytë, siç u përmend disa herë këtu, domethënë, është ligj i cili është në kundërshtim edhe me ligjet pozitive në Kosovë dhe është në kundërshtim edhe me parimet ndërkombëtare, në bazë të të cilave funksionojnë këto institucione mikrofinanciare, të cilat në Kosovë janë të themeluara sikur organizata joqeveritare, të bazuara në parimin e jo për përfitim, që quhet "not for profit" ministër, në anglisht, meqenëse i paske pas aty ndërkombëtarët, ndoshta ta kanë shpjeguar çka është.

Ligji për lirinë e asociimit, i kaluar nga ky Kuvend në vitin 2010, pra është ligji i cili e ndalon në mënyrë kategorike shndërrimin e këtyre OJQ-ve në shoqëri aksionare, pra të bazuara në kapital privat. Dhe, ky ligj edhe atëherë edhe në vitin 2010, ka pasur një lloj tendence, që këtu të futet edhe klauzola, që ua lejon këtyre institucioneve mikrofinanciare, që të shndërrohen në shoqëri aksionare edhe atëherë, por edhe atëherë është ndaluar dhe ligji, që ka kaluar në Kuvend e ndalon këtë çështje dhe, tash po kërkohet që kjo gjë të bëhet përmes Ligjit për banka.

U përmend këtu, është përmendur disa herë edhe nga ministri, që ky ligj na kërkohet nga FMN-ja. Unë nuk po e kuptoj, së pari këtë urgjencë. Domethënë, së pari ligji nuk i ka

kaluar të gjitha procedurat, duhet ta themi këtë qartë. Në Komisionin për Legjislacion, ky ligj nuk ka shkuar fare dhe kjo është një shkelje e procedurës së Kuvendit.

Pra, në asnjë mënyrë ne nuk bën t'ia lejojmë askujt që të kërkojë nga ne që t'i shkelim procedurat dhe t'i shkelim interesat e vendit, vetëm e vetëm pse ata po na e kushtëzojnë me një marrëveshje tjetër.

Çështja tjetër është se, nëse kjo është kërkesë e FMN-së, atëherë duhet të thuhet cila pjesë është kërkesë e FMN-së, pra çka po kërkon FMN-ja, a po kërkon tërë ligjin në tërësi, apo po e kërkon, është e interesuar vetëm për një pjesë të ligjit?

Dhe çështja tjetër, që është edhe më e rëndësishme është se, nëse është vetëm për pjesën që i rregullon bankat, nuk është se Kosova nuk ka ligj për bankat, por nuk është çështja edhe aq urgjente. Ne e kemi ligjin për banka. Sektori bankar është i rregulluar në Kosovë. Me këtë ligj synohet që ajo të përmirësohet dhe në disa fusha edhe përmirësohet, në disa jo edhe aq siç do të kishte qenë e duhur, mirëpo nuk është se sektori bankar, pa kalimin e këtij ligji sot, do të jetë një sektor, i cili do të jetë jashtë ligjit dhe i parregulluar.

Dhe, çështja, janë disa parime, që i përmend aty që, shkelen me këtë ligj, kur është puna te institucionet mikrofinanciare, pra që janë parime edhe të ligjeve pozitive në Kosovë, veçanërisht të Ligjit për lirinë e asociimit, por edhe parime ndërkombëtare karshi këtyre çështjeve.

Pra, çështja e parë që dua ta përmend këtu, është ajo që u përmend disa herë këtu, pra kush do të jenë pronarët, kush do të jenë aksionarët e këtyre portofolëve të them ashtu, të milionave, të cilat i kanë këto institucione mikrofinanciare, për shkak se ligji e parasheh, ky ligji ose projektligji, të cilin po kërkohet të futet këtu, e parasheh që donacioni fillestar t'u kthehet domethënë, donatorëve?

Mirëpo, këtu nuk po flasim vetëm për donacionet fillestare. Këto institucione mikrofinanciare, pjesën më të madhe të fondeve që e kanë aktualisht në menaxhim, në fakt nuk është donacioni fillestar, mirëpo është portofoli apo përfitimet, që ato i kanë bërë përgjatë viteve sa kanë funksionuar si institucione mikrofinanciare, duke dhënë kredi me kamata dhe duke i kursyer pastaj këto kamata dhe duke i shndërruar ato në kapital. Tash, çka ndodhë me këto? Domethënë, unë nuk e dëgjova ministrin të na tregoj se çfarë ndodh me këto para, të cilat konsiderohen të jenë para të këtyre OJQ-ve. Në rekomandimin e Këshillit të Evropës, të nxjerr në vitin 2007, pra CM/REC 2007 14, i Komitetit të ministrave të vendeve anëtare mbi statusin ligjor të organizatave jo qeveritare në Evropë, pra neni 9 thotë kështu: “Ndalon shpërndarjen e të ardhurave neto ose fitimeve për ndonjë person, si dhe përdorimin e pasurive, të ardhurave dhe fitimeve të një OJQ-je për të sjell drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat, që kryejnë punë për organizatën”.

Pra, tash me këtë ligj, me shndërrimin e këtyre institucioneve mikrofinanciare ose OJQ-ve në shoqëri aksionare, atëherë, ata që do t'i përfitojnë këto aksione do ta shkelin,

domethënë këtë parim, i cili është parim ndërkombëtar që përdoret në këto raste, veçanërisht në Evropë.

Çështja tjetër është se OJQ-të nuk mund ta ndryshojnë veprimtarinë përmes transformimit, pra kjo po ashtu me parimet ndërkombëtare dhe evropiane është e ndaluar. Ato mund të shuhën si OJQ, por jo që të transformohen në diçka tjetër, ndërsa, këtu me ligjin që po propozohet nga ministri dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa kërkohet, që këto institucione mikrofinanciare të transformohen në banka, në shoqëri aksionare, gjë që është shkelje e këtij parimi.

Dhe, çështja tjetër që dua ta ngris këtu, pra është shkelja e Ligjit për asociimin, i cili në mënyrë të qartë e tregon, domethënë edhe e sanksionon mënyrën se si mund të shuhën OJQ-të dhe çfarë ndodh me kapitalin që ato mund ta kenë? Ndërkohë që, me këtë ligj edhe atëherë kjo Qeveri ka tentuar që ta kontrabandojë këtë pjesën për eksproprijim të kapitalit të OJQ-ve në duar private, por atëherë ka dështuar, tash po e risynon këtë çështje.

Pra, do të them qartë edhe ministri, besoj që do të na e thotë nëse e merr fjalën prapë, që nuk është kërkesë e FMN-së që të kalohet ky ligj me këto parime ose me këto nene për institucionet mikrofinanciare dhe si e tillë vetëm po kamuflohet.

Pra, një kërkesë e FMN-së, e cila mund të jetë për përmirësimin e Ligjit për bankat, pastaj po transferohet duke e futur aty edhe një çështje tjetër, e cila e dëmton rënd, do të kisha me thënë interesin e shtetit të Kosovës edhe qytetarëve të Kosovës, duke u krijuar mundësi pasurimi disa individëve, të cilët edhe ashtu deri tash kanë marrë shumë para duke punuar në këto organizata dhe siç u përmend, domethënë, këto organizata deri tash nuk kanë paguar tatim, domethënë, nuk i kanë kontribuar interesit të shtetit të Kosovës pikërisht, duke u thirrur në atë që janë organizata ose institucione jo për përfitim. Dhe tash, e tërë ky evazion fiskal, kisha me thënë, do të shndërrohet në kapital privat dhe do të shndërrohet në një lloj krimi ndaj shtetit, po edhe ndaj qytetarëve.

Institucionet mikrofinanciare, zakonisht hapen edhe financohen në ato vende, ku ka varfëri të madhe, qëllimi i tyre është për ta ndihmuar zbutjen e varfërisë. Institucionet mikrofinanciare të Kosovës, jo që nuk e kanë bërë një gjë të tillë, po tash në fakt po na dalin edhe si banka, të cilat do ta rrisin mundësinë e eksploatimit të parave të qytetarëve të Kosovës për përfitime personale të disa njerëzve, për të cilët ne as nuk e dimë ku janë.

Prandaj, Lëvizja Vetëvendosje konsideron që edhe nuk duhet të futet ky ligj në këtë formë në seancë, por edhe nëse futet ne do ta votojmë “kundër”.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo bash profitabile s’paskan qenë, po ne jse. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, kryetari i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Për ta qartësuar pozicionin, shumë shpjegime u dhanë, po duhet të themi kështu, ne nuk jemi kundër që marrëdhëniet e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar të kalojnë në

nivel më të lartë dhe mbështesim një gjë të tillë. Ne po ashtu, nuk jemi kundër që të rregullohen mikrofinancat në Kosovë. Ne mendojmë, se po ashtu duhet të vendoset rend edhe në këtë fushë. E dimë se si ka ndodhur deri më tani, e dimë se mjetet e akumuluar janë akumuluar në mënyrë të bërjes së bizneseve, edhe pse këto institucione kanë qenë të një natyre tjetër.

Por, sidoqoftë mendojmë se ka qenë dashur që këto çështje të jenë të ndara, mendojmë se pjesa e cila merret me rregullimin e mikrofinancave, që po them edhe njëherë, është çështje e cila duhet të rregullohet, ndërhyt edhe në status ligjor dhe në vetë mënyrën e themelimit të institucioneve mikrofinanciare dhe një ndërhyrje e tillë bie ndesh me ligjet tjera, të cilat i ka kaluar Kuvendi i Kosovës, u përmend këtu njëri prej tyre, Ligji për lirinë e asociimit.

Ne mendojmë se Qeveria e Kosovës ka mundur që ndryshe t'i qaset këtij problemi, mendojmë se ndoshta qëllimi kryesor, në këtë rast edhe pse shihet që është qëllim vendosja e rregullit në sistemin mikrofinanciar, është edhe akumulimi i disa mjeteve, për çka fola pak më herët. Sidoqoftë, ne mendojmë se nuk duhet të futet kështu në rend të ditës dhe Kuvendi le të deklarohej dhe le të dalë se çka po na del prej krejt kësaj pune.

Ardhja ndesh e këtij ligji me ligjet tjera, do të na përcjell edhe në ligjet tjera, të cilat do t'i votojmë sot në Kuvendin e Kosovës. Edhe ky ligj, sikur shumë ligje që po na vijnë, e vërteton se Kuvendi i Kosovës, po ballafaqohet me projekte të cilat vijnë prej Qeverisë e të cilat nuk mund të harmonizohen as 6 muaj paraprakisht. Do të thotë, nuk mund të parashohin, janë të paafte për të paraparë 6 muaj përpara e lëre më vite ose diçka tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejdene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar, shëfja e Grupit Parlamentar!

Përshëndetje për Kabinetin Qeveritar dhe të gjithë deputetët.

Koalicioni për Kosovën e Re, përkrah Projektligjin për bankat dhe mikrofinancat.

Kuptoj hezitimin e disa deputetëve lidhur me organizatat mikrofinanciare si OJQ, por ne konsiderojmë se pikërisht me këtë ligj rregullohet kjo çështje.

Ato futen në mbikëqyrjen e BQK-së, ato mund të korporatizohen dhe menaxhohen sipas parimeve të caktuara, duke paguar obligimet e mbetura të tatimeve dhe vazhdojnë të paguajnë tatimin.

Ato mund të marrin pjesë në themelimin të bankave, por jo më shumë se 25%, prandaj ato nuk mund të shndërrohen thjesht në banka dhe duke iu nënshtruar kriterëve të barabarta. Nuk janë OJQ të thjeshta, por janë OJQ që kanë implikime financiare dhe duhet të futen brenda sistemit financiar dhe mbikëqyrjes nga BQK-ja.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah që ky projektligj të hyjë në rend të ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, a e do dikush fjalën? E ka fjalën deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani članovi Vlade,

Uvežene kolege poslanici,

Na osnovu datog obrazloženja od strane Vlade i od strane predsednice komisije, poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke, podržava ovaj predlog da se Zakon o bankama uvrsti u današnjem dnevnom redu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kryetari i grupit Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” pas arsyetimit të nevojshëm dhe sqarimit, i cili u dha nga kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ministri dhe duke pasur parasysh peshën dhe rëndësinë e këtij projektligji në raport me institucionet dhe mekanizmat ndërkombëtar, Grupi Parlamentar “6+” e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme, që këtë projektligj ta fut në këtë rend dite, në këtë seancë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër edhe njëherë e ke fjalën për të sqaruar, pastaj hyjmë e votojmë për këtë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë deputetët për kontributin e tyre, mirëpo ta kemi shumë të qartë, unë e vlerësoj edhe mendimin e secilit deputet dhe secilit grup parlamentar, po në këtë rast Grupi Parlamentar i LDK-së, ka marrë pjesë aktivisht, për çka e falënderoj për punën dhe angazhimin e tij gjatë punës rreth këtij ligji në mes dy leximeve, leximit të parë dhe tash që po diskutojmë. I kanë votuar të gjitha amendamentet, kanë votuar që ky ligj t’i rekomandohet Kuvendit për aprovim. E shoh një ndryshim, ekzistojnë procesverbalet, domethënë, kanë votuar për të gjitha amendamentet për këtë ligj.

Qëllimi është që, a po duam të bëjmë rregull apo duam për të vazhduar me parregullsi? Ne nuk po ndërhyjmë në punën e organizatave joqeveritare, ne po dëshirojmë të vendosim standarde, të vendosim rregull për të gjitha subjektet. A janë, në këtë rast OJQ, a janë në këtë rast shoqëri aksionare apo çka të duan, që merren me çështje bankare dhe financiare, të jetë një standard, të jetë një rregull?

Janë të rregulluara edhe procedurat e likuidimit, janë të rregulluara të gjitha çështjet, mirëpo ne duhet të kemi kujdes edhe për shpëlarjen e parave që krijohen mundësi për të ndodhur në mungesë të rregullit dhe standardeve.

Prandaj, edhe njëherë ju kisha falënderuar shumë për kontributin dhe ju kisha lutur që ky ligj të futet në agjendë dhe të aprovet. Është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar

Ndërkombëtar, është pjesë e punës së përbashkët të Thesarit Amerikan, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Komisionit Evropian, të gjithë deputetëve të Kuvendit, EULEX-i ka dhënë kontributin e vet, kanë pasur mundësi edhe OJQ-të kanë qenë në diskutim publik. Prandaj, konsideroj që i ka plotësuar të gjitha kushtet, që të futet në seancë dhe të votohet. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Nuk ka! Realisht, janë kryer debatet! Në emër të Grupit e ka pasur Hykmetja fjalën, Ismet!

(Ndërhyrje)

Në emër të Grupit, ne e dimë. Ismet, unë ty po ta jap fjalën, veç ne emër të Grupit e keni harxhuar. Urdhëro, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që jeni njeri që e respektoni, megjithatë Rregulloren e Kuvendit. Kur të përmendet LDK-ja dhe Grupi Parlamentar, në këtë rast nga ministri, është e drejtë jona ta themi shkurt atë, në këtë rast që s'është e vërtetë çka e tha ai.

Qëndrimet e Grupit Parlamentar i paraqesim ne. Mbledhjet në komision janë mbledhje të Komisionit dhe nuk është e vërtetë, që ka qenë unike ose qëndrim i krejt komisionit. Sidoqoftë, nuk është mirë me na interpretua qëndrimet e Grupit në këtë rast, sepse sikur bie ndesh me atë që është thënë në komision.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar u tha nga deputetja Bajrami, prandaj nuk është mirë, sepse ky është një, për mendimin tonë, është një spekulim, pastaj. Ajo që e ka grupi parlamentar, e kemi thënë qartë, si punohet në Komision, kontributin, ne jemi deputetë, sigurisht që e japim, por kjo nuk do të thotë që finalisht mund të përkrahim diçka, që për mendimin tonë nuk është për ta përkrahur. Dhe, kjo është e tëra.

KRYETARI: Urdhëro ministër, shkurt!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e vlerësova mendimin dhe kontributin e secilit grup parlamentar. Është e drejtë e secilit grup parlamentar, e secilit deputet ta ketë qëndrimin e vet. Grupi parlamentar e shpreh mendimin e vet këtu në seancë, ndërsa fola për pjesën e punës të anëtarëve të Komisionit nga radhët e LDK-së në punën e këtij Komisioni, në mes të dy Kuvendeve. Unë kam qenë pjesë, anëtarët e Komisionit i falënderoj shumë për punën e tyre, për kontributin e tyre, që kanë kontribuar me propozimet e tyre, me amendamentimet, në përmirësimin e cilësisë së këtij dokumenti dhe pjesa e madhe e amendamenteve kanë qenë me votim unanim. Në disa amendamente ka pasur votë të ndarë, përfaqësuesja e Vetëvendosjes, në disa numër i vogël, edhe përfaqësuesja e LDK-së, por në fund ligji, me

të gjitha amendamentet është votuar me shumicën e votave duke i përfshirë edhe anëtarët e partive tjera. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Hykmete Bajrami , replikë, por shkurt, dy minuta.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit shumë, kryetar!

Ministri, në vend se të përgjigjet në pyetjen se kush do të jenë aksionarët, e pyeta edhe unë, si përfaqësuese e Grupit Parlamentar të LDK-së, e pyeti edhe deputeti Visar Ymeri, si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes: kush do të jenë aksionarët? E, ky merret me votat dhe format e votimit në Komision!

Kjo nuk është absolutisht e drejtë. Nëse do me i ditë votat, kur është votuar ligji në përfundim, në komision, Sali Asllani, i cili ka qenë anëtar i Grupit punues, ka votuar kundër, Hykmete Bajrami ka abstenuar. E, Naseri nuk është këtu, e thotë votën e vet, e bën publike.

Po, nëse i keni ndërruar procesverbalet, ajo është diçka tjetër, për këtë ne kemi dëshmi. Nuk ke nevojë me u marrë diçka tjetër, përgjigju në pyetjen kryesore: kush do të jenë aksionarët e organizatave joqeveritare? Pasi ato të shndërrohen në institucione bankare, kush do të jenë aksionarët?

Kjo është pyetja, ky është thelbi i diskutimit, kjo është arsyeja pse ne po refuzojmë me e fut në rend të ditës dhe me e votua këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Prezentë janë 86 deputetë. Regjia le të përgatitet për votim! Votojmë për futjen në rend të ditës Projektligjin bankat institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Kështu është titulli i ligjit. Votojmë tash:

Atëherë, me 44 vota “për”, 31 “kundër”, 5 abstenime...

(Ndërhyrje)

Atëherë 32 janë “kundër”, 44 “për” dhe 5 abstenime.

Pra 45 “Për”, 32 “kundër”, 5 abstenime. Do të thotë, kalon.

Unë kërkoj nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, që le ta shqyrtojë dhe nëse kanë ndonjë amendamentim, e kanë të drejtën me amendamentua gjatë kohës, derisa të vijë deri te rendi i ditës. Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti, për ndryshim të rendit të ditës, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në pikën e 12-të, sot është prapë shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Meqenëse, në Komisionin Funkcional nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme ky propozim dhe meqenëse edhe në seancën e kaluar nuk ka arritur të realizohet kjo pikë e rendit të ditës, unë kërkoj që të hiqet fare sot nga rendi i ditës. Të kërkojmë informacione shitesë nga Qeveria dhe të shohim, nëse mund të kthehet mbrapa nga Qeveria, apo të qitet në ndonjë seancë tjetër, pasi të jemi me informacione të plota. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: A shkojmë drejt procedurës të votimit?

Lus regjinë të përgatitet për votim dhe kush është për kërkesën e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik? Votojmë tash.

Prezentë 84 deputetë, kanë votuar “për” 58, 9 “kundër”, 3 abstenime, hiqet nga rendi i ditës.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Arsim, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Po ashtu, kërkesa ime në emër të kryetarit të komisionit funksional është që të hiqet nga rendi i ditës pika 11, përkatësisht **Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.**

Këtë unë e arsyetoj këtë me faktin se edhe ky propozim-vendim nuk e ka pas përkrahjen e komisionit funksional dhe për këtë arsye kërkojmë që të shtyhet për një herë tjetër. Këtë e kemi bërë edhe në konsultim me ministrin e Arsimit, e po ashtu edhe Grupi Parlamentar i PDK-së është i pajtimt që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nëse jeni dakord edhe me këtë, shkojmë drejtpërdrejt në votim, pa debat?

Prezentë janë 79 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatitet për votim dhe votojmë kërkesën e kryetarit të Grupit për Arsim.

Atëherë, konstatoj se me 59 për, 9 kundër dhe 6 abstenime, kërkesa e deputetit Vehapi hiqet nga rendi i ditës. Vazhdojmë tutje:

2. Koha për pyetje parlamentare.

Urdhëro! Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Kërkoj ndjesë, por unë e di që u krye votimi.

Mirëpo, kryetari i Komisionit është dashur me e thënë se kjo i kthehet Qeverisë, sepse rekomandimi i komisionit është me ia kthye Qeverisë.

Nuk është njësoj me u shty, dhe me iu kthye Qeverisë. Se shtyrja, zoti kryetar, i bie - i bien të njëjtit. Prandaj, nëse ka qenë mendimi t'i kthehet Qeverisë, zotri kryetar i Komisionit, është diçka tjetër.

(Ndërhyrje)

E di që e votuam, por veç për sqarim. Sepse nëse i kthehet, e veç shtyhet, kjo i nënkupton të njëjtit njerëz, vjen përsëri! Kjo është!

Më fal që e mora fjalën pas koh, por nuk pata mundësi ta marr fjalën. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ti ke të drejtë, por ajo u votua. E ai a kërkoi me u shty a me ia kthye?

(Ndërhyrje)

Deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën! Çka kërkove Idriz, le ta kemi të qartë?

IDRIZ VEHAPI: Unë e kërkova që kjo pikë të shtyhet, dhe pas konsultimeve që i kemi bërë me ministrin e Arsimit, kjo listë ka mundësi edhe të ndryshohet.

(Polemikë)

KRYETARI: A po e lëmë kështu? Nëse komisioni ka kërkuar me ia kthye Qeverisë, na po ia kthejmë Qeverisë. Pastaj, vjen propozimi i ri dhe e votojmë propozimin e ri.

Atëherë, do të thotë se e votuam propozimin e Komisionit.

Vazhdojmë tutje. Ishim në pikën: **Koha për pyetje parlamentare.**

Deputetja Afërdita Berisha – Shaqiri, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete e ke fjalën!

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë.

Në Shkollën e mesme teknike në Suharekë ekziston një numër i madh i nxënësve me një hapësirë shkolle të pamjaftueshme.

Numri i nxënësve nëpër klasa arrin deri në 50. Shkolla teknike punon me orar rrëshqitës dhe i ka dhjetë klasë lëvizëse.

Sipas informatave jo zyrtare, Ministria e Arsimit ka mbetur pa e realizuar pagesën e ndërmarrjes që e ka fituar tenderin në vitin 2010 për ndërtimin e shkollës profesionale në Suharekë, për diku rreth 800.000 euro, apo më tepër, dhe puna është duke u zvarritur.

Në vitin shkollor 2012/2013 shkolla e mesme teknike “Skënder Luarasi” nuk ka hapësirë shkollore për të pranuar asnjë nxënës në klasën e dhjetë. Hapësira shkollore e Shkollës së mesme teknike është vetëm për 1.200 nxënës, ndërsa në këtë vit ajo i ka 1.933.

Si maturantë në këtë vit largohen vetëm 89 nxënës. Përsëri numri i nxënësve mbetet i madh dhe mbeten pa u regjistruar në klasën e dhjetë një numër i madh i tyre. I nderuar ministër i Arsimit, zotëri Ramë Buja,

Cilat janë informatat e sakta lidhur me përfundimin e këtij projekti?

Cilat janë arsyet për moskryerjen e pagesës në kohë të tenderit në fjalë që është dhënë për ndërtimin e shkollës profesionale në Suharekë në vitin 2010?

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zotni Sabri Hamiti)

KRYESUESI: Urdhëro, ministër Buja!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuari, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Deputete e nderuar dhe e respektuar Afërditë,

Faleminderit shumë për pyetjen e bërë.

Ndërtimi i Shkollës së mesme në Suharekë ishte prioritet i MASHT-it dhe vazhdon të jetë i tillë.

Ndërtimi i kësaj shkolle të re të mesme në Suharekë është me sipërfaqe prej 6.000 m² dhe me etazhitet prej P+2, me sallë të sportit 20 dhoma dhe 9 kabinete e laboratorë, si dhe bibliotekë, është filluar me lidhjen e kontratës me Kompaninë ndërtimore “Bajramaj” me datën 30.9.2009 dhe me vlerë financiare prej 2.082.529 euro.

Realizimi i projektit është në vazhdimësi, çka shihet edhe në buxhetet sipas viteve të aprovuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në 2009 kanë qenë 312.000 euro, në 2010 - 274.000, në 2011 - 439.166, kurse për vitin 2012 vlera e buxhetit për këtë projekt është 480.00 euro. Dhe, kjo procedurë e bartjes së mjeteve, me sa kam njohuri është bartur dhe nuk ka asnjë pengesë procedurale për këtë gjë.

Andaj, ky është informacioni që ju sjell dhe mund t’ju jap dhe në formë të shkruar dhe të saktësuar.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete Berisha – Shaqiri, a ke pyetje shtesë? Deputetja e merr fjalën!

AFRËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar ministër!

Faleminderit për informacionin. Mua dhe qytetarëve na intereson se cilat janë mundësitë për përfundimin e ndërtimit të kësaj shkolle, në mënyrë që në vitin shkollor që vjen 2012/2013 të ketë hapësirë të mjaftueshme për regjistrimin e gjeneratave të reja.

KRYESUESI: Ministri, Buja!

MINISTRI RAMË BUJA: Ne e nderuara deputete, po bëjmë përpjekje që vërtetë ta përfundojmë që me 1 shtator të jetë ky vit që do fillojë procesi mësimor. Megjithatë, ne jemi shumë skeptikë për shkak të mjeteve, sepse nuk janë të përplotësuara gjitha mjetet në bazë të këtyre 480.000, që është thënë në fund. Domethënë, nuk janë të gjitha mjetet e realizuara për këtë vit dhe në buxhetin e këtij viti nuk është gjithçka e realizuar dhe unë besoj që kjo mund të na difektojë. Përndryshe, synimi është që ta realizojmë.

KRYESUESI: Faleminderit, zotni ministër Buja!

Deputetja Donika Kadaç – Bujupi pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari – Lila. Nuk shoh se është deputetja këtu. Zëvendësministrja është këtu, le të lihet për tjetër herë.

Deputeti Agim Kuleta, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Unë nuk e shoh këtu kryeministrin! Deputet a doni ta bëni pyetjen? Nuk do, ta bëjë pyetjen!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Zonja deputete Kadrijaj, e ke fjalën!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, në Planin legjislativ të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011 dhe tash 2012, ka qenë në agjendë pakoja e ligjeve për miratim, Ligji i shëndetësisë dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore.

Ku kanë mbetur këto ligje dhe kur priten të vijnë në Kuvend për amendamentim dhe miratim?

KRYESUESI: Ministri Agani!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ligji i shëndetësisë dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, në të vërtetë – projektligjet, janë në një procedurë të vazhdueshme të konsultimeve që nga dorëzimi i tyre në Qeverinë e Kosovës, në muajin shtator të vitit të kaluar.

Konsultimet janë duke u zhvilluar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore. Mund të flasim për konsultimet e përmastave ditore dhe deri më tani kemi arritur që ta harmonizojmë pjesën më të madhe të të dy dokumenteve ligjore që paraqesin themelin e reformës së sistemit shëndetësor në vend.

Sipas, informatave të fundit, të kësaj jave, ka gjasa shumë reale që ne Projektligjin e shëndetësisë ta miratojnë në Qeverinë e Kosovës në mes të prillit dhe ta procedojnë për Parlament.

Miratimi i Projektligjit për sigurime shëndetësore, do të bëhet pas konsolidimit të procesit të përgatitjeve brenda Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht përpilimit të pakos themelore të kujdesit shëndetësor, çmimoreve të shërbimeve shëndetësore, të cilat janë të kërkuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore para se ky projektligj të miratohet në Qeveri.

Sipas dinamikës së parashikuar të punëve në Ministrinë e Shëndetësisë, ka gjasa reale që Projektligji i sigurimeve shëndetësore të miratohet në Qeveri në fillim të muajit shtator.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputete Kadrijaj a ke pyetje shtesë? E merr fjalën, deputetja!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

A ekziston mundësia, meqenëse deri tash është proklamuar se këto dy ligje do të vijnë si pako të ligjeve reformatore, të quajtura nga ju për shëndetësi, a ekziston rreziku meqenëse tash ndahet Ligji i shëndetësisë që Ligji i sigurimeve shëndetësore të prolongohet e ndoshta të mos vijë fare në Kuvend për miratim dhe amendamentim?

KRYESUESI: Ministri Agani!

MINISTRI FERID AGANI: Besoj se pajtoheni se këto dy projektligje nuk quhen më vetëm nga unë si ligje reformatore por ekziston një konsensus i përgjithshëm se bëhet fjalë për ligje kualitative dhe janë të vlerësuara si të tilla, dhe nga faktorët vendorë, dhe ndërkombëtarë.

Mundësitë që kjo të ndodh ajo që e parashikuat, janë minimale, në radhë të parë duke pasur parasysh Deklaratën e qëllimit, e cila është dakorduar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Delegacionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, gjatë vizitës tyre të fundit dhe e cila do të miratohet në mbledhjen e parë të Bordit të FMN-së në prill, k në mënyrë shumë të qartë theksohet se Qeveria e Kosovës ka për synim themelimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, si një mënyrë për përmirësimin e sistemit të financimit të shëndetësisë kosovare dhe si një mënyrë e cila do të ndihmojë në decentralizimin e financimit të institucioneve shëndetësore.

Prandaj, prezenca e fondit të sigurimeve shëndetësore në këtë dokument tejet me rëndësi, garanton që sipas dinamikës së përcaktuar kohore, në momentin që do t'i kemi të zhvilluara të gjitha kapacitetet e nevojshme për zbatimin e fondit të sigurimeve shëndetësore do të bëhet edhe miratimi i Projektligjit të sigurimeve shëndetësore, që në pjesën më të madhe është i dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Blerta Deliu – Kodra ka pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri s'është këtu! A do ta bëni pyetjen? Urdhëro, Deputete Deliu – Kodra!

BLERTA DELIU – KODRA: Faleminderit, kryesues!

Pasi që ministri nuk ndodhet këtu, do ta tërheq pyetjen për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Valbona Dibra ka pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputetja Valbone Dibra!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dihet se 21 marsi është Dita Botërore e Sindromit Daun dhe kjo ditë fatmirësisht po shënohet edhe në Kosovë.

Statistikat tregojnë që pas luftës së fundit në Kosovë numri i lindjeve me këtë sindrom është trefishuar në krahasim me periudhën e para luftës.

Shtatzënat e rrezikuara për të lindur fëmijën me sindromin daun, në mungesë të një laborator për diagnostifikim prenatal janë të detyruara të paguajnë rreth 400 euro për një analizë, të cilën duhet ta bëjnë jashtë Kosovës.

Duke pas parasysh që laborator i tillë nuk kushton më tepër se 150.000 euro, zoti ministër Agani, pyetja ime është se:

- A ka kapacitete Ministria e Shëndetësisë, që në një të ardhme të afërt të pajiset me një laborator diagnostifikues prenatal, i cili do të ndikonte në zvogëlimin e lindjeve me sindrom daun në Kosovë dhe do t'iu lehtësonte shtatzënave barrën e pagesës për diagnostifikim prenatal? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Agani e ka fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara zonja deputete,

Laboratori i diagnostikës perinatale është fakt se paraqet një domosdoshmëri të një sistemi të avancuar shëndetësor. Ky laborator është i parashikuar me Strategjinë e Ministrisë së Shëndetësisë për shëndetin e nënës dhe fëmijëve.

Arsyeja pse ky laborator nuk është në funksion deri më tani, ekskluzivisht ka të bëjë dhe në radhë të parë me mungesën e mjeteve të nevojshëm financiare për këtë qëllim.

Atë që Ministria e Shëndetësisë është duke u përpjekur ta bëjë, është se këtë laborator në mesin e disa projekteve tjera urgjente, ta parashih në kornizën afatmesme të shpenzimeve të vendit mu këto ditë, në mënyrë që të jemi në gjendje ta financojmë dhe njëkohësisht jemi edhe në kontakte të drejtpërdrejta me disa institucione shtetërore të shtetit të Ajavës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kemi pasur rastin të realizojmë një vizitë studiu dhe në bashkëpunim me ta të provojmë nëpërmjet donatorëve dhe komunitetit të donatorëve që ta sjellim këtë laborator në Kosovë dhe ta vëmë në funksion.

KRYESUESI: Deputete, a e do fjalën? Jo, nuk do! Faleminderit!

Deputetja Ganimete Musliu, ka pyetje për ministrin Ramë Buja. Fjalën e merr deputetja Musliu! S'është këtu? Atëherë, themi se s'është këtu.

Deputetja Time Kadrijaj, ka pyetje për ministrin Nenad Rashić. Deputetja Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Amendamentimi i Ligjit të punës dhe zgjatja e pushimit të lehonisë 6+3+3, është pritur me entuziazëm nga gratë e Kosovës.

Derisa në institucionet publike ky nen po respektohet, në sektorin privat ka lajme shqetësuese se gratë jo që po e marrin pushimin e lehonisë, por në shumë raste, po largohen nga puna. Pyetja, është:

- Sa po inspektohet nga Inspektorati i punës kjo çështje dhe a keni paraparë masa mbrojtëse për nënat lehona, që të mos largohen nga puna?

KRYESUESI: Ministri Rashić!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo,

Narodni poslanici,

Poštovana gospođo Kadrijaj,

I na onom jučerašnjem sastanku kad ste bili vi kao grupa kod nas, mislim da sam i tada rekao u vezi ovih detalja, ali ponoviću još jednom statistike, koje kažu koliko smo puta mi dosad imali inspekcija i pogotovo statistike što se tiče zaštita trudnica, odnosno materničkog odsustva.

Od svih inspektovanih kontrola, obavljene su 4.273 redovnih, 1.204 ponovnih kontrola, odnosno to je u jednom delu kad se prvi put obavi kontrola pa se na dopunu dolazi drugi put, čisto da se utvrdi da li su ti nedostaci otklonjeni.

Zatim 308 inspekcija po zahtevu stranaka određenih, 611 zajedničkih kontrola sa ostalim nadzornim institucijama, od toga su pre svega Policija Kosova, Poreska administracija i ostali inspektorijati.

Što se tiče samih ovih porodilja, odnosno pitanja koje ste vi sami postavili, zaštitne mere za majke i porodilje i njihova prava su utvrđena Zakonom o radu. To je broj 03/Z-211 i sa administrativnim uputstvom o regulisanju i uređivanju procedura finansijskih isplata za porodiljski odmor prema članu broj 49. i Zakona o radu o sistematizovanju teških i rizičnih poslova, koja oštećuju zdravlje žena i dojlja i nadzor sprovođenja ovih odredaba, redovno se monitoriše u Inspektorijatu za rad.

Tokom 2011. godine Inspektorat za rad prilikom izvršenja kontrole pronašao je samo 4 sporna kršenja ili 4 sporna dela, koja su bila na štetu žena koje su bile na trudničkom bolovanju.

Znači u tih 4 slučajeva, koji su se nama desili, mi smo preduzeli adekvatne mere i po tim adekvatnim merama je bilo i postupljeno i samim tim nedostaci su bili uklonjeni, tako da konkretan odgovor na vaše pitanje je da: u toku 2011.godine bilo svega 4 slučajeva prijavljenih i analiziranih. I delovajući na njima, došlo je do otklanjanja nepravilnosti i sad je sa tim slučajevima sve u redu, odnosno oni su dobili nadoknadu za to što im zakonom pripada. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete Kadrijaj a e do fjalën? Po!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministër! Ligji është ligj dhe ai duhet të respektohet, por edhe të gjejë zbatueshmëri në të gjithë sektorët, qofshin ata publikë apo privatë, në të gjithë territorin e Kosovës, nëse kjo është një shkelje e të drejtave dhe të nënave dhe fëmijëve.

Dhe, nëse te ju janë lajmëruar veç 4 raste, e që është bërë kjo shkelje e drejtë ligjore e tyre për me marrë pushimin e lehonisë një vit, ka raste shumë në sektorin privat për shkak se ato nuk guxojnë të lajmërojnë rastet sepse iu shkelet kjo e drejtë, për shkak se e humbin edhe punën.

Mirëpo, a keni ndonjë plan - si me gjet zbatueshmëri ky nen, neni 44 i Ligjit të punës dhe të zbatohet në përpikëri? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër! Ministri e ka fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Kao što sam rekao, pored svih onih mera komunikacije, koje imamo mi kao Inspektorijat sa svim našim korisnicima, odnosno sa svim radnicima, pored sastanaka kojih imamo svakih dve nedelja sa svim sindikatima, koje bi trebali baš da nam prenesu te eventualne slučajeve, koji mogu da budu problematični i pored otvorene linije, odnosno stalnih kontakata i sa jednom dozvolom da tako kažem sa nemogućnošću da sve žene, koje smatraju da im je neko pravo uskraćeno da mogu da prijave kod nas, ja mislim da smo mi do jedne mere uradili sve što se tiče našeg posla, obezbeđivanja prisutnosti Inspektorijata i Ministarstva za rad na terenu.

E možda je to jedan deo koji bi trebali vi odnosno same žene da urade, da se u vezi svojih prava još jednom informišu i da nama prijave, ukoliko postoji bilo kakvo kršenje njihovih prava.

Još jednom kažem, mi smo koristili i koristimo i dalje sve mere, sve kontakte koji mogu da doprinesu pronalaženju više slučajeva koji mogu da budu eventualno kršenje prava žena.

Prema tome i ovom prilikom ohrabrujem sve žene, koje misle da su njihova prava ugrožena, da se jave nama. Mi ćemo da reagujemo, mi ćemo da intervenišemo za svaki slučaj koji je prijavljen kod nas, tako da su prvi ti osnovni zadaci ispunjeni. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Nazane Breca, ka pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Agani,

Më parë, asnjëherë në Kosovë nuk ka ekzistuar shërbimi i kardiokirurgjisë në kuadër të institucioneve publike.

Në vitin 2008, Ministria e Shëndetësisë e ka ndarë një shumë prej 700.000 eurove për adaptimin e një hapësire të ish repartit të ortopedisë për këtë lloj të shërbimit. Punimet kanë përfunduar në lidhje me adaptimin rregullimin e kësaj hapësire dhe tani pritej që të bëhet furnizimi me pajisjet e duhura, me material harxhues edhe të fillojë të punoj. Pyetja ime është:

- Kur pritet që të bëhet funksionalizimi? Pra, të fillojë të punojë kjo pjesë e QKUK-së?

KRYESUESI: Ministri Agani!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara zonja deputete,

Keni të drejtë plotësisht. Shërbimet kardio-kirurgjike paraqesin një nevojë të madhe të qytetarëve të vendit. Këto shërbime kemi arritur që në dy vitet e fundit t'i ofrojmë edhe në vend, dhe brenda sektorit privat të shëndetësisë. Mirëpo, një numër i madh i pacientëve ende këto shërbime i kërkojnë jashtë vendit.

Atë që ne e kemi bërë si ministri në këtë vit është që fillimisht e kemi paraparë këtë shërbim brenda organizimit juridik të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe me statutin e ri i cili do të miratohet javën që vjen është paraparë që të themelohet shërbimi kardio-kirurgjik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nën një.

Nën dy. Para dy javësh ka arritur transha e parë e donacionit të Qeverisë italiane për themelimin e shërbimit kardio-kirurgjik. Tërë donacioni ka vlerë 3.069.000 euro. Është depozituar transha e parë në vlerë prej 1.150.000 euro, me të cilat ne do t'i fillojmë aktivitetet e para në prokurimin e disa pajisjeve të nevojshme, si dhe të trajnimit të stafit për këtë qëllim.

E dyta është se në gjashtë muajt e fundit jemi në një aktivitet të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave që në kuadër të programit të huave të buta nga Qeveria austriake të sigurojmë një kredi në vlerë prej 4 milionë deri në 5 milionë euro për pajisjen e këtij shërbimi kardio-kirurgjik me sallat e nevojshme të operacionit, me njësinë e kujdesit intensiv dhe njësitë e tjera të nevojshme për funksionimin adekuat të tij.

Ky proces është një fazë mjaftë e avancuar dhe kam kënaqësinë t'ju informoj që sipas informatave të fundit projekti është miratuar nga Qeveria austriake, nga Ministria e Financave e tyre. Është në proces të konsultimeve brenda kësaj Qeverie dhe pas njoftimit zyrtar të Ministrisë tonë të Financave do të del si propozim në Kuvendin e Kosovës për tu mbështetur si hua e butë.

Me këtë konstruksion financiar, unë mendoj se ne do t'i krijojmë të gjitha parakushtet e nevojshme që shërbimi kardio-kirurgjik të funksionojë gjatë këtij viti në Qendrën Klinike Universitare. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputete a e do fjalën? Deputetja Breca fjalën, rishtas!

NAZANE BRECA: I nderuari ministër!

Ka qenë kjo, domethënë një marrëveshje në mes të Qeverisë të Italisë dhe Kosovës që t'i jepet një shumë prej 1.800.000 eurove në lidhje me këtë projekt.

Unë kam informata, që 1.800.000 euro kanë ardhur në konton e Ministrisë së Shëndetësisë për fillimin dhe realizimin e këtij projekti.

Po më intereson a keni formuar ndonjë grup punues që do të kishte një ekspert të kësaj larmie, domethënë një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ambasada Italiane në mënyrë që më shpejtë të realizohen punimet dhe sa më shpejt popullata e Kosovës ta ketë më në fund këtë shërbim në Kosovë, e mos të shkojnë jashtë, për shkak se dihet që prej vitit 2003 e deri në vitin 2010, 8.691.000 euro janë harxhuar për trajtim jashtë vendit, ku mbi 60% të këtyre mjeteve kanë shkuar për....

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI, JAKUP KRASNIQI: Ministër e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja deputete, unë e thash se vlera totale e donacionit të Qeverisë Italiane është 3.069.000 euro. Ky donacion nuk e përfshin vetëm zhvillimin e shërbimeve kardio-kirurgjike, por edhe mbështetjen e strategjisë për cilësinë e shërbimeve shëndetësore në vend, si dhe mbështetjen e disa njësive të kujdesit parësor në komunën e Pejës.

Në Ministrinë e Shëndetësisë ka arritur transha prej 1.150.000 euro. Ministria e Shëndetësisë e ka themeluar Bordin për zhvillimin e shërbimit kardio-kirurgjik para gjashtë muajsh, dhe para 2 dite që kemi pas takimin e parë me zyrtarët e Ambasadës Italiane në Kosovë dhe jemi dakorduar për themelimin e Këshillit Mbikëqyrës për realizimin e këtij projekti dhe jemi në proces të konsituimit të këtij këshilli. Iu janë shkuar letra institucioneve relevante, të cilët duhet t'i delegojnë përfaqësuesit e tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri s'është këtu. A doni me bë pyetjen?

(Ndërhyrje)

Atëherë, bëne pyetjen deputete dhe përgjigjet ministri i Financave.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, shumë!

Në mbledhjen e tretë të Qeverisë, të mandatit të parë të Qeverisë Thaçi 1, me 22 janar kryeministri Hashim Thaçi asokohe mori disa vendime, të cilat i kam këtu: vendimi Nr. 06/3, 05/3, 04/3, të cilat kanë të bëjnë me reduktimin e shpenzimeve të veturave, me reduktimin e shpenzimeve të telefonave mobilë dhe me reduktimin e shpenzimeve të reprezentacionit.

Që atëherë, ne kemi parë vetëm ngritje të shpenzimeve. Pyetja ka qenë për kryeministrin se çka ndodhi me vendimet e asaj kohe?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!
E nderuara deputete Bajrami, faleminderit për pyetjen!

Në Kosovë viteve të fundit, fatbardhësisht vazhdimisht ka pas progres sa i përket të hyrave për buxhetin e Kosovës dhe konsideroj që këtë progres e paraqet më së miri ky grafikoni.

Kur në vitin 2007, të hyrat për buxhetin e Kosovës ka qenë 891.000.000 tash ka mbërri në 1.303.000.000, domethënë është një trend pozitiv.

Gjithashtu, trend pozitiv kemi edhe sa i përket shpenzimeve buxhetore në vitin 2007, buxheti i Kosovës ka pas shpenzim 661.000.000, ndërsa në vitin 2011 kemi 1.387.000.000 domethënë një rritje prej më shumë se 110%.

Kemi pas bartje të kompetencave, kemi pas bartje të përgjegjësi, kemi pas krijim të institucioneve të reja, u rrit vëllimi i punës dhe nga 155.000.000 që është shpenzuar investime kapitale në vitin 2007, në vitin 2011 kanë mbërri në 528.000.000 derisa në vitin 2007, kemi pas mallra dhe shërbime 127.000.000 dhe investime kapitale 155.000.000, domethënë, raporti në mes mallrave, shërbimeve dhe investimeve kapitale ka qenë thuajse 1:1.

Sot e kemi një proporcion krejt tjetër në favor të investimeve kapitale dhe në fund të vitit 2011, në raport me vitin 2010, kemi një zvogëlim të mallrave dhe shërbimeve për 4%.

Nëse hyjmë në strukturën e shpenzimeve për të cilat po flasim, prapë duhet me hy në strukturë. Raporti për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011 është aprovuar në kabinetin qeveritar, është publik edhe e keni edhe ju deputetë të nderuar dhe nëse hyjmë në strukturën e këtyre shpenzimeve shohim se, nëse e ndajmë Qeverinë qendrore duke përfshirë kryeministrinë edhe ministrinë, se raporti nuk i përfshin veç Qeverinë, e përfshin: Qeverinë, kryeministrinë, ministrinë, gjitha komunat e Kosovës dhe institucionet e pavarura. Del që në pjesën më të madhe niveli qendror ka pas zvogëlim të shpenzimeve, ndërsa rritja ka ndodh në nivelin komunal dhe në agjencionet e pavarura. Por, nëse hyjmë edhe brendapërbrenda ministrive, atëherë del se disa ministri kanë pas rritje, disa kanë pas zvogëlim.

Mirëpo, po flasim me radhë: shpenzimet e telefonisë fikse, në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010 kanë pas një rënie prej 7.4% në total. Ndërsa, në strukturë, nëse është e

nevojshme unë sigurisht do ta jepi në vazhdim. Shpenzimet e telefonisë mobile në raport me vitin 2010 kanë pas një ngritje prej 0,29%. Në strukturë, Qeveria qendrore ka pas një zbritje 12%, Kuvendi 23% zbritje. Niveli lokal e ka pas një ngritje prej 35% dhe agjencionet kanë pas një ngritje prej 19.5%.

Drekat zyrtare: niveli qendror ka pas një ngritje prej 8.30%, Kuvendi ka pas një zbritje prej 0,52%, niveli lokal ka pas një ngritje prej 4.12%...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, le t'i vazhdohet fjala!

MINISTRI BEDRI HAMZA: ... dhe agjencionet e pavarura. Sa i përket karburanteve për vetura, pa dashur me justifikuar asnjë shpenzim, mirëpo duhet ta kemi në konsideratë që çmimet e këtij artikulli në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010, kanë pasur një ngritje në treg.

Mirëpo, sidoqoftë situata është kjo: Qeveria në nivel qendror ka pas një ngritje prej 20%, Kuvendi një zbritje prej 6.64%, niveli lokal një ngritje prej 37.68% dhe agjencionet e pavarura 35.63%.

Domethënë, të gjitha shpenzimet në të gjitha kategoritë e shpenzimeve ngritjen kryesore e ka pas niveli komunal, të gjitha komunat pa përjashtim se kush i qeverisë ato, a i qeverisë LDK-ja, PDK-ja, apo AAK-ja dhe agjencionet e pavarura. Nëse ka nevojë na hyjmë në strukturë edhe për secilën komunë, për secilën ministri dhe për secilin organizatë buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, shumë!

Ministër, për rritjen e buxhetit duhet të falënderojmë qytetarët e Kosovës që po i paguajnë taksat. Ndërsa, sa i përket rritjes së shpenzimeve, unë këtu kam, do të thotë, të dhëna pikërisht që i kam marrë nga raporti vjetor financiar që e keni publikuar, e kam marrë prej ueb faqes se si deputetë nuk na është shpërndarë ende, dhe kemi këtë rritje. Unë i kam të dhënat për vitin 2009 dhe e bëj krahasimin me vitin 2011. Do të thotë, shpenzimet e udhëtimit nga 4.99 milionë janë rrit në 8.16 milionë. Shpenzimet e telekomunikimit janë rrit nga 3.44 milion në 3.97 milion.

Ju e përmendët për shpenzimet për derivate, që kanë pas ngritje të çmimeve. Është shumë e vërtetë, bile një pjesë e inflacionit i atribuohet kryesisht ngritjes së çmimit të naftës dhe derivateve të naftës.

Këtu kemi një ngritje prej 17.82 milion në 23.000.000. Mirëpo, nëse kemi pas ngritje të çmimeve të derivateve dhe lëndëve djegëse, kemi pas ulje drastike të çmimeve të telekomunikimit. Do të thotë impulset për minutë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Ju njoftoj se raporti në mënyrë elektronike iu është dërguar deputetëve me shumëzim dhe mendoj se shpejt do ta kenë edhe në kutitë tuaja.

(Ndërhyrje)

Urdhëro, komentoje ti! Ministri Hamza e ka fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Po, komentojmë pra!

Faleminderit, zoti kryetar! Do të thotë, për rritje të buxhetit është e vërtetë që tatimpaguesit kanë kontribut të madh, por kontribut të madh ka edhe Qeveria se ka punuar mirë edhe e ka rritur buxhetin.

Mirëpo, sa i përket shpenzimeve, unë isha shumë preciz. Iu referova raportit, ne i kemi edhe nëpër vite. Rritja kryesisht ka ndodhur në agjencionet e pavarura dhe ka ndodhë në nivelin komunal.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Deputete, e ke fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Me 29 shkurt, nëse nuk jam gabim për datën, të këtij viti, Minsitria e juaj e ka përzgjedhur Konzorciumin francezo-austriak La zart friest dhe Raiffeisen Investment AG për këshilltar të transaksioni për privatizimin e Post-telekokmit të Kosovës, me një çmim prej 2.495.000 euro.

Pyetja është: A mund të na tregoni se çfarë konkretisht do të bëjë këshilltari i transaksionit kësaj here pasi që dihet që PTK-ja ka qenë në privatizim edhe më herët dhe Qeveria Thaçi e ka paguar një këshilltar të transaksionit aso kohe që ka qenë konsorciumi Telko AG dhe Wolf Thaiss me një çmim prej 1.15 milionë euro, këshilltar ky i cili në të njëjtën kohë ka qenë i 000mbikëqyrur nga një super këshilltar nga Hnton & Williams që Qeverisë i ka kushtuar 550.000 euro. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër Beqa, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Ju faleminderit kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Bajrami.

Angazhimi i një këshilltari të transaksionit është praktikë e vendosur ndërkombëtare kurdoherë që një entitet privat por sidomos publik ndërmerr realizimin e transaksioni strategjik dhe në këtë rast, këtu flasim për një transaksion strategjik.

Angazhimi i këshilltarëve të transaksionit për proceset e shitjes së aksioneve të operatorëve, realisht nuk ka alternativë, nuk ka asnjë lloj përvoje tjetër.

Në rastin e PTK-së, Qeveria e Republikës së Kosovë në vitin 2009, kishte kontraktuar një këshilltar të transaksionit i cili asistoi në implementimin e fazave të projektit dhe, siç e kemi njoftuar edhe publikun e gjerë disa herë deri me tani, në procesin e kaluar për shkak të mungesës së konkurrencës, Komisioni qeveritar kishte vendosur ta rifilloj atë për ta çuar në vend vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për konkurrentshmëri dhe maksimizim të transaksionit.

Detyra e reformimit dhe veçmas e privatizimit të një pjese të aksioneve të pronës publike është shumë komplekse. Transaksionet e tilla duhet të përgatiten mirë dhe do të implementon vetëm duke marrë maksimumin e vlerës së kompanisë dhe duke siguruar në një të ardhme më të mirë për sektorë. Këto janë sfida të cilat duhet të kalohen me këtë proces.

Rifillimi i procesit ka nënkuptuar edhe angazhimin e një këshilltari të ri ndërkombëtar, me detyrë komplekse të komunikimit me investitorë, në hulumtimin e tregut por edhe detyrat tjera të azhurnimit të dokumentacionit dhe asistencës të vazhdueshme në implementim të projektit.

Konsiderojmë se konzorciumi fitues ka reputacion jo vetëm evropian, por reputacion global, ndërsa të arriturat e këshilltarit të mëparshëm do të shërbejnë si bazë shumë e mirë për përfundim me sukses të këtij transaksioni. Më saktësisht, sepse flitet për çështjet dhe angazhimet të cilat i ka, angazhimet e tyre të ndahen në dy faza.

Në fazën e parë do t'i bëjmë këto veprime:

- Kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të tregut të investitorëve potencial, strategjik dhe financiar në PTK, duke përfshirë dizajnimin dhe zbatimin e një strategjie për promovim të mundësisë investuese në PTK, përfshirë organizmit dhe deri pjesëmarrjen dhe shfaqjen e PTK-së nëpër qendra financiare të fuqishme, të cilat duhet ta financojnë investitorët, potencial strategjik të cilët janë në këtë proces.

- Azhurnimin sipas nevojës së raportit të analizës ligjore, financiare, afariste teknike dhe raportin diagnostifikues dhe rishikimin rregullativ i cili është i nevojshëm.

- Monitorimin e ndarjes së njësive së postës nga PTK-ja dhe ofrimin e asistencës sipas nevojës në këtë ndarje, dhe

- Prezantimin e rekomandimit në lidhje me kornizën privatizimit dhe strukturën e transaksionit. Kjo është faza e parë.

Në fazën e dytë, pra në fazën e implementimit, do të merret me hartim dhe azhurnim të të gjitha dokumentet tenderuese dhe të kontratave të nevojshme për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E harxhove kohen! Deputete, a keni pyetje shtesë? Regjia fjalën deputetes Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Ministër!

E përmendët shumë azhurnimin, do të thotë detyra kryesore ka me qenë azhurnimi i dokumenteve që i ka bërë këshilltari i transaksionit, që ka qenë i angazhuar gjatë vitit 2009 dhe 2010.

A nuk është kjo shumë e madhe të ndahet nga buxheti i Kosovës, do të thotë kjo vetëm për azhurnim të dokumentacionit, se këtë punë ndoshta ka mundur me e krye edhe stafi brenda Ministrisë? Dhe kur ne e kemi quajtur dështim tërheqjen nga privatizimi i PTK-së, Qeveria e ka quajtur si fitim, do të thotë kanë thënë që kemi bërë hapin më të mirë. Tash po shihet që do të thotë pikërisht për shkak të atij aksioni, Qeveria e Kosovës duhet të ndajë mjete shtesë nga buxheti i Kosovës për përgatitjen e privatizimit. Dhe, nëse forma e privatizimit që ka qenë, do të thotë, i cili ka qenë i plasuar në treg gjatë vitit të kaluar, nëse ndryshon ka qenë mirë që kjo t'ju bahet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër! Vazhdo me përgjigjen!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Do ta vazhdoj përgjigjen.

Pra flasim për asistencë në menaxhim në të gjitha fazat e prokurimit, organizimin e konferencës për ofertues, menaxhimin e dhomës së të dhënave, asistencën në menaxhimin e konsultimeve me ofertues dhe kërkesa për sqarime, vlerësimin e ofertave dhe asistencë në negociatat dhe mbyllje të procesit. Për më shumë, këta këshilltarë edhe këshilltari i transaksion edhe këshilltari strategjik mbahen përgjegjës ligjërisht për transparencën dhe plotësimin e standardeve më të larta në një transaksion të tillë.

Nuk flasim këtu vetëm për punë operative ditore, por janë përgjegjës ligjërisht për transparencën e transaksionit.

Flasim për dy lloje sepse ju e quajtur edhe një super këshilltar, jo një super këshilltar, por një këshilltar strategjik i cili ka për detyrë para se çfarëdo vendimi të merr Komisioni për privatizim, ta vërteton ligjshmërinë dhe bazën e transparencës së marrjes së këshillave nga këshilltari i transaksionit dhe atëherë, konform konfirmimit të këtyre gjërave nga këshilltari strategjik, Komiteti qeveritar merr vendime të tilla.

Ndërkohë, sa i përket vendimit, unë jam plotësisht i bindur dhe po e them edhe një herë se ne jemi të vendosur për ta bërë reformën strukturale të ekonomisë së Kosovës, por vetëm atëherë kur mund të mbërrihen vlerat maksimale. Nuk do të bëjmë privatizime vetëm sa për hir të përmbylljes së një agjende, por do të bëjmë privatizime për të mirën e qytetarëve të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Ferid Agani.

ALBANA GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Çështja ka të bëjë me Udhëzimin administrativ, nr. 04/2008, mbi autorizimin e marketingut për plasimin e produkteve medicinale në Republikën e Kosovës.

Neni 10 i këtij Udhëzimi, thotë: “Të gjitha produktet medicinale që plasohen në tregun e Kosovës, duhet të kenë fletë-udhëzuesin i cili duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe serbe dhe i shkruar në atë mënyrë që të jetë i qartë, i lexueshëm dhe i kuptueshëm për pacientin. Ndërsa në treg qarkullojnë shumë produkte medicinale pa fletë-udhëzuesin e lartcekur. Andaj, shtroj pyetjen:

- Pse edhe pas katër viteve nga hyrja në fuqi i këtij Udhëzimi administrativ në tregun tonë qarkullojnë medikamente pa udhëzuesin për përdorim në gjuhën zyrtare?

KRYETARI: Ministër Agani, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

E nderuar zonja deputete,

Kjo që e thatë, është një fakt. Por është edhe një fakt se krahasuar me vitin 2006 me vitin 2010, numri i këtyre preparateve, pra i këtyre produkteve medicinale të cilët nuk e kanë këtë fletë-udhëzim, është shumë më i vogël se sa që ka qenë pra në vitin 2006.

Megjithatë ne jemi duke punuar në ngritjen e kapaciteteve të Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale, veçanërisht të Inspektoratit farmaceutik i cili duhet të jetë ai që do t'i identifikojë këto shkelje ligjore dhe njëkohësisht kryeshefi i ri i Agjencionit Kosovar të Produkteve Medicinale, i cili është emëruar javën që shko veç ka marrë një vendim dhe i ka informuar të gjithë përfaqësuesit e kompanive të ndryshme farmaceutike në vend që deri me datën 27 prill, pra të muajit që vjen duhet të njoftojnë se kush është përfaqësuesi juridik, pra kush është përfaqësuesi ligjor i këtyre kompanive, në atë mënyrë sepse konsekuencat ligjore për mos përmbushjen e kësaj dispozite ligjore, do t'i mbajë personi juridik apo fizik i caktuar nga prodhuesi si përfaqësues i tyre për territorin e Kosovës.

KRYETARI: Deputete, a keni pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Ministër! Medikamentet në fjalë janë kryesisht produktet të cilat qendrën kryesore për shpërndarje e kanë shtetin serb, por edhe ato që përfaqësitë e tyre i kanë në Maqedoni. Pra, paska edhe medikamente të tilla dhe në këtë mënyrë po shkelet edhe ligji.

Një gjë tjetër! Keni premtuar se infrastruktura ligjore e domosdoshme për fuqizimin e segmenteve të shëndetësisë, do të përfundojnë së hartuari në qershor të vitit 2011, kurse tani një vit më vonë jeni nën pikën zero në mos më poshtë. Dhe, të gjitha konkurset e shpallura nga kjo Ministri ose janë anuluar disa herë ose disa prej këtyre pozitave ende vazhdojnë të udhëhiqen nga ushtrues detyre.

Gjendja në QKUK, vazhdon të jetë e rëndë sa i përket furnizimit me barëra të listës esenciale. Pra, kjo gjendje është rezultat i keqmenaxhimit nga kjo Ministri duke filluar nga kriteret e tenderëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Nëse ke koment ministër, merre fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Natyrisht, se pjesa më e madhe e këtij komenti nuk ka të bëjë fare me pyetjen e cila u shtrua në fillim. Dhe, vetëm t'ju them se furnizimi i Qendrës Klinike Universitare dhe e spitaleve rajonale, si dhe qendrën kryesore të mjekësisë familjare me barëra, është dukshëm e përmirësuar dhe këtë mund ta konstatojmë çdo ditë edhe në kontaktet me punëtorët shëndetësorë të këtyre institucioneve, natyrisht edhe qytetarëve që shfrytëzojnë këto shërbime.

E sa i përket ligjeve që i përmendet, unë e dhashë një përgjigje në fillim, zonjës deputete Time, iu përgjigja. Nuk jemi në pikën zero, jemi larg, larg përpara dhe të jeni të bindur se reforma legjislative është kësaj here reformë gjithëpërfshirëse, nuk është reformë fragmentare e cila numëron ligje se sa janë miratuar, por numëron përmbajtje. Pra nuk numëron formë dhe nuk e ka vëmendjen në formë, por e shikon përmbajtjen.

Dhe unë jam i bindur se menjëherë pas miratimit të Ligjit të shëndetësisë në mes të prillit, vjen në rend edhe Ligji për produkte medicinale dhe pajisje mjekësore, i cili është po ashtu i gatshëm dhe i cili nuk ka ardhur në miratim vetëm për shkak se kemi pasur dëshirë që të jetë në vijë të plotë me Ligjin e shëndetësisë që do të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Deputete, e ke fjalën!

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse zëvendëskryeministrja radhën e kaluar na raportoi se ka pasur një takim për çështjen e të zhdukurve në dialogun që po zhvillohet në Bruksel, pra është biseduar. Unë e bëj pyetjen:

- Cilët janë rezultatet e këtij takimi në këtë dialog në lidhje me zbardhjen e çështjes së të zhdukurve?

KRYETARI: Zëvendëskryeministre Tahiri, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Lama,

Për sa i takon pyetjes tuaj, më lejoni t'ju numëroj disa nga rezultatet kryesore.

E para. Duke qenë të shqetësuar për çështjen e të pagjeturve dhe mungesën e një zgjidhje të plotë në këtë çështje, ne si Qeveri e Republikës së Kosovës, kemi pasur për qëllim që duke futur në agjendën e dialogut teknik këtë çështje, të bëjmë që kjo çështje

të ngritët në nivel të trajtimit të Bashkimit Evropian si dhe Bashkimi Evropian të pranojë të marr rol udhëheqës në zgjidhjen e plotë të këtij problemi, përkatësisht në zbardhjen e plotë të fatit të pagjeturve dhe këtë e kemi arritur plotësisht, sepse sot kjo çështje është zyrtarisht në agjendën e dialogut teknik në Bruksel, e cila zhvillohet me ndërmjetësimin e BE-së dhe me mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët janë edhe prezentë në të gjitha raundet e bisedimeve.

E dyta. Kemi arritur që të informojmë dhe të sensibilizojmë BE-në për të gjitha sfidat nëpër të cilat po kalon ky proces si dhe kemi nxjerrë në pah që në arkivat e ish ushtrisë jugosllave ka të dhëna dhe informacione të cilat Serbia nuk është e gatshme që t'i jap dhe në përgjithësi që Serbia nuk është bashkëpunuese për ndriçimin e fatit të të pagjeturve. Po ashtu e kemi ngritur çështjen e varrezave të reja masive të cilat Serbia i mohon se ekzistojnë.

Pastaj e kemi ngritur veçanërisht çështjen e profesor Ukshin Hotit si dhe kemi kërkuar nga BE-ja, që për çështjen e të pagjeturve dhe procesin e zgjidhjes, Raporti i progresit i BE-së ta trajtojë në mënyrë më të hollësishme si dhe të jap obligimet pra, të dyja shteteve edhe Kosovës edhe Serbisë, në mënyrë që ky proces të përshpejtohet dhe në fund vazhdimisht në takimet që unë i kam në Bruksel me zotin Cooper, kërkoj që të rritet trysnia ndaj Serbisë në mënyrë që ajo të jetë më bashkëpunuese dhe t'i hapë arkivat e krimit dhe gjenocidit që i ka bërë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministre! Deputete, a keni pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe një herë dua t'i them zonjës Tahiri se ne nuk po e vëmë tashmë në diskutim që kjo çështje është futur në agjendë. Por, pyetja ime ishte cili është rezultati? Nga përgjigja që dha tani, u pa që nuk ka asnjë rezultat.

Ju thatë që Serbia nuk po bashkëpunon në këtë çështje. Në rast se Serbia nuk po bashkëpunon në këtë çështje, pse ju bashkëpunoni me Serbinë për çështje të tjera, për çështje që atyre iu interesojnë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ke, zëvendëskryeministre Tahiri!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Zonja deputete! Nuk është mirë që të gjitha rezultatet e arritjet në Kosovë dhe arritjet e Qeverisë të Republikës së Kosovës, t'i shihni me nihilizëm.

Nihilizmi nuk është një tipar i mirë i një politikani i cili me të vërtetë ka vizion edhe e ka parasysh interesin nacional. Nuk është e mundur që çdo gjë që arrihet si rezultat, ju i mohoni. Madje, edhe studimin e fizibilitetit që po hapë pra kapitull të ri në marrëdhëniet Kosovë – BE me Marrëveshjen e stabilizim asociimit, ju edhe ato i mohoni. Ju faleminderit!

(Reagime - polemikë)

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! Deputetja Alma Lama pyetje për Kryeministrin Thaçi. A doni të bëni pyetje? Kryeministri nuk është këtu! Fjalën, deputetes Alma Lama.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ta sqaroj zonjën Edita që ne jemi realistë jo nihilistë! Sa për informacion! Kurse, në lidhje me pyetjen për Kryeministrin:

- Ndërtimet pa leje janë shndërruar në një masë të vërtetë për qytetarët e Kosovës, si në qytete ashtu edhe në fshatra.

Në qytete, qytetarëve iu është pamundësuar frymëmarrja për shkak të ndërtimeve pafundësisht pa leje, ndërkohë që nëpër fshatra po dëmtohen tokat bujqësore.

Sigurisht që këtij fenomeni do t'i ishte vërejtur në rast se do të ishte miratuar Ligji për legalizimin e ndërtimeve pa leje, i cili ka pasur për qëllim ndërmarrjen e veprimeve për legalizimin e ndërtimeve ekzistuese pa leje, por brenda një kohe të shkurtër të ndërprerjes së ndërtimeve pa leje në të ardhmen.

Ky Projektligj në fakt, është përgatitur nga Ministria e Ambientit që në vitin 2009 dhe prej atë viti është në sirtarin e Kryeministrit. Prandaj unë e pyes Kryeministrin, se për çfarë arsye ai nuk e sjellë këtë ligj në Kuvend?

Ju faleminderit! Mund të them që në rast se nuk do vijë edhe herën tjetër, do t'ia....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, e ke fjalën!

NAZANE BRECA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Agani,

Me qëllim të krijimit të bazës ligjore për unifikimin dhe standardizimin e dokumenteve shëndetësore, në institucionet shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë udhëzimin administrativ 02/2010, ku ka për qëllim unifikimin dhe standardizimin e dokumenteve shëndetësore, të kujdesit parësor shëndetësor, shërbimin specialistik konsultativ dhe diagnostik në kujdesin parësor shëndetësor, kujdesin dytësor dhe tretësor.

Ju si Ministri për realizimin e këtij Udhëzimi administrativ, sipas nenit 12, duhet të përzgjedhësi një apo më shumë. A mund të na informoni se sa kontraktor keni përzgjedhë në lidhje me këtë çështje?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
E nderuara zonja deputete,
Bazuar në nenin 12 të Udhëzimit administrativ 02/2010, Ministria e Shëndetësisë ka kontraktuar dy operatorë ekonomik në nivel të Kosovës për këtë qëllim.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? E ke fjalën!

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!
Në lidhje me këtë çështje, Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar edhe një qarkore me të cilën informon se njëri prej atyre që keni kontraktuar është edhe operatori litografia në Gjakovë.

Realizimi i Udhëzimit administrativ edhe të qarkores, nuk është problem për kujdesin sekondar dhe terciar. Mirëpo, kur vjen te realizimi i kësaj në kujdesin parësor, është problematike për shkak se vjen ndesh me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ndesh me ligjet e prokurimit edhe kështu ju vështirëson shumë realizimin në qendrat kryesore të mjekësisë familjare.

- A do të ndërmermi diçka lidhur me këtë, se ma merr mendja se edhe ju si ministër nuk keni dëshirë me ardhur deri te shkëlja e Ligjit për vetëqeverisje lokale edhe ligjeve të prokurimit se këto duhet të shkojnë në procedura ashtu si keni shkuar ju në Ministri, do me thënë edhe në qendrat kryesore, duhet të respektohen këto procedura dhe në këtë mënyrë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,
Ashtu siç edhe e thatë në pyetjen e juaj, qëllim i një veprimi të tillë të Ministrisë, pra të kontraktimit të operatorëve ekonomik të cilët do të prodhojnë këtë lloj të materialit shëndetësor, dokumentacionit shëndetësor, ka qenë që të krijojmë praktikisht një bazë ligjore për unifikimin dhe standardizimin e dokumenteve shëndetësore, në të vërtetë të respektojmë në tërësi bazën ligjore e cila e kërkon këtë në institucionet shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor. Pra jo vetëm nivelin dytësor dhe tretësor.

Këtë që ju po e thoni, është fakt se ka pasur pakënaqësi të artikuluar në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor, por unë nuk kam pasur asnjë kërkesë zyrtare nga përfaqësuesit e institucioneve të nivelit parësor shëndetësor në këtë aspekt. Do të ishte mirë që kjo kërkesë të artikulohet dhe të parashtrohet në mënyrë të qartë se ku ekziston kolizioni sa i përket prokurimit me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ne do t'i ndërmarrim të gjitha masat a përcaktuara me ligj në këtë situatë.

Procedura e prokurimit në këtë rast, është zbatuar në pajtim me të gjitha procedurat ligjore dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga organi i shqyrtimit të Prokurimit publik sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, por natyrisht se ne jemi të interesuar që ta kemi një harmoni në veprim dhe kjo duhet të tejkalohet në një koordinim ndërmjet drejtorive

komunale të shëndetësisë që kanë vërejtje në këtë zgjidhje dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetja e fundit, deputetja Kimete Bytyqi, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete, e ke fjalën!

KIMETE BYTYQI: Ju faleminderit kryetar!

Të nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në muajin tetor të vitit 2009 gjatë fushatës parazgjedhore, për zgjedhjet lokale ka hapur tenderë për ndërtimin e tri shkollave në komunën e Therandës, si në vijim:

Nën një, ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Nishor.

Nën dy, ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Grekoc dhe

Nën tre, ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Vraniq.

Më pastaj, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i ka anuluar aktivitetet e prokurimit pa asnjë arsytim dhe si pasojë as sot e asaj dite, këto shkolla kanë mbetur pa u ndërtuar, edhe pse komuniteti atje ka pritur realizimin sipas pretimit të Qeverisë.

Duke pasur për bazë këtë gjendje, kërkoj nga ana e juaj zoti ministër, që të më njoftoni se si ka ardhur deri te kjo situatë dhe cili do të jetë angazhimi i juaj që të përmbyllet ky proces i ndërtimit të kryer në këto shkolla?

KRYETARI: Ministër Buja, e ke fjalën!

RAMË BUJA: I nderuari zoti kryetar!

Ministër Agani,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Bytyqi,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është e përkushtuar në përmirësimin e hapësirave shkollore dhe për këtë qëllim dhe gjatë viteve të fundit ka punuar shumë në ndërtimin e shkollave të reja.

MASHT, për të gjitha objektet arsimore në Kosovë, ka të dhënat e përgjithshme specifike për gjendjen e tyre dhe vjetërsinë e tyre.

Bazuar në këto të dhëna dhe strategjitë për zhvillimin arsimit në Kosovë, si dhe në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, formohen edhe prioritetet për këto investime.

Edhe pse kemi zhvilluar shumë projekte, kërkesat dhe nevojat për investimet në godinat shkollore, janë shumë më të mëdha se kaq. Disa nga këto nevoja janë edhe tri projektet për të cilat keni parashtruar edhe ju pyetjen dhe ato, natyrisht që janë edhe që i përendët ju, në Nishor, në Vraniq dhe në Grikoc.

Në vitin 2009, nga MASHT-i janë tenderuar tri objekte shkollore në komunën e Suharekës, por janë anuluar dy projekte në fund të dhjetorit dhe një në fillim të janarit të vitit 2010.

Arseja e vetme për këtë anulim, ka qenë se në buxhetin e vitit 2010 të Republikës së Kosovës, të ndarë për MASHT-in, nuk ka pasur mjete për vazhdimin e këtyre projekteve. Kjo është arsyeja e vetme, nuk ka arsye tjetër përplotësuese.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

KIMETE BYTYQI: Ju thatë: - i kemi anuluar tri tenderët. Atëherë a do t'i mbushni këto premtime që i keni dhënë apo këtë e keni bërë vetëm për fushatë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: Unë besoj se kjo puna e fushatës hiq nuk është aktuale tash, atëherë mbase ka qenë. Por është insistimi ynë është që gjithsesi t'i përplotësojmë të gjitha nevojat e arsimit në Kosovë me infrastrukturë teknike shkollore dhe nuk përmenda dy anulime, por e përmenda edhe të tretin, është në fillim të janarit 2010 dhe dy të tjerat i thash që janë anuluar në fund të dhjetorit po të njëjtit vit. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe nga ju. Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigjen në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 15 mars 2011.

Pyes a keni vërejtje në procesverbal? Nëse nuk ka konstatoj se Kuvendi miratoi....Më falni, deputetja Sala Berisha-Shala, e ka fjalën!

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Në procesverbal nuk kam vërejtje, por e kam një sugjerim për materialet e transkripteve, dhe ky sugjerim le t'i shkojë Njesisë së transkripteve, pra: që t'ia bashkëngjisin transkriptit rendin e ditës së seancës.

(Ndërhyrje, S. Hamiti: Po, e drejtë dhe me vend shumë!)

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ne po votojmë për procesverbalin dhe në të nuk ka vërejtje, por miratohet. Kalojmë në pikën e katërt.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transmetimin publik në Kosovë.

Komisionet parlamentare, kanë shqyrtuar Projektligjin për transmetimin publik në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për arsim, kulturë, rinë, sport, administratë publike, qeverisje lokale dhe media, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetoj raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj është gjatë në diskutim në Komisionin funksional dhe ka pasur ekspertizë e cila ka ardhur nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Pastaj është diskutuar mjaftë gjatë edhe me zyrën e ICO dhe si Komision funksional jemi munduar që t'i harmonizojmë të gjitha këto qëndrime dhe propozime me këta dy mekanizma të rëndësishëm ndërkombëtar.

Projektligjin e kemi shqyrtuar, e kemi amendamentuar dhe në përgjithësi Projektligji përmban 21 amendamente, prej të cilave 20 e kanë përkrahjen e komisionit funksional. Përfundimisht bën amendamenti 6 i cili nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional. Pastaj Projektligji, bashkë me amendamentet, është shqyrtuar edhe nga komisionet e përhershme që disa prej tyre i kanë dhënë vërejtje në disa amendamente.

Për shembull, Komisioni për legjislacion ka pasur vërejtje në amendamentin 8, 9 dhe 16.

Po kështu, edhe Komisioni për financa ka pasur një vërejtje të amendamenti 9. Kurse në Komision funksional, njëzëri jemi pajtuar që amendamentet, të cilat i kemi propozuar si Komision, i kemi përkrahur. Pra, me përjashtim të amendamenti 6 të përkrahur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Unë jam i gatshëm të jap sqarime shtesë në lidhje me amendamentet, të cilat kanë marrë vërejtje nga komisionet e përhershme, por gjithsesi do të mbetet fjala kryetarëve të komisioneve të përhershme, e pastaj jam i gatshëm të jap edhe sqarime tjera shtesë.

Dhe në fund, ju ftoj që Projektligji, bashkë me amendamentet, të miratohet për faktin se është edhe në pakon e ligjeve për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës dhe është një medium publik i vetmi i cili është pa ligj. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Vazhdojmë tutje!

Paraprakisht, edhe unë po ua tërheq vërejtjen! Amendamenti 6, është propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, pa përkrahje të komisionit funksional.

Amendamentet 8, 9 dhe 16 - të propozuara nga komisioni funksional, nuk janë përkrahur nga Komisioni për legjislacion.

Ndërsa në amendamentin 9, të propozuar nga komisioni funksional, Komisioni për buxhet e financa ka propozuar amendament në paragrafin 4 të këtij neni. Dhe, kur të shkojmë te këto nene, lidhur me këtë ju paralajmëroj.

Në sallë janë prezent 74 deputetë.

Po vazhdojmë me votimin e këtyre amendamenteve:

Amendamenti 1.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

(Ndërhyrje)

Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj! Urdhëroni!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, faleminderit!

Unë i kam dy vërejtje për amendamentin 2, që ka të bëjë te përkufizimet dhe që ndërlidhet me ligjin paraprak që ne e kemi votuar në Komisionin e pavarur për media dhe i cili ka të bëjë me pikën 1.6 Operatori i rrjetit, dhe te 1.9 Plani i frekuencave të transmetimit.

Këtu, te të dy paragrafët, mungon pjesa ku janë autorizimet e KPM-ës, si organ i pavarur dhe kategori kushtetuese.

Te 1.6 mungon: “posedim dhe korrespondim i licencave ose autorizim i lëshuar nga KPM-ëja” dhe kjo nuk është e paqëllimshme!

Dhe, e dyta, te Plani i frekuencave të transmetimit, që lidhet me nenin kushtetues 1.4.1 mungon pjesa “për Komisionin e pavarur për media që menaxhohet nga Komisioni i pavarur për media”. Domethënë, te shpërndarja, që do të thotë, për planin e frekuencave të radio-transmetimit ose të transmetimit televiziv, të caktuara nga autoriteti kompetent për telekomunikim, që nënkuptohet për Komisionin e pavarur për media.

Prandaj, këto dyja, duhet të jenë në përputhje me Ligjin për KPM-ën, të cilin ne e kemi votuar, hiq më shumë se tri seanca, para kësaj.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit?

IDRIZ VEHAPI: Kryetar, faleminderit shumë!

Unë plotësisht pajtohem me deputetin Zemaj, për faktin se këto përkufizime duhet të jenë të përputhshme me Ligjin për KPM-ën.

KRYETARI: Atëherë, e votojmë amendamentin 2, me vërejtjet e dhëna nga deputeti Armend Zemaj. A jeni dakord?

A ka kundër? Nuk ka.

Konstatohet se u miratua amendamenti 2 me vërejtjet e deputetit Armend Zemaj.

Deputet, nëse do me i bë vërejtjet, lidhur me amendamentin, ato mundesh me i dorëzuar edhe me shkrim.

Vazhdojmë me votim të amendamenteve:

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Danush Ademi!

DANUSH ADEMI: Faleminderit kryetar!

Te amendamenti 5, pika 2.2. Dy kanalet e Radio-Kosovës. Këto dy kanale janë të detyruar t'i ndajnë 15% të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës.

Këtu kemi vërejtje kryetar, sepse ne e dimë që komuniteti hashkali flet gjuhën shqipe këtu në Kosovë dhe në tërë rajonin, prandaj unë mendoj se këtu e ndien veten të diskriminuar sepse në këtë 15%-shin nuk ka mundësi prapë të përfshihet në skemën programore komuniteti hashkali.

Pra, këtu propozojmë që t'i shtohet: “si edhe komunitetet tjera që flasin gjuhën shqipe”, sepse ne nuk kemi gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe, si komuniteti hashkali edhe ai egjiptas.

KRYETARI: Faleminderit! Ne e votuam amendamentin.

Amendamenti 6. Propozim i grupit...

(Ndërhyrje)

Urdhëroni! Por, unë këtu e kam që s'është lajmëruar askush. Këtu i kemi: Duda Balje, Emilija Rexhepi, Hamza Balje, e nuk kemi tjerë të paraqitur. Pra, këtu si po e shoh, në elektronikë, nuk është.

(Ndërhyrje)

Urdhëro? Po, për cilin amendament, do me marrë fjalën?

(Ndërhyrje)

Unë s'e kam dëgjuar asnjë kërkesë. Vazhdojmë me amendamentin 6.

Amendamenti 6, i propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, pa përkrahje të komisionit funksional. Fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Amandman koji smo podneli, nije prošao na funkcionalnoj komisiji. On je prošao na Komisiju za zajednice.

Komisija za budžet je konstatovala da ne postoje budžetske implikacije za ovogodišnji budžet, a obzirom na to da mi smo rekli da nije ništa obligativno, nego kada se budu stvorili svi uslovi, da se to realizuje.

U Komisiji za zakonodavstvo je takođe prošao. I u Komisiji za evropsku integraciju, nije.

Imati kanal na kanal RTK-3 za sve druge jezike, osim srpskog, za nas predstavlja vrlo veliku potrebu s obzirom na to da smo na RTK-1 vrlo malo zastupljeni. Toliko ćemo biti zastupljeni na RTK-2, verovatno na srpskom jeziku.

Nismo stavili ništa kao obavezno, samo smo dali mogućnost da kada se stvore uslovi za to, da se desi. I zato molim sve poslanike da razmisle o tome jer je vrlo velika potreba za sve zajednice, pored Bošnjačke i tražimo podršku od svih.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Pra, vazhdojmë me votim, aty ku mbetëm:

Amendamenti 6. Propozim i Grupit parlamentar 6+, pa përkrahje të komisionit funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota për, 36 kundër dhe asnjë abstenim, amendamenti 6 kalon.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk e qes asnjëherë, por ju them se nuk po dini me votuar!

(Ndërhyrje, S. Hamiti: Po shkruan atje, se kush e qysh ka votuar!)

Jo, shumë mirë e keni ditur. E kam thënë – propozim i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahjen e komisionit funksional. Unë, shqip e kam lexuar!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve tjera.

Amendamenti 7.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 8. Komisioni për legjislacion, pa përkrahje të komisionit funksional.

Fjalën e ka kërkuar deputeti, kryetar i Komisionit për legjislacion, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Nuk është amendament i Komisionit për legjislacion, por Komisioni për legjislacion ka vërejtje në amendamentin 8.

KRYETARI: Atëherë, pa përkrahje!

ARBEN GASHI: Po, në rregull! Atëherë, Komisioni për legjislacion ka vërejtje në amendamentin 8, e po ashtu edhe në amendamentin 9.

Vërejtjet janë të karakterit juridik dhe karakterit kushtetues. Dhe, pikësëpari duhet të sqaroj se nuk ka mund me marrë ndonjë vendim të prerë për këtë çështje, sepse ka qenë shumë i ndarë dhe është kërkuar nga Komisioni që kryetari i Komisionit ta arsyetojë qëndrimin dhe diskutimin lidhur me këto dy amendamente dhe me amendamentin 16, kur t'i vjen radha.

Pra, amendamenti 8 e 9, konsiderohen se mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Komisionin e pavarur të mediave, sepse e përcaktojnë 10% shumën e kohës për reklama për RTK-ën.

Po edhe amendamenti 9, është në kundërshtim me buxhetin e Republikës së Kosovës dhe me këto dy amendamente krijohet një sistem i paqëndrueshëm.

Paqëndrueshmëria e sistemit qëndron në faktin se me këto dy amendamente krijohet një disbalancim buxhetor. Garantojmë nëpërmjet buxhetit të Kosovës 0,7% ose 0,8% buxhetit të Kosovës të shkojë për Radiotelevizionin e Kosovës, ndërkohë që në të njëjtën kohë i garantojmë Radiotelevizionit të Kosovës që të ketë hapësirë publicitare 10% të programit të saj.

Po ashtu, në të njëjtën kohë i garantohet Radiotelevizionit të Kosovës që brenda një viti të fillojë dhe të bëjë inkasimin nga të hyrat vetjake.

Kjo i bie se, nëse Radiotelevizioni i Kosovës nga buxheti i Kosovës do të marrë 10 milionë euro, e po ashtu nga reklamat do t'i marrë 5 milionë euro, ato bëjnë 15 milionë euro dhe nëse nga të hyrat vetjake i merr edhe 2 apo 3 milionë euro tjera në vitin e parë, i bie që buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës të bëhet për 17 milionë euro dhe nuk është marrë parasysh elementi i përshkallëzimit për vetë qëndrueshmërinë e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Pra, është diskutuar dhe propozuar që te amendamenti 8 të thuhet se duhet të jetë në përputhje me Ligjin për KPM-ën dhe në kuadër të kësaj RTK-ëja, në bashkëpunim me KPM-ën të përcaktojnë kohën e reklamave, por të mos jetë më shumë se 10%.

Propozimi është që të thuhet në ligj: të mos jetë më shumë se 10% e reklamave dhe koha e saktë të përcaktohet në bazë të buxhetit dhe të nevojave të RTK-ës, në bashkëpunim me KPM-ën.

Çështje tjetër, që është po ashtu e rëndësishme, është çështja e financimit që bie në amendamentin 9.

Te amendamenti numër 9 është propozuar dhe diskutuar në Komision, që do të ishte më e qëndrueshme që të bëhet përshkallëzimi, se të gjitha të hyrat vetjake që i realizon Radiotelevizioni i Kosovës, po ashtu edhe nga reklamat, të zbriten në donacione që ia jep Kuvendi, sepse ne po japim donacion për tri vite të ardhshme. Dhe nëse Radiotelevizioni i Kosovës fillon të realizojë të hyra veta në kuadër të parapagimit dhe në kuadër të reklamave, atëherë donacionet që i jep Kuvendi, normalisht se duhet të zbriten.

Prandaj, ky është propozimi që të bëhet një sistem i përshkallëzuar, aq sa mbledhë të hyra, që është i detyruar me i mbledhë Radiotelevizioni i Kosovës, të zbriten nga donacionet që i jep Kuvendi i Kosovës.

Ndërsa, sa i përket reklamave, reklamat të jenë në korkondancë me Komisionin e pavarur të mediave. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetar i Komisionit, Idriz Vehapi, a keni diçka me na thënë?

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne kemi paraparë këtu, për dallim prej sponzoruesit se ka propozuar 10 deri 20%, kurse ne si Komision funksional e kemi paraparë 10% të jetë hapësira publicitare. Por kjo është tranzitore, për faktin se ky limit do të rishikohet në momentin e financimit të parapagimit, në pajtim me Ligjin e KPM-ës.

Domethënë, kur kalon periudha tranzitore e financimit të RTK-ës përmes buxhetit të Kosovës, atëherë edhe hapësira publicitare rregullohet me Ligjin e KPM-ës.

Kështu e kemi paraparë ne, prandaj propozojmë që ky amendament të shkojë kështu, si ka propozuar komisioni funksional.

KRYETARI: Eqrem, e do fjalën? Urdhëroni!

EQREM KRYEZIU: Moti e kam kërkuar fjalën, kryetar!

Tani në rolin e nënkryetarit të këtij komisioni po flas, jo si qytetar i lirë!

Parlamenti pati mirësinë dhe fuqinë që me kaluar amendamenti, që edhe pakicat tjera të kenë një kanal publik, është anti-kushtetues, është anti-politik, është krejt. Por, në qoftë se veç ky Parlament i nderuar, e ka miratuar, atëherë unë po e shfrytëzoj rastin meqë jemi

ende te ky ligj, me e bë një amendament tjetër, që do të duhej të ishte rrjedhje logjike e asaj çka e miratoi Parlamenti.

Kjo, do të thotë se, kur të krijohen kushtet, sikur që tha zonja Balje dhe kjo do të thotë se krijohen kushte që mazhoranca shqiptare, se serbët është problem me u bë turq ose romë. Shqiptarët munden me u bë turq dhe romë, dhe atëherë hiqet kanali në gjuhën shqipe dhe taksat i paguajnë këta tjerët që u asimiluan dhe u bënë romë, turq ose boshnjakë!

Për serbët s'po mundem, burra, me ju thënë bëhen turq ose romë, por shqiptarët e kanë atë mundësi dhe që ky është paralajmërimi që ky Kuvend pati forcën vizionare ta ketë parasysh se mund të shndërrohet tërësisht kjo mazhorancë në diçka tjetër dhe të bëhet kanali kur të krijohen kushtet.

Dhe, unë po ju përkujtoj se rekomandimet evropiane nuk parashohin gjëra të tilla. Ne kemi insistuar me marrë krejt atë çka marrim me rekomandime. Iu lumtë edhe komisioneve tjera të Parlamentit, që e kanë kaluar këtë, por si thotë Horaci "Edhe Homerin e madh e zë gjumi nganjëherë".

Unë po e përgëzoj Parlamentin që e ka pasur atë forcë vizionare me paraparë që mazhoranca mund të transformohet në diçka tjetër... .Se serbët jo! E di që ata e kanë një identitet shumë të fortë dhe s'ka shans me u bë as turq as romë, por unë jam i gatshëm me u bë turk ose rom dhe tani na e mbajmë atë televizion me taksa, jo me donacione. Nuk ka shans me donacione Televizioni publik me u mbajt. S'ka shans me donacione! Me taksa të qytetarëve dhe taksat e qytetarëve i paguajmë kur unë kam nevojë me ndërrua kombin dhe me dëgjuar.

Unë fola në emër të nënkryetarit të këtij komisioni. Urime, përgëzime! Është shumë një hap i mirë ky. Urime edhe kryetarëve të komisioneve tjera që janë "dremitë si Homeri i madh". Quandoque, tha Horacio - bonus dormitat Homerus. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Do të kthehem edhe te amendamenti! Por vetëm dua të them se krejt çka ka bërë Kuvendi i Kosovës për shumë vite, krejt çka po provojmë me bë ne, krejt ky ushtrim i ndërtimit të një ligji është për me e distancuar politikën prej transmetuesit publik. Bile, bile, kemi bërë amendamente e nene që Qeveria e Kosovës mos me pas të drejtë direkt me u përzier në transmetuesin publik.

E dimë që përhihet! Por ne po provojmë me e ndalë Qeverinë e Kosovës mos me pas dorë në transmetim publik. Dhe, për deri sa me amendamente që po i voton këtu mazhoranca, po lejojmë që eventualisht ndonjë qeveri e huaj me u përzier në transmetues publik.

Tash, paramendoni paradoksin! Krejt çka po bëjmë është me ndalë Qeverinë tonë, për deri sa me një amendament po i lëmë qeveritë tjera me na u përzier në transmetues publik, dhe me na financuar. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë. Te këto amendamente, te amendamenti i fundit, për të cilin folëm. Ne, në njëfarë forme, qysh e thash paraprakisht kur fola, po vijmë në pozitë me votuar ligje, të cilat bien ndesh me ligjet e Qeverisë. Domethënë, ky është një masakrim i sistemit legjislativ në Kosovë.

Amendamentet, që po i votojmë ne, janë në kundërshtim me ligjet të cilat i kemi të votuara, po prej këtij Parlamenti. Bien ndesh me Ligjin për buxhetin, bien ndesh me Ligjin për KPM-ën amendamentet të cilat ne i bëjmë tash.

Dhe, çka na ndodhë? I japim Radiotelevizionit të Kosovës 2 orë e 25 minuta mundësi për me pas reklama në ditë, me i mbyl televizionet tjera nacionale, dhe plus i japim mjete prej buxhetit. Dhe, çka ndodhë me ato mjete? Zoti kryetar, keqpërdoren!

Familjarët e pushtetarëve i marrin nga një gjysmë milioni në vit pagë. Fëmijët e drejtorëve të Universitetit paguhen nga 4 mijë euro në muaj, më shumë se deputetët, me këto pare që iu japim ne. Dhe, tash dikush po pret prej nesh me vazhduar me i votuar këto ligje. Po pret dikush me bë kësi maskarallëku në Kuvend të Kosovës. Këto, çka po ndodhin në Kuvend me vota të mazhorancës, janë paradoksale! Dhe, më falni në shprehje, janë maskarallëk! Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Vërtet, votimi ishte i pa menduar. Duhet të mendohet, të shkohet në lexim të tretë. Ju lutem, keni votuar diçka, që deputetët s'e dinë çka kanë votuar.

(Reagim)

Absolutisht, s'e dini! Dhe, nuk e kanë përgjegjësinë e votës që e kanë dhënë. Bile, bile, do të duhej kryetarët e Komisionit të jenë kundër amendamenteve që bien ndesh me Kushtetutën, me ligjin, por në fund të fundit edhe me interesin e këtyre qytetarëve. Ne nuk jemi këtu për vete, e as me ia plotësuar dëshirën kurrkujt.

(Ndërhyrje - reagime)

Jo, nuk e qes sot më në votim! Le të mësoheni të votoni! Mos e votoni ligjin, le të shkojë në votim të tretë.

Dhe, po vazhdojmë. Asnjë diskutim s'do ta kemi më. I kemi tri nene që i kemi të kontestuar dhe për to mund të votojmë.

Tani e votojmë amendamentin 8, pa përkrahje të Komisionit për legjislacion, dhe votojmë tash:

Me 44 vota për, 10 kundër, 16 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Në amendamentin 9, e kemi një shtesë nga Komisioni për buxhet dhe financa, që e ka propozuar, si në vijim:

Në nenin 22, paragrafi 4, fjalët “çdo vit RTK-ës i ndahen 0,8% të të hyrave nga buxheti i Kosovës”.

Komisioni propozon që të zëvendësohet me fjalët:

“Çdo vit RTK-ës i ndahen 0,7% të hyrave nga buxheti i Kosovës”.

Arsyetimin lidhur me këtë, do ta paraqet deputetja, kryetare e Komisionit, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për buxhet e financa, për amendamentin 9, e ka bërë një amendament të vetin mirëpo këtu nuk është përfshirë si amendament i ndarë.

Dhe, arsyeja pse ne e kemi propozuar që çdo vit RTK-ës t’i ndahen 0,7% e të hyrave nga buxheti i Kosovës ka qenë se në buxhetin e vitit 2012 është planifikuar ashtu që buxheti i RK-ës të jetë 0.7% e të hyrave nga buxheti i Kosovës, kurse një gjë e tillë është e paraparë edhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve. Arsyeja ka qenë, respektimi i Ligjit të buxhetit.

Fundja, për këtë Kuvendi merr vendim dhe ne me vendime të cilat i merr Kuvendi, jemi të detyruar të merremi më vonë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Jo, jo! Ju lutem! Hiq bile s’po shkojmë në votim.

E kemi këtu amendamentin 9, dhe Komisioni për buxhet dhe financa ka kërkuar që të mbetet si është në Ligjin për buxhetin dhe fillimisht e votojmë këtë amendament për amendament të Komisionit për buxhet e financa.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se amendamenti i shtuar i Komisionit për buxhet e financa, kaloi.

Tash i votojmë amendamentet në tërësi, pa atë pikën 4 të Komisionit funksional.

Pra, lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 43 vota për, 14 kundër dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 9.

(Ndërhyrje - reagime)

Kush ka kuptuar, ka kuptuar. Kush s’ka kuptuar, le të shkojë te shpia!

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 16, pa përkrahjen e Komisionit për legjislacion.

Arben, e ke fjalën!

ARBEN GASHI: Kryetar!

Amendamenti 16, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në kundërshtim me ligjet pozitive në Republikën e Kosovës sepse krijon asimetri, asimetri në konkurrim përpara ligjit. Domethënë, për të njëjtin institucion për dy kanale të ndryshme ka asimetri në aspektin e konkurrimit për tu bë drejtor.

Prandaj, vlerësohet se barazia përpara ligjit është një kategori kushtetuese, e cila duhet të vlerësohet dhe Komisioni ka arritur në përfundim se kjo asimetri nuk është e pranueshme dhe duhet të jetë amendamenti i cili thotë se drejtori zgjidhët me procedurë të njëjtë si drejtori për kanalin në gjuhën shqipe edhe drejtori në kanalin serb.

KRYETARI: E kemi pranuar diskriminimin pozitiv! Deputeti, kryetar i komisionit funksional, Idriz Vehapi e ka fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, për hir të arsyes së shëndoshë, nuk kam qare pa u pajtua me kryetarin e Komisionit për legjislacion.

Por, e dini se Ligji pikërisht për këtë, nuk ka kaluar një vit, për te përzgjedhja e drejtorit në kanalin në gjuhën shqipe dhe në këtë amendament e kemi bërë në konsultim me Zyrën e ICO-s, dhe si komision funksional shumica e kemi përkrahur kështu si është amendamenti 16.

Prandaj, si kryetar i komisionit, unë ju thërras që ta votoni amendamentin, edhe pse jemi pajtuar me diskriminime pozitive, qysh moti.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se është kamuflim i problemit, nëse thirrëmi në diskriminim pozitiv.

Diskriminim pozitiv, për të cilin jemi pajtuar të gjithë këtu, është që në kanalin e parë të Radiotelevizionit të Kosovës të ketë 15% emision në gjuhën serbe dhe që, diku më pak se 7% e popullsisë së Kosovës, ta kenë një kanal të veçantë.

Ky është diskriminim pozitiv dhe ne jemi për këtë diskriminim pozitiv.

Por, nuk është diskriminim pozitiv me lejuar që kanali në gjuhën shqipe me pas procedura tjera të zgjedhjes së drejtorit, e kanali në gjuhën serbe me pas procedura tjera të zgjedhjes së drejtorit.

Dhe, po ju them diçka, çka kam thënë edhe në Komision. Nëse kishim provuar me e bërë RTK-ën në këtë mënyrë, kishim me pas edhe Komisionin Evropian në Komision, edhe Ambasadën Amerikane në Komision. Kishim me pas edhe BE-në në Komision me na thënë që po i shkelni të drejtat e transmetuesit publik, për deri sa një kanal tjetër duhet me iu mundësuar politikës së një pakice drejtpërdrejt me ndikuar në zgjedhje të drejtorit.

Nuk është diskriminim pozitiv me iu mundësuar me e zgjedhur drejtorin ndryshe këta. Diskriminim pozitiv është me iu dhënë një kanal të veçantë në gjuhën e tyre. Dhe, prapë është maskarallëk çka jemi duke bërë. Nuk kemi nevojë me bërë kështu.

Edhe mazhoranca ka pas nevojë më mirë me i lypë votat e opozitës, nëse do me e kaluar këtë ligj, se sa me shkuar me u bllokuar me disa vota të veçanta dhe me thënë se çka po na ndodh neve kështu.

Ne po pranojmë me pas kanal në gjuhën serbe, dhe duhet me pas kanal në gjuhën serbe. Por, mos ta teprojnë në këtë sistem, që politika drejtpërdrejt, një politikë aktuale e Qeverisë me u përzier në njërën prej kanaleve televizive të Kosovës.

Prapë është jo parimore, është jo kushtetuese. Nuk është në frymën e Kushtetutës dhe të demokracisë së Kosovës, nëse doni me e ditë këtë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Urdhëroni! E ke fjalën, deputete Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ne, në lidhje me këtë amendament, e kemi shprehur qëndrimin shumë qartë edhe nëpër komisione, kur kemi qenë.

Unë e shikoj dhe lexoj ndryshe këtë amendament. E shikoj që një grupacion politik po kërkon t'i fusë duart në pavarësinë e editorialit të RTK-ës, nëpërmjet zgjedhjes së drejtorit.

Domethënë, ne duam që RTK-ën ta bëjmë të pavarur, sepse e dimë që politika i futë duart herë pas here. E, tani ka dalë edhe komuniteti serb që me çdo kusht kërkon që të fusë duart në zgjedhjen e drejtorit. Bile, kam informacion, se nuk janë të kënaqur me atë që është aktualisht, që është një person.

Domethënë luftë personale: kërkojnë të shndërrojnë në ligj. Kjo është totalisht e pa pranueshme. Njëra. E dyta, është edhe kundër Kushtetutës së Kosovës, dhe e treta cenon parimet e shtetit unitar.

Nuk mund të përgatiten ligje, do të thotë, brenda një ligji në dy mënyra të ndryshme zgjedhje. Kjo nuk ndodhë askund! Ky është tamam cenim i parimit të shtetit unitar. Nuk ka të bëjë me diskriminim pozitiv, por thjeshtë është shkelje e parimit dhe të ligjeve.

Mendoj se, Komisioni Evropian të gjitha vërejtjet që i ka dhënë, janë hyrë në Ligjin për RTK-ën. Dhe, po të kishte pasur ndonjë vërejtje, e kishte dhënë edhe atë vërejtje, por meqë është e papranueshme, logjikisht, nuk e ka dhënë. Kështu që, nuk është i pranueshëm ky amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vendosni me votën tuaj!

(Konsultime)

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 36 vota për, 31 kundër dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 21 dhe i fundit.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Tani, e votojmë Projektligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 42 vota për, 38 kundër dhe 3 abstenime, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Tani, do të japim pauzë deri në orën 15,00.

(Vijon pauza)

- - -

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën në ora 15,00)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë punën. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni kryetar!

Unë, në shenjë pakënaqësie për ato që po ndodhin në këtë Kuvend, e veçmas edhe para dite çka ndodhi, me vendimet që vazhdon ky Kuvend të merr kundër kushtetuese – kundër Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ne Grupi Parlamentar i LDK-ës nuk marrim pjesë në vazhdimin e kësaj seance. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Visar Ymeri, e ka kërkuar fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Njëjtë, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, për shkak të atyre që po ndodhin vazhdimisht në këtë Kuvend, e veçanërisht sot gjatë para ditës, dhe për shkak të miratimit të ligjeve që janë në kundërshtim me Kushtetutën, në kundërshtim me ligjet tjera, po edhe

për shkak të shkeljeve të mëdha të procedurës, do ta lëshojmë sallën dhe nuk marrim pjesë në punimet e këtij Kuvendi.

KRYETARI: Procedura të shkelura nuk ka pasur! Për tjerat, është çështje e juaj. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Nëse shumica në Parlament ka vendosur me proceduar kësisoj, me i kaluar ligjet në këtë mënyrë, me e shkelë Kushtetutën e vendit, me i imponuar format e punës, atëherë edhe ne nuk jemi absolutisht të interesuar me i bë nder kësaj metode të punës në Kuvend, kësaj fryme të punës në Kuvend.

Mendojmë se dikush duhet me fillu me e vë gishtin në kokë, këtu! Faleminderit!

(Deputetë të opozitës, lëshojnë sallën e Kuvendit)

KRYETARI: Faleminderit! Pra, procedurat nuk janë shkelur! Dhe, nëse ju doni me ia imponuar shumicës, është diçka tjetër, por procedurat nuk janë shkelur.

Atëherë, mirupafshim nesër, në ora 10,00!

- - -

(Seanca, vazhdoi punën të nesërmen, më 30 mars 2012, në ora 10,25)

KRYETARI I KUVENDIT: Pozita i ka 65 – 67 deputetë, prej tyre në sallë janë 45. Me 45 deputetë, ne s'mund të mbajmë mbledhje.

Kjo, edhe një herë, po tregon se shefat ose kryetarët e grupeve parlamentare të opozitës nuk janë në nivelin e përgjegjësive.

Deputetët e opozitës do të duhej të ishin në sallë dhe me ta, ose me numrin 61 e më shumë do të mund ta vazhdonim seancën. Kjo ne obligon që edhe ta mbyllim seancën.

Mirëpo, për hir të së vërtetës, duhet të them edhe një herë se opozita është dashur ta arsyetojë daljen nga salla, jo të thirret në procedura, sepse asnjë procedurë nuk është shkelur, dhe përveç vullnetit të deputetëve për të votuar, kjo nuk është shkelje e procedurës. Do të thotë, ata do të mund t'i kishin shfaqur pakënaqësitë e tyre reale, por jo të thirren në procedura, sepse procedurat nga Rregullorja e Kuvendit në përpikëri janë respektuar dhe zbatuar.

Prandaj, ne sot e mbyllim seancën, për ta vazhduar në javën e ardhshme dhe lidhur me këtë ne si Kryesi, do të bisedojmë të hënën dhe do ta caktojmë ditën kur do të mbahet seanca.

Deri atëherë, mirupafshim!

(Seanca, ndërpreu punën në ora 10,40)

- - -

(Seanca vazhdoi punën me 5 prill 2012, në ora 10,30)

(Drejton seancën, kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra të kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 29 mars 2012.

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka propozuar që në rendin e ditë të shtohet edhe pika:

- Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjet në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar,
I nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,
Meqenëse veç është bërë një ndërhyrje në rend të ditës, me një pikë tjetër, unë kam kërkuar me shkrim e po e kërkoj edhe sot këtu që në rend dite, po ashtu, të futet edhe Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, meqenëse ne në Komision e kemi kaluar me kohë dhe e kemi proceduar në Kryesi, prandaj edhe është mirë të futet për sot në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lidhur me këtë vendosë seanca. Nait Hasani, e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!
Ne si Komision, sot e kemi shqyrtuar dhe kërkoj që brenda seancës së sotme të vendoset në rend dite Projektligji për ndërtim, sepse i plotëson kushtet për seancë. Është shqyrtuar dy herë në Komision dhe sot morëm vendim që ta përcjellim për seancë parlamentare dhe ta radhisim në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e deklaramit të kryetarëve të grupeve parlamentare. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni kryetar!
Ju e dini se ne e kemi bërë një kërkesë, si grupe parlamentare të opozitës, dhe ne kërkojmë që së pari të deklarohejmë rreth kërkesës sonë për Ligjin për bankat dhe institucionet mikro-financiare që ka qenë, kushtimisht me e thënë, kusht të jetë këtu, e pastaj të deklarohejmë për të tjerat.

Nëse shkohet me këtë renditje, ne na detyroni me e lëshuar sallën përsëri. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Duke pas parasysh rëndësinë e dy projektligjeve të cilat u propozuan nga kryetarët e komisioneve, ne si Grup Parlamentar i propozojmë seancës që sot të ndryshojë rendi i ditës dhe të hiqet Ligji që ka qenë dhe të mbetet për seancën e nesërme, që propozojmë të mbahet një seancë e re, dhe sot të shqyrtohen dy ligjet të cilat janë tepër të rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ismet! Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Atëherë, po e bëj edhe më të qartë.

Futja e dy projektligjeve që kërkohet tani, është po ashtu shkelje e procedurave. Dhe, këtë që e thotë zoti Grabovci! “Po e tërheqim sot, e mbajmë nesër një seancë”! Leni këto lojëra!

Zoti kryetar,

Ky është një dallim i madh. Nëse tërhiqet Ligji dhe e tërheq Qeveria, e jo të shtyhet siç e thotë zoti Grabovci, atëherë ne rrimë në seancë. Nëse jo, vazhdoni pa ne!

Lere që është bërë shkelje te Ligji i mëhershëm dhe arsyet që dihen, por tash tentohet kjo të trashet, nëse mund të thuhet, edhe me dy veprime tjera jashtë procedurale.

Nuk thirret mbledhja e komisionit, po e zëmë te Ligji për ndërtim në mënyrë të jashtëzakonshme. Është shkelur Rregullorja, sepse katër ditë më herët duhet me u thirrë anëtarët e Komisionit. Dhe, në mbledhjen e sotme, në orën 9,30 nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e LDK-ës dhe të grupeve tjera, sa e di, opozitare.

Zoti kryetar,

Jeni kryetar i Parlamentit! Mos lejoni këto gjëra me ndodhë kësisoj. Dhe, shikoni se në çfarë mënyre thuhet tash: E shtyjme për nesër, e mbajmë një seancë, të tërhiqet ky ligji.

Po, nuk e tërheq Adem Grabovci ligjin, as Ismet Beqiri! Duhet me e tërheq ministri që është këtu dhe kjo është diçka krejt tjetër, për dallim: po e shtyjme. Prandaj, sqaroni gjërat.

Kërkoj që Ligji për bankat dhe institucionet mikro-financiare të largohet nga rendi i ditës. Të deklarohemi për këtë: Të tërhiqet nga rendi i ditës dhe jo të shtyhet. Këtë, po e them shumë qartë. Dhe, pastaj ne i kemi deklarimet për dy çështje, gjegjësisht tri tjerat. Janë dy ligje dhe informata e zotit ministër Rexhepi.

Nuk shkojnë këto në pako! Dhe mosni kësisoj, sepse atëherë e vazhdoni pa ne. Faleminderit!

KRYETARI: Ne i kemi dy kërkesa të dy kryetarëve të komisioneve. Urdhëroni, e ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!

Natyrisht se kërkesa jonë ka qenë që ky Ligji për bankat mos të vjen në rend dite fare. Dhe kundërshtimi ynë ka qenë edhe për mënyrën se si është proceduar ky ligj në Kuvend, në seancën e kaluar, por më shumë ka qenë edhe për natyrën e Ligjit.

Dhe tash, kjo kërkesë për ta shtyrë për një ditë, kjo nuk e ndryshon fare ligjin, madje – madje e bën edhe një, të them ashtu, shpërfillje të plotë të procedurave. Pra, këtu tash është bërë si fontanë dëshirash ky Kuvendi, me propozime më të çuditshme. Pra, “nuk po e diskutojmë sot, po e diskutojmë nesër, nuk po e shtyjme për sot, por e shtyjme për nesër”.

Kjo mendoj se nuk është as në frymën e as sipas rregullave të procedurave që duhet t’i ketë një parlament. Dhe, rrjedhimisht ky kundërshtim yni i javës së kaluar e ka pasur pikërisht këtë qëllim: që ta normalizojmë punën në Kuvend. E në ndërkohë, këtu sot po propozohet që këtë ç’normalizim të punës ta vazhdojmë tutje dhe ta thellojmë, që është absolutisht e papranueshme.

Po ashtu, edhe me këto dy ligjet tjera, veçanërisht me Ligjin për ndërtim, që u përmend nga zoti Beqiri dhe s’kam pse t’i përsëris çka ka thënë, por vetëm po dua të them edhe një gjë që as përfaqësuesi i Vetëvendosjes nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit.

Në atë mbledhjen që kemi marrë pjesë, e kemi vërejtur se Ligji për ndërtim është në fakt në vi me Ligjin për bankat, ose rregullimin që e propozon ai për institucionet mikro-financiare, e në shumë aspekte është edhe më i dëmshëm se ai.

Dhe kjo mënyrë e ngutisë këtu që ta procedojmë në Kuvend këtë ligj, kur sot ka marrë vendim Komisioni dhe sot deputetët e kanë marrë vendimin e Komisionit, po na duket përveç se e panevojshme, absolutisht e papranueshme.

Prandaj, po që se procedohet kështu, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, del nga salla dhe nuk merr pjesë në këtë seancë.

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të AAK-ës, deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht, më duhet të them se radha ka qenë që të zgjidhet fillimisht problemi i cili ka ekzistuar të enjten, do të thotë që ju të propozoni ashtu siç, po supozoj, jemi marrë vesh që të tërhiqet nga rendi i ditës Ligji për bankat dhe institucionet mikro-financiare, i cili e ka shkaktuar problemin në seancën e fundit dhe atëherë të propozohen tema tjera, të cilat u propozuan nga dy kryetarët e komisioneve.

Çështje tjetër është se prapë po krijohet përshtypja se ky është një truk që sot ta kalojmë një problem dhe nesër ta kthejmë të njëjtin problem prapë në seancë plenare.

Mendojmë se kjo Qeveri dhe kjo shumicë, duhet me kuptuar se nuk mundet çdo ligj me ardhë me procedurë të përshpejtuar, se nuk është çdo gjë urgjente, se nëse çdo gjë është urgjente në një vend, atëherë institucionet nuk po munden me punuar dhe gjithçka po iu del përpara në momentin e fundit, kur ne po ballafaqohemi me situata jashtëzakonisht emergjente.

Mendojmë se kjo nuk është mënyrë për me udhëheq me vendin, as me udhëheq me shtetin. Dhe mendojmë që, nëse vazhdohet kështu, atëherë institucionet e Kosovës po shndërrohen në institucione të cilat vetëm e ngrisin dorën dhe vetëm bëjnë diçka për të cilën as vet nuk janë të qartë ose të vetëdijshëm se çka po ndodhë.

Edhe ne do të veprojmë sikur dy grupet tjera parlamentare në opozitë. Mendojmë se me mënyra të këtilla po e ç'respektojmë vetveten, po bëjmë që askush të mos na respektojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Shefja e Grupit, zotëri Jakup Krasniqi!

Duke marrë parasysh se kërkesat e dy kryetarëve të komisioneve parlamentare për futjen në rend të ditës të Ligjit për ndërmarrje publike, edhe pse Ligji për ndërmarrje publike dihet se ka ardhur me pakon e presidentit Ahtisari dhe për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë ai ligj duhet të amendamentohet të pësojë plotësim-ndryshim dhe Ligjit për ndërtim, mund të qitet në votim dhe të shihet se a janë të pajtimit të gjithë deputetët që të procedohet me këto dy projektligje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-ës, Sasha Millosavljeviq, e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

I Samostalna liberalna stranka prihvata predlog da se ova dva nacrtta zakona uvrste u dnevni red današnje Skupštine, jer smatramo da su od velike važnosti za kosovsko društvo.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 6+, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna grupa 6+ se slaže sa novopredloženim dnevnim redom za današnju sednicu.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Halit Krasniqi!! Deputeti, Halit Krasniqi, e ka fjalën!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar! Faleminderit, edhe për korrigjimin!

Edhe pse u bë, pa dashje, një objekt tallje në favorin e një deputeti dhe në dëm të tij, mua po më vjen mirë që i shoh pozitë dhe opozitë duke buzëqeshë dhe u krijua një moment relaksues dhe besoj se edhe qasja e këtyre diskutimeve do të ndryshojë.

Në propozimet e dy kryetarëve të komisioneve, unë reagoja menjëherë dhe e kërkoja fjalën, duke mos e pëlqyer propozimin por kur e dëgjova propozimin e kryetarit të grupit parlamentar, unë u tërhoqa nga propozimi që doja ta bëja dhe tani nga diskutimet që i dëgjova prej grupeve parlamentare e kisha një kërkesë si deputet që e marr këtë të drejtë në bazë të Kushtetutës, neni 70, që të bëjë një konsultë me kryetarët e grupeve parlamentare opozitare dhe të gjej një marrëveshje e një kompromis që kjo mbledhje të shkojë në një frymë konstruktive dhe ashtu sikur e domi ne, ashtu siç e kërkojnë qytetarët dhe ashtu siç jemi të ngarkuar me Kushtetutë. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Krasniqi!

Unë po propozoj ta kemi një pauzë prej 20 minuta. Kryetarët e grupeve parlamentare dhe ministri i Financave le të vijnë te unë dhe të bisedojmë e merremi vesh për çka të bëjmë më tej.

(Ndërhyrje)

Po ta jap fjalën, por të bisedojmë një herë, të merremi vesh e të kthehemi. Unë mendoj se mund të merremi vesh. Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar.

ISMET BEQIRI: Kryetar!

OK! Do të vi për hak, siç thuhet, tuajin dhe për hir të respektit. Por, edhe një herë po e them publikisht.

Mos luani me ne! Keni thënë që do të tërhiqet Ligji për bankat që në fillim. Nuk po e bëni këtë, atëherë dikush, s'po them ju, na ka rrejt. Dhe, ky vazhdimi i konsultave kësisoj, po e them jo për të paragjykuar çfarë thonë tjerët, por rezultati është i njëjtë.

Unë vi në emër të Grupit, por nëse s'tërhiqet Ligji, në fillim i bankave, ne nuk vazhdojmë më tutje të jemi prezentë. Faleminderit!

KRYETARI: Unë po them, takohemi e bisedojmë dhe kthehemi këtu bashkë të marrim vendim. Tash e kemi një pauzë të shkurtër!

(Vijon pauza)

- - -

(Pas, pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT: Deputetë, të nderuar, po vazhdojmë punën! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi këtë qëndrim, zoti kryetar.

E para, që Ligji për bankat të tërhiqet nga rendi i ditës, dhe e dyta që dy ligjet e propozuara sot të shqyrtohen në procedurë të rregullt javën e ardhshme. Nëse kjo ndodhë ne rrimë në sallë. Me këtë respektohen edhe procedurat sepse janë shkelur edhe procedurat edhe për dy ligjet e propozuara, zoti kryetar. Le të thirren mbledhjet e Komisionit në mënyrë të rregullt, të mbahen javën e ardhshme, Grupi Parlamentar i LDK-së është në seancë, po flas për dy ligjet e propozuara sot.

Ndërkaq, qëndrimi ynë sa i përket Ligjit për bankat dhe institucionet mikro-financiare mbetet i pandryshuar, nëse s'i kthehet Qeverisë dhe nëse nuk ndahet në dy pjesë, ashtu siç është thanë.

Ndërkaq, për këto dy ligje të tjera, ne nuk jemi të interesuar të bllokojmë punë, por të respektohet procedurat, kjo mund të bëhet javën e ardhshme. Unë jam i bindur sikur edhe të tjerët që ne nuk jemi në luftë dhe kjo punë mund të bëhet edhe javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Edhe kërkesat tona mbesin ato të njëjta siç ishin edhe para pauzës, nuk ka ndryshuar asgjë, pra Ligji për bankat duhet të tërhiqet edhe këto dy ligje tjera që na erdhën kaq befasisht në seancë nuk duhet të pranohen dhe të procedohen sipas procedurës normale. Pra, ta përjashtojmë një herë e përgjithmonë këtë procedurën e përsheptuar. Natyrisht se këto dy ligje veçanërisht për Ligjin për ndërtimin, ne jemi kategorish kundër, mënyrën se si është bërë ajo dhe se çka paraqet, por do ta bëjmë këtë edhe në vazhdim, domethënë, në punën e Kuvendit. Mirëpo, po që se ky rend dite siç është sot, nuk ndryshon me këto pika që i përmenda, atëherë edhe Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” e ka të pamundur të rrijë në seancë.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se të gjithë deputetët në sallë e kanë të qartë se çka duhet të përmbushë Kosova. Sidoqoftë, kushdo që kërkon prej nesh t'i plotësojmë disa kushte e në vazhdimësi ka kërkuar prej nesh që ta respektojmë demokracinë. Dhe mendoj se kushti kryesor i këtij Kuvendi duhet të jetë që të respektohen procedurat dhe demokracia, për shkak se këto nuk na qojnë në rrugë pa u krye, respektimi i procedurave të demokracisë nuk na qon në asnjë variant në ndonjë situatë të keqe dhe mendojmë se kjo demokraci dhe këto rregulla duhen të respektohen.

Edhe ne siç u morëm vesh me grupet tjera mendojmë se duhet të tërhiqet Ligji për bankat dhe financat të rregullohet ashtu si jemi marrë veshë dhe dy ligje tjera që kanë ardhur sot të procedohen në mënyrë të rregullt dhe javën tjetër mund të mbajmë seancë ku do të jemi të gjithë, do t'i shqyrtojmë dikush do të votoj “pro”, dikush do të votoj “kundër”

edhe mendoj se në atë mënyrë e zgjidhim këtë situatë në Kuvend. Nëse nuk procedohet kështu edhe ne do të veprojmë si dy grupet tjera parlamentare në opozitë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne e dimë se dy- tri ligjet të cilat i kemi, po kërkojmë që të hyjnë në shqyrtim, janë ligje të cilat kanë afate të caktuara, janë ligje të cilat i hapin perspektivën vendit tonë, janë dy ligje që sot kërkuar komisionet parlamentare për të hyrë: Ligji mbi ndërtimin dhe Ligji mbi ndërmarrjet publike, janë ligje që përmbushin kriterin për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, që vlerësoj se është në interes të çdo qytetari të Kosovës, jo vetëm në interes të Partisë Demokratike, apo të ndonjë grupimi politik, por është në interes të krejt qytetarëve të Kosovës dhe i hap perspektivën këtij vendi.

Ligji i dytë mbi bankat, po ashtu është një ligj tepër i rëndësishëm, që sot ne edhe me zëvendëskryetarin e Bankës Botërore, që kishim takimin e përbashkët, me gjithë shefat e grupeve parlamentare, dëgjuam se ruajtja e raporteve me Fondin Monetar Ndërkombëtar është tepër i rëndësishëm dhe ne si Qeveri si Grup Parlamentar dhe si institucione dhe si qytetarë, besoj të gjithë jemi të interesuar që t'i kemi dhe kemi vlerësuar shumë lart anëtarësimin në Fondin Monetarë Ndërkombëtar, kemi vlerësuar si një fitore shumë të madhe që realisht është e tillë, prandaj, ne e lusim opozitën që t'i ketë parasysh interesat madhore të qytetarëve të Kosovës, të shkelim mbi interesat partiake dhe të jemi bashkë në marrjen e vendimeve për hapjen e rrugës së perspektivës.

Grupi Parlamentar i PDK-së është i gatshëm që të shtyhet pika e parë e rendit të ditës, Ligji për bankat, ndërsa dy ligjet e tjera të shqyrtohen se është shqyrtim në parim dhe të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët kanë kohën e mjaftueshme për t'i dhënë sugjerimet, vërejtjet, plotësimet e tyre deri në afatin e aprovimit përfundimtar.

Prandaj, ne jemi të gatshëm që, po e ritheksoj, Ligji për bankat mund të shtyhet, ndërsa dy ligjet e tjera të aprovohen sot.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Një gjë që duhet ta them është, ne dëshirojmë t'i respektojmë procedurat, se procedurat janë domosdoshmëri e funksionimit demokratik të një institucioni. Por në Rregulloren e punës sonë për dy çështje që po diskutojmë e rregullon këtë çështje. Neni 84 thotë se mund të anashkalohet Rregullorja dhe seanca mund të marrë vendim me 2/3 e deputetëve prezentë dhe nëse një çështje do të shmangej nga Rregullorja dhe votojnë 2/3 e deputetëve prezentë, një çështje mund të hyjë në rend të ditës dhe kjo është procedurë që e parasheh Rregullorja e Kuvendit.

Edhe një çështje tjetër, neni 50 i Rregullores së Kuvendit, parasheh mundësinë që në çdo kohë një grup parlamentar të bëjë kërkesë për t'u hequr një çështje nga rendi i ditës për tu ndërprerë debati për të vazhduar seanca, këto janë çështje që janë procedurale dhe vendos seanca, nuk vendos drejtuesi i seancës, as nuk vendo veç një grup parlamentar, por kërkesa mund të jetë vetëm e një grupi por vendimmarrja është e seancës. Kështu që

nëse kemi parasysh këtë çështje mendoj që procedurat ne mund të merremi vesh t'i shmangemi një çështje nëse votojnë 2/3 e Kuvendit. Ne kemi 3 pika të rendit të kontestuar. Nëse kemi parasysh se kjo është vazhdimi i seancës, por megjithatë për njëherë ka vendos Kryesia me mundësi që ministri i Punëve të Brendshme me bë një informatë mbi të cilën do të debatohet në Kuvend, kjo është paraparë nga Kryesia e Kuvendit. Nga 2 komisione kemi kërkesë për të futë dy çështje në rend të ditës dhe ne si Kuvend kemi të drejtë t'i shmangëm kësaj por nëse votojnë 2/3 e deputetëve prezentë. Këto janë çështje të precizuara në Rregulloren të Punës së Kuvendit dhe nëse seanca merr një vendim për t'iu shmangur Rregullores, kjo është e drejtë e Kuvendit nuk është e drejtë e askujt, por e deputetëve prezentë. Urdhëro, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Ju e thatë shumë mirë, ne nuk po dëshirojmë të futemi në votim me 2/3 për t'u shmangur nga procedura, sepse s'i keni votat dhe ne po dëshirojmë që kjo të bëhet në procedurë të rregullt javën e ardhshme për këto dy ligje për të cilat folëm.

Sa i përket ligjit të parë, këtu s'kemi çka të bisedojmë. Puna e parë që ju do ta bëni, zoti kryetar, sepse ka qenë një marrëveshje interne nëse mund të thuhet kështu që Ligji për bankat dhe institucionet mikro-financiare të tërhiqet.

Tërhiqeni këtë, shtyni për javën e ardhshme këto dy ligje, mos i shtini në votim se 2/3 nuk i keni. Ne po i themi këto në mënyrë deklarative, sepse kur të votohet e që s'e fiton të futet në rend të ditës, ti atë as javën e ardhshme nuk mundesh t'i radhitësh në rend të ditës.

Prandaj, ky është tentimi yni për të ndihmuar, dhe nëse nuk dëshirohet në këtë mënyrë me u ndihmua që dy ligjet për të cilat u propozuan të bëhen javën e ardhshme dhe ky i bankave të shtyhet, gjegjësisht të tërhiqet, atëherë procedoni edhe e shihni rezultatin.

Po unë po e them atë që ishte në deklaratimet tona dhe më shumë e mora edhe fjalën për tjetrën. Nuk duhet me na moralizua për interesat shtetërore të vendit tonë. Ne nuk po u referohemi partive me thanë: ju po e bëni për interesa partiake! Prandaj, nuk është koha as të na moralizoni, as të na thonë se çka duhet bërë për shtetin e çka për partinë.

Prandaj, i kemi të qarta obligimet tona dhe pikërisht duke i pasur të qarta, edhe po veprojmë në mënyrë institucionale dhe obligimet që janë marrë nga kjo Qeveri, do të kryhen, sepse as që na kanë pyetur kur i kanë marrë edhe do obligime karshi FMN-së.

Ne jemi dakord, po dëshirojmë të japim kontributin tonë por të tërhiqet Ligji për bankat, të shtyhen për javën e ardhshme këto dy të tjerat. Ky është qëndrimi ynë.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të Aleancës, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë një eko e kërkoja më herët fjalën për këtë pjesën e moralizimit për interesa partiake, për interesa për të ardhur në pushtet. Partia Demokratike e Kosovës i ka prishur

marrëdhëniet me FMN-në, vetëm për atë interes, për kurrfarë interesi tjetër, e tash zoti Grabovci po na thotë neve për interesa të vendit duhet ndrequr, nuk bën kështu, nuk bën me kesi farë cinizmi të na drejtohet neve. Vetë i kanë prishur marrëdhëniet për të fituar vota, për të ardhur në pushtet i kanë prishur marrëdhëniet, tash po thotë dilni prej interesave partiake, nuk bën kështu.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, Unë po jap edhe një mundësi, po kërkoj nga grupet parlamentare që të bisedojnë edhe një herë për këto çështje dhe pas gjysmë ore, le të na kthehen me qëndrimet. Kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e kërkoja fjalën më herët, me gjasë nuk më keni parë. Po, kjo që po thuhet këtu, në fakt kur po flasim për interesin e vendit e kështu me radhë, interesin madhor të qytetarëve, kam përshtypje se nganjëherë, ose s’po e kuptojmë fjalën çka është interes edhe madhor, ose qëllimisht po e ri interpretojmë atë.

Po a mund të thuhet që është në interes të një shteti që me një ligj të caktuar t’i shkelim ligjet tjera, a mund të thuhet që është në interes të një shteti që për një çështje të caktuar, për një interes të kujt do qoftë të shkelën, shpërfillën dhe shtrembërohen procedurat të cilat mëtojnë ta sigurojnë një veprim demokratik në institucionet e Kosovës, në këtë rast, Kuvendin e Kosovës.

E përfundimisht a mund të jetë në interes të një Republike parlamentare që Kuvendi të shndërrohet në një instrument ku vetëm merren dhe insistohet që të merren votat për çështje të caktuara që i interesojnë ose Qeverisë ose ministrit të caktuar e shpeshherë edhe qarqeve që nuk janë fare pjesë e këtyre institucioneve.

Dhe, përfundimisht po them a mund të jetë në interes të vendit që ne vazhdimisht të veprojmë në skenën politike duke arsyetuar veprimet tona, as me arsyen tonë e as me interesin e qytetarëve, po me tryshinë që na vjen nga jashtë nga iks personi, nga iks institucioni ose nga ipsilon njeriu.

Pra, këto nuk janë në interes të vendit dhe përfundimisht mendoj që ne duhet të fillojmë të veprojmë ndryshe në këtë institucion. Duhet ta kemi parasysh që institucioni më i rëndësishëm në demokracinë parlamentare është pikërisht parlamenti dhe ky është institucioni i fundit të cilin s’duhet ta përqeshim dhe atë ta shndërrojmë në kesi lloj teatri, qysh kemi tendencë nganjëherë këtu ta kemi.

Pra, askush këtu nuk e arsyetoi pse janë aq të rëndësishme këto ligje të cilat po kërkohen të futen në rend të dite, askush nuk na tha dhe shpjegoi qartë që Ligji për bankat i cili qartazi edhe i shkel ligjet tjeram por edhe është i kundërshtuar nga shumë qarqe në Kosovë, pse ky domosdoshmëri duhet të jetë në formën të cilën është për ta përmbushur kërkesën e FMN-së. Dhe, unë mendoj që para se të flasim për kërkesat e FMN-së e të tjerëve, ne duhet të flasim për atë se çka i intereson Kosovës dhe duhet të flasim për vendin të cilin po dom ta ndërtojmë në Kosovë.

Unë personalisht, por edhe ne si Grup Parlamentar, nuk mendojmë se Kosova duhet të jetë një vend i cili vepron vetëm sipas trysnive, nuk duhet të veprojmë fare sipas trysnive dhe duhet ta mbrojmë interesin e vendit tonë edhe nëse kjo kërkon nganjëherë ballafaqim me të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni, më lejoni se unë jam duke udhëhequr seancën! Po kërkoj një takim me nënkryetarët e Kuvendit dhe tash e kemi një pauzë prej 30 minutash.

(Vijon pauza)

- - -

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar, deputetë, po vazhdojmë seancën. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë propozoj që pika e rendit të ditës që ka qenë e paraparë, Ligji për bankat, të tërhiqet deri në një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe akterët e tjerë do të bëjnë përpjekje që të gjejnë një marrëveshje dhe në seancën tjetër pastaj të vendosim. Dhe, propozoj që dy pikat e para, pra Ligji për ndërtimin dhe Ligji për ndërmarrjet publike të jenë pikat e para të rendit të ditës dhe propozoj që pika në të cilën do të raportojë ministri i Punëve të Brendshme të jetë pas këtyre dy pikave, pas aprovimit në parim të këtyre dy ligjeve.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse se një kërkesë që ka qenë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e Grupit Parlamentar, që të tërhiqet Ligji për bankat dhe institucionet mikrofinanciare, u propozua edhe nga vetë udhëheqësi i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe që besojmë se kjo seancë do të vendosë kështu që të tërhiqet, ndërkaq, për dy ligjet tjera po ashtu le të vendos sipas procedurës në seancë.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri, kryetar i Grupit!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” mbetet në qëndrimet e veta të mëparshme. Ne edhe nuk e pranojmë që ta votojmë këtë Ligjin për bankat dhe institucionet mikrofinanciare për arsyt të cilat i kam përmendur edhe absolutisht jemi “kundër” që këto dy ligje që u propozuan sot të futen kështu në rendin e ditës së këtij Kuvendi.

Ne mendojmë që kjo është mënyra se si Kuvendi bëhet vërtetë Kuvend. Nuk mendojmë që Kuvendi ka të drejtë të votojë me shumicë votash që ta shkelë veten dhe nuk

mendojmë që Kuvendi edhe deputeti ka të drejtë që me shumicë votash, po ashtu, ta transformojë natyrën edhe rëndësinë e një institucioni çfarë është ky. Përfundimisht ne insistojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës vërtet të jetë Kuvendi i Republikës së Kosovës, t'i përfaqësojë qytetarët e Kosovës, t'ua mbrojë atyre interesin dhe t'ua mbrojë atyre vullnetin politik dhe jo të jetë institucion i cili vendos në bazë të asaj që dikush tjetër mund ta servojë si interes i Kosovës. Dhe, duke pasur parasysh që po veprojnë në kësi kushte dhe duke pas parasysh që kjo seancë pak a shumë u pajtua që këto dy ligje të futen në rendin e ditës, atëherë Grupi Parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje" e lëshon sallën dhe nuk merr pjesë në të.

KRYETARI: Faleminderit!

Rregullorja i përcakton të gjitha procedurat, ne e respektojmë Rregulloren. Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Përderisa të procedohet në bazë të marrëveshjes që arritëm, do të vazhdojmë. Është në rregull që është tërhequr Ligji për bankat. Ligjet tjera do të procedohen dhe le të votojë seanca.

Po ashtu, mendojmë se nuk ka nevojë që këto dy ligje të reja, të cilat sot hyjnë në rend të ditës të jenë të parat. Mendoj se mund të procedojmë me raportin e ministrit të Brendshëm dhe pastaj të vazhdojmë me dy ligjet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicionit për Kosovë të Re deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke përshëndet marrëveshjen e cila u arrit që të hyjnë dy projektligjet sot në lexim të parë dhe të hyjnë në rend të ditës, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të "6+" deputeti dhe kryetari i Grupit Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit! I nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar "6+" është që këto dy projektligje të futen në rend të ditës me propozimin që Ligji për bankat dhe institucionet mikrofinanciare të mos hyjë sot në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit SLS? Atëherë, deputeti Murselj Haljilji në emër të Grupit SLS-së.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedniče Skupštine!

I mi čemo podržati ovaj predlog, dakle nastavljamo sa radon, što se tiče poslaničke grupe SLS-a.

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë i kemi dy mocione.

Në sallë kemi 87 deputetë.

Votojmë për heqjen nga rendi i ditës të Ligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Lus një votim formal. Kush është “për”? Faleminderit!
A ka “kundër”? Një “kundër”. Faleminderit!

Tani kemi futjen në rend të ditës të dy projektligjeve, si vijon:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike; dhe

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërtim.

Procedura kërkon që me votën e 2/3 të deputetëve prezentë këto dy ligje mund të hyjnë në rend të ditës.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 57 vota “për”, 15 “kundër”, 4 abstenime, që do të thotë se i kemi 2/3-at e votave miratohen.

Atëherë, kalojnë dhe hyjnë në rend të ditës këto projektligje. Faleminderit!

Kemi ri-kërkesën e Grupit, nga kryetari i Grupit të Aleancës, që ligjet të mos jenë para debatit. Edhe unë mendoj që shkon debati dhe pastaj ligjet, a jeni dakord?

(Ndërhyrje)

Jo, drekën e bëjmë në orën 14:00. Mirë, hajt vazhdojmë me ligjet, pastaj pas dreke debatin. Ardian, a bën kështu? Mirë! Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, dhe Industri deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar javën që shkoi këtë projektligj. Meqenëse është miratuar nga Komisioni, i kërkojmë Kuvendit që ta miratojë, po ashtu, i thërrasim edhe grupet parlamentare që ta miratojmë dhe t'i japim shanse pastaj komisioneve që ta trajtojnë në vijim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ministër a ke çka thua për ligjin?

Fjalën e ka ministri Besim Beqaj, për Ligjin për ndërmarrjet publike.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar, deputetë,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni të paraqes para jush sot Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, për aprovim në parim.

Ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, shpallur në Gazetën Zyrtare numër 31, më datë 15 qershor 2008 dhe është i paraparë në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2012. Me këtë ligj është përcaktuar korniza ligjore lidhur me pronësinë e ndërmarrjeve publike dhe qeverisjen e tyre koorporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, si dhe me raportimin dhe përgjegjësinë mbi mbikëqyrjen e aktiviteteve të ndërmarrjeve publike.

Amendamentimi i këtij ligji do të ndikojë në avancimin e qeverisjes koorporative në përputhje me parimet e organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik. Po ashtu, është paraqitur edhe nevoja për ndryshime konkrete që kanë të bëjnë me transferimin e përgjegjësisë nga ish- Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, rritjen e nivelit të mbikëqyrjes ndaj funksionimit të ndërmarrjeve publike në harmoni me parimet e qeverisjes koorporative, auditimin e ndërmarrjeve publike posaçërisht auditimin nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, që në ligjin aktual kjo nuk ishte paraparë dhe ligji i deri tanishëm mbi ndërmarrjet ishte në konflikt me Ligjin për auditorin e përgjithshëm, rritja e rolit të komunave në menaxhimin e ndërmarrjeve publike rajonale, sidomos tek ujësjellësit dhe kompanitë e ujitjes në komponentët si në vijim: raportimi 3 mujor dhe raportimi vjetor në plotësim- ndryshim të Ligjit mbi ndërmarrjet publike në të ardhmen do t'u bëjë të mundur edhe kryetarëve të komunave një pjesëmarrje më të fuqishme.

Dhe, kjo shkon në këtë drejtim: plani i biznesit do të hartohet në përputhje me politikat zhvillimore të komunave ku këto ndërmarrje kryejnë veprimtarinë e tyre. Përfshirja e komunave do të bëhet edhe në bordet e ndërmarrjeve në nivel 50% përmes procesit konkurrues i cili do të shkojë konform procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të bordit të këtyre ndërmarrjeve.

Themelimi i ndërmarrjeve lokale publike do të mundësohet nëpër komuna pas paraqitjes së arsyeshmërisë nga komunat mbi qëndrueshmërinë operative dhe financiare të kompanive të reja për themelim. Dhe, normalisht kemi edhe plotësimin e listës 2, që ka të bëjë me ndërmarrjet publike lokale, me stacionet e autobusëve me pronarë komunat, që aktualisht janë nën administrimin e AKP-së. Në listën 1 të ndërmarrjeve publike qendrore janë edhe dy kompani të reja dhe ndarja e hekurudhave, ajo që merret tani me operim Train Kos dhe ajo që ka infrastrukturën Infra Kos. Me miratimin e këtij projektligji krijon mundësi për rritje të efikasitetit dhe menaxhimin më të mirë të ndërmarrjeve publike si pasuri e shtetit, krijimin e niveli më kualitativ të shërbimeve publike për qytetarët, rritjen e kontrollit të brendshëm dhe avancimin e qeverisjes koorporative të këto ndërmarrje.

Prandaj, unë lus seancën e Kuvendit që ta ketë parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe ta miraton sot në parim këtë projektligj. Faleminderit!

(Kryeson seancën, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësues të grupeve parlamentar në qoftë se duan fjalën kryetarët. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah dhe u bën thirrje të gjithë deputetëve që të votojnë në parim këtë projektligj dhe pastaj nëpërmes të komisioneve dhe të procedurave të mëtutjeshme, do të japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së e ka fjalën deputetja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Këto ligje hyjnë qysh hynë në rend të ditës, ne nuk mund të flasim shumë për përmbajtjen e ligjeve veç dimë të themi se të vetmet ndryshime që duhet bërë ndërmarrjet publike është: duhet luftuar korrupsionin, e korrupsioni nuk luftohet duke ndryshuar ligje, por luftohet duke vu njerëz e pa korrumpuar ta luftojnë korrupsionin. Ndërmarrjet publike me ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, radhiten ndër të parat për korrupsion. I vetmi ndryshim është ky që duhet edhe kërkohet prej ministrive që janë kompetente që të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i kenë nën kontroll. Ne kemi dy forma që po mundohemi t'i luftojmë krejt dukuritë negative përmes shitjes së aseteve publike edhe përmes ndryshimit të ligjeve.

Ne këtë ligj e kemi ndryshuar vitin e kaluar tash paskemi ardhur në përfundim se na duhet ta ndryshojmë prapë. Deri kur ma kështu me ligje për ndryshim të ligjeve? Edhe ata që duan t'i respektojnë këto ligje kanë shumë problem. Se të shkosh dhe ta kërkojë një ligj në internet ose në Gazetë Zyrtare, një ligj e kemi në dhjetë dokumente, sepse e kemi ndryshuar 100 herë. Ai që do ta respektojë e merr një dokument, mendon që ai është ligji, kështu që kurrfarë pune s'jemi duke bërë, kurrfarë vlere s'jemi duke krijuar për shoqërinë kosovare. Ju lutemi, boll ma me këto! Lidhja Demokratike e Kosovës do ta votojë "kundër" këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Gjini, kryetari i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se ky ligj tanimë po kalon në lexim të parë dhe krejt çka mbetet të thuhet është që gjithë deputetët dhe gjitha komisionet parlamentare, duhet të kenë kujdes të shtuar në leximin e dytë, në mënyrë që krejt çka mund të ndryshojmë për të mirë, ta bëjmë sa më saktë që të jetë e mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, deputeti Sasha Millosavljeviq. E pash, po e ka tërhequr fjalën një herë. Atëherë, e ka fjalën kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke e marrë parasysh se Ligji për ndërmarrjet publike ka ardhur me pakon e presidentit Ahtisari dhe gjatë zbatueshmërisë së këtij ligji është parë mjaftë mirë që ka probleme dhe pas nënshkrimit të një marrëveshje mes gjithë liderëve të partive politike për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, ky ligj vjen në plotësim- ndryshim.

Ministri e sqaroi çështjen e projektligjit ku do të ketë plotësim- ndryshime dhe mund të themi se është fatbardhësi që më në fund ky ligj vjen në seancë plenare dhe gjatë draftimit në leximin e dytë shihet qartë se do të kemi mundësi që t'i plotësojmë shumë çështje, të cilat gjatë implementimit të këtij ligji nuk i kanë mundësuar as komunave, as ekzekutivit të punojnë në atë mënyrë çfarë kanë dashur ata të punojnë për arsye se ligji nuk ka lejuar. Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah ligjin dhe gjithë punën e vet do ta jap në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, zoti Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj nacrt zakona u načelu, jer smatramo da je od izuzetnog značaja pogotovu za sve opštine na Kosovu, i kao što sam rekao podržaćemo zakon u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Nga „6+“, deputeti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit! I nderuari kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar „6+“ në parim do ta miratojë këtë Projektligj për ndërmarrjet publike, ndërsa kontributin e vetë do ta jep përmes punës së komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Mendoj se në debatet e ardhshme në komisione, por edhe në këtë Kuvend, duhet të analizojmë thellësisht çështjen e aksionarit, kush duhet ta luajë rolin e aksionarit të ndërmarrjeve publike? Sipas këtij ligji aksionar është Qeveria. Unë mendoj se ndërmarrjet publike, për shkak të rëndësisë së tyre edhe implikimeve të gjëra që kanë: sociale, financiare etj. kanë një rëndësi të gjerë shoqërore dhe për menaxhimet dhe qeverisjen e tyre duhet të ekzistojë një konsensus bazik minimal në shoqëri, i cili mund të arrihet në Kuvend.

Prandaj, parimisht rolin në aspektin e të drejtave të pronësisë, në aspektin e të drejtave të marrjes së vendimeve strategjike mbi pronësinë edhe mbi zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve, duhet ta mbajë Kuvendi i Kosovës. Unë po mendoj se kjo çështje duhet të fillojë të diskutohet dhe rrjedhimisht edhe anëtarët e bordeve të këtyre ndërmarrjeve duhet t'i emërojnë Kuvendi i Kosovës.

Gjithashtu, ne kemi bërë një përparim me konkurset që shpallen, por kjo ka ngelë në gjysmë të rrugës.

Mendoj se, për shkak të përmirësimit të qeverisjes kooperative, sipas parimeve të OCD-së, të cilat i theksoi edhe ministri këtu, ne duhet t'i shohim këto sepse ne këto po i marrim vetëm si në mënyrë deklarative, por këto kërkojnë vërtet që anëtarë të bordit të jenë njerëz që nuk janë partizanë politikë dhe nën dy të kenë nivel profesional. E nën tre, në në shumë vende të botës, po aplikohet edhe një lloj certifikimi i nivelit profesional i atyre që mund të shërbejnë si anëtarë të bordeve, të cilët duhet t'i njohin: çështjet financiare, ekonomike e juridike, pra duhet të kenë një integritet profesional dhe një integritet moral dhe etik.

Në këtë drejtim, mendoj se është rasti që ne t'i shohim këto zgjidhje, të cilat janë në këtë fushë, në këtë segment dhe gjatë diskutimeve të mëtejme të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë.

Gjithashtu, nuk jam i sigurt se ne ligj ne duhet theksuar që komiteti qeveritar për privatizim do të përfshijë ose do të përkrahet nga këshilltarë të jashtëm profesional. Mendoj se në këtë mënyrë ne nuk mundemi në ligj t'i fusim këshilltarët e jashtëm profesional. Natyrisht, askush nuk i pengon, as Qeverinë, as komitetin, as Komisionin që të angazhojë këshilltarë, por futja e tyre në ligj po më duket që është artificiale dhe e tepruar.

Prandaj, unë kërkoj që kjo çështje të analizohet, a ka nevojë të jetë kështu, a jo? Ju faleminderit, po përfundoj me këto dy vërejtje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë veç e mora fjalën ta bëj një sqarim për opinionin publik po edhe deputetët tjerë që janë këtu.

Ky ligj është ligj që është miratuar me procedurë të shpejtë me ligjet e pakos së Ahtisaarit dhe për herë të parë i nënshtrohet plotësim-ndryshimit në këtë legjislaturë dhe në këtë vit kalendarik. Nuk besoj që është ndokush prej grupeve parlamentare që nuk do të pajtohet për t' i hyrë plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve të pakos së Ahtisaarit, sepse janë 4 vjet që kanë kaluar dhe tani duhet përshtatur rrethanave edhe politike edhe ekonomike të Kosovës.

Prandaj, ftoj të gjithë kolegët deputetë, që ta miratojnë në parim këtë ligj dhe kontributin e tyre ta japin gjatë fazës së amendamentimit përmes komisioneve funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit që ia shkarkove punën edhe zotit ministër, se ky kishte për të na sqaruar. E votojmë ligjin në parim dhe e vë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Në sallë janë 86 deputetë.

Faleminderit!

Konstatohet që me 59 vota "Për", 16 "kundër", 1 abstenim, Kuvendi miratoi projektligjin për ndërmarrjet, në parim.

Ngarkohen komisionet funksionale, që në afatin e paraparë të paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që tash është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërtim

Ftoj ministrin a zëvendëskryeministren që ta marrë fjalën dhe të sqarojë ligjin në fjalë.

EDITA TAHIRI, zëvendëskryeministre.

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet Qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Qeveria e Republikës së Kosovës paraqet për plotësim-ndryshim Projektligjin për ndërtimet dhe ne mund të ju themi se shqyrtimet dhe analizat si dhe propozimet që janë bërë, janë të karakterit esencial, prandaj ftojme Kuvendit e Kosovës që ta miratojë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, radhën e kanë përfaqësuesit e komisioneve. Kryetar i Komisionit, a e doni fjalën? Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit, ministër!

Të nderuar kolegë,

Ligjin për ndërtimet Komisioni e ka shqyrtuar dy herë dhe ka kërkuar nga Ministria ta plotësojë dhe të na ndihmojë neve në këtë ligj edhe me mbështetësit e tyre, që i ka pasur USAID-in dhe ne për këtë ligj si Komision kemi marrë vërejtjet e arkitektëve, Shoqatës së Arkitektëve të Kosovës, të cilët kërkojnë që ky ligj të mos miratohet për shkak, ku ta di unë, çështjeve të tyre, ndërsa, Shoqata e Ndërtimtarëve, kërkon që të miratohet.

Në takimin që kemi pasur edhe me kryetarët e komunave bashkë me Komisionin, kemi hasur në vërejtjet e tyre të shumta, që ne kemi kërkuar që vërejtjet e tyre të gjenden, të na ofrojnë si Komision, që në debatet publike, që do t'i bëjmë te kemi mundësi dhe t'i miratojmë.

Prandaj, kërkoj nga seanca dhe deputetët, që në parim ta miratojnë këtë ligj, ndërsa me vërejtjet e tyre, amendamentet që do t'i bëjnë deputetët janë të mirëseardhur që të na ndihmojnë ta miratojmë dhe ta procedojmë këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar sot këtë projektligj. Ne i kemi parasysh edhe vërejtjet që i kanë dhënë palët e ndryshme të interesit, jemi marrë vesh që ato vërejtje t'i integrojmë në punën e mëtutjeshme të Komisionit dhe ne mendojmë që ky projektligj duhet ta vazhdojë punën më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e ka fjalën deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, edhe një herë na mbetet ta sqarojmë edhe për opinionin që sot në Komisionin, i cili është mbajtur me emergjencë, deputetët e LDK-së nuk kanë marrë pjesë në këtë Komision, sepse kemi konsideruar që është shkelje e Rregullores së Parlamentit të Kosovës. Megjithatë, në bazë të marrëveshjeve të cilat u arritën në mes grupeve parlamentare, ne kërkojmë që ky ligj ka disa mangësi të cilat kërkojnë shqyrtim, kur dihet që ky ligj është derivat i Ligjit për plan hapësinor dhe ligji pastaj, ky është në kundërshtim me Ligjin për ndërtimin, pasi që si i tillë 60% ky ligj bie në kundërshtim me ligjin ekzistues.

Vlen të theksohet se diku rreth 13 komuna janë të cilat nuk e kanë bërë planin hapësinor dhe njëkohësisht, përderisa nuk ka ardhur në Parlament, për të cilën mbetet nga Komisioni jonë të bëhet ligji për planifikim, drejtpërsëdrejti bihet në kundërshtim me ligjin për ndërtim.

Tarifat duhet strikt të përcaktohen nga komunat në përputhje me Ligjin për financat publike dhe vetëqeverisje lokale, pa pasur nevojë të aprovohet nga Ministria e Mjedisit.

Tarifat e lejeve reflektojnë koston e ndërtimit të infrastrukturës dhe shërbimit, gjë që bie në kundërshtim, do të thotë, me ligjin aktual. Njëkohësisht, kërkojmë që të ndahen kushtet urbanistike nga leja e ndërtimit dhe po ashtu duhet t'i jepet lista e objekteve të kategorisë së tretë, që mbesin si kompetencë e Ministrisë dhe të jenë kompetencë vetëm ato objekte të cilat janë të nivelit nacional.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, pasi që nuk e ka shqyrtuar në hollësi ende këtë ligj dhe pasi që ky ligj ka ardhur në formën e shpejtuar ose në formën e nxituar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, nuk do ta votojë në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ka një kohë të gjatë që Kosova është marrë me një ligj të tillë. U tha më përpara se ligji kështu si ka ardhur, bie ndesh me dy ligje tjera të cilat janë tepër të rëndësishme. Po ashtu mendojmë se përmes disa provizioneve, të cilat janë në këtë ligj, nuk po shkoj në detaje, meqenëse nuk ka mbetur as atmosferë për të diskutuar në detaje, sidoqoftë duhet të them se duke u tentuar që të parandalohet arbitrariteti nëpër komuna për disa çështje, po lejohet mundësia ose po hapen dyert për arbitraritet të llojit tjetër dhe mendoj se zgjidhjet, të cilat

janë gjetur për parandalim të arbitraritetit, po e rrumbullakoj me parandalim të arbitraritetit krijojnë mundësi për arbitraritet në nivele tjera të qeverisjes në Kosovë. Mendojmë se posaçërisht te ky ligj, i cili po them edhe njëherë ne do ta votojmë, për shkak se ashtu premtuam, u morëm vesh, mirëpo për këtë ligj duhet seriozisht që të punohet jo vetëm në një komision parlamentar, duhet të gjithë të kemi kujdes, në mënyrë që kur vjen në lexim të dytë të mos kemi probleme, të cilat i kemi pasur edhe deri më tani, derisa u dakorduam mes vete.

Do të thotë, i lus deputetët edhe një herë, jo vetëm të Grupit Parlamentar të Aleancës, por edhe të grupeve të tjera parlamentare, të kenë kujdes që të mos krijojmë situata, të cilat më vonë do të na hakmerren duke provuar ta parandalojmë një situatë.

Nuk po iu vë emrat tani, por me siguri se do të keni kohë që të diskutojmë bashkë edhe t'i shohim pikë për pikë se cilat janë këto probleme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni “Kosova e Re”, deputetja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, ka shqyrtuar projektligjin e ndërtimit dhe vërejtjet tona kanë qenë, kryesisht te tarifat. Kërkojmë që të ndahet tarifa e aplikimit me tarifen e infrastrukturës. Përndryshe ne e përkrahim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, zoti Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

SLS će podržati ovaj nacrt zakona u načelu i glasaćemo za njega!

KRESUESI: Faleminderit! “6+” zoti Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim këtë projektligj për ndërtim, ndërsa kontributin e vet do ta japë përmes punës së Komisionit. Falemnderit!

KRYETARI: Zonja Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Përsëendetje për të gjithë!

Edhe unë në parim e përkrah këtë projektligj, mirëpo i kam disa vërejtje të vogla, të cilat do t'i kisha theksuar tani. Për shembull, tek neni 24 thotë se dëmet e shkaktuara objekteve ndërtimore nga forca madhore, ku në pikën e njëjtë parashihet se objektet, të cilat janë rrënuar gjatë luftës apo gjatë forcës madhore, çka përfshinë vërshimin, zjarrin e tjera, nuk kanë nevojë të kërkojnë leje për ndërtim, çka pajtohem edhe unë, mirëpo kishte qenë mirë që të informohet komuna përkatëse për një ndërtim të tillë.

Pastaj në pikën 2, thotë se në rast se riparimet e bëra sipas paragrafit 1 më lart bëjnë ndryshime qenësore në objekt, leja ndërtimore për riparim do t'u merret brenda dy viteve. Do të merret, nënkupton këtu të lëshohet dhe nëse është për dy vite, atëherë konsideroj se është një periudhë shumë e gjatë.

Në kreun e 7-të e kemi vend-ndërtimin apo nenin 25, dokumentet në vend-ndërtim çka titulli për mua është shumë i paqartë.

E kemi pastaj nenin 16, ku thotë se ndërtimet, për të cilat nuk kërkohet leja ndërtimore, mendoj se këtij ligji i mungon edhe një nen, ku kishte me qenë, ndërtimet për të cilat nuk lëshohet leja ndërtimore, sidomos tek ne dhe të parashihet, duke marrë parasysh se në tokat bujqësore kemi ndërtime shumë dhe kemi ndërtime të larta në pikë të qytetit, në qendër të qytetit kemi ndërtime, ku lartësia apo më mirë të themi distancat nëpër objekte, në ndërtimin e objekteve nuk respektohen, mendoj se duhet të paraqitet edhe një nen ku për ndërtimet e tilla nuk duhet të lëshohet leje, për arsye se një ndërtim i tillë është i paplanifikuar dhe krijon një imazh apo të them një pamje të keqe të qytetit tonë dhe qyteteve në përgjithësi, në të cilat ndërtohet pa një planifikim hapësinor. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, e ka fjalën deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Vetëm disa çështje të shkurta. Sa i përket projektligjit, na krejt jemi dëshmitarë që fusha e ndërtimit është një ndër fushat, të themi më atraktive apo e cila ndikon jashtëzakonisht shumë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Megjithatë, sot në këtë fushë sipas të gjitha parametrave, rangohemi sipas studimit të Bankës Botërore, jashtëzakonisht poshtë, mos të themi që jemi diku kah vendi 170, që tregon të gjitha problemet që i kemi.

Momentalisht, për ta marrë një leje ndërtimi, nevojiten sipas ligjeve aktuale 331 ditë, çka ka ndikuar që ne të jemi të ranguar shumë poshtë.

Unë besoj se me ligjin e ri, të gjitha këto çështje do të adresohen dhe do të kemi një ligj, i cili do të na sjellë në suazat normale gjatë aplikimeve marrjen e lejes së ndërtimit.

Çështja tjetër e dytë, është situata aktuale që kemi në fushën e ndërtimit e që ka të bëjë me licencat, licencimin e ndërmarrjeve apo profesionistëve. Sipas ligjeve, ligjit aktual Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me një vendim të Qeverisë nga viti 2005, ka bërë licencimin e ndërmarrjeve ndërtimore, kurse licencimi i profesionistëve në fushën e ndërtimtarisë, arkitektët apo ndërtimtarët, është dashur të licencohen nga Ministria e Mjedisit.

Kjo gjë nuk është bërë asnjëherë kurse tash kemi edhe tërheqjen apo anulimin e licencimit në Ministrinë e Tregtisë, që në njërin anë është mirë, kur s'kemi licenca, por në anën tjetër është krijuar, të themi një kaos apo një rregull jo sa duhet në fushën e

ndërtimit, kur çdo kompani mund të merret me ndërtim, pa pasur nevojë për licencim nga ana e ndonjë institucioni.

Kështu që, besoj se edhe në këtë aspekt ligji duhet t'i ketë parasysh këto çështje që ta drejtojnë çështjen e licencimit të ndërmarrjeve apo çështjen e licencimit të profesionistëve në fushën e ndërtimtarisë.

Çështja e tretë ka të bëjë mënyrën e organizimit apo administrimin qeveritar të ndërtimit, aktualisht sektori i ndërtimit administrohet apo rregullohet nga Ministria e Tregtisë, Industrisë, që i ka në kompetencë produktet e ndërtimit dhe çështjen e ndërtimit, që administrohet nga ana e Ministrisë së Mjedisit. Edhe në kohën e Qeverisë së kaluar, ne kemi biseduar që ndarja e këtyre kompetencave është shumë e vështirë në praktikë. Po e marrim një rast, ndoshta është ekstrem, veç nëse e kemi një prishje të një objekti, do të kemi shumë problem të gjendet a është problemi te produktet e ndërtimit apo është problemi te vetë ndërtimi apo te projektimi i atij objekti?

Kështu që, unë besoj edhe se në kuadër të Qeverisë, duhet të bëhet fuzionimi i këtyre dy departamenteve, apo në fushën e ndërtimit dhe ato të jenë në njërin prej Ministrive, pavarësisht se cila është ajo Ministri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në vazhdim, po hyjmë në votim.

Në mbledhje janë prezentë 79 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të votojnë, të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Faleminderit!

Konstatohet që me 57 vota "Për", 15 "kundër", 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndërtim.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pauzë për drekë deri në orën 15:00, kur edhe fillon debati lidhur me informatën.

(Vijon pauza)

- - -

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

(Kryeson seancën, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Atëherë, ju lus t'i zëni vendet!

Po procedojmë me rendin e ditës, që është sipas shmangies dhe që e kemi bërë pikë të rendit të ditës:

7. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë më 31 mars 2012.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 3 prill 2012, ka vendosur që ministri i Punëve të Brendshme të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për ngjarjen në kufi me Serbinë më 31 mars 2012 me ç'rast forcat policore të Serbisë i arrestuan dy zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që para deputetëve të paraqet informatën për ngjarjet në kufi me Serbinë më 31 mars 2012. Zoti Rexhepi, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Me datën 31 mars të vitit 2012, rreth orës 10,30 në vendin e quajtur “Te pika 4” afër lagjes Matarova, në fshatin Dumnicë, komuna e Podujevës, me koordinatat e KFOR-it numër EN 195491-574187 oficerët policorë Shukri Binaku dhe Sami Beqiri, pjesëtarë të togut patrullues kufitar “Oskar”, pranë Drejtorisë rajonale të veriut, me seli në Lluzhan, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të patrullimit të rregullt përgjatë brezit kufitar të kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, në brendi të territorit të Kosovës afër 120 metra, nga prita e përgatitur, kanë qenë të kidnapuar nga ana e një grupi prej 12-13 pjesëtarëve të xhandarmërisë së Serbisë.

Oficerët policorë kanë qenë duke patrulluar me veturën e tyre Toyota, me targa numër 122-02 dhe me veti kanë pasur këto pajisje:

dy pushkë automatike zyrtare AK-47, me dy karikatorë dhe gjithsej 120 fishekë;
dy armë të shkurta - revole zyrtare Glock19 me nga dy karikatorë dhe gjithsej 60 fishekë;
një palë dylbi;
dy radiolidhje dore, dhe
dy aparate GPS.

Zona e përgjegjësisë, të cilën e kishin për detyrë ta patrullojnë, ishte rajoni numër 2, që përfshin fshatin Dumnicë - lagja e Matarovëve, për të vazhduar pastaj në drejtim të fshatit Prepellac, komuna e Podujevës.

Gjatë patrullimit, herën e fundit, që janë i janë lajmëruar bazës së tyre para rrëmbimit, ishte ora 9,15 dhe sipas kësaj kohe, edhe për kundër faktit se Qendra operative në Lluzhan, kishte tentuar disa herë të kontaktojë përmes telefonit dhe radio-lidhjeve, nuk kishte arritur të vendoste komunikim me oficerët, të cilit ishin në detyrë.

Rreth orës 14, përmes informacioneve jo zyrtare, jemi informuar se ata janë kidnapuar nga ana e xhandarmërisë serbe.

Si ka ndodhur ky rrëmbim? Sipas hetimeve fillestare dhe në bazë të dëshmive të zyrtarëve të rrëmbyer në vendin e quajtur “Te pika 4” afër lagjës Matarova në fshatin Dumnicë, fillimisht nga ana e rrëmbyesve ishte vendosur një pengesë me disa drunjë dhe pasi që zyrtarët policorë ishin afruar 3-4 metra para kësaj pengese e kanë ndaluar veturën

me qëllim që ta largojnë këtë pengesë, por përnjëherë nga pusia kishin dalë nga të dy anët e rrugës grupi prej 12 -13 pjesëtarë të maskuar, duke i drejtuar armët e gjata dhe duke i çarmatosur e prangosur, si dhe duke ua vë nga një thes në kokë, e pastaj duke i hedhur në bagazhin e veturës së tyre. Menjëherë i kishin lëvizur, duke i futur në brendi të territorit të Serbisë diku afër 200 metra, duke i dërguar në bazë të tyre dhe më pas janë nxjerrë jashtë duke i fotografuar.

Vlen të theksohet se ky fotografim është bërë duke e inskenuar situatën. I kanë detyruar t'i marrin armët e t'i vendosi në krahë, si dhe të shikojnë me dylbi. Në këtë mënyrë i kanë marrë disa foto e pastaj janë kthyer në bazë, por pas 45 minutave janë nxjerrë prapë dhe janë dërguar në një vend tjetër, ku janë detyruar të shtrihen në pozicionin e rrëzuar përtokë, me pajisje të shpërndara përreth tyre, i kanë fotografuar me qëllim të tregimit se gjoja aty janë kapur.

Këtë veprim e kanë përsëritur edhe në një lokacion tjetër e pastaj i kanë dërguar në një bazë të tyre në afërsi të një ndërtese të tipit montues me kullë të vëzhgimit. Në këtë objekt, fillimisht i kishin intervistuar disa zyrtarë të tyre tjetër të uniformuar dhe civilë.

Menjëherë pas intervistimit të parë, i kishin dërguar fillimisht në stacionin policor në Kurshumli, pastaj në gjykatë dhe pas intervistimit të dytë iu kanë shqiptuar masën e ndalimit prej 48 orëve, duke i dërguar në mbajtje në qendrën e mbajtjes në Prokuple.

Të gjitha pajisjet dhe veturën ua kanë konfiskuar, ndërsa, sipas deklaratës së oficerëve të rrëmbyer, ata nuk kanë qenë të keqtrajtuar fizikisht.

Ndërkohë, rreth orës 18, iu është mundësuar kontakti me familjet dhe eprorët për të informuar lidhur me ngjarjen.

Me datën 2 prill 2012, pas skadimit të afatit prej 48 orëve dhe paraqitjes në gjykatë, zyrtarët policorë të kidnapuar nga xhandarmëria serbe, janë liruar, dhe në përcjellje të EULEX-it janë kthyer në pikën kufitare në Merdar.

Veprimet e ndërmarra nga Policia e Kosovës. Menjëherë pasi janë informuar me ngjarjen, eprorët përgjegjës të Policisë kufitare rreth orës 14 kanë zhvilluar një kontakt në pikën e kalimit kufitar në Merdar me zyrtarë të policisë së Serbisë, të cilët vetëm shkurt kishin informuar se nga ana e xhandarmërisë së tyre janë arrestuar dy zyrtarë të Policisë së Kosovës, por duke mos dhënë informata tjera. Menjëherë janë informuar mekanizmat ndërkombëtarë, duke kërkuar lirin e tyre dhe zbardhjen e rastit.

Po të njëjtën ditë, më 31.3.2012 rreth orës 17, pjesëtarët e Drejtorisë rajonale të kufirit dhe përfaqësuesit e EULEX-it kanë shkuar në vendin e ngjarjes, duke e lokalizuar vendin ku supozohej se kishte ndodhur ngjarja dhe se nga shikimi i parë ishte konstatuar se vendi ndodhej në territorin e Republikës së Kosovës, por pa u konstatuar distanca e saktë.

Të nesërmen, më 1.4.2012, rreth orës 10, ekipit të njëjtë i janë bashkëngjitur edhe pjesëtarë të KFOR-it, të cilët prapë kishin shkuar në vendin e ngjarjes, që ishte konstatuar prapë se vendi ku ishin kidnapuar zyrtarët policorë ishte në territorin e Republikës së Kosovës, saktësisht afër 120 metra.

Vizita e vendit të ngjarjes, është përsëritur edhe për herën e tretë, më 2.4.2012 rreth orës 15,40 me ekip të njëjtë, por tani së bashku me oficerët e rrëmbyer që ishin liruar prej mbajtjes nga autoritet serbe. Po ashtu, edhe kësaj radhe ishte konstatuar njëjtë si më parë, ndërsa dy zyrtarët policorë kishin konfirmuar vendndodhjen ku kishte ndodhur rrëmbimi dhe sipas tyre ai vend ishte i njëjtë, siç ishte konstatuar edhe më parë, pra rreth 120 metra në territorin e Republikës së Kosovës.

Me datën 3.4.2012, me qëllim të hetimit të mëtejshëm të rastit, rasti ka kaluar si përgjegjësi e Drejtorisë për hetimin e krimeve në Drejtorinë e përgjithshme të Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës po vazhdon me zhvillimin e hetimeve, në këtë rast, nën udhëzimet e prokurorit të EULEX-it, ndërsa EULEX-i është në cilësi të monitoruesit.

Desha vetëm edhe të ju sqaroj, se ne kemi kërkuar një hetim të pavarur nga KFOR-i e EULEX-i në mënyrë që këto dëshmi faktografite të jenë valide dhe të vlejshme edhe për Këshillin e NATO-s dhe për Komisionin Evropian, për arsye se ata janë të dezinformuar nga ana e Serbisë dhe sigurisht që raporti i tyre do të vlerësohet shumë më mirë. Tani, më lejoni të nxjerr disa përfundime.

1. Policia e Kosovës e ka marrë përgjegjësinë nga KFOR-i për kontrollimin dhe mbikëqyrjes së vijës së gjelbër të kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Ndërsa, me Serbinë, kontrolli i vijës së gjelbër mbetet ende përgjegjësi e KFOR-it.

Sidoqoftë, për shkak të reduktimit të trupave të KFOR-it, Policia e Kosovës e ka patrulluar vijën e gjelbër edhe në kufirin me Serbinë, gjithnjë sipas dakordimeve paraprake me KFOR-in.

2. Me Serbinë nuk është bërë demarkacioni i kufirit dhe patrullimi është bërë gjithnjë duke u bazuar në hartat, të cilat janë në posedim të KFOR-it. ...

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

KRYESUESI: Ia mundësoni të vazhdojë deri sa ta kryej.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Jo, si të doni! Për mua është njëjtë, edhe një minutë më nevojitet.

3. Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në momentin e kidnapimit, kanë qenë duke patrulluar në zonën e përgjegjësisë së Policisë së Kosovës dhe në asnjë moment nuk e kanë tejkaluar zonën e përgjegjësisë së tyre.

Më lejoni t'ju informoj se policët e kidnapuar kishin me vete edhe pajisjen GPS, përmes së cilës orientohen për zonën e përgjegjësisë së tyre, që iu tregon se nuk kanë kaluar në territorin e Serbisë.

4. Ky veprim tinëzar dhe i organizuar i xhandarmërisë serbe, ka dëshmuar edhe një herë orientimin dhe mentalitetin agresor të shtetit serb ndaj Republikës së Kosovës.

5. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës vlerëson angazhimin dhe përpjekjet e mekanizmave ndërkombëtarë, në veçanti EULEX-in, për lirim të zyrtarëve policorë të kidnapuar nga ana e xhandarmërisë serbe, por në të njëjtën kohë kërkon të zbardhet urgjentisht ky rast tipik i agresionit të shtetit serb ndaj Republikës së Kosovës.

Është obligim i KFOR-it dhe EULEX-it që, në bazë të informacioneve dhe fakteve të mbledhura bashkërisht, hapur të konstatojnë se zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë patrulluar brenda juridiksionit të Republikës së Kosovës.

6. Bashkimi Evropian duhet t'i gjykojë veprimet e fundit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë të cilat janë në kundërshtim të plotë me rendin e ligjin dhe janë veprime anti-evropiane dhe në dëm të perspektivës evropiane të rajonit.

Ministria e Punëve të Brendshme siguron institucionet shtetërore dhe të gjithë qytetarët e vendit se Policia e Kosovës do të vazhdojë kryerjen e detyrave të saj sipas mandatit në mbrojtje të integritetit territorial dhe në ruajtje të rendit e ligjit konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ne, pas çdo veprimi ose aksioni, i kemi procedurat standarde të cilat sipas raportit do të vlerësohen se a ka pasur dështim në çështjen e komandimit dhe të gjitha tjerat, të janë pjesë të hetimeve të mëvonshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhepi! Sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,
Rasti i ndodhur me kidnapimin e policëve të Policisë së Kosovës nuk është asgjë tjetër përveç një agresion ndaj territorit të Kosovës, ndaj institucioneve të Kosovës dhe goditje e rëndë për rendin dhe ligjin në Kosovë.

Ky veprim është antidemokratik, anti-evropian dhe antinjerëzor, madje, sepse çdo shtet që pretendon të hyjë në territorin tjetër nuk meriton asgjë tjetër përveç kundërvënies, në bazë të kushtetutës së atij vendi.

Nuk është rastësi pse ka ndodhur ky rast! Sepse, i kanë paraprirë veprimet e papërgjegjshme të një Qeverie e cila ka shkuar në bisedime me shtetin serb, pa platformë, pa agjendë, pa afate, pa një orientim. Dhe kjo mënyrë e nënshtrimit të Qeverisë ka sjell deri te një akt i tillë, dhe jo vetëm ky.

Marrëveshjet të cilat janë transmetuar në konkluzione për tu realizuar si mos-marrëveshje, janë veprime të cilat Serbia në vazhdimësi i ka bërë në territorin e Republikës së Kosovës dhe e ka bërë me rastin e kidnapimit të dy policëve të Policisë së Kosovës.

Edhe sot, përgjegjësia bie mbi institucionet e Kosovës, sepse veriu i Kosovës dhe vendet ku vepron shërbimi sekret serb janë ende prezencë agresive e Serbisë.

Prandaj, jo rastësisht, po e them përsëri që, në ditën kur lirohen punonjësit e MUP-it serb ose UDB-ës serbe, të njëjtën ditë të ndodhë kidnapimi i dy policëve të Policisë së Kosovës.

Kësaj i ka parapri edhe një paralajmërim i ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë dhe aspak nuk është marrë seriozisht Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, Policia e Kosovës, institucionet e sigurisë së Kosovës. Kjo neglizhencë, edhe më tutje po e përcjell këtë Qeveri sepse në vend se të ndërmerren masa ndaj të gjithë atyre që kanë qenë të papërgjegjshëm në rolin komandues, bëhen arsyetime të cilat absolutisht edhe më shumë e rëndojnë aktin i cili ka ndodhur.

Nuk janë në pyetje këtu individët, nuk janë në pyetje ata të cilët janë gjetur në moment, por është në pyetje uniforma e shtetit të Republikës së Kosovës, është simbolika e shtetit, është integriteti personal i tyre, integriteti territorial dhe jeta e qytetarëve të Kosovës. Dhe kjo ka ndodhur për shkak se në institucionet e sigurisë në Kosovë, në vend se të shkojnë në nivele më të larta të komandimit, profesionistë të cilët e njohin zanatin, kanë shkuar njerëz në bazë të pikëpamjeve politike të cilët i shërbejnë një partie politike. Dhe, po ashtu arsyetimet që bëhen, edhe më tutje rreth rastit, tregojnë për nivelin e seriozitetit të kësaj Qeverie lidhur me raportin e sigurisë në Kosovë.

Nuk është fare e arsyeshme një konferencë shtypi të mbahet nga një autoritet, cilido qoftë ai nga policia, që të njoftojë opinionin se çka ka ndodhur, përveçse kur gazetarët janë interesuar se çka po ndodh në ven din tonë.

Nuk ka pasur një gatishmëri që të thirren institucionet e sigurisë, Këshilli i Sigurisë, që jo vetëm këtë akt, por tërë gjendjen e siguri në Kosovë ta analizojë dhe të marrë qëndrim rreth kësaj gjendje. Mosgatishmëria për tu ballafaquar me problemet, është për tu ngulfatur në probleme.

Prandaj, konsideroj se obligim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i Policisë së Kosovës, i nivelit qeveritar, është të dalë para përgjegjësisë dhe së paku para qytetarëve të Kosovës e të deklarojnë se nuk janë të aftë të udhëheqin me vendin, të komandojnë Policinë e Kosovës, të ushtrojnë funksionin e vetë dhe jo të lejojnë që një shtet, i cili tradicionalisht, qe njëqind vjet Kosovën e ka sulmuar, e ka degraduar deri në tendencën për shfarosje. Kjo Qeveri më në fund duhet të japë një llogari para qytetarëve të Kosovës, sepse ka obligim kushtetues.

Dhe, për fund, po them se uniforma është simbol dhe është cenuar shteti, është cenuar integriteti dhe territori i Kosovës, është cenuar ndërgjegjja e qytetarëve të Kosovës, prandaj kjo Qeveri më mirë është ta lëshojë rrugën edhe të japë dorëheqje, në mënyrë që forcat progresive të Kosovës, ato profesionale të jenë në policinë e Kosovës dhe ta çojnë vendin përpara si një shtet demokratik, i cili nuk lejon që një vend tjetër t'i ndërhyjë në territor, t'i ndërhyjë në ndërgjegjen e vetë pas 12 vjetësh të lirisë së krijuar. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Isufi! Radha është e kryetarëve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Fatmir Xhelili! Regjia, zotit Xhelili fjalën!

FATMIR XHELILI: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje, Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Është e vërtetë se zyrtarët policorë me veprime të jashtëligjshme dhe joparimore kanë rënë në grackë të atyre, që me vite të tëra na kanë shkelë, kanë tentuar të na përbaltosin dhe kanë tentuar të na asimilojnë.

Mirëpo, është një e vërtetë e madhe që përgjegjësinë për vijën kufitare, si e potencoi edhe ministri, në vijën me Serbinë e ka KFOR-i. Është e vërtetë që ato kompetenca përcillen shumë ngadalë dhe në mënyrë të planifikuar dhe resurset njerëzore me kapacitetet njerëzore dhe teknike nuk janë plotësuar për vijën kufitare në drejtim të Serbisë dhe është e vërtetë, që policia jonë kufitare ende nuk i ka kapacitetet e plota për të menaxhuar me atë vijë kufitare dhe për të bërë patrullime, të cilat janë në gjendje të përballen me ata që e thyjnë vijën kufitare apo gjenden ilegalisht në Kosovë.

Nuk është detyrë e policisë kufitare të luftojë në vijën kufitare. Detyra e policisë kufitare është që të identifikojë, të fokusojë dhe të evidentojë ata që bëjnë shkelje në kufirin tonë dhe të merren masat adekuate hetimore dhe disiplinore që të veprojnë ndaj atyre, që e thyjnë kufirin.

Policia jonë është një polici e strukturuar në mënyrë metodologjike, me standarde evropiane dhe është polici, që përdorë metoda civile, në luftë kundër atyre që kalojnë kufirin, kontrabandojnë apo merren me aktivitete ilegale dhe duhet pasur parasysh që xhandarmëria e Serbisë është një strukturë e cila është gjysmë ushtarake dhe gjysmë policore, që përdorë metoda shumë të vrazhda edhe atëherë kur ato janë ligjore e le më që në këtë rast ka përdorë metoda, të cilat janë joligjore dhe ka cenuar integritetin e kufirit tonë.

Besoj se syçeltësia, vigjilenca dhe kujdesi i zyrtarëve tonë policorë, ka qenë dashtë të jetë më në nivel, mirëpo duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe relacionet që kemi me Serbinë, duke marrë parasysh relacionet që kemi me sigurinë rajonale, duke marrë parasysh që ne një kohë të gjatë kemi qenë konsumues të sigurisë, unë besoj se matura e ministrit dhe matura e Qeverisë tonë ka qenë në nivel, në mënyrë që të mos jemi shkaktues të incidenteve të mëdha, që do të kishin çrregulluar raportet, jo vetëm me Serbinë por edhe më gjerë. Dhe, besoj se matura e ministrit dhe Qeverisë tonë ka qenë në atë, që të dëshmohet që jemi partnerë seriozë, partnerë që marrim obligime, partnerë që marrim përgjegjësi dhe partnerë që së bashku me partnerët që na kanë ndihmuar në gjithë hapërimin tonë, prej fazës së çlirimit e edhe tani në fazën e shtetndërtimit dhe në fazën e integritetit në procese evropiane, kemi obligim ndaj këtyre partnerëve dhe do të jemi së bashku në këtë hapërim.

Gjithashtu edhe kemi obligim, që veprimet që disa i dëshirojnë të jenë veprime hyxhymi a veprime reaksioni, të jenë ato veprime të matura, të kujdesshme dhe të koordinuara me faktorin ndërkombëtar.

Unë pres që hetuesia jonë së bashku me hetuesinë e EULEX-it, të marrë veprimet adekuate në drejtim të identifikimit të atyre personave, që kanë cenuar në integritetin tonë

territorial dhe në momentin adekuat dhe në periudhën adekuate do të përballen edhe me ligjin edhe me drejtësinë, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare. Shpresoj që ky do të jetë një moment, ku të gjithë do të jemi më syçelë dhe më të gatshëm që të përshpejtojmë zhvillimin e policisë tonë e posaçërisht policisë kufitare, duke e pajisur me mjete tekniko-teknologjike adekuate për kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijës kufitare dhe pikave kufitare dhe pse jo, prej këtij pësimi do të jetë një mësim për veprimet në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Çuni e ka fjalën! Zotit Çuni, fjalën!

ANTON ÇUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ndërhyrja e forcave policore ushtarake të Republikës së Serbisë në brendi të territorit të Republikës së Kosovës, në terminologjinë politiko-ushtarake njihet si agresion.

Kurse, arrestimi dhe kidnapimi i zyrtarëve të policisë së Kosovës, në krye të detyrës, po ashtu brenda territorit të Republikës së Kosovës, në fjalorin e drejtësisë njihet si akt kriminal.

Dhe, në fund kalimi i të njëjtave forca nga bazat e tyre, nëpërmjet zonës tokësor të sigurisë është thyerje e marrëveshjes ushtarako-teknike në mes të KFOR-it dhe forcave të sigurisë Jugosllave dhe ato Serbe.

Është e pakuptimtë se nga cilido mekanizëm, ndërkombëtar apo vendor për çështje të sigurisë të kërkohet siguria absolute e kufijve, sepse është thjeshtë e pamundur.

Por, po ashtu është edhe më shumë e pakuptimtë qëndrimi i institucioneve tona të sigurisë, kur përkundër paralajmërimeve nga ministria e punëve të brendshme të Serbisë se do të arrestohen zyrtarët e policisë së Kosovës, si masë e reciprocitetit, autoritetet e policisë së Kosovës, Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë, Këshillit të Sigurisë Kombëtare, këshilltarët e sigurisë vazhdojnë me punët rutinore të përditshme duke mos u brengosur fare për situatën e paralajmëruar.

Policia kufitare, si përgjegjëse kryesore për zbatimin e Ligjit për menaxhimin e integruar të kufijve dhe kontrollin e kufijve është e familjarizuar me logon “Vija e parë e mbrojtjes”, por në rastin në fjalë ata ishin “vija e parë e viktimizimit”. Falë papërgjegjshmërisë dhe mungesës së vigjilencës së drejtuesve të tyre politik dhe udhëheqësve më të lartë të policisë së Kosovës.

Përkundër kërcënimit të hapur, në terren nuk u vërejtën fare masat shtesë të sigurisë dhe ngritja e nivelit të gatishmërisë dhe fare nuk u hartua as si ide zhvillimi i operacionit për përgjigje adekuate, në situatën e krijuar.

Me një mospërfillje të tillë, xhandarmëria serbe e kishte shumë të lehtë, që me arrestimin e kidnapimin e dy zyrtarëve të policisë së Kosovës dhe simbolikën e këtij akti të përçojë

një mesazh shumë të fuqishëm, se ne nuk kemi aftësi, kulturë, traditë dhe vetëdije të shtetformimit.

Sidoqoftë, kjo ngjarje ne na shërben që edhe një herë t'i rishikojmë politikat e sigurisë, ligjet dhe strategjitë, që mbulojnë dhe determinojnë sigurinë, procedurat standarde operative, kapacitetet kadrovike teknike taktike e tjera. Jam më se i bindur se policia e Kosovës ka djem dhe vajza të zotë dhe të zonja, të përgatitur, të motivuar, me nivel të lartë etik, që mund t'i dalin në krye situatave edhe më të ndërlikuara. Me një angazhim profesional të këtyre djemve pjesëtarët e xhandarmërisë serbe sot do të ishin prapa grilave, nën akuzën e agresionit mbi një shtet sovran dhe të pavarur. Arsyetimet se është evituar më e keqja nuk qëndrojnë, sepse pasojat e papërgjegjshmërisë janë të shumta dhe vështirë të riparueshme. Agresioni i forcave serbe ka ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e sigurisë ne vend, si parakusht për stabilitet politik, zhvillim socio-ekonomik, kulturor, e tjera.

Të nderuar deputetë, paramendoni se si ndjehen qytetarët e Kosovës dhe se sa të sigurt janë, kur policët tanë janë të gjunjëzuar dhe të pafuqishëm para atyre, që para një dekade me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndihmën e NATO-s i shporrën nga Kosova dhe po të njëjtit tani kthehen në mënyrë triumfale në vendin e krimit. Ky akt është turp i llojit të vet. Dhe, në këtë rast peshon mbi ata që bartin përgjegjësitë me hierarkinë politike dhe profesionale, brenda policisë dhe institucioneve tjera të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është askush. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Shala e ka fjalën.

BLERIM SHALA: I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më 31 mars dhe në ditët vijuese, herë me nerva dhe me emocione, të cilat në këtë rast kanë qenë fare të kuptueshme e herë pak më gjakftohtë, jemi munduar t'i tregojmë botës atë që ne e dimë, atë që ne e përjetojmë dhe e ndiejmë, që Serbia e sotme është vazhdimësi e asaj së djeshmes, që e tashmja e Beogradit zyrtar nuk dallon prej së kaluarës, që me këtë politikë të Serbisë ndaj Kosovës e ardhmja e raporteve midis dy shteteve është larg asaj, që tashmë paralajmërohet me ngulm prej Qeverisë së Kosovës si evropiane dhe perëndimore.

Të gjithë ne jemi munduar të tregojmë se çfarë ka ndodhur në Dumnice dhe çfarë ka bërë Serbia më 31 mars në brezin kufitar Kosovë-Serbi. Në rregull! Por, pak ose aspak nuk jemi marrë me çfarë kemi bërë ne. Si jemi sjellë si shtet në atë ditë dhe në ditët e mëpasme dhe çfarë nuk kemi bërë ato ditë? Dhe, më në fund, çka do të ishte e arsyeshme të ndërmarrim tash e tutje?

Më 31 mars, në ditën gjithqysh të rëndë për Republikën dhe politikën kosovare, ne realisht, kemi qenë të paralizuar apo nuk kemi funksionuar fare.

Nuk ka pas as përpjekje minimale për të reaguar si duhet në karshillëkun me këtë sprovë, që ka sjellë tek të gjithë ne ndjenjën e përbashkët të poshtërimit. Çfarë është dashtë të bëhet atëherë, atë ditë?

Së pari, komunikimi i institucioneve qendrore me mediat, është dashtë atë ditë të jetë shumë më i mirë, duke ndarë me ta dhe me qytetarët e Kosovës të gjitha informatat.

Në këtë kontekst, është dashtë të krijohet një press qendër e veçantë, që do të funksiononte deri në përfundim të rastit, duke emetuar lajme edhe në gjuhët e huaja.

Së dyti, kryeministri i Kosovës është dashtë të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në trajtim të këtij rasti dhe në synim për ta ruajtur sigurinë dhe stabilitetin në gjithë vendin, si dhe për angazhimet shtesë të policisë së Kosovës dhe të AKI-së për këtë siguri.

Së treti, presidenti dhe kryeministri i Kosovës do të duhej në këto raste t'i prinin një takimi të përbashkët me liderët e opozitës për të shfaqur kështu konsensusin e plotë politik në Kosovë, për ngjarjet e këtij lloji.

Prej këtij takimi do të dilte pastaj një deklaratë e qartë politike, që do të shfaqte pozicionin e Republikës së Kosovës. Prej këtij takimi do të mund të hartohej edhe një letër e shkurtër, që do t'i dërgohej qeverive të pesë shteteve kryesore të perëndimit.

Reagimet tona as pas përfundimit të kësaj ngjarjeje të rëndë, nuk janë aspak mbresëlënëse dhe shquhen me synim për ta lënë në harresë të tërën. Tash e tutje, realisht, do të ishte mirë të ndërmerren këto veprime.

Së pari, Qeveria e Kosovës dhe policia e Kosovës do të duhej të ndërmerrenin të gjitha masat e duhura, që diçka e kësaj të mos përsëritet më.

Së dyti, duhet të zbardhet përfundimisht e vërteta për ngjarjen e 31 marsit, sepse ekziston rreziku që për shkak të pragmatizmit politik rasti t'i lihet harresës.

Së treti, do të ishte mirë të përgatitet dosja e të gjitha shkeljeve të Rezolutës 1244 dhe të Marrëveshjes tekniko-ushtarake të Kumanovës, e cila është pjesë e kësaj rezolute, e cila pos tjerash do të konstatonte edhe njëherë praninë e strukturave të Serbisë brenda Kosovës, që është në kundërshti me sovranitetin e Kosovës dhe me Rezolutën 1244.

Së katërti, Qeveria e Kosovës duhet të dalë para qytetarëve të Kosovës me informatë të hollësishme se çfarë po ndodhë me marrëveshjen IBM, se ndërtimi i të cilës do të duhej të evitonte incidente të këtilla të rënda. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi Parlamentar Kosova e Re, kush... do të flasë në emër të grupit? Kryetarja e grupit, Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, zotëri nënkryetar!
Përsëritje për dy ministrat dhe deputetët!

Ne dëgjuam raportin e ministrit Rexhepi dhe duke marrë parasysh situatën, çfarë ndodhi atë ditë, si grup parlamentar dënojmë kidnapimin e Policisë së Kosovës nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, për fushatë elektorale, e cila ju duhet në këtë moment.

Kërkojmë nga ministri, që në punën e tij të punojë edhe më tepër për arsye të forcimit të rendit të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës, me të gjitha forcat tjera.

Përkrahim Policinë e Kosovës, që të kryej punën e tyre në mënyrë të ndershme dhe njëkohësisht kërkojmë nga shtetet e BE-së, NATO-ja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, OKB-ja, që të marrë masa shumë të rrepta ndaj shtetit serb, i cili mundohet të ndërhyjë në punën, në sovranitetin dhe territorin e Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, si shefe e Grupit Parlamentar Koalicionit për Kosovë të Re dhe deputete dhe qytetare e Kosovës, kërkoj që në të gjitha institucionet ndërkombëtare, të cilat na kanë përkrahë deri në këtë moment, që të bëjnë të pamundurën që të dërgohet ky rast në Kombet e Bashkuara, për arsye se është e drejtë e çdo shteti sovran të kërkojë ndihmën për qytetarët e vet, në rast se shteti fqinjë ndërhyjnë me atë metodë çfarë ka ndërhyrë shteti serbë, me kidnapimin e Policisë së Kosovës. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS nuk ka të paraqitur! “6+”? Nuk ka të paraqitur! Atëherë, vazhdojmë me deputetët e paraqitur. Sipas renditjes, zoti Selimi e ka fjalën!

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Meqë po e shoh se ka në pritje edhe të tjerë që të diskutojnë, do të përpiqem të mos e zgjas, por njëkohësisht edhe të përkujtoj diçka të rëndësishme. U tha këtu se kemi të bëjmë me qeveri të papërgjegjshme dhe se kemi të bëjmë me qeveri joserioze.

Nuk e di se sa kemi të drejtë ta quajmë kështu Qeverinë, ndërkohë që edhe ne si Kuvend dhe deputetë, para më shumë se një muaji, më rastin e aprovimit të Ligjit për policinë, nuk u patëm treguar shumë të përgjegjshëm dhe seriozë, kur herën e parë amendamentin me të cilën fuqizohej organizimi dhe strukturimi i Policisë Kufitare, nuk e patëm pranuar, mu ky Kuvend, mu këta deputetë.

Unë s’e pata votuar, atëherë. U deshtë që të na kthehet ligji prapë këtu dhe të na vijë sërish një amendament, me të cilin rregullohej organizimi i Policisë Kufitare.

Prandaj, para se të kritikojmë Qeverinë, është mirë për hir të integritetit personal dhe të integritetit të deputetit, t’i bëjmë pyetje vetes se a mos e lëshuam një rast, që me ligj ta forcojmë Policinë Kufitare, duke i marrë parasysh këto dhe situata të ngjashme, që do të na ndodhin në të ardhmen.

Së dyti, dëshiroj ta përsëris edhe njëherë se përgjegjësinë për mbikëqyrjen e vijës kufitare e ka KFOR-i. Me asnjë dokument, asnjëherë, me asnjë deklaratë, asnjë kompetencë Policisë së Kosovës nuk i është bartë.

Ajo çka opinioni e ka parë me trishtim, me emocione, ka qenë një patrullë e policisë, e cila është e mandatuar për të parandaluar kontrabandën në atë pjesë të Kosovës, kontrabandën me kafshë dhe dëmtimin dhe vjedhjen e pyjeve.

Askund në botë nuk shkohet me batalione apo me njësi të specializuara, për ta luftuar këtë lloj kontrabande. Gjithkund në botë mjaftojnë dy policë për të patrulluar dhe për ta kryer atë mision, gjegjësisht atë mandat. Ata nuk janë mandatuar akoma, për ta mbrojtur integritetin territorial e sigurish që do të shkojë edhe një kohë e gjatë, derisa të mandatohen. Prandaj, trajnimi i tyre, detyra e tyre, pajisjet e tyre, kanë pasur një mision tjetër, prandaj edhe janë zënë në befasi, prandaj edhe është vepruar ashtu, sepse është fut njësia e specializuar, që nuk janë fare xhandarë, e komanduar nga zëvendëskryeministri i Serbisë, për qëllimet që tashmë u përmendën këtu, janë fut thellë në territorin tonë, që do të mund të futeshin akoma më thellë, për arsye se është përgjegjësi e plotë e KFOR-it. Nuk dua ta shfajësoj Policinë e Kosovës, por dua ta theksoj një të vërtetë, në mënyrë që të dihet qartë se ku është përgjegjësia.

E treta, unë vazhdoj të besoj edhe sipas definicionit edhe sipas Kartës të OKB-së edhe sipas Rezolutës të vitit 1974, me të cilën sqarohet nocioni, përkatësisht definicioni i aktit të agresionit. Ky ka qenë një akt klasik i agresionit në Republikën e Kosovës.

Thuhet, shprehimisht: “Forcat e armatosura të një shteti, nëse ndodhen në territorin e shtetit tjetër pa pëlqimin e tij, kanë bërë agresion.”

Unë besoj se ne nuk do të heshtim, ne do të veprojmë me mjete politike, diplomatike, do të ngrisim padi në Gjykatën Ndërkombëtare, paçka që Gjykata ndërkombëtare do të autorizohet plotësisht të gjykojë raste të tilla pas pesë vitesh, por t’ia fillojmë tash. Kur Beogradi vazhdon akoma edhe sot e kësaj dite, siç ndodhi para disa ditësh, të shpallë aktgjykime për ushtarët e UÇK-së, pse ne të mos fillojmë padinë dhe kurdo qoftë ne ta bëjmë punën tonë.

Dhe e fundit, dua të besoj shumë se përfundimisht Ministria e Brendshme, do ta trajtojë posaçërisht Policinë Kufitare. Përfundimisht ka ardhur koha, që pas shumë përpjekjesh, pas shumë këshillash, pas shumë përpjekjesh personale që i kam pas si drejtor i Policisë Kufitare e që ka dëshmitarë në këtë sallë, përfundimisht ta kemi të qartë që neve na duhet një polici e specializuar kufitare, në kuadër të Policisë së Kosovës, por e specializuar dhe e përgatitur.

Dhe, dua të besoj thellë, se do të krijohen edhe njësitë e inteligjencës operative të Policisë Kufitare dhe dua të besoj se do të krijohen edhe njësitë e veçanta speciale, siç i kanë shtetet me demografi, gjeografi dhe me problematikë të ngjashme me tonën. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Haziri e ka fjalën! Pse ke dalë në fund ti? E shtype dy herë a? Ishe i pari! Zoti Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit nënkryetar, kryesues i kësaj seance!
Falënderoj ministrin për informatën në detaje, që na e dha!

Në radhë të parë ne duhet me... i falënderoj oficerët e Policisë, Policinë tonë dhe forcat e Policisë për punën që po e bëjnë në rrethana dhe kushte politike, çfarë po jetojmë. Ajo u pa qartë. Ky kidnapim i policëve ka qenë i motivuar politikisht dhe hakmarrje politike e një ministri të Qeverisë së Serbisë.

Këta dy oficerë të policisë, që në jetën e përditshme janë dy djem, dy shokë, dy miq, dy kolegë, kanë rënë pre e një vendimi politik dhe në atë patrullë policie ka mund me qenë gjithkush dhe gjithkund në territor apo në zonën e gjelbër të kufirit, që po e quajmë ne. Por, ministri në fjalën e fundit e duam një përgjigje, a e di saktë zonën e gjelbër, sepse zona e gjelbër pas Marrëveshjes së Kumanovës ka ndryshuar si pasojë e një marrëveshjeje që është ratifikuar në OKB, në mes Serbisë e Maqedonisë? Dhe, pjesë e kësaj ka mundur të bëhet edhe problemet që implikojnë.

Nën dy, përveç oficerëve të Policisë dhe fotografisë së keqe, përdhosjes së dinjitetit njerëzor dhe të oficerit të policisë, ne kemi të arrestuar në Serbi edhe qytetarë tjerë. Nuk është kah merret askush me atë propozim që është marrë për të njëjtat rrethana po në ambient tjetër politikë, është marrë Arben Murseli, i cili ka qenë duke shkuar në Zvicër me punua është akuza për një vepër që s'ka lidhje Serbia, as s'do të duhem me pas sepse ai s'ka asnjë vepër nga gjykatat e Kosovës as të Zvicrës. Është marrë qytetari tjetër në Zvicër është pru, është dërgua në Beograd po e vuan dënimin. "Grupi i Gjilanit" po rinë në burg i dënuar nga 20 vjet për vepra në Kosovë, nuk ka kurrfarë juridiksioni edhe ai është agresion apo një tip lloji - agresion tjetër vetëm që askush nuk është kah merret me këto probleme.

Natyrisht zoti ministër, do të duhej Qeveria bashkë me policë me i pas sjell edhe dy civilë sepse njëri është veprimtar i njohur, është qytetar i ndershëm edhe punëtor i njohur te ne sindikalit, tjetri është qytetar i cili jeton e punën në një shtet të tretë dhe i cili e ka shfrytëzuar rrugën dhe në marrëveshje që e ka mbërri zëvendëskryeministria e Kosovës me delegacionin e Serbisë dhe që marrëveshja po lëvdohet nga gjitha anët këtu. Ne kemi dyshua në këto marrëveshje, vazhdojmë me dyshua sepse njerëz janë bërë peng të besimit dhe po e paguajnë tash edhe me burgim.

Ju kisha lutur që Qeveria jonë edhe ju në kompetencat tuaja të merreni edhe me civilë që kanë mbet atje edhe me gjitha problemet tjera siç është edhe rasti i kushtëzimeve sepse njerëzit s'po munden me ardhur në Kosovë, po detyrohen me pagua 60 euro hyrjen, përderisa të tjerët hyjnë e marrin qytetarë, kidnapojnë, arrestojnë dhe i lirojnë kur të donë dhe i tregojnë muskujt.

Është thanë që Serbia ka nevojë për konsum të brendshëm sepse i kanë ata zgjedhjet dhe po donë me tregua serbomadh.

Njëra prej arsyeve që e kemi dëgjua kuluare ndërkombëtare në Kosovë është se konsumin e brendshëm po e shfrytëzon duke keqtrajtuar njerëzit e Kosovës. Ky është problem edhe më serioz sepse ne nuk mundemi me garantuar kush fiton e kush humb në Serbi, dhe nëse

ju lejoni me ua u marrë njerëzit përditë atëherë një ditë kanë me ardhur në Prishtinë me marrë dikun prej Kabinetit qeveritar e mandej ju duhet me negociua me nxjerr. Veç po ju siguroj që punët kanë me shkua më larg se kaq sepse kemi fillua me i harruar njerëzit që edhe sot janë në burg.

Ju e thatë që policia janë kthye me uniforma, por armët ja kanë marrë dhe ata procedurën për vepër penale - armëmbajtje po ua vazhdojnë dhe kjo nënkupton që ai nuk e njeh Policinë e Kosovës dhe nuk e njehë Policinë e Kosovës si institucion i organizuar. Armët zyrtare që janë ble me buxhet të Kosovës janë në gjykatat serbe. A ke ndërmarrë në këtë drejtim diçka, dhe çka mendon me realizua?

Dhe pjesa e dytë, unë po i kthehem prapë çështjes së kufirit. Ju lutem, qytetarëve së paku duhet me ua shpjeguar ku është zona e gjelbër sepse për policë po besoj që e keni shpjegua, sepse njerëzit nuk e dinë sot e asaj dite implikimin e marrëveshjes Gligorov – Milosheviq dhe rishikimi i zonës së gjelbër, ajo është rishikua në tërësi prej Stançiqi në Gjilan e deri në Dumnice, është e rishikuar dhe këtë duhet me ua bë qartë, duhet me iu tregua njerëzve ku është ajo zonë sepse më herët i kanë arrestuar njerëzit që kanë shkua në pyll me pre ose me e ruajt bagëtinë e tash ka kaluar policia e nesër a ka mbet kush tjetër pos ndonjë ministër u arrestua në kabinet e mandej mu bë hora e zotit krejt ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Emin Gërbeshi, e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Serbia ka bërë agresion në shtetin e Kosovës dhe këtë nuk e ka bërë për të parën herë dhe në të gjitha rastet nuk ka gjetur përgjigjen adekuate nga institucionet e Kosovës.

Kidnapimi i policëve brenda territorit shtetëror të Kosovës i ka vënë seriozisht në prova aftësitë e institucionit të sigurisë së Kosovës, ka degraduar autoritetin e policisë dhe na ka bërë me dije se Serbia është po ajo që ka qenë dikur dhe se Qeveria e Kosovës duhet të ndërrojë politikat karshi Serbisë.

Gjithashtu mendoj se ka defekte në zinxhirin komandues dhe të profesionalizmit dhe se përgjegjësia kryesore bie mbi drejtorin e Policisë së Kosovës i cili në këto kushte do të duhej të jepte dorëheqje, e po ashtu edhe ministri duhet të rishikoj pozicionin e tij.

Qeveria e Kosovës duhet të ndërpres bisedimet me Serbinë dhe ato t'i kushtëzojë me njohjen e pavarësisë nga ana e Serbisë. Dhe derisa Serbia nuk e bënë këtë, nuk kanë kurrfarë kuptimi bisedimet me një shtet agresor që nuk respekton asnjë marrëveshje qofshin edhe ato marrëveshje ndërkombëtare.

Qeveria duhet të forcojë sigurinë për rreth kufirit me Serbinë dhe duhet pajisë forcat e sigurisë me mjete shtesë që agresorit t'i përgjigjet me mjete adekuate që përgjigjen të gjitha shtetet e botës kur preket sovraniteti i tyre.

Për të mbrojtur sovranitetin e shtetit nuk mjafton vetëm ana deklarative çfarëdo qoftë ajo deklaratë. Ne duhet kuptojmë se jemi shtet dhe ne duhet të sillemi konform të asaj që jemi shtet dhe duhet të veprojmë me mekanizmat shtetërore gjithherë dhe kurdoherë kur atakohet sovraniteti shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuleta, e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryesues i Kuvendit,
Deputetë të nderuar,

Kohëve të fundit, sa herë që është folur për arrestimet e famshme të dy policëve të Kosovës, fjala që më së shumti është dëgjuar nga faktorë të ndryshëm ka qenë fjala poshtërim. Dhe kjo fjalë është përdorur në dy rrafsh: në rrafshin institucional, ku akti i arrestimit dhe i formës së trajtimit së të arrestuarve cilësohet si poshtërim i shtetit; dhe në rrafshin personal, ku ky akt dhe ky trajtim cilësohet si poshtërim dhe mungesë integriteti personal i policëve të arrestuar. Konsideroj se në të dy rastet ky cilësim ishte dhe mbetet i padrejtë.

Në rrafshin institucional, nuk konsideroj se është poshtërim për faktin se ky është një akt që mund t'i ndodhë secilit shtet, sado i fuqishëm që është ai. Madje, në një të kaluar shumë të afërt kemi shembuj edhe më eklatantë të sulmeve ndaj shtetit më të fuqishëm në botë. Fjala është për rastin e sulmit terrorist mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ç'rast u goditën dy pika që simbolizojnë edhe fuqinë e vërtetë të Amerikës. U goditën objekte që reflektojnë fuqi ekonomike si Kullat binjake dhe u godit Pentagoni, që konsiderohet vendi më i sigurt në botë. Pra, nga rastet e veçanta nuk duhet konstruktuar cilësime të përgjithshme.

Ndërsa, sa i përket cilësimit në rrafshin personal, cilësimi i tillë jo që nuk është i drejtë por, për më tepër, nuk është as human. Të gjithë e kemi fare të lehtë të krijojmë një fotografi para nesh, në të cilën gjenden 13 pjesëtarë të policisë serbe të vendosur në pozicione, në një aksion të përgatitur mirë, të cilët iu drejtojnë armët e tyre dy policëve të ekspozuar në një hapësirë pa mbrojtje.

Është cinizëm të kërkosh nga ta të rezistojnë në këtë situatë. Sepse, nëse ata do ta bënin këtë, sot në raportin e Ministrit të Punëve të Brendshme fjala më e ashpër nuk do të ishte kidnapim i policëve por vrasje e policëve. Sot, ne do të kishim dy familje pa një anëtarë të tyre, do të kishim vëllezër e motra pa vëlla, do të kishim fëmijë pa prindër. E unë nuk besoj që kjo është një gjë e dëshirueshme nga dikush prej nesh.

Nëse duhet patjetër ta përdorim fjalën poshtërim, atëherë mendoj se përdorimi më adekuat do të ishte që me të cilësohet veprimi i shtetit serb. Askush më shumë nuk është treguar i ulët e qyqar me këtë akt sesa shteti serb. Dhe kjo, së paku për dy arsye: e para, për faktin se Serbia e parasheh Kosovën në Kushtetutën e saj si pjesë të vet, ndërkohë që në realitet, në raport me Kosovën detyrohet të bëjë veprime banditeske rreth kufirit të saj dhe veprime ilegale brenda territorit të saj. Dhe arsyeja e dytë që e tregon joseriozitetin e Serbisë, është fakti që ky shtet ia lejon një funksionari të saj si Daçiç që t'i keqpërdorë mekanizmat e shtetit për qëllime personale elektorale. Por ajo që është më e rëndësishmja sot, ka të bëjë me të ardhmen. Ne, si Lëvizje për Bashkim, kërkojmë nga

Qeveria e Kosovës që pavarësisht nga arrestimet e Serbisë të cilat kanë qenë hakmarrje e drejtpërdrejtë ndaj arrestimeve të mëparshme të pjesëtarëve të MUP-it serb, të mos ndalet në pengimin e zgjedhjeve serbe në Kosovë, të vazhdojë me arrestimet e pjesëtarëve të MUP-it serb të cilët hyjnë ilegalisht në territorin e Kosovës dhe të bëjë çdo veprim tjetër shtetëror të nevojshëm për forcimin e shtetit të Kosovës. Dhe këtë të mos e bëj për hakmarrje apo përgjigje reciproke – ta bëjë thjesht, në funksion të kryerjes së detyrave shtetërore.

Gjithashtu, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që në të gjitha institucionet ndërkombëtare ta denoncojë këtë rast si agresion ndaj shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në mars të vitit 2011 kanë filluar të ashtuquajturat bisedimet teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Madje ato kanë filluar para se të miratoj vendimi për bisedime nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Kundër vendimit të tillë ishte opozita kosovare e cila paralajmëroi se epilogu final i bisedimeve do të jetë i dëmshëm për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Pavarësisht nga shqetësimet e opozitës, Qeveria e Kosovës filloi bisedimet me Serbinë, kurse në agjendë kishin mbrojtjen e kufijve, doganat, tregtinë, ekonominë, transportin, telekomunikimin, trashëgiminë kulturore dhe fetare si dhe krimin e organizuar. Ndërsa, kryeministri i Kosovës emëroi zëvendëskryeministren si udhëheqëse të delegacionit të Kosovës për dialogun për çështjet praktike me Serbinë.

Cilat janë rrjedhat, efektet dhe pasojat e këtyre bisedimeve deri më tani? Gjatë këtyre bisedimeve Qeveria e Kosovës dalëngadalë ka hequr dorë nga një varg elementesh të shtetësisë së saj. Konkretisht, kështu ka ndodhur kur pala kosovare ka pranuar që qytetarët e saj të lëvizin nëpër Serbi pa pasaporta që mbajnë mbishkrimet e Republikës së Kosovës.

Veprim tjetër i kësaj natyre ishte pranimi që kufiri ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë të cilësohet si kufi administrativ.

Veprim tjetër i cili cenon shtetësinë e Kosovës është pranimi që pala serbe t'i dorëzojë fotokopjet e regjistrave civilë në vend të origjinaleve të tyre.

Në vazhden e bisedimeve me Serbinë, Kosova humbi edhe emërtimin Republikë duke pranuar përfaqësimin me fusnotë në organizmat ndërkombëtarë, duke u kthyer kështu në statusin e Rezolutës 1244 që për fat të keq pësimet e Kosovës nga këto bisedime nuk do të përfundojnë me kaq sepse sipas të gjitha rrjedhave dhe vlerësimeve më reale në vazhdim të këtij procesi karakteri i bisedimeve do të pësojë një ndryshim radikalë nga ai tanimë i njohur si bisedime praktike apo teknike në ato të karakterit politik ku pritet që në tavolinën e bisedimeve do të vendoset për statusin politikë të veriut të Kosovës.

Në anën tjetër, pa u mbushur një vit i plotë nga dita e fillimit të bisedimeve, bashkësia ndërkombëtare e shpërbleu Serbinë edhe me një dhuratë tjetër politike. Konkretisht, me 2 mars të këtij viti Bashkësia Evropiane formalisht i ofroj Serbisë statusin e kandidatit për pranim në bllokun e 27 shteteve evropiane.

Të gjitha këto koncesione dhe benefite politike bashkësia ndërkombëtare së bashku me Qeverinë e Kosovës ia bërën regjimit të Serbisë i cili përfaqësohet prej pasardhësve respektivisht bashkëpunëtorëve politikë të diktatorit Milosheviq, i cila për nga krimet, vrasjet, dhunimet dhe mizoritë e urdhëruara ndaj popullatës civile të ish Jugosllavisë i ofrohet, e madje në segmente të caktuara, e tejkalon edhe vetë Adol Fitlerin.

Kur them bashkëpunëtorëve të Milosheviqit në radhë të parë mendoj në zëvendëskryeministrin respektivisht ministrin e Punëve të Brendshme të Serbisë Ivica Daçiçin i cili ka qenë i përkëdheluri dhe përkrahësi i verbër i të gjitha krimeve të regjimit të Milosheviqit.

Fatkeqësisht, Qeveria e Serbisë nuk u kënaq me të gjitha këto përfitime politike por vazhdoi edhe më tutje t'ua vështirësoj jetën qytetarëve kosovarë dhe shqiptarëve që jetojnë në Serbi. Fillimisht duke u caktuar tarifa shumë të larta për sigurimin e veturave në lartësi prej 105 euro për një muaj, ndërsa për kamion dhe autobus në lartësi prej 236 euro për muaj, që pasur parasysh pagat mesatare në Kosovë dhe Serbi, për qytetarin e rëndomtë këto tarifa janë vështirë të përballueshme.

Goditje tjetër ishte ndaj lëvizjes së lirë të shqiptarëve nga Serbia në Kosovë përmes caktimit të tarifës së lartë për sigurimin e veturave dhe atë 60 euro për dy javë. Në këtë mënyrë Qeveria e Serbisë ua vështirësoi për të mos thënë pamundësoj lëvizjen në drejtim të Kosovës të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Serbi me theks të posaçëm atyre që jetojnë në Luginën e Preshevës.

Më tutje, në shenjë mospërfillje të palës kosovare dhe në një farë mënyre si një lloj ndëshkimi për Qeverinë tonë që pranoi pjesëmarrjen në procesin e bisedimeve Qeveria Serbe në muajin e fundit ndërmori një varg veprimesh ndaj qytetarëve të rëndomtë kosovarë. Kështu, kohëve të fundit me qëllime dhe prapavi politike në vendkalimet kufitare policia dhe doganierët serbë janë duke krijuar në mënyrë artificiale radha të gjata të veturave kosovare për të hyrë në Serbi. Madje, ditë të caktuara për të kaluar këtë kufij qytetari ynë duhet të pres nëpër shi e të ftohtë deri në 15 apo 20 orë. Por as këto maltretime të udhëtarëve kosovarë nuk i kanë përmbushur instinktet e sëmura të qeveritarëve serbë të cilët gjatë marsit të këtij viti iniciuan dhe urdhëruan valën e arrestimeve të kosovarëve në mesin e të cilëve ishte edhe kryetari i sindikatës së industrialistëve të Kosovës.

Këto arrestime ishin të natyrës së pastër politike e jo të asaj juridiko ligjore për çka reagoi Amnesty internacional duke kritikuar ashpër Serbinë për arrestimet hakmarrëse dhe njëkohësisht duke i gjykuar deklaratat e karakterit revanshist të ministrit serbë të Punëve të Brendshme Ivica Daçiçit.

Për regjimin jodemokratik serb nuk ishte i mjaftueshëm vetëm poshtërimi dhe maltretimi psiko-fizik i qytetarëve kosovarë, por ai vazhdoi më tutje në drejtim të poshtërimit të skajshëm të qeverisë kosovare. Këtë poshtërim e realizoj duke kidnapuar dy pjesëtarë të Policisë së Republikës së Kosovës e cila në të njëjtën kohë është edhe palë biseduese me Serbinë. Ky kidnapim i policëve kosovar u bë në mënyrë më poshtëruese se irituese duke shfrytëzuar pamjet e këtij poshtërimi për nevojat e fushatës elektorale të bashkëpunëtorëve të Millosheviqit. Kurse Qeveria e Kosovës, për habinë e qytetarëve të saj dhe opinionit ndërkombëtar, përveç disa deklarimeve mediale, nuk ndërmori asnjë veprim konkret për të treguar veten si palë serioze dhe të barabartë në procesin e bisedimeve. Pra, thjeshtë nuk ndërmori ndonjë veprim me të cilin do t'ia bënte me dije Qeverisë së Serbisë se nëse vazhdojmë me sjellje dhe provokime të tilla atëherë do të tërhiqej nga procesi i bisedimeve. Aq më keq Qeveria kosovare u kënaq me faktin se pala serbe pas angazhimit dhe presionit të faktorit ndërkombëtar dhe EULEX-it liroj policët kosovarë të kidnapuar duke u krenuar se gjatë qëndrimit në burgjet serbe fare nuk ishin maltretuar dhe torturuar nga kolegët e tyre serbë.

Në këtë mënyrë dëshironin të fshihnin para opinionit kosovar faktin se nuk ka maltretim, torturim dhe poshtërim më të madh për një shtet dhe një Qeveri se sa kur oficerët policorë me uniformë të shtetit në këtë rast të Republikës së Kosovës të kidnapohen, lidhen, fotografohen, keqpërdoren dhe trajtohen sikur se të ishin kriminelë ordiner e jo zbatues të ligjit të një shteti të pavarur dhe sovranë.

Mendoj se në këtë mënyrë janë poshtëruar dhe përdhosur në skajshmëri personat zyrtarë, simbolet dhe institucionet shtetërore të vendit tonë. Andaj, më habit sjellja indolente e Qeverisë tonë e cila po paraqitet sikurse asgjë e dëmshme nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodhë, dhe njëherësh po duket sikurse po përgatitet për koncesione tjera që do t'ia bëjë palës serbe në procesin e bisedimeve, i cili tani më veç ka hyrë në vitin e dytë të zhvillimit të tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar, zoti kryesues Haliti,

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Situata e cila po interpretohet kohëve të fundit me incidentin e fundit në kufij të provokuar nga ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë zotit Daçiq është një reflektim politikë më shumë normalisht duke reflektuar dhe në cenimin e sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës dhe si i tillë duke dëgjuar nga mediat dhe nga format e interpretimit të sillet shumë në prekjën e sedrës dhe autoritetit të Republikës së Kosovës, më shumë në mënyrë emocionale se sa në mënyrë analitike dhe faktike se sa çka duhet ne të bëjmë.

Unë mendoj që kjo ndërhyrje të cilën e ka bërë zoti Daçiq e ka përdorur për çështjen e konsumimit politik më shumë në fushatën e vetë paraelektorale që ka dhe si pasardhës i Millosheviqit çon një mesazh të qartë në faktorin ndërkombëtarë se Republika e Serbisë nuk është ende e liruar nga ndjenjat e shovinizmit dhe krijimit të pasigurisë në Ballkan.

Unë dua të jem më i shkurtër dhe më i qartë që nga këto veprime të cilat janë bërë të shohim çfarë mësimesh ne duhet të nxjerrim dhe cilët do të jenë hapat të cilat ne do t'i ndërmarrim.

Ne kemi filluar të tregohemi konstruktivë dhe parimorë në diskutime me Republikën e Serbisë duke facilituar nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në këtë frymë mendoj që bisedimet e ardhshme duhet të jenë të kushtëzuara për tu funksionalizuar marrëveshjet paraprake të cilat janë paraqitur nën facilitimin e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prandaj, nën një. Mendoj që bisedimet nuk duhet të vazhdojnë pa u funksionalizuar IBM apo integrimi i kufijve.

Nën dy, ne në mënyrë urgjente faktori ndërkombëtar, duke bërë presion mbi institucionet e Serbisë, duhet të fillojë procedurën e demarkacionit të kufirit me Republikën e Serbisë.

Nën tre, librat kadastralë të cilët janë, të kompletohen sa më shpejtë në marrëveshje po ashtu. Lëvizjet e qytetarëve të garantohen pa hipotekim të lëndëve të mëparshme të cilat i ka ngritur dhe është duke i ngritur Serbia qoftë për ish ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, qoftë për aktivistët të cilët nuk kanë qenë në vijë bashkërenduese me Republikën e Serbisë dhe duke keqpërdorë edhe autoritetin e Interpolit.

Dhe, po ashtu KFOR-i duhet të adresohet në veri. E kemi thënë dhe e themi prapë që KFOR-i të adresohet seriozisht në kufi në vinë ku kufizohet me Republikën e Serbisë Republika e Kosovës.

Në të kundërtën përpjekjet e Republikës së Serbisë janë për ta cenuar marrëveshjen e Ahtisarit dhe ne e themi qartë, dhe duhet ta themi fuqishëm se cenimi i marrëveshjes së Ahtisarit nuk do ta lejojë funksionalizimin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, nëse vjen deri tek cenimi i marrëveshjes së Ahtisarit nuk do të ketë mekanizma rehabilitues dhe lidhës stabil as në Republikën e Kosovës e as në Republikën e Serbisë që ta qetësojnë situatën sepse situata do merr kahe tjera kaotike dhe nëse është në interes të minimimit të këtij aktiviteti 12 vjeçar që është bërë për ta ndërtuar një Kosovë, e cila ka kaluar një të kaluar jo të mirë në fqinjësi me Serbinë, atëherë mendoj që nuk është investim i mirë.

Sa i përket vlerësimit të policisë, unë mendoj që policia përkundër se zoti ministër Rexhepi u mundua t'i përmend aftësitë e veta profesionale të policisë, mendoj që policia me një eksperiencë njëdekadore është polici jashtëzakonisht e mirë nëse krahasohet realisht me shtetet tjera që kanë një eksperiencë edhe më të lartë.

Prandaj, ka shumë çka që duhet të investohet në polici, por kishim lutur që as mos t'ia matin politikanët trimërinë policëve por edhe policët le të jenë më kërkues me pajisjet e tyre të cilat duhet të jenë në nivel të detyrës qoftë të shërbimit kufitar, qoftë në parandalimin e krimit të organizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramadani, e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Fryma e qeverisjes zakonisht reflektohet edhe përmes skandaleve dhe rasteve të rënda sikurse ishte ky, dhe kjo frymë e qeverisjes së tashme të Kosovës normalisht se s'ka se si të reflektohet ndryshe përveç nënshtrim edhe poshtërim të qytetarëve të Kosovës dhe ulje të besimit të qytetarëve të Kosovës për institucionet e veta.

Shteti dhe sistemi politik nuk matet vetëm me skandal, por shteti dhe sistemi politikë matet me atë se si reagon shteti dhe shoqëria ndaj atij skandali dhe ndaj atij rasti të rëndë.

Dhe çka kemi pa në këtë rast, kemi pa se ky është një poshtërim dhe duhet ta themi tepër qartë. Është një skandal dhe duhet ta themi tepër qartë dhe mbi të gjitha tregon se në çfarë gjendje të rëndë dhe të keqe është Ministria e Punëve të Brendshme, politikat e saj të këqija e të gabueshme dhe në të njëjtën kohë qeverisja dhe udhëheqja e keqe e kësaj Ministrie me gjithë agjencitë që i ka brenda si të tilla.

E dimë fare qartë se kërcënimet e ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë kanë ekzistua. Ato kanë qenë publike, janë thanë jo vetëm një herë por shumë e shumë herë. Dhe tashmë e kemi edhe ministrin Rexhepi që edhe publikisht e ka pranuar se nuk i ka marrë seriozisht kërcënimet e ministrit Daçiq.

Pra, problemi është ky, se nuk ka pas qasje serioze ndaj kërcënimeve që vijnë prej Serbisë në momente të caktuara dhe normalisht në faza më të rënda politike edhe që kalojnë në Serbi edhe në raport me Kosovën.

Pyetja kryesore që duhet t'i drejtohet ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Policisë është se: pse nuk janë rritë masat ose niveli i gatishmërisë në Policinë e Kosovës dhe në veçanti Policinë kufitare pas kërcënimeve që i ka bërë ministri i Serbisë Daçiq?

Kjo është përgjegjësia politike, kjo është përgjegjësia udhëheqëse dhe kjo është përgjegjësia edhe e zinxhirit komandues që ekziston brenda Policisë së Kosovës dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ministri Rexhepi ka thënë se nuk i ka marrë seriozisht dhe kemi pa rastin se si ka reflektuar kjo mosqasje serioze e ministrit Rexhepi dhe e Ministrisë Punëve të Brendshme.

Dhe, këtu nuk kërkohet dhe nuk lypet përgjegjësi morale. Absolutisht nuk po flasim për veprime ose qasje morale apo përgjegjësi morale për këtë.

Ka përgjegjësi në bazë të detyrës, sepse detyra nuk është kryer. Dhe detyra ka qenë e duhet të jetë se sa herë që Kosova kërcënohet nga dikush, institucioni përkatës duhet ta rritë nivelin e gatishmërisë, varësisht prej kërcënimeve që kanë ardhë.

Kërcënimet kanë qenë, s'ka pas gatishmëri të rritur, dhe incidenti ka ndodh.

Pastaj, çka ka pas incidentit? S'ka pas reagim institucional! Nuk është mbledh Këshilli i Sigurisë Kombëtare. E tash, në të njëjtën kohë, ministri Rexhepi na flet sikurse të ishte kandidat për Çmimin Nobel për paqe dhe nuk flet sikur ministër i Punëve të Brendshme dhe si Qeveri e Kosovës asnjëherë nuk e kemi dëgjua se çfarë qëndrimi ka në këtë rast.

Tash po na thuhet, me njëfarë çudie se: Serbia na qenka e keqe, se Serbia paska qasje fashiste, se Serbia qenka anti-evropiane. Por zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka thënë se na ka njohur Serbia. Dhe nëse po e bëj pak me ironi, ata policë ndoshta kanë menduar dhe i kanë besuar zonjës Tahiri se Serbia na ka njoftë dhe, hajde që paskan dal andej, që nuk besoj fare. Po, hajde që edhe paskan dal, sepse i kanë besuar kësaj zonjës së Qeverisë se Serbia na ka njoft dhe kemi raporte të mira

Tash po na del se Serbia është fashiste, është e keqe, është anti-evropiane. Dhe si ndodh kjo që edhe të na njeh, edhe të na arrestojë dhe të gjitha këto?!

Po, problemet e Policisë dhe Ministrisë Punëve të Brendshme po vazhdojnë të jenë te planifikimi strategjik dhe te planifikimi operacional si pasojë e ndërhyrjeve edhe politike në këto elemente.

E dimë fare qartë për emërimet politike, në zinxhirin komandues të policisë si agjenci e MPB-së, e dimë fare qartë numrin tepër të madh të pozitive menaxheriale në Polici të Kosovës që janë me ushtrues detyre, e dimë fare qartë se çdo 2-3 muaj ndërrohen edhe këta ushtrues detyre brenda Policisë Kosovës dhe këto janë hiq ma pak se ndërhyrje politike në strukturën e Policisë së Kosovës dhe normalisht se kjo ndikon edhe në demotivimin e zyrtarëve policorë.

Policia e Kosovës është institucioni që më së shumti ka motiv dhe duhet të ketë. Por këto ndërhyrje normalisht se ndikojnë në demotivimin e tyre dhe normalisht se ndikojnë edhe në servilitetin e zyrtarëve policorë karshi shëfave, sepse ata po ndërrohen çdo 2-3 muaj. Dhe normalisht se ata ushtrues detyre nuk mund ta kryejnë punën e vetë duke e ditur fare qartë se nuk e kanë të siguruar madje as një mandat prej asaj se që janë zgjedhur që të funksionojë në të njëjtën pozitë menaxheriale. Sepse, ata mund të ndërrohen çdo 2-3 muaj dhe kjo po e dëmton Policinë e Kosovës.

Dhe për fund, me cinizëm dhe me ironi po e them por ministri Rexhepi është i njohur me ato “hajmalitë” që ua shkruan shqiptarëve në veri. Po pse nuk iu shkroi “hajmali” edhe policëve që të mos frikësohen dhe të mos dorëzohen?! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati, e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë do t'i bashkëngjitëm gjithë dënimit të fuqishëm në raport me gjithë atë çka ka ndodhur me kidnapimin dhe trajtimin e policëve të Republikës së Kosovës.

Realisht, duke e parë këtë dhe sado që në përshtypjen e parë kemi pas përshtypjen se ne kemi të bëjmë me një fqinjë që po fillojmë normalizimin e raporteve, krejt ajo çka ka ndodh janë fotografi që mund t'i shohim në Korenë e Veriut apo fotografi në të kaluar nga lufta në Bosnjë. Prandaj kjo edhe njëherë mendoj askënd në Kosovë nuk ka befusuar, por po besoj që edhe njëherë ka vend që të këndellen disa qarqe, të cilët shpresojnë se me kandidaturën, Beogradi do të ndërrojë në esencë, dhe e vërteta është që jo.

Ne e dëgjuam raportin nga ministri dhe shpresojmë që edhe hetimet e grupit po e quajmë kështu “neutral” do të përkojë, apo do të përputhen me të gjeturat dhe konstatimet fillestare që i ka dhënë grupi hetues, siç i prezantojë ministri.

Sido që të jetë, dhe pavarësisht që po themi në mënyrë hipotetike se janë gjetur policët pak metra majtas apo djathtas, gjithë ajo që i ka parapri jashtë kompetencave dhe sjelljeve normale në situatat e ngjashme, e tregon edhe njëherë qëllimin e keq të ministrit Daçiq, por jo vetëm të ministrit sepse të mos ta kishte pas ai heshtjen ose përkrahjen e institucioneve tjera dhe të asaj klime në Beograd, nuk do të ishte sjell ashtu.

Fatkeqësi është që ai ka shpresuar se duke i bërë veprime të tilla do ta ngritë reitingun e vet dhe eventualisht do të pozicionohet më mirë në interesat e brendshme, por edhe për ta realizuar fjalën e tij që ishte paraprakisht kërcënuese, që e ka dhënë më herët.

Por, ajo çka unë do të kisha dëshiruar që të jetë mësim edhe këtë herë - është që gjatë analizave të ndryshme, gjatë bartjeve të kompetencave, pa keqardhje dhe pa nënçmim, duhet gjithmonë të analizohet se një kompetencë për ta ushtruar duhet së pari të shihet të merret edhe përgjegjësia dhe duhet të shihet se me cilat kapacitete do të ushtrohet.

Duke ditur se për cilën pjesë bëhet fjalë, ka pas fare mundësi të mos ecet vetëm, por të vazhdohet me KFOR-in deri në ngritje të plota të kapaciteteve, sidomos në fazat e tensionimeve që i kemi tash.

Unë nuk do isha paraqitur për fjalë, ngase vërtetë shumë u thanë, por unë dua të shprehi dhimbjen time dhe solidaritetin me gjithë atë dhimbjen që e kanë pësuar policët e familjet e tyre, por edhe i gjithë opinionit kosovar.

Nga ana tjetër, unë mendoj se i gjithë ky komunikim tani, edhe diplomatik edhe nëpërmes të opinionit duhet të jetë vetëm një fillim i presionit të madh, por edhe i sqarimeve të mëdha, ngase ky është vetëm fillimi i kontakteve direkte të institucioneve të Republikës së Serbisë dhe i qytetarëve.

Ne e dimë se na pret veriu dhe nëse sot jemi befusuar për një veprim të Daçiqit ose të Serbisë në një pjesë të Kosovës, nesër sigurisht këto tendenca do të jenë akoma më të ashpra.

Prandaj, para se të fillohet me veprimet pozitive dhe konkrete në veri këto situata duhet të qartësohen dhe unë mendoj se po që se këto mbyllen këtu ku ne po diskutojmë sot, unë

mendoj se tek bëhet gabimi i madh, ngase do të pajtohemi që nesër mund të ndodh një tjetër.

E që të përgatitemi që të mos ndodhin gjëra të tilla, unë mendoj se këtë çështje mund ta trajtojmë në formë shumë të edukuar që po e trajtojmë këtu për hir edhe të opinionit, por mendoj se edhe institucionet duhet ta bëjnë punën e vetë dhe këtu duhet të fillojë. Prandaj, nëse themi se për njohje duhet të udhëtojnë 5 ministra, për këtë çështje unë mendoj se gjithë ministrat kompetentë sot ishte dashur të jenë në Bruksel dhe kjo çështje duhet të fillojë të trajtohet shumë seriozisht edhe më tutje.

Mirëpo, po shpresoj se herën tjetër kur të kemi rastin të bisedojmë për këtë çështje, kjo çështje do të jetë më e ndriçuar definitivisht dhe s'mos ta kemi vetëm version, por ta kemi versionin përfundimtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj që do të kemi edhe raportin e KFOR-it se kush në territor të kujt është hy dhe unë mendoj që do të duhej me u përqendruar tek këto çështje dhe jo me u marr me "vajtim" shumë. Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Unë mendoj që më tepër se një analizë episodike, ne duhet të bëjmë një debat për reflektimet e këtij veprimi, sepse veprimi i vërtetë është banditesk dhe kriminal, por porosia është jashtëzakonisht politike. Dhe nuk do mend se ky nuk është asgjë e re, pos një provokim i radhës i Serbisë, një provokim në radhën e provokimeve që i ka pas Kosova nga shpallja e pavarësisë dhe provokimet që do të vazhdojnë në kontinuitet, sepse nuk është kjo një pasqyrë e një Serbie paraelektorale, por kjo është një politikë e Serbisë reale.

Mendoj se ky veprim banditesk, që cenon rendin kushtetues, e tregon karakterin e vërtetë të policisë në një shtet që e quan veten demokratik, në një shtet që jo më shumë se pak muaj e ka marrë edhe statusin e kandidatit si një shpërblim apo mirënjohje për një orientim pro evropian.

Prandaj, mendoj se veprimet e saj janë shqetësuese për opinionin e Kosovës, janë edhe një veprim që duhet të shtyjë të mendojë edhe hartuesit e politikave privilegjuese evropiane, që në të vërtetë në Serbi kemi të bëjmë ende me një regjim të vjetër, kemi të bëjmë me një polici e cila shumë pak ka ndryshuar nga policia që në Kosovë ka bërë aq shumë krime.

Pra, nuk do mend se nga kjo ngjarje që ka qenë jashtëzakonisht e rëndë për qytetarët e Kosovës, mund të nxjerr tri mesazhe, të cilat ne duhet t'i kemi parasysh si Parlament dhe si politikanë.

Mesazhi i parë është që ne, në vazhdimësi do të kemi provokime të tilla dhe provokimet e tilla do të vijnë gjithmonë në momente të caktuara dhe bëhen në këtë kohë kur Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Rendit ka filluar me marr veprime të vendosura shtetërore për

parandalimin e veprimeve kriminale, shpërbërjen e strukturave jo ligjore dhe jo kushtetuese, parandalimin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe përdorimi i tillë i këtij aksioni banditesk e ka edhe një efekt psikologjik që të tregojë që me kundërmasa do të mund tu parirohet këtyre vendimeve legjitime të Qeverisë së Kosovës, sepse ajo çfarë po bën Qeveria e Kosovës është krejtësisht legjitime dhe do ta bëjë çdo polici në çdo shtet demokratik për të mundësuar funksionimin e ligjit dhe Kushtetutës dhe përmes këtij veprimi banditesk, sikur duhet të paralizohet Qeveria në këmbëngulësinë e saj dhe në vazhdimësinë e saj për të vendosur rendin, sidomos për të vendosur rendin në pjesët ku sundon krimi e jo ligji.

Për mendimin tim, Qeveria e Kosovës dhe Policia e Kosovës nuk duhet për asnjë milimetër të zbrapset nga projekti i vendosjes së ligjit e rendit dhe marrjes së të gjitha masave për zhbërjen finale të gjitha strukturave jo ligjore e jo kushtetuese dhe jo vetëm në veri por edhe në brendi dhe parandalimin e vendosur shtetëror ndaj tendencës së mbajtjes së zgjedhjeve lokale, që është një provokim shumë i rëndë ndaj sistemit kushtetues.

Por, në radhë të parë, unë mendoj se ky është një mesazh shumë i mirë për bashkësinë ndërkombëtare e cila po e shpërblen Serbinë me statusin e kandidatit në kohën kur në fakt në Serbi vazhdon i njëjti mentalitet. Këtu nuk është fjala për një ministër të ledhatuar për një mbetje të Millosheviqit, por është fjala për një Qeveri, e cila ka imazhin e një Qeverie demokratike në Bruksel dhe e cila shpërblehet, prandaj mendoj se Bashkësia ndërkombëtare duhet ta ketë të qartë që asgjë s'është bërë me reforma demokratike në Serbi. Serbia ndaj Kosovës vetëm ndërron format e manifestimit, por nuk ndërron esencën e politikës së saj antishqiptare dhe antikosovare.

Në anën tjetër, këto provokime të rënda të integritetit kushtetues të vendit tonë duhet të jenë edhe një mesazh për Qeverinë e Kosovës se çfarë sfida do të ketë Qeveria e Kosovës në proceset e dialogut teknik apo proceset e bisedimeve. Duhet të kihet parasysh që asnjë proces me Serbinë nuk do të shkojë lehtë, asnjë marrëveshje politike nuk do të implementohet dhe më tepër Serbia këto veprime po i ndërmerr për të përfituar. E mori përfitimin, përfitimin kryesor që kishte – e mori statusin e kandidatit dhe mjaft mori edhe kredi, sepse tani e ka një kredi bukur të madhe për shkak se nuk do të ketë tryzni te Serbia derisa të kryhen zgjedhjet për të vazhduar procesin e normalizimit të raporteve me Kosovën dhe duhet pas gjithmonë parasysh që asnjë marrëveshje me Serbinë nuk ka garanci të implementimit. Dhe, Serbia do të gjejë momente, si momenti i fundit për të destabilizuar Kosovën dhe për ta rikthyer vëmendjen apo për ta larguar vëmendjen nga proceset normale të normalizimit të raporteve me Prishtinën.

Dhe në fund do të kthehem në atë që deputeti Selimi me të drejtë e shtrojë. Po, ne mund të themi se kjo është përgjegjësi e KFOR-it, mund të themi se me marrëveshjen teknike ushtarake të Kumanovës dhe me Rezolutën 1244 garantimi i kufijve të Kosovës është përgjegjësi e KFOR-it.

Por, siç e dini ne kemi shpall si projekt kombëtar, sivjet projekt shtetëror përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur. Dhe, kjo kërkon nga ne, e nga gjithë ne, sidomos nga strukturat e sigurisë kombëtare që të përgatisin strategjinë e sigurisë kombëtare ku projekti i

sigurisë kufitare është me rëndësi vitale, sepse jo vetëm tani, por edhe shumë vite ndoshta edhe dekada kufiri me Serbinë nuk do të jetë i qetë, do të jetë burim i krimit shumëdimensional dhe do të jetë burim permanent i cenimit të integritetit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Nuk duhet të thirremi në kufizimet legale dhe kushtetuese, por si politikë pragmatike, si politikë pragmatike ne duhet të ndërtojmë këtë koncept të sigurisë kombëtare. Ne i kemi edhe shembujt e mirë këtu, kemi për shembull rastin e Sllovenisë e cila ka qenë shumë pragmatike në ndërtimin e projekteve të sigurisë kombëtare dhe ato i ka vu në funksion në momentin kur iu kanë dashur. Pra, të tregohemi pragmatik dhe mos të bëjmë politika me çështjet shtetërore dhe me çështjet kombëtare, por të tregohemi pragmatikë dhe të mos pësojmë gjithmonë nga rastet, mos të udhëhiqemi gjithë nga motivi “na ndodhi tash duhet me bë diçka” por të punojmë që integriteti dhe dinjteti i shtetit të Kosovës gjithmonë të jetë i mbrojtur, të jetë i mbrojtur me institucionet të shtetit të Kosovës. Jemi shtet dhe duhet në çdo formë të veprimit, të veprojmë në formë shtetërore dhe institucionale në përmbushjen e detyrimeve tona kushtetuese, në mbrojtjen e integritetit territorial dhe në mbrojtjen e rendit unik kushtetues. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Faleminderit! Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është e pazakonshme kjo çka po them, por u intrigova për shkak se nuk e pata në plan të flas, se në emër të grupit u tha krejt çka u desh me thënë. Por, ajo që më intrigoj është fakti që në Kuvend të Kosovës nja 50 herë ju përmend emri ministrit të Serbisë!

Po më duket se s’ka nevojë bre! A po iu bie ndërmend që s’është mirë me ia përmend emrin hiq këtu, se po i bëjmë fushatë, puna e parë. Ai nuk është ministër i joni dhe është ministër i një vendi.

Çështja e dytë që më intrigoj është se gjysma e diskutimeve kenë tu kajt sa e keqe është Serbia, sa të mirë jemi na. Dhe prapë, s’kemi nevojë bre këto sene me i bë kështu, domethënë në njëfarë forme po duket keq Kuvendi, keq po duket Kuvendi duke ia përmend 50 herë emrin një ministri të Serbisë, duke kajtë krejt kohën sa e keqe është Serbia, sa të poshtër janë ata, çka po na bëjnë neve.

Përderisa nuk pat debat real përpos dy ose tri diskutimeve, çka duhet me bë na? A duhet ndoshta Kuvendi me bë ndonjë për mos me na ndodh diçka e tillë në vazhdimësi, për shkak se po e dimë sa të këqij qenkan ata andej. E morëm vesh më në fund.

E a duhet me pas ndonjë politikë të veçantë? Me na treguar ministri cilat janë politikat që donë me i nis tash e tutje, që mos me na ndodh diçka e tillë në të ardhmen. Me na kallëzuar çfarë masa ka marrë edhe në aspektin ndërkombëtar se na e kemi të qartë që nuk e bëjmë krejt sigurinë tonë vetë, tani për tani.

Bile, bile ndoshta edhe me na kallëzuar, më falni për këtë digresion, në fund me na kallëzuar edhe a na i kanë kthye radio-lidhjet dhe revolet që na i kanë marrë.

Shkurt shumë e pata, po me të vërtetë domethënë deputetët e Kuvendit duhet me ia veshin pak kësaj pune, nuk kemi nevojë me ia përmend emrin një ministri të Serbisë në Kuvend të Kosovës, një. Dhe e dyta, nuk kemi nevojë me kajt krejt kohën se sa e keqe është Serbia, sa të mirë jemi na. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti dhe anëtari i kryesisë Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Faleminderit!

U intrigova realisht nga diskutimet e mëparshme dhe qasja e kohës së kaluar kur neve jemi pas mësuar vetëm të protestojmë ashpër në konferenca shtypi dhe të mos veprojmë, sepse s'kishim tjetër rrugë.

Po harrojmë se na jemi shtet i pavarur dhe i mbrojtur fuqishëm jo vetëm nga Forca jonë e Sigurisë, por jemi të mbrojtur dhe të garantuar nga një fuqi shumë e madhe që është NATO dhe nuk është mirë që të dëgjojmë fjalë në foltoret e Kuvendit të Kosovës që NATO qenka fajtor pse kanë gabuar policët serbë ose pse kanë gabuar policët e Kosovës. Unë nuk e kam të qartë dhe nuk e kam të saktësuar se kush është fajtor këtu, kush e ka shkel vijën e kufirit dhe nuk e kam pa dhe nuk e kam dëgjuar zyrtarisht një raport dhe këtë raport përgjegjës për ta bërë janë organet kompetente dhe jo ne, pra që ta shohim të gjithë e ta kuptojmë edhe populli se kush ka gabuar.

Tani sa i përket kufirit, çdo shtet edhe Kosova në këtë rast, edhe Serbia ka të drejtë që të veprojë, ta burgosë secilin shkelës të kufirit duke përfshirë edhe atë se mund të jetë polic i njëres apo tjetres palë.

Ka mund me qenë edhe më keq dhe është mirë që s'ka pas viktime. Kjo do të ishte më e keqja, sepse, do të ulte besimin edhe nga ndërkombëtarët edhe nga fuqitë të cilat po përpiqen vërtet që Ballkanin ta bëjnë Evropë.

Mentaliteti ballkanik, duke e parë secili secilin vetëm si armik mendoj se duhet të fillojë të ndryshojë. Duhet të fillojë të ndryshojë! As s'kemi nevojë ne të bëjmë patriotizëm në Kuvend për një incident që ka ndodh dhe as s'ka nevojë që ne të sulmojmë tani në karriget e Kuvendit njërin qoftë ministrin këtu që është ulur, qoftë policët që ndoshta nuk e kanë ditur a janë në territor të Kosovës apo të Serbisë. Por, edhe ne kemi informata shitesë sepse ne kemi të dhëna që edhe policët mes veti komunikojnë shumë herë, bile edhe pinë kafe policët e Kosovës dhe të Serbisë dhe ky është një realitet. Na duhet me pranuar dhe nuk është keq kjo, se na kemi bërë, e kemi bërë një marrëveshje për kontrollin e kufirit të integruar që po e quajmë, por kësaj radhe na ka ndodh një incident.

Mos të harrojmë ka pas incidente në Ballkan që jo policia, po forca të caktuara janë futur në territor të huaj. Në këtë rast po e përmendi rastin e Shqipërisë kur janë futur ajo organizata MAVI edhe i ka zënë ushtarët e Shqipërisë në gjumë dhe i ka vra në garnizon. Dhe Shqipëria nuk e ka filluar luftën me Greqinë, edhe pse janë vra.

Këtë, te ne e kanë bërë qoftë për çështje elektorale, qoftë për njërin, qoftë për tjetrin dhe vendet normale i gjejnë kanalet e komunikimit dhe i ulin tensionet. Dhe, nga Parlamenti i Kosovës mendoj që nuk është mirë që ne të përpiqemi të ngrisim tensionet thua që ka ndodh diçka që po që paska ndërruar tani gjithçka në raportet tona ose në pretendimet tona, t'i quaj të përbashkëta, do të dëshiroja, për të qenë vërtetë evropian dhe pjesë të Evropës.

Unë nuk e di se a e keni parasysh që secili vend po e përjashtoj Kosovën që s'ka ligj për kufirin, por e ka ligjin e vetë për kalimin ilegal të kufirit dhe secili vend vepron. Hajde ta miratojmë ligjin dhe hajde të insistojmë që sa më shpejt në bisedimet që janë duke u zhvilluar me Serbinë të bëhet edhe demarkacioni i kufirit Kosovë-Serbi dhe këto probleme të zgjidhen gradualisht.

Në qoftë se policët e kanë kaluar kufirin në atë zonë ose janë mashtruar, sepse unë e thash dhe po e them jo rastësisht se ata po komunikojnë njëri me tjetrin, po që e kanë kaluar gabimisht kufirin atëherë të shohim se cila do të jenë veprimet e tyre.

Fjalët e mëdha dhe fushata, realisht siç e tha edhe zoti Gjini që jam plotësisht dakord, në favor të votave të dikujt atje nuk janë të mira. Prandaj mendoj që ministri e ka bërë raportin e në qoftë se ka vend për përgjegjësi të ministrit, në qoftë se ka vend për përgjegjësit e komandantit të policisë, në qoftë se ka vend për përgjegjësi të dy policëve - ne duhet të diskutojmë. Duhet ta kemi parasysh që na nuk mund të kërkojmë, as s'mund ta qesim para përgjegjësisë askënd në një shtet të huaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Vjollcë Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar, ministra,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht do të doja t'i bëja vërejtje kryesuesit të seancës, për mbajtjen e radhës së fjalëve të deputetëve.

Ne zoti kryetar këtu do të duhej të punonim sipas një Rregulloreje të punës. Dhe, këto aparatura që i kemi këtu përpara, i kemi për të sinjalizuar se duam ta marrim fjalën dhe e kemi një radhitje.

Isha e dyta kur desha ta marr fjalën, ndërsa tash jam thuaja se e fundit dhe mund të ju them që asnjë femër s'ka diskutuar deri më tani.

Nëse kanë privilegj deputetë me legjislatura të shumta apo keni ju një listë atje të të privilegjuarve, atëherë ta dimë dhe të presim deri në fund.

Rasti i kidnapimit apo rrëmbimit të dy zyrtarëve policorë shqiptarë nga ana e policisë serbe ishte një imazh i keq, një fotografi e keqe për Policinë e Kosovës dhe skemë shqetësuese për qytetarët tanë.

Ishte e dhimbshme të shiheshin dy policë të uniformuar të shtrirë në pranga në duar e me tyta të armëve të policisë serbe mbi kokat e tyre.

Kjo është një vepër e shëmtuar shumë e ulët nga ana e policisë serbe. Ky veprim dëshmon edhe një herë se bisedimet me Serbinë, bëhen vetëm e vetëm për përfitimet e palës serbe dhe assesi dhe asgjë nuk përfitojnë qytetarët tanë. E, këtu në këtë Kuvend, nga protagonistët e bisedimeve na flitet me injorancë bile edhe me fodullëk për suksesin e këtyre bisedimeve dhe për përfitimet e qytetarëve tanë.

Këto skena nuk janë edhe befasese. Janë vazhdimësi e agresionit serb në shtetin e pavarur të Kosovës.

Aq më tepër është e dhimbshme kur veprimi ndodhë me paralajmërim dhe ministri apo Ministria e Punëve të Brendshme nuk merr kurrfarë masa të shtuara sigurie, po merren deklaratimet e zyrtarëve serb me neglizhencë dhe jo serioze.

Prandaj unë nuk do të kërkoj dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme, sepse e di se nuk do të kalojë kjo kërkesë e imja, sepse koalicioni është i ndërtuar në konstruksionin mikst duke përfshirë këtu edhe numër të madh të minoritete. Por do të doja t'i thoja ministrit, pak sa me ironi të shtoj masat e sigurisë se jetoni në pjesën e veriut të vendit në Mitrovicë dhe kam frikë se një ditë do të mund të kidnapojnë edhe juve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Hydajet Hyseni! Le të përgatitet diskutuesja e fundit, Ganimete Musliu.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Edhe unë isha në dilemë të marr apo të mos te marr fjalën edhe për një arsye sepse që është e vërteta, raste si ky meritojnë vëmendje, por nuk jam i siguritë se fjalët kallaballëk janë edhe ilaçi i duhur.

Nuk besoj madje se as fjalët e sarta, fjalët tepër të forta ndihmojnë diçka. Ajo çka na ka munguar dhe besoj i ka munguar edhe opinionit, është së pari e vërteta, zbardhja e rastit dhe një qasje e duhur institucionale, profesionale shtetërore. Ka munguar!

Na ka ndodhur ajo që nuk duhej të na ndodhte. Na ka befasuar kjo që ndodhi siç e ka befasuar Komunën e Prishtinës bora midis janarit. Edhe pse objektivisht kjo ka qenë paralajmëruar me daulle si thonë nga niveli më i lartë, mos t'i përmendi emra.

Mendoj që sforcimi i tepruar i fjalëve nuk e bënë qasjen tonë më të fortë, druaj që efekti është i kundërt.

Për shembull, nëse themi ne se ky ishte agresion, siç u tha nga të gjitha nivelet edhe në këtë sallë, shtrohet atëherë edhe pyetja shoqëruese: e si u ndamë ne në këtë agresion?

Dhe, nëse është ky agresion, e çka sikur të ndodhte më shumë se kaç? E di që dhimbja nganjëherë dhe mëria e tjera, e ashpërsojnë gjuhën. Por unë mendoj se fillimisht do të mjaftonte të vlerësohej si një akt, le të jetë edhe agresiv, si një diversion sepse diversion ishte objektivisht, një diversion që objektivisht mund t'i ndodhë çdo vendi, siç

u tha. Unë jam i bindur pa e tepruar se edhe Policia jonë me ato kapacitete që ka, ka mundur të krijojë situata të tilla spektakulare dhe nuk ndihem keq pse nuk i ka bërë ato. Çështja megjithatë është më serioze dhe do qasje serioze.

Më ka bërë përshtypje, po ashtu një shfaqje edhe me këtë rast, e atij sindromit tonë prej analistit, edhe zyrtarët edhe ministrat edhe të gjithë, e marrin menjëherë rolin e gazetarëve, ulen para ekraneve dhe bëjnë analiza: a thua pse ka mundur ta bëjë këtë ai tjetri që e ka bërë. Dhe ndonjëherë bile e marrim edhe rolin e avokatllëkut të tyre, nuk e kanë bërë për ndonjë tjetër, por u duhet për fushatën elektorale.

Po ku e dimë ne se ky është motivi kryesor? Aq më tepër kur prej njeriut të parë të shtetit fqinjë e poshtë, thuhet: “ne nuk e njohim dhe kur s’e njohim përpiqemi edhe ta rrënojmë edhe imazhin edhe tutje” Pse ne përpiqemi të themi atë që nuk është punë e jona? Pajtohem edhe me vërejtjet që u thanë.

Le të shikojmë ne shfaqjen tonë, ç’do të duhej të bënim ne, ç’bëmë dhe cilat janë mbi të gjitha mësimet që duhet nxjerr nga kjo situatë?

Do të duhej ndoshta të rishikonim disa formula që i kemi dëgjuar kohëve të fundit, shpesh edhe nga nivele prej të cilave nuk do të duhej të dëgjoheshin. Si ato, ta zëmë se Serbia nuk është më problem! Për Kosovën Serbia s’është problem! Serbia ka ndryshuar, Serbia e ka njohur Kosovën, Serbia që është e vërteta Kosovën e ka njohur gjithmonë por nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ndonjëherë edhe na e ka njohur pavarësinë edhe de fakto e de jure e tjera. Kurse këndeji kemi situatat çfarë i kemi.

Lidershipi i Serbisë po ndryshon, është fjala për një lidship evropian, është thënë ndonjëherë për negociatorë evropian, e tjera dhe tash duhet t’i harmonizojmë këto. E çka do të thotë kjo me situatat e krijuara dhe çka paralajmërojnë këto nëse lejohen edhe në të ardhmen.

Dhe do të mund edhe të mos merreshim me këto po të mos jetë nevoja që ne të shkundemi dhe të nxjerrim mësim, dhe veçanërisht të mos lejojmë që të shkojmë me të njëjtin noshalancë edhe në çështje që janë të hapura, siç është kjo e famshmja dhe shumë e mjegulluara çështja e menaxhimit të integruar të kufijve.

Është thënë se me këto praktikisht u rregulluan çështjet e kufijve. Çka to të thotë rasti që ndodhë? Për më tepër, vetë koncepti menaxhim i integruar i kufijve, kam përshtypjen që nuk është sqaruar sa duhet. Është injoruar ndoshta pa dashje, ndoshta me dashje fakti se ky koncept ka dy kuptime, është i dykuptimshëm: menaxhim i kufijve të jashtëm dhe menaxhim i kufijve të brendshëm. Këtu qëndron ndoshta edhe marifeti i ndërmjetësuesve ndërkombëtarë. Këta shesim dushk për gogle, për dike ashtu siç iu leverdisë, për të tjerët ashtu siç dëshirojnë ata. Mirëpo, në praktikë këto nuk funksionojnë edhe aq lehtë. Nuk ka ndonjë vend ku menaxhimi i integruar i kufijve ka ndodhur midis palëve të cilat kanë dallime aq të mëdha sa njëra e konsideron tjetrën pjesë të nënshtruar të pushtetit të vet, tjetra e konspiron të pavarur.

Unë mendoj, më mirë është çështjet t'i themi ashtu siç janë troç dhe të përgatitemi seriozisht, siç thuhet: ta mbushim për ujë e le të dal edhe thëllëzë.

Por, ajo që mendoj do të mund të dilte si konkluzion dhe unë do të dëshiroja ta nënvizoj - është fakti se Kosova kështu siç është, me kaq rreziqe, nuk do të duhej të lejonte këtë noshalancë në kufijtë e saj, veçanërisht në kufijtë e kësaj të kërcënuar dhe të panjohur. Kosova dhe konkluzioni kryesor që duhej t'u nxirrte, do të ishte: forcimi i kapaciteteve në pjesët e rrezikuara të kufirit të saj.

Kosova ka mundësi ta bëjë këtë. Besoj që ka edhe përkrahjen e duhur të partnerëve që tani kanë edhe arsye për ta kuptuar këtë preokupim të madh të Kosovës dhe mendoj që, siç e thotë populli, frika i ruan vreshtat.

Megjithatë edhe një çështje që më bëri ta marrë fjalën, nuk e dëgjova në debat, është edhe rreziku që debati ynë të krijoj një histeri që mund të kthehet pastaj edhe në atavizmat të së kaluarës, të paragjytimeve, të urrejtjes, e kjo Kosovës nuk i duhet.

Kosovës nuk i duhen raste si ato që ndodhen këto ditë. Nuk i duhet që mëria e mllefi i natyrshëm ndaj aparatit policor të kthehet në diçka negative kundër asaj që nuk ka të bëjë me këtë, ndaj qytetarëve të një komuniteti, ndaj monumenteve fetare e të ngjashme. Kosova e ka kaluar këtë fruth herët dhe nuk do të duhej të lejonte të rishfaqet. Ndoshta edhe kjo do të ishte shërbimi më i mirë që i bëhet strategëve të provokacioneve të tilla serioze. Ndoshta edhe janë bërë pikërisht që të na hutojnë dhe të na nxjerrin prej shtegut tonë.

Do të dëshiroja ta përfundoj me një porosi të një plaku shumë vite më vonë kur Kosova provokohej çdo ditë nga aktet si vrasjet e fëmijëve e veprimeve të ndryshme çnjerëzore dhe kur ndonjë i papjekur po thoshte: le t'i përgjigjemi me të njëjtën masë dhe ne. Një plak i mençur, i urët thoshte: kjo është më së lehti, por është më së keqi. Ajo çka duhet është jo të vrasim siç vrasin ata të tjerët fëmijë e njerëz të pafajshëm, por ta vrasim politikën që i shkakton këto. Kosovës i duhet ta ruajë kursin që ka pasur dhe ta konsolidojë atë duke institucionalizuar.

Një proverb i presidentit Amerikan që është bërë proverb i përgjithshëm është: "Mënyra më e mirë për të ruajtur paqen është të forcojmë vetveten", të forcohem edhe në pikëpamje të mbrojtjes dhe të sigurisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu, e ka fjalën dhe është deputetja e fundit e lajmëruar.

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Dhe unë fillimisht dua të mbështesë fuqishëm atë çka e tha kolegja ime Vjollca Krasniqi nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse në seancat parlamentare, asnjëherë nuk respektohet rendi në bazë të kërkesës së deputetëve për të marrë fjalën.

Të nderuar ministra,

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuara kolegë dhe ju kolegë deputetë,
 Pamjet e transmetuara në media, si në elektronike ashtu dhe në ato të shkruara, me të vërtetë kanë prekur thellë në ndjenjat tona dhe në të gjitha ndjenjat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pamjet e tilla në kokën 4 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe 13 vite pas përfundimit të luftës për çlirim në Republikën e Kosovës, kur anekënd Kosovës përkujtohen dëshmorë e martirë të cilët u flijuan që të kemi kufi dhe të kemi një Kosovë të mbrojtur territorialisht siç kemi rastin edhe sot kur në Rezallë të Skenderajt përkujtohen 98 dëshmorë e martirë, gjysma prej të cilëve i kanë varret ende të zbrazura, është me të vërtetë një pamje e trishtueshme dhe shumë e dhimbshme.

Unë kam një bindje të plotë dhe kam besim, e dua të besoj tek qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët nuk do të bijën në provokimet e Serbisë dhe do të shtojnë edhe më tepër besimin dhe respektin në uniformën e Policisë së Republikës së Kosovës, do të shtojnë besimin në institucionet e Kosovës, sepse janë flijuar shumë breza deri më tani që vetëm e vetëm të kemi institucionet e dinjitetëshme. Kosova i meriton institucionet e dinjitetëshme, qytetarët e saj i meritojnë këto institucione.

Dua të përfundoj fjalimin tim vetëm edhe me një fjali. Nga Serbia nuk është pritur asnjëherë më shumë dhe një fjalë e urët thotë: “Ujku qimen e ndërron, por zanatin nuk e harron”. E unë pres nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga organet kompetente vendore e ndërkombëtare, që të bëjnë punën e tyre dhe pamjet e tilla siç kemi parë më 31 mars, mos të lejohen asnjëherë më të transmetohen në televizionet e Kosovës dhe gjithë botës që janë parë ditëve të fundit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit për debatin dhe informatën e Ministrit të Punëve të Brendshme.

Megjithatë, dua të them vetëm një çështje. Deputetët e grupeve parlamentare duhet ta dinë se nuk janë deputetë të pavarur, janë subjekte politike dhe subjektet politike para se të vijnë në Kuvend duhet t’i pjekin qëndrimet e tyre politike.

Çdo debat që bëhet pa i menduar mirë qëndrimet politike të grupeve politike, debati rrjedh ashtu siç rrodhi ky por ne si deputetë realisht nuk duhet të nxitemi të diskutojmë mbi bazën e komenteve në faqet e internetit.

Unë mendoj se përgjegjësia jonë është krejt ndryshe, është një përgjegjësi që çdo fjalë e thënë, duhet të jetë e matur mirë, e peshuar mirë dhe e thënë në kohën e duhur dhe në vendin e duhur. Zoti ministër, e përfundon, e përmbyll si më shkurt, nëse mundesh.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Sinqerisht falënderoj për sugjerimet konstruktive të një numri të madh të deputetëve, po edhe kritikën janë pjesë e këtij debati dhe sigurisht që këto do t’i marrim në konsideratë për hetimet që i bëjmë edhe në lidhje me veprimet që kanë qenë, por edhe ku ka pasur lëshime e dështime.

Desha dy-tri gjëra t'i ceku. Sa i përket vijës së gjelbër, ta kemi një qartësi. Me Shqipërinë, me Maqedoninë, janë të demarkuara dhe është ajo vijë që e ndanë kufirin dhe sipas ligjeve mund të ofrohesh edhe deri në një metër te vija dhe nëse ka patrullime të përbashkëta, mund t'i kalon edhe kufijtë.

Me Malin e Zi është proces, dhe shpresojmë në këtë vit me u krye, ndërsa me Serbinë ekzistojnë dy harta kadastrave tonat dhe të NATO-së, dhe për momentin meqenëse është kompetencë e KFOR-it përdoret vija të cilën e aplikon NATO dhe ata GPS-at janë treguesit që ku mos tejkaluar për gjysmë metre apo në atë kuptim.

Ndërsa, nëse nisemi nga Marrëveshja e Kumanovës, fillimisht ka qenë 25 kilometra vi ajrore, nuk kanë guxuar aeroplanët, mandej 5 kilometra e zonës së demilitizuar dhe kanë pësuar transformime në bisedimet e mëvonshme.

Ishte edhe një kërkesë, a është bërë kërkesa për kthimin e pajisjeve, së pari të automjetit, të revoleve AKSH-47, pajisjeve tjera, radio-lidhjeve tjera natyrisht. Dhe, natyrisht se përmes EULEX-it kemi kërkuar t'i kthejnë më shpejtë. Ata e bëjnë një lloj ekspertize ose forenzike të atyre armëve edhe do të na i kthejnë sa më shpejtë që edhe na kur t'i marrim, sigurisht që do t'i bëjmë bashkë me ekspertë ndërkombëtarë hetim të atyre mjeteve se mund të ndodhë që diçka kanë mundur me vendosur në ato mjete.

A është bërë hetimi? Ditën e parë pas arrestimit, pra të nesërmen e kemi bërë shkresën zyrtare edhe KFOR-it, EULEX-it, dhe Komisionit Evropian, nëse kanë interes me i dërguar ekspertët e tyre dhe me u bërë një hetim i pavarur.

Na të gjitha këto që kemi thënë në territorin tonë, janë në bazë të dhënave që na i kemi dhe jemi të bindur se gojarisht i kanë përmendur edhe hetuesit, se është në territorin e Kosovës, por që të ketë vlerë ky raport, kemi kërkuar ta jetë edhe nga ndërkombëtarët dhe pozicioni është ky.

KFOR-i ka thënë na e bëjmë vetëm krahasimin e hartave, pra lokacionin, EULEX-i dhe prokurori i EULEX-it e menaxhon hetimin që e bën Shtylla e hetimeve dhe krimeve të Policisë, bashkë me forenzikën tonë, në mënyrë që të mbledhim sa më tepër faktografi.

Çka është me rëndësi? Me rëndësi është kur të bëhet ky raport, që do të ketë më tepër validitet. Do të kërkojmë nëpërmjet KFOR-it të dërgohet në Këshillin e NATO-së, në Komisionin Evropian dhe në mekanizmat e tjerë relevant që ky rast të mos kalojë vetëm si i harruar, por në bazë të faktografisë të kërkojmë përgjegjësinë e Serbisë për këtë akt. Por këtë do ta bëjmë pasi të përfundoj dhe ajo lypë pak kohë.

Na e përmendëm, jo me u justifikuar, por realisht edhe më tutje legalisht është përgjegjësi e KFOR-it. KFOR-i për shkak të numrit të reduktuar dhe obligimeve që i ka më shumë në veri, më tepër e bënë kontrollimin në pjesën veriore, sa i përket veriut të Kosovës edhe pse edhe këtu, në këtë zonë të përgjegjësisë quhet komanda regjionale veri dhe në marrëveshje me ta, kemi filluar patrullimet që bëhen nganjëherë të pavarura por paraprakisht në çdo fillim të muajit lajmërohet orari dhe dinamika.

Shihet se nuk janë arritur të gjitha kapacitetet dhe ka nevojë për logjistikë shtesë. Natyrisht, meqenëse nuk është bërë demarkacioni dhe demarkacionin nuk mund ta bënë KFOR-i, e ka caktuar atë vijë, por demarkacioni bëhet kur dy shtete të merren vesh me e bë demarkacionin e kufirit, shihet se LLuzhani si qendër regjionale në veri kufitare, është larg diku afër 20 kilometra në disa pjesë dhe duhet që të kemi vëzhgimore më afër kufirit siç janë me Shqipërinë - Maqedoninë. Duhet të kemi kontanier më afër vijës kufitare, në mënyrë që komunikimi, logjistika dhe përkrahja të jetë më e mirë.

Këtë e kemi përgatitë dhe jemi duke e përgatitur kërkesën që KFOR-i të na lejojë. Për momentin duhet me e dhënë ata lejen, meqenëse ata e kanë ende përgjegjësi legale. Pra këta janë disa hapa që do t'i marrim dhe të provoj veç shkurt se shpeshherë përzihet termi menaxhim i integruar i kufijve dhe kontrollim i vijës së gjelbër.

Koncepti menaxhim i integruar i kufijve ka të bëjë më tepër me vendkalimin kufitar ku policia kufitare e kryen punën e vet, doganieri e bënë punën e vet dhe Agjencioni fito-sanitar ose i ushqimit e bënë të vetën por të gjithë bashkëpunojnë në mënyrë që t'i kanë të dhënat e përbashkëta në bazë të procedurave standarde të parapara me ligj që sublimohen dhe shkojnë në nivelin qendror bashkë me sistemin që te na është BMS dhe PIS-is dhe kjo në të vërtetë është ai menaxhimi i integruar i kufijve. I përbashkët është kur, sistemi i ri kur afrohen, shteti i ofrojnë objektet afër njëri tjetrit edhe e bëjnë shkëmbimin e komunikimet.

Kontrollimi i vijës së gjelbër që do me thënë nëpër rrugët tokësore, qoftë ato malore, fusha e tjerë, dhe vijë e kaltër edhe nëse ka liqe ose det ose në atë kuptim, kontrollimi i tyre bëhet nga Policia kufitare, me shtetet që kemi marrëveshje për patrullime të përbashkëta, ata bëjnë shkëmbimin edhe informata dhe bashkëveprojnë me parandalua krime të trafike e të tjerë, dhe si e kemi me Shqipërinë dhe me Maqedoninë, ka raste kur për luftimin e kontrabandimit mund të hyjmë në territorin e njërit tjetrit, me lejen, me kërkesën që bëhet dhe në atë mënyrë, bashkërisht i menaxhojnë. Ju faleminderit për kontributin!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Këtu edhe mbaron debati i sotshëm.

Por, konsideroj që nga ky debat të obligohet Këshilli Kombëtar i Sigurisë me të gjithë faktorët tjerë tij që t'i marrin të gjitha masat e domosdoshme për mbrojtjen e sovranitetit të shtetit dhe të jetës e të dinjitetit të qytetarëve të tij. Dhe me këtë besoj se e kishim mbyll sot debatin dhe fillojmë pikën e radhës të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për bibliotekat në republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, qeverisje lokale dhe media, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetoj raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

U bë mirë që kaluam në këto pikat e rendit të ditës që nuk kërkojnë shumë patriotizëm dhe besoj se do t'i kryejmë më shpejtë.

Projektligji për bibliotekat është shqyrtuar, i ka kryer të gjitha procedurat të parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe Projektligji si i tillë i përmban 17 amendamente të cilat si Komision funksional, kërkojmë që të përkrahen në tërësi bashkë me projektligjin.

Të nderuar deputetë,

Vetëm amendamenti 8, ka dy propozime dhe njëri propozim është i Komisionit funksional, po e përsërisë propozimi i parë është i Komisionit funksional dhe kërkoj që të përkrahet. Ndërkaq, propozimi i dytë i të njëjtit amendament është nga Komisioni për të drejtat dhe interesat për komunitete dhe kthim.

Unë si kryetar i Komisionit, pasi që në Komision ka kaluar propozimi i parë, kërkoj nga deputetët që të përkrahet propozimi i parë, mos të ketë paqartësi kur po vijmë te votimi, e pastaj deputetët po hutohen dhe po thonë se nuk di çka kemi votuar.

Prandaj zoti kryetar, kur të vijmë te amendamenti 8 ose ma jep fjalën edhe një herë ose unë tani po them se kërkohet të votohet propozimi i parë që është i Komisionit funksional.

Edhe diçka, për këtë amendament mungon përkthimi në gjuhën serbe dhe këtu unë dua publikisht administratën e Komisionit, t'ia jap një vërejtje publike sepse vazhdimisht kam vërejtje me këto lëshime teknike që ndodhin te dokumentet e ligjeve dhe tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetët le të kthehen se kemi menjëherë me votuar dhe për të votuar duhet të jenë së paku 61 deputetë. Këtu nuk i kemi 61 deputetë, 59 sepse një doli.

(Ndërprerje e gjatë e incizimit)

Meqenëse nuk kemi kuorum, nesër do të vazhdojë seanca, në ora 11,00.

- - -

(Seanca, vazhdoi punën më 6 prill 2012, në ora 11,30)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E nderuara zëvendëskryeministre,

I nderuar ministër,

Vazhdojmë me seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 29 mars, e vazhduar më 30 mars dhe 5 prill 2012.

Vazhdojmë- Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Në sallë janë 68 deputetë. Arsyetimin e raportit me rekomandime e ka paraqitur dje kryetari i Komisionit, Idriz Vehapi, ndërsa sot vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Po e ritheksoj se në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 17 amendamente, nga Komisioni funksional.

Për amendamentin numër 8 janë paraqitur dy propozime:

a) Propozimi i Komisionit funksional dhe
Propozimi i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Prezentë janë 75 deputetë. Votojmë amendamentin 1. Votojmë tash.

Amendamenti 1.
54 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim.
Miratohet.

Amendamenti 2.
Kundër, s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
Kundër, s’ka.
Abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
Kundër, s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
Kundër, s’ka,
Abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër s'ka.
 Abstenim, s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 7.
 Kundër s'ka.
 Abstenim, s'ka
 Miratohet.

Te amendamenti 8 kemi dy propozime.
 Fillimisht votojmë amendamentin e Komisionit funksional dhe tash shkojmë me votim.
 Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 44 vota “për”, 17 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti i Komisionit funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 9.
 Kundër, s'ka,
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.
 Amendamenti 10.
 Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 11.
 Kundër, s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 12.
 Kundër, s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 13.
 Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 14.
 Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 15.
 Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Dhe, tani e votojmë ligjin në tërësi.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 53 vota “për”, 16 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetin Fikrim Damka, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.
Deputet, e ke fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka pasur mjaft debat për këtë projektligj.

Projektligji nga të gjithë anëtarët e Komisionit, është konsideruar shumë i rëndësishëm, që rregullon një fushë që ka të bëjë me procedurat e evidentimit të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Në Komision është diskutuar dhe janë propozuar amendamente që plotësojnë Ligjin dhe njëherit e bëjnë më të kuptueshëm dhe rrjedhimisht më funksional.

Të gjithë anëtarët e Komisionit dhe të gjitha komisionet funksionale janë pajtuar me amendamentet, që gjithsej janë 14 amendamente.

Kërkoj përkrahjen për këto amendamente. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të fillojmë votimin edhe unë po ju njoftoj se ë këtë projektligj janë të propozuara gjithsej 14 amendamente.

Amendamenti numër 2 është propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 2, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit funksional.
Deputet, e ke fjalën!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Desha vetëm ta arsyetoj amendamentin e propozuar edhe para kolegëve deputetë. Unë kam propozuar që në Ligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, mosha 15 vjeçare të ndryshohet dhe të zëvendësohet me moshën 18 vjeçare.

Në bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta e saj 44/25 datës 20 nëntor 1989 dhe hyrjen në fuqi më 2 shtator të kësaj konvente, në nenin 1 thuhet se, me fjalën "fëmijë" nënkuptohet çdo njeri nën moshën 18 vjeçare.

Sipas propozimeve të Komisionit, i bie që fëmijët e moshës 15 vjeçare të evidentohen si të papunë, andaj unë kam propozuar që mosha 15 vjeç për evidencën e të papunëve të zëvendësohet me moshën 18 vjeçare, sepse ashtu si është propozuar nga ana e Komisionit, është në kundërshtim edhe me nenet 5, 6 dhe 7 të po këtij ligji dhe Kushtetutën e Kosovës, në nenin 50 për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Është e pakuptimtë, që fëmijët e moshës 15 vjeçare të evidentohen si të papunë, sepse ata do të duhej atëherë, që nga bankat shkollore të shkojnë dhe të regjistrohen në evidencë të papunëve dhe punëkërkuesve.

Asnjë vend në botë nuk e ka moshën 15 vjeçare për t'i evidentuar fëmijët si të papunë, ngase kjo është në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare për të Drejta të Fëmijëve.

Fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe ata të moshës mbi 16 vjeç, lejohet të punojnë me gjysmë orari punë të lehta, në bazë të rregulloreve për të drejta të fëmijëve, por ata nuk hyjnë në regjistrat e personave që kërkojnë punë, ngase janë në shkollim dhe e drejta e tyre për shkollim mbrohet.

Prandaj, kërkoj përkrahjen e kolegëve deputetë që ky gaf i bërë nga ana e Komisionit të përmirësohet nga ana e deputetëve të këtij Kuvendi. Falemnderit!

KRYETARI: Unë pajtohem me këtë që e tha deputeti. Megjithatë, fjalën e ka kërkuar deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Padyshim, që ne të gjithë anëtarët e Komisionit e kuptojmë qëllimin e mirë të deputetit Haxhiu, sa i përket këtij ndryshimi të nenit, por ne siç e dimë edhe kemi kërkuar afat shtesë nga Kuvendi për miratimin dhe amendamentimin e këtij ligji në Komision dhe kemi qenë vazhdimisht në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, përfaqësues nga UNHCR-i, nga UNDP-ja dhe shoqërisë civile dhe të gjithë anëtarët e Komisionit jemi dakorduar, sa i përket këtij propozimi të deputetit, për arsye se ky propozim sa i përket ndryshimit të moshës është në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare, neni 133, ku moshë është 15 vjeçare. Gjithashtu edhe Ligji aktual i punës në Kosovë, parasheh që moshë e të drejtë pune kanë personat prej moshës 15 deri... do të thotë minimum moshë është 15 vjeçare, ndërsa deputeti ka kërkuar që ky të ngritet në moshën 18 vjeçare.

Sa i përket regjistrimit të papunësuarve që e përmendi deputeti më herët, aty është fort mirë e cekur në po këtë ligj se nxënësit të cilët janë në shkollat fillore, shkollat e mesme dhe studimet themelore, nuk kanë të drejtë të evidentohen si të papunësuar. Andaj, unë këtu po dua me ia heq brengën deputetit se fëmijët të cilët janë në proces mësimor në shkollë, nuk kanë të drejtë të evidentohen si të papunësuar. Nëse ne e mbështesim këtë amendament, i cili kërkon që të rritet moshë nga 15 në 18 vjet, atëherë kjo është në kundërshtim me Ligjin e punës aktual në Kosovë, i cili parasheh moshën e punës prej moshës 15 vjeçare dhe është në kundërshtim të plotë me Konventën Ndërkombëtare, neni 133.

Andaj, të gjithë anëtarët e Komisionit kemi qenë njëzëri që ky amendament nuk është në përputhje me Ligjin aktual të Punës dhe Konventën Ndërkombëtare, andaj edhe nuk e ka marrë pëlqimin e Komisionit.

KRYETARI: Jo, nuk ka replikë!

I keni dhënë mendimet dhe tash unë shkoj sipas radhës që janë paraqitur për debat dhe do t'ua jap fjalën të gjithëve që kanë çka të thonë. Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Nëse e shohim propozimin e deputetit Haxhiu, dhe i shohim edhe konventat, shumica e konventave thotë atë çka po e thotë deputeti. Mirëpo, nëse e shohim Ligjin e punës, i cili ka kaluar dhe e jep moshën 15 vjeçare, jo për punë të rregullt tanë ditën tetorëshe, qysh është për punëtorët tjerë, pra prej moshës 18 vjeçare, atëherë ky nen mund të bie ndesh me Ligjin e punës. Domethënë të dy ligjet pastaj kanë kolizion njëri me tjetrin.

Ne nuk mund ta ndryshojmë këtë nen, por nëse vjen në plotësim -ndryshim Ligji i punës, atëherë ai është ligji themelor për punësimin e personave apo individëve, pastaj mund ta ndryshojmë këtë nenin tjetër.

Përndryshe, siç thash, këto dy ligje mund të jenë në kolizion, dhe këtë shpjegim më së miri mund ta japë ministri, i cili është këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Unë desha si anëtare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të tregoj se unë në Komisionin funksional, kam qenë dhe kam votuar për amendamentin e zotit Bekim Haxhiu. Arsyeja është sepse ky ligj, nëse nuk bëhet prej moshës 18 vjeçare, bie ndesh me nenin 5 të po këtij ligji, i cili thotë se si të papunësuar llogarite ai i cili nuk është nxënës dhe student i rregullt në studimet themelore.

Ndërsa, sa i përket kësaj me Ligjin e punës, që po përzihet tash, e vërtetë është që Ligji i punës lejon që fëmijët e moshës 15 vjeçare të punojnë punë të lehta. Mirëpo, ne me këtë amendament nuk ua ndalojmë që të punojnë punë të lehta, por vetëm po e ndalojmë që ata të mos regjistrohen si të papunësuar në entet e punësimit.

Ky është dallimi dhe unë konsideroj se nuk duhet të lejohet që një nxënës i moshës 15 vjeçare të regjistrohet si i papunë në zyrat e punësimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kemi shumë të lajmëruar, por konsideroj që ia vlen ta votojmë amendamentin e deputetit. Ligji i Punës mund të amendamentohet. Fjalën e ka ministri Nenad Rashiq.

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Gospodo ministri,

Poštovani narodni poslanici,

Tačno jeste, u pravu ste i vi gospodine poslaniče, i vi takođe.

Jedini razlog, ustvari pravo da vam kažem ja ne znam zašto je došlo do toga da bude 15 godina starosti pa na gore..

Po starim informacijama, svi znamo da naša databaza, mislim generalno, u većini institucija nije kompletna i nije savršena. Treba tek da se dorađuje i da bude onako baš kao što treba. Ali, šta smo evidentirali mi od prvog dana u ministarstvu za rad.

Da ima veliki broj mladih koji imaju samo osnovnu školu završenu. I to se pojavljuje kao jedan problem. Čak smo mi baratali cifrom od oko 200.000, verovali ili ne. E sad, to jesu stare cifre, jesu ne toliko pouzdane, ali mi znamo da i dalje se dešava to da deca, odnosno mladi da posle osmog razreda, određeni njihov broj ili bude ispisan iz škol ili zbog različitih razloga ne nastave da se školuju. I ovaj, upravo ovaj deo, kad smo mi predlagali u tom momentu od 15 godina pa do 65 je bio element zašto smo rekli da bude

od 15. Tu niko nije imao nikakvu nemeru da na bilo koji način prava dece od 15 - 18 godina ugrožava jer se jasno kaže da to mogu biti samo laki poslovi.

Znači pola radnog vremena, ono što je normalno. Ali ukoliko ih ne evidentiramo na neki način u neku posebnu databazu, oni će ostati kao da ne postoje, kao da ne postoje nigde. Zato bi moj predlog bio da amendament, koji glasi da 18 godina plus, da bude taj važeći u smislu da mi tu brojku o našoj nezaposlenosti na Kosovu stvarno devedemo u normalu. I mi stalno imamo taj problem, gde je mnogo više onih po registru nezapolsneih, koliko ustvari, u realnosti jeste.

Prema tome amendament koji usvaja od 18 do 65 je u redu, ali bi predložio da se daje još jedan amendament koji bi rekao da treba da se posebna databaza od 15 do 18 godina, koji bi se pravio samo naravno za te lake poslove, koje oni mogu da rade.

Znači, ponavljam još jednom, absolutno se slažem da originalna osnovna databaza treba da bude od 18 do 65 ali da imamo jednu posebnu, koja će na spisku imati tu decu ili mlade koji su od 15 do 18 godina koji, još jednom ponavljam, mogu samo u lakim poslovima da budu angažovani. Hvala!

KRYETARI: Realisht, unë pajtohem me këtë që e tha edhe ministri, po është dashur të vijë me kohë. Po vazhdojmë pasi që kemi të lajmëruar për diskutim. Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Shefja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, zoti kryetar.

Duke marrë parasysh se ministri sqaroi deklarinimet e tij, ndërsa deputeti Haxhiu dha versionin e tij, ministër, me gjithë respektin, databazat është dashur ndoshta t'i cekësh në ligj, mirëpo nuk thuhet i papunë në rast se një i mitur është i moshës 15 vjeçare. Si do ta komentosh këtë para opinionit ndërkombëtar? Një i mitur është i papunë i moshës 15 vjeçare. Sa kishe toleruar fëmija yt, nesër a pasnesër të llogaritet si i papunë, kur i ka 15 vjet. Është nonsens për një shtet, i cili mendon se është shtet demokratik.

KRYETARI: Unë nuk e kam problem t'ju them jo veç kryetare, po nëse doni edhe bajraktarë e bajraktare të Kuvendit, por realisht jeni deputetë të gjithë. Dhe, nuk është mirë tash t'i përdorim njëqind epitete për t'ia dhënë fjalën një deputeti. Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Më fal se isha i intriguar më përpara. Në ligj nuk shkruhet ajo që tha ministri. Nuk ka databazë të veçantë për ata që janë nën 15 vjet dhe mendoj se po i komplikojmë çështjet në mënyrë të panevojshme me konventa e me diçka tjetër. Ajo çka duhet ta dijë Kuvendi dhe çka ka qenë dashur të na tregojë edhe ministri e Komisioni, ose kryetari i Komisionit, është se a ka ndonjë vend, që ne e marrim si model, databazë ku si të papunë regjistrohen edhe fëmijët 15 vjeçar? Kjo është pyetja dhe ne nuk po e çpikim akullin këtu.

Nëse ndonjë vend, prej vendeve të cilat ne i marrim model, i regjistron në databazë fëmijët 15 vjeçar si të papunë, edhe ne po e shikojmë këtë punë. Mirëpo, mendoj se propozimi i deputetit Haxhiu është me vend. Pasojat, nëse ne do t'i kishim regjistruar

fëmijët 15 vjeçar në listën e të papunëve, nuk do të ishin vetëm morale, se fëmijët po hyjnë si të papunë në lista, mirëpo paramendoni sa do të rritej edhe artificialisht numri i të papunëve në Kosovë nëse ata do të regjistrohen në atë listë. Tjetërkund nuk regjistrohen.

Ne nuk po shpjegojmë këtu në këtë ligj se kush bën të punojë dhe kush nuk bën të punojë, po ky me sa di unë dhe sa po kuptoj - është Ligj për evidencimin e të papunëve. Dhe nëse është ligj për evidencimin, atëherë a do t'i evidentojmë ne si të papunë fëmijët 15 vjeçar? Jo.

Unë mendoj se amendamenti i propozuar nga deputeti Haxhiu është në rregull dhe i thërras deputetët, që ta votojnë. Nuk kemi çka ta komplikojmë jetën më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të bëj përpjekje që të mos e zgjas. Në Grupin Parlamentar e kemi shqyrtuar këtë amendament me kujdes shumë të madh, kemi konsultuar të gjitha praktikatat e vendeve tjera, dokumentacioneve tjera dhe askund nuk kemi hasur që ndonjë shtet ka në evidenca të papunëve në moshën 15 vjeçare.

Prandaj, i lus deputetët që të votojnë amendamentin e zotit Haxhiu, se është në interes të mbrojtjes së të drejtave, më së pari të fëmijëve dhe të nxitjes që fëmijët tanë të shkollohen dhe jo të ndërpresin shkollimin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë në votim të amendamentit të propozuar nga deputeti Haxhiu. Unë jam dakord se vërtet është amendament i mirë dhe duhet të votohet. Megjithatë, deputetët e kanë të drejtën të vendosin.

Prezentë kemi 80 deputetë. Votojmë tash.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 14 “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin e deputetit Bekim Haxhiu, amendamentin e dytë

Amendamenti 3.

Kundër s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.
Amendamenti 10.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.
Amendamenti 11.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Dhe në fund, e votojmë ligjin në tërësi. Votojmë, tash. Por, para kësaj, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kërkoj falje se jemi në proces votimit, por u paraqita pak më herët. Atëherë, duhet të përmirësohet edhe neni 6, ku flet po ashtu për moshën... neni 6, nuk ka tash... ne duhet ta bëjmë amendament që duhet ta harmonizojmë me amendamentin i cili kaloi nga deputeti Bekim Haxhiu, përndryshe ka kolizion. Atëherë, duhet edhe këtu të jetë 18 deri në moshën 65 vjeçar se përndryshe ka diskrepancë në mes të dyjave.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe për vërejtjen e kolegut Armend Zemaj, në amendament është e propozuar kjo që edhe nenin 2 dhe 6 të ndryshohet. Domethënë, mosha 15 të zëvendësohet me moshën 18.

KRYETARI: Mirë! Faleminderit!

BEKIM HAXHIU: Po ai amendament që votohet, e zëvendëson këtë.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash.

Me 73 vota “për”, 5 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve. Faleminderit!

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për lojërat e fatit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Në këtë projektligj raportuese e Komisionit ka qenë deputetja Hykmete Bajrami. Ia kisha dhënë fjalën Hykmete Bajramit, sepse ka qenë raportuese dhe jemi marrë vesh që ajo të paraqitet në emër të Komisionit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Para se me hy me raportuar për ligjin unë veç e përgëzoj Qeverinë dhe partinë në pushtet se me amendamentin i cili sapo kaloi e ka ul papunësinë dukshëm.

Kështu që - bravo, sa i përket Ligjit për lojërat e fatit, Komisioni për Buxhet edhe Financa në cilësinë e Komisionit funksional e ka formuar grupin punues i cili ka punuar intenzivisht për përmirësimin dhe amendamentimin e këtij projektligji. Të gjitha

amendamentet e propozuara nga grupi punues janë përpunuar dhe janë votuar në mbledhjen e Komisionit për Buxhet edhe Financa. Komisioni edhe grupi punues kanë marrë amendamente edhe nga deputetë të tjerë, të cilat janë shqyrtuar me shumë kujdes dhe pjesa më e madhe e tyre janë refuzuar dhe sot në seancë vijnë si amendamente pa përkrahje të Komisionit funksional.

Qasja e Komisionit funksional rreth këtij ligji ka qenë se me qenë kjo veprimtari në ekonominë e tregut nuk mund të ndalohej, të krijohet një kornizë ligjore e cila do të kontrollonte këtë veprimtari duke evituar maksimalisht dëmet që kjo veprimtari po i sjell shoqërisë tonë. Bastoret sportive, lokalet me të ashtuquajtura “slot machine” janë sot pjesë e realitetit të shkollave fillore dhe të mesme. Sot fëmijët tanë ikin nga orët e mësimit dhe bëjnë klientelën kryesore për këto biznese dhe kjo na brengos të gjithëve, por dëmet nuk kufizohen vetëm në këto. Komisioni ka vu kufizime si ato të distancave minimale që këto biznese duhet t’i kenë nga: objektet arsimore, kulturore, fetare dhe prona komunale dhe, ka vu kriteret restriktionet e arsyeshme dhe masat të kontrollit që do t’i implementojnë organet kompetente. Komisioni me këto kufizimet që i ka bërë konstaton se projektligji dhe amendamentet e propozuara përbëjnë një kornizë ligjore shumë praktike dhe efektive me rëndësi të veçantë për rregullimin e kësaj veprimtarie.

Kështu që ne si Komision funksional për Buxhet dhe Financa i paraqesim Kuvendit raportin me amendamente dhe ju ftojme që t’i votoni amendamentet normalisht të Komisionit funksional, Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç amendamentin që e votuam e votoi Kuvendi, jo Qeveria. Mirë, shikoni rezultatin e votimeve. Edhe, mendoj që Kuvendi ka votuar drejt. Për ligjin që u raportua, unë paraprakisht po e jap një vërejtje në amendamentin e propozuar nga deputeti Shaip Muja.

“Distanca prej objekteve arsimore, fetare dhe edukative duhet të jetë së paku 100 m, distanca midis lokaleve së paku 30 m”. Unë nuk kisha marrë për distancën në mes lokaleve, le të jetë kështu edhe si është propozuar, por distanca nga shkollat, do të thotë që janë me karakter edukativ dhe arsimor, unë konsideroj që edhe 500 m është pak, këto duhet të jetë më së paku... bile ndoshta kishte me qenë mirë që kjo distancë të jetë 1 km së paku. Çdo kund, gati nëpër vende të ndryshme këto janë krejt jashtë qyteteve, nuk janë as brenda qyteteve, por kjo distancë prej 100 m s’është distancë. Ju lutem, më së paku le të jetë nga 500 deri në 1.000 m, por jo më afër. Kur të shkojmë tek ky amendament ta kemi parasysh.

Ne mbi të gjitha jemi të obliguar ta mbrojmë interesin e fëmijëve dhe të qytetarëve. Ne e dimë se këto po shkaktojnë probleme të mëdha dhe ne si deputetë s’mund të jemi në shërbim të atyre që duan të fitojnë nga mashtrimet.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 52 amendamente.

Amendamenti numër 3, 4, 17, 18, 31, 36, 37, 38, 40, 41 dhe 45, janë propozuar nga deputeti Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti numër 10, 14, 39 janë propozuar deputeti Shaip Muja me përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti numër 7 është propozuar nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re me përkrahjen e Komisionit funksional.

Për amendamentin numër 15 dhe 32 janë dhënë dy propozime: propozimi i Komisionit funksional dhe propozimi i deputetit Shaip Muja pa përkrahjen e komisionit funksional.

Për amendamentin numër 47 janë dhënë dy propozime: propozimi i Komisionit funksional dhe propozimi i Grupit Parlamentar të koalicionit Kosova e Re pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Duhet dhënë sqarime për të gjitha këto, kur të shkojmë për gati secilin amendament. Dhe, po shkojmë me votim. Votimi do të jetë elektronik. Çka ta përmenda emrin?! Unë jam duke lexuar propozuesin e amendamente dhe s'ka lidhje kjo a ta përmenda emrin a s'ta përmenda emrin.

(Ndërhyrje, **Xhavit Haliti**: Ke të drejtë! Në çdo amendament, Shaip mund ta marrësh fjalën 10 minuta, sa herë ta kërkos.)

KRYETARI: Më falni! Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Unë, zoti kryetar meqë the: “kur të shkojmë në çdo amendament, mund të jap sqarime” atëherë, do të pres që në çdo amendament, të cilin unë e kam konsultuar me një grup të personave ekspertë që janë edhe në prezencë të GIZ-it, ku kam kërkuar nga GIZ-i dhe nga ata ekspertë të kthehen me shkrim vërejtjet. Nuk janë kthyer dhe deri më tani kam një vërejtje shumë serioze dhe për ata që na monitorojnë dhe i shoh nëpër televizor nëse kanë vërejtje serioze në propozimet e amendamenteve tona, ata që na monitorojnë neve, atëherë le t'i japin me shkrim vërejtjet pse i kanë këto vërejtje. Ndërsa, për arsyetimet e mija, do të shkoj në çdo amendament veç e veç të arsyeshmërisë. Faleminderit!

KRYETARI: A e do dikush fjalën? Deputeti Halit Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Unë ju kisha lutur për mirëkuptim. Do të flas pakëz, nuk do të flas shumë, por do të flas diçka që është substanciale dhe që është shumë me rëndësi për ligjin edhe ju kisha lutur që të keni mirëkuptim.

KRYETARI: Nëse e ke për amendamentin e parë, fol për amendamentin e parë.

HALIT KRASNIQI: Kam komplet për ligjin.

KRYETARI: Jo, ajo çështja për ligjin komplet është kryer. Tash ne i kemi amendamentet. A ka dikush të thotë diçka për amendamentin e parë? Nuk do. Atëherë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe e votojmë amendamentin e parë.

Me 61 votë “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

A ka dikush diçka për amendamentin 2? Nuk ka. Atëherë, votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti i dytë.

Amendamenti numër 3, propozimi i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Deputet e ke fjalën.

SHAIP MUJA: Po, zoti kryetar ky nen bie ndesh me një nen më poshtë i cili është prapë i amendamentuar për çështjen e reklamimeve ku as Komisioni funksional as ata që na kanë monitoruar nuk kanë ditur të japin shpjegim lidhur me reklamimin e këtyre lojërave të fatit. Në parim unë jam “kundër” bixhozit edhe lojërave të fatit, mirëpo nëse ne nuk i kontrollojmë atëherë këto do të çthuren të kalojnë në anarki.

Dhe, nëse këto thuhet në një nen më poshtë thuhet: “lejohen reklamat në zonat e lira”, unë pyes të gjithë deputetët kush janë zonat e lira në Republikën e Kosovës, për reklamim? Janë rrugët mediatike të cilat caktohen në gazeta të veçanta, vendi ku nuk kanë akses për fëmijët, televizioni, monitorimi kohor ku nuk lejohet gjatë ditës, por i kanë kohërat e caktuara kur reklamohen dhe për atë arsye unë kam kërkuar, mandej, ky ligj në bashkëpunim edhe me mediat bën restriksione për afirmimin e këtyre lojërave e jo të qiten p.sh. edhe me reklamime të ndryshme. Nuk është lexuar mirë, ndoshta edhe nuk kam pasur vërejtje serioze që të bindem se duhet të tërhiqem nga ky amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Komisioni funksional, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Në Komisionin për Buxhet janë diskutuar, janë analizuar është ftuar edhe deputeti i cili mori fjalën pak më parë që t’i japë arsyetimet e veta. Komisioni funksional ka angazhuar edhe ekspert të GIZ-së që ka qenë njohës i mirë i kësaj lëmie, por njëkohësisht na ka ndihmuar edhe ekspertë nga USAID-i.

Tek ky amendament, të cilin e dha arsyetimin pak më parë deputeti që ka sjell amendamentin në Komision, në pikën 6 të nenit 4... thuhet që në nenin 4, pas paragrafit të pestë të shtohen dy paragrafë të rinj së në vijim, domethënë është fjala për licencat e lojërave të fatit, lojërave elektronike dhe lojërave të tjera. Me konsultat të cilat i kemi pas edhe me ekspertët, por edhe me sponsoruesit e këtij projektligji kemi ardhur në përfundim që përmes këtij ligji nuk lejohen lojërat elektronike “online” dhe përmes internetit, për arsye se Kosova nuk ka kushte të organizojë lojëra të tilla. Madje, për këtë çështje kemi pasur rekomandime siç ju thashë nga ekspertët edhe nga SHBA-ja edhe nga Gjermania, të cilët na kanë rekomanduar se lejimi i lojërave elektronike nuk është një përvojë e mirë edhe në vendet ku këto janë lejuar, sepse shumë me vështirësi mund të monitorohen dhe kontrollohen.

Të gjitha amendamentet tjera, të cilat pasojnë kanë për të rregulluar këtë lojë online, të cilat lojëra nuk janë të mundshme për momentin janë të ndaluara me Ligjin për lojërat e fatit. Unë nuk dua ta zgjas shumë në lidhje me këtë çështje, i kisha lutur të gjithë deputetët që t'i votojnë amendamentet, të cilat janë përkrahur unanimisht nga Komisioni funksional. Kurse, amendamente të cilat nuk janë përkrahur nga Komisioni funksional, unë i kisha rekomanduar të mos pranohen fundi i fundit është e drejtë e deputetit të votojë siç të dëshirojë. Por, dua t'ju them me përjashtim të tri amendamenteve të deputetit Shaip Muja, amendamentet tjera unanimisht nuk janë përkrahur nga Komisioni funksional. Mirëpo, janë analizuar po them me përgjegjësinë më të madhe. Ftoj që t'i votoni amendamentet e Komisionit funksional.

KRYETARI: Mundesh, me i dhënë ato sqarime, por Komisioni e ka më mirë. E ka fjalën deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, mua më vjen keq Komisioni aspak nuk është treguar në nivelin profesional të analizës së problemeve. Për njohuritë tuaja dhe për procesverbal po ju tregoj në Republikën e Kosovës kush luan sot online lojëra, të cilat nuk i ndalon askush dhe në këtë mënyrë kalojnë mjetet financiare në kontot jashtë Republikës së Kosovës.

Dhe në nenin 6, në amendamentin 3 të nenit 4 kam thënë që të shtohet "licenca për lojërat elektronike të fatit, lojërat online dhe bastet nëpërmjet të internetit do të lëshohen vetëm për kompanitë që mbajnë licencë në Republikën e Kosovës dhe të cilat janë dhe për kazinot, makinat, bastoret sportive që janë në prezencë fizike në Kosovë dhe subjekte juridike të regjistruara në ATK." Dhe në Republikën e Kosovës momentalisht nja 3 po i japi për mos me i përmend të gjitha, janë: Lumi Bet, Euro Loto, Loto Sport që të kalojnë mjetet në kontot tjera dhe provajderët e internetit, i ke tre provajderë sot në Republikën e Kosovës, e ke: PTK-në, Ipkon dhe Kujtesën. Të gjithë mund t'i ndalojnë këto lojëra ose problemi tjetër fiskal që kalohet një evazion tjetër që kalohet nga Kosova mund të luhet në Las Vegas sot dhe mjetet kalojnë nëpër sistemin bankar në Las Vegas. Prandaj, ato mjete nuk taksohen dhe nuk certifikohen në sistemin e taksave të Republikës së Kosovës.

Unë kam propozuar që të monitorohet një sistem i cili hyn në Kosovë dhe i cili taksohet në Kosovë, por jo të lejohen lojërat të cilat janë mënyrë ilegale që janë nga dy shtete përreth, njëra është edhe nga Serbia dhe njëri nga këto bastoret që i përmenda është nga Republika e Shqipërisë. Prandaj, këtu nuk është duke u kërkuar një diçka e re të shtohet, por është kërkuar një rol i disiplinuar që është më multi disiplinor: Ministria e Ekonomisë nesër që është në varshmëri Posta dhe provajderët e internetit të kenë obligimet e restriksioneve, siç e kemi ne në Kuvend këtu. Në Kuvend ne kemi restriksione në muvi, në lojëra, në gjitha. Paskemi ne mundësi t'i bëjmë në Kuvend dhe nuk mund t'ia bëjnë Kosovës këto? Kjo do të thotë ne me vetëdije po i lejojmë që këto të luajnë këtu në mënyrë ilegale dhe mjetet financiare të kalojnë jashtë Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ligji po i ndalon edhe mirë ka bërë që po i ndalon. Ajo është përgjegjësi tjetër, ne e bëjmë ligjin për t' i ndaluar, e kush e ndalojnë le ta ndalojnë. Fjalën e ka kërkuar deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Deputeti Shaip Muja sapo tha që Komisioni edhe grupi punues nuk janë treguar aspak profesional, unë ju them që ne kemi punuar shumë brenda kapaciteteve tona.

Ajo çka na ka çuditur shumë ka qenë interesimi kaq i madh i papritur, për herë të parë intervenimi në Komisionin për Buxhet dhe Financa, i deputetit Shaip Muja, se asnjëherë më herët për asnjë ligj s'ka prur ndonjë amendament. Kështu që kjo çka po kërkon deputeti Shaip Muja, është legalizimi i lojërave online, por po mundohet ta mbështjell dhe të tregojë që po donë me qit kufizime.

Unë nuk e di që Kuvendi i Kosovës mundet me prur ligj edhe me ju thënë njerëzve që kanë internet nëpër shpija "na ua ndalojmë juve me e shiku këtë ueb faqe ose atë ueb faqe". Ne që kemi internet në shtëpi mund ta shikojmë cilin ueb faqe duam dhe nuk munde të na e ndaloj kurrkush edhe provajderët e internetit nuk bëjnë restriksione të tilla, sepse ata po operojnë në një ekonomi të tregut. Nëse mundesh me ia ndalu lojërat online e facebookun etj, Qeverisë, ministrive e Kuvendit etj, këtë nuk mund të bësh domethënë, nëpër shtëpitë private. Ata që duan të luajnë online ata kanë për të luajtur edhe luajnë gjithkund në botë edhe nuk mundet kurrkush me ua kufizuar.

Ne e kemi pas qëllim do të thotë aspektin fizik të lojërave të fatit që të mos kemi bastore afër shkollave, të mos kemi afër institucioneve kulturore, fetare, arsimore dhe pronës komunale. Kjo ka qenë qëllimi dhe këtu i kemi vu kufizimet maksimale që na ka lejuar përfaqësuesit e ATK-së duke thënë që kjo është ajo çka na mund ta implementojmë brenda kapaciteteve tona. Edhe sa i përket distancës kur ishte fjala te distanca, ne në amendamentet si Komision funksional distancën prej shkollave e kemi vu 500 m, në qoftë se amendamenti e thotë ndryshe aty është ndonjë gabim shtypi i Administratës së Kuvendit, sepse distanca është 500 m nga institucioni arsimor, kulturor, prona komunale ose ndonjë institucion fetar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë e lexova amendamentin e deputetit dhe realisht ashtu s'bën të jetë se ne nuk mund të bëhemi mbështetës i lojërave të fatit dhe t'i qojmë në oborr të shkollave. Këtë duhet ta kemi parasysh. Jo s'ka replikë. Ne u dëgjuam, dhe tash votojmë. Nuk ka replikë, thashë. E ke thënë mendimin tënd. Urdhëro, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë kisha kërkuar mirëkuptim se me të vërtetë është një ligj i cili i përket një veprimtarie të re, ndoshta pak a shumë edhe e panjohur edhe për neve edhe për vetë Administratën Tatimore, Doganat edhe Ministrinë e Financave, prandaj, nuk mendoj që edhe forma e debatit të tillë mund t'i kontribuojë një amendamentimi të mirëfilltë të këtij projektligji.

Prandaj, është mirë t'i shqyrtojmë me kujdes këto çka janë propozuar. Komisioni funksional që mendoi që e ka bërë punën më të mirë dhe efikase, por edhe temat që i kemi trajtuar qysh në leximin e parë. Unë pikërisht për amendamentin që e ka paraqitur deputeti Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional, unë po flas për pjesën e dytë paragrafi 7, nuk kam njohuri për paragrafin 6 dhe nuk jam kompetent të flas.

“Kompanisë së licencuar për lojërat elektronike i lejohet reklama vetëm në gazeta dhe televizione”, çka është në logjikën edhe të asaj që ju po e kërkon që të mos ketë reklama, pra në objekte shkollore, fetare, institucionale etj. Prandaj, unë mendoj që kjo duhet të jetë dhe kërkoj edhe përkrahjen edhe deputetëve tjerë, se pse reklamën përmes televizioneve dhe gazetave kontrollohen, edhe minutazha kontrollohet dhe të gjitha, ndërsa hapësirat e lira që lejohen atje, nuk mund të ketë kufizime dhe ju e dini billboarda ka edhe pranë objekteve shkollore, edhe pranë objekteve fetare edhe çdo kund në vend. Prandaj, është mirë t’i shqyrtojmë, t’ia japim logjikën e hartimit këtij legjislacionit dhe të mos kemi konflikt mendimesh apo mënyrës së paraqitjes të amendamentet. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Jo, jo. Propozimi i deputetit pa përkrahjen e Komisionit funksional se as mund të shkojë 6, as 7, se këto bien pastaj në kolizion njëri me tjetrin. As paragrafi 6, as paragrafi 7 s’duhet të shkojnë. Fjalën e ka deputeti Latif Gashi.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se edhe këtë çështjen që deputeti Muja e ka propozuar, domethënë, në paragrafin 7 në kuadër të Ligjit e kemi rregulluar, kështu që edhe kjo çështje është e rregulluar dhe konstatoj që të gjitha amendamentet që kanë qenë të arsyeshme të deputetit Muja, i kemi marrë. Ato që nuk kanë qenë të arsyeshme nuk i kemi marrë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Tash votojmë amendamentin 3 të deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë, tash.

Me 11 vota “për”, 39 “kundër”, 6 abstenime, amendamenti nuk kalon.

E kemi mendamentin 4. Propozimi i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional. A e do fjalën deputet? Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

Së pari, po i lus deputetët të kthehen në sallë, sepse jemi duke votuar!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar!

Unë nuk mund të ballafaqohem me disproporcion intelektual të performancës kur studiohen ligjet, mirëpo i kisha lutur edhe anëtarët e Komisionit që të jenë më të vëmendshëm në vlerësime.

Ne jemi duke folur për një sistem i cili ka gjeneruar evazion fiskal për 12 vite në Republikën e Kosovës.

Kur flitet për çështjen e reklamave, ua kam shtruar pyetjen logjike dhe nëse munden anëtarët e Komisionit të thonë: në pikën 3 të nenit, ku thuhet: “publiciteti për lojërat e fatit, nuk lejohet të ushtrohet në zonat e lira të përcaktuara me legjislacionin përkatës”

sepse unë nuk kam marrë sqarim se kush janë zonat e lira në Republikën e Kosovës që quhen.

Tjetra, sa i përket problemit pse unë angazhohem në këtë ligj, mu këta që po japim shumë zjarr janë më në problem me këtë ligj se sa unë.

Prandaj, unë jam i interesuar që të futet: transparencë, monitorim dhe licencim. Në të kundërtën unë i përmenda që për procesverbal dhe të mbesin gjërat se dikush një herë do t'i lexoj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në sallë janë 81 deputetë. Prapë, i kisha lutur deputetët që janë duke pirë kafe, le të kthehen për të votuar! Po do tua jap fjalën, por realisht konsideroj që ky ligj është dashur pak më shumë të analizohet. Urdhëro! Deputeti Latiaf Gashi, e ka fjalën! Le të përgatitet Halit Krasniqi!

LATIF GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Unë realisht nuk e di, dhe definitivisht nuk e kam asnjë dyshim që deputeti Muja ka ndonjë interes personal nga kjo që e kërkon me çdo kusht.

Të njëjtin debat dhe të njëjtat telashe i kemi pasur edhe në Komision me te. Kjo, më sa duket është çështje inati i tij dhe gjend edhe asi fjalori sa t'i fyejë anëtarët e Komisionit.

(Ndërhyrje)

Më lejo vetëm pak, të lutem. Është shumë e vërtetë që me seriozitetin më të madh i kemi marr të gjitha rekomandimet. Është shumë e vërtetë si Grup punues që e kemi konsultuar edhe njësinë mbështetëse të GIZ-it, kemi ftuar edhe ekspertë nga Gjermania. Është shumë e vërtetë që kemi konsultuar edhe ekspertë të tjerë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kështu që edhe në shtetet më moderne të botës lojërat online elektronike nuk kanë këto shtete kapacitete me i kontrolluar, nga se shteti hyn në obligime ndaj atyre lojtarëve që luajnë në internet edhe duhet me i paguar humbjet e tyre.

(Ndërhyrje)

Të lutem, vetëm pak! Unë mendoj që për të mos e politizuar këtë, Shaip Mujën e ftoj të reflektoj pozitivisht dhe ta heqin inatin, që nuk është çështje inati as e interesit këtu.

Nuk pajtohem me deputeten Bajrami që thotë: ka insistuar. Unë përkundrazi e falënderoj zotin Muja për kontributin e tij që e ka bërë, por kësaj radhe nuk ka të drejtë dhe atë që e ka pasur të drejtë, e kemi aprovuar në Komision. Kështu që unanimisht kemi votuar kundër atyre amendamenteve të zotit Muja. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi, e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Këtë Projektligj duhet ta kalojmë sa më shpejtë, gjithsesi brenda kësaj seance patjetër dhe jo më vonë. Është i mrekullueshëm!

Gjatë studimit që kam bërë kësaj fushe, mjaft problematike dhe tejet profitabile për subjektet biznesore që ushtron këtë veprimtari dhe shumë sfiduese për kodin moral të shoqërisë tonë, kam gjetur arsye shumë të forta dhe shumë shqetësuese në trajtimin e lojërave të fatit që është bërë për një kohë të gjatë.

Së pari, nga 1 janari 2010 deri me 31 maj 2011, nuk ka pasur kuota fikse të cilat janë hartuar nga grupi i dytë punues dhe nuk është aplikuar as akciza e lojërave të fatit.

Në grupin e dytë punues të Qeverisë, është përgatitur një projektligj për trajtimin e lojërave të afatit. Në këtë grup punues kanë qenë të përfshirë, përveç institucioneve të Qeverisë, edhe Zyra e thesarit amerikan, të cilët kanë dhënë një kontribut shumë të madh duke angazhuar edhe ekspertin e Las Vegasit i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në përpilimin e këtij projektligji.

Duke mos përfillur këtë punë, është krijuar një kohë e El do Rados për këto biznese tepër të mjaftueshme për to, e të paarsyeshme për publikun dhe të patolerueshme për Ligjin, duke dëmtuar buxhetin e Kosovës me qëllim apo pa vetëdije, për përfitim personal apo për të krijuar mundësi për përfitime të kundërligjshme të subjekteve që merren me këtë biznes. Pra, është krijuar një precedent penal sipas legjislacionit në fuqi dhe ky precedent i rëndë penal, ka adresë dhe emra të përveçëm.

Sikur ky ligj të hynte në fuqi atëherë kur është përgatitur nga grupi i dytë punues dhe i është dërguar Ministrisë për financa në shtator 2009, për të hyrë në fuqi me 1 janar 2010, buxheti i Kosovës do të pasurohej sipas një logjike përlllogaritëse nga ky grup punues që varion miliona euro. Ndërsa, sipas logjikës përlllogaritëse të tarifave që aplikohet sot akciza e lojërave të fatit, buxheti do të pasurohej me një shifër edhe më të madhe - mbi 36 milion, deri rreth 40 milion nga 1 janari 2010 deri me 31 maj 2011.

Shifër rrëqethëse, lehtësisht për ta verifikuar dhe krejtësisht e pa tolerueshme. Edhe babain tim, po të ishte, vështirë se do ta falja. Por do ta këshilloja për bashkëpunim me prokurorinë, për t'i krijuar rrethana lehtësuese vetes dhe për të bërë sqarime të nevojshme, siç e parasheh ligji.

Këto të dhëna mund t'i vërtetojë dhe duhet patjetër të vërtetohen nga organet kompetente për të forcuar besimin mbi institucionet e shtetit dhe për të ndëshkuar të gjithë ata që e dëmtojnë buxhetin e Kosovës, duke i krijuar favore të paligjshme subjekteve biznesore.

Neni 339 dhe neni 340 i Kodit Penal të Kosovës, i kanë rregulluar mjaft qartë sanksionimet dhe përgjegjësitë për të gjithë zyrtarët që shpërdorjnë detyrën e tyre zyrtare.

PDK-ja, brenda saj ka një mori vlerash morale profesionale që janë pa kompromis për interesa të shtetit dhe, zotëri ministër, duhet t'i kërkonin ndjesë për lajthitjet dhe për dëmtim të buxhetit të Kosovës.

Për kaq kohë të gjatë dhe për këtë shifër rrëqethëse, kapacitet profesionale që i ka PDK në gjirin e saj, nuk falin dhe nuk do të tolerojnë gjithashtu as elektorati i saj i cili është krenuar në sloganin tonë: Së pari Kosova.

Rrjedhimisht me këtë slogan kemi grishur dhe kemi rritur shpresat për të gjithë qytetarët e Kosovës. Këtë besim të elektoratit të PDK-ja dhe këto shpresa të qytetarëve, do t'i rrisim edhe më shumë pavarësisht shembullit të keq që e kemi.

Për fund, dhe krejt në fund, me këtë paraqitje dëshiroj të fijaskoj një dukuri negative të zyrtarëve të papërgjegjshëm dhe të forcoj besimin në vlerat e Partisë Demokratike të Kosovës, të cilat ai i ka brenda saj. Me këtë rast edhe opozita do të marr një leksion se si duhet të funksionoj operenca jo me bojkot, jo me zhurmë, jo me grindje, jo me ofendime, por me një qeverisje ndryshe, me angazhime konstruktive dhe me ide e koncepte të mundshme, ndryshe nga Qeveria dhe përgjegjësia e lartë...

KRYETARI: Regjia, ia ndal fjalën. Ju lutem, të jeni në rend dite!

(Ndërhyrje)

Po, realisht ia dhashë fjalën sepse e kërkoi shumë herë, por duhet të mësoheni të flisni për temën që e kemi në shqyrtim dhe për diçka krejt tjetër.

(Ndërhyrje)

Po jo more, çfarë teme! Ministër a e dëshiron fjalën! Urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave, e ka sponsoruar këtë Ligj. Është një fushë mjaft e ndjeshme, një fushë e re që asnjëri prej neve besoj që nuk mundemi me fol me kompetencën maksimale profesionale, e me thënë kështu është, dhe pikë.

Po e rregullojmë një lëmi shumë të ndjeshme, që prek shumë segmente. Çështja e taksave është vetëm një segment, por kur po dua me u përkufizuar te çështja e taksave, deri në gjysmëvjetorin e dytë të vitit të kaluar, kjo lëmi nuk ka qenë e taksuar në mënyrë siç duhet.

Në Kosovë është përdorur modeli anglez dhe është vendosur tatimi i akcizës, që është një shumë fikse. Ne mund të diskutojmë se a është e lartë e a është e ulët, por si sistem është duke funksionuar.

Dhe për informatën tuaj, deputetë të nderua, në vitin e kaluar prej momentit të vendosjes së akcizës në buxhetin e Kosovës janë inkasuar nga kjo veprimtari rreth 6 milionë euro, që në të kaluarën nuk ka ndodhur.

Prandaj, unë i përgëzoj të gjithë deputetët për punën e tyre, për kontributin e tyre dhe sidomos Komisionin funksional por edhe deputetët e tjerë që kanë kontribuar me amendamentet e tyre dhe sigurisht ne si Qeveri do ta zbatojmë Ligjin, atë të cilin e aprovon Kuvendi.

Nëse ka të atillë që e bishtnojnë zbatimin e ligjit, atëherë sigurisht se Ligji do të merret me te. Mirëpo, jam shumë i sigurt që drafti aktual që po diskutohet në Kuvend, e përmirëson në mënyrë shumë kualitative situatën në raport me situatën aktuale në të cilën ka qenë dhe cila është.

Prandaj besoj se me aprovimin e këtij ligji, ne do të bëjmë progres në këtë fushë. Ju Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët duhet ta dinë se jemi duke votuar Ligjin dhe i lus le të rrinë në sallë. Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Zoti kryetar!

Ministër dhe deputetë,

Unë dola që t'i përgëzoj pronarët e lojërave të fatit që paskan lobuar shumë e shumë mirë dhe t'i përgëzoj edhe ata që kanë interesa këtu në këtë sallë.

Ne kemi kaluar edhe një herë, e kemi pasur një histori të veçantë lidhur me lojërat e fatit, e dimë që një herë çka nuk ka ndodhur askund në botë ne ia kemi ulë tatimin lojërave të fatit, pra pak më herët. E pastaj e kemi ngritur në një pozitë fikse dhe tani unë nuk e di se ku po domi me mbet, por e di se kontrolli i mundshëm, cili do qoftë, është i mirë i Qeverisë. Mirëpo, unë dëgjova këtu që këtë ligj e kanë bërë dhe ekspertë kanë qenë gjermanë dhe amerikanë, dhe e dëgjova ministrin që modeli është marr ai i Anglisë.

Tani unë nuk e kuptoj, gjermanët edhe amerikanët, pse nuk s'e kanë preferuar modelin e vet por e kanë preferuar modelin anglez. Këtë, nuk po e kam të qartë, për veti.

Në krejt Evropën ka lojëra të fatit, i kanë rregullat e tyre dhe kishe qenë mirë me e marrë një shembull, të kësaj fushe, i cili funksionon mirë dhe i cili nuk e futë në lajthitje buxhetin e Kosovës dhe i cili nuk çon në konflikt dhe nuk i shkatërron familjet, qysh është duke i shkatërruar ky fenomen në Kosovë. Është bërë një fenomen, po them i rëndë për shoqërinë tonë dhe po vazhdon.

Ne nuk mundemi me ia ndaluar dikujt që të luaj ashtu siç nuk mund t'ia ndalojmë dikujt që i plotëson kushtet dhe standardet e biznesit të kësaj fushe që të bëjë biznes në këtë fushë. Por, do të isha mirënjohës ndaj të gjithë faktorëve këtu dhe jashtë kësaj salle që merret me këtë fushë ta kenë parasysh që këto lloj lojërash kudo në Evropë kanë një tatim tepër të madh dhe ky tatim mbikëqyren online mbi bazën e fitimit.

Vëzhgimi im, është i tillë dhe konstatoj që me ligj, sistemin e fuqishëm që është krijuar ne po e mbështesim në njëfarë mënyre dhe nuk jam i sigurt që nuk do të vijmë prapë në këtë sallë dhe të themi që për shkak të taksave të mëdha ose, siç u shpjegua sistemi anglez të grumbullimit të taksave për këto lojëra, do të krijojmë salla shtesë ku janë këto lojëra fati, të cilat me aparate të paparaqitur i fusin lojtarët në to dhe të paraqitur për tatime e kanë një numër shumë të vogël aparatesh.

Prandaj, si të doni, por unë nuk e kam dëgjuar sallën e Parlamentit ndonjëherë kaq të shqetësuar për ndonjë ligj si për këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë dh po ju njoftoj që do t'ia jap fjalën edhe deputetit Ali Sadriu dhe tani fjalën do ta ketë vetëm propozuesi i amendamentit dhe i Komisionit, por jo edhe për debat tjetër. Deputet, e ke fjalën!

ALI SADRIU: Ju faleminderit!

Në një mënyrë ju e thatë atë që unë desha ta them. Ne jemi në leximin e dytë dhe nuk shohë arsye që të hyjmë në debate të tilla, sepse kemi parasysh që ky Ligj e ka kaluar leximin e parë dhe në leximin e dytë.

Komisioni funksional ka pasur edhe ekspertë të natyrave të ndryshme që e njohin mirë bazamentin e këtij ligji, prandaj, nuk e shohë të arsyeshëm shumë debatimin këtu ta bëjmë.

Unë jam njëri nga ata që, për ligjin e parë për lojën e fatit është bërë kur unë kam qenë ministër dhe kam një njohuri, por prapë e konsideroj veten jo shumë kompetentë të kësaj fushe. Prandaj, ju lutem dikujt duhet t'i besojmë dhe unë mendoj se Komisioni funksional e paska kryer detyrën e vet.

KRYETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë me amendamentet.

Kemi në votim amendamentin 4 të deputetit Shaip Muja pa përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë, tash.

Prezentë janë 68 deputetë.

Me 13 vota për, 50 kundër, 1 abstenim, nuk kalon amendamenti 4 i propozuar nga deputeti Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Tani e kemi amendamentin 5 të Komisionit funksional.

Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 6

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 7

Është propozim i Grupit Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re me përkrahjen e Komisionit funksional.

Kryetarja e Komisionit, e ka fjalën. Deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Kryetar! Amendamenti 7 është përkrahë, me propozimin që e ka pru Koalicioni për Kosovën e Re, por ka qenë mendimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit që ia vlen mu bë. Dhe, ndoshta, sikur edhe mos ta kishin sjellë këta amendamentin, kjo kishte me kaluar në Komision.

KRYETARI: Mirë. Ju faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve, që e patëm amendamentin 7, me propozim të Grupit Parlamentar Kosova e re, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

Me 51 vota për, 1 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8, është i Komisionit funksional.

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 9 i Komisionit funksional.

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 10, propozim i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

Me 42 vota për, 13 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10 i propozuar nga deputeti Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti 11 i Komisionit funksional

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 12 i Komisionit funksional

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 13 i Komisionit funksional

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 14, propozim i deputetit Shaip Muaja, përkrahjen e Komisionit funksional

Kundër, a ka? Nuk ka.

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 14 i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti 15, i ka dy propozime të Komisionit funksional.

Votojmë, tash:

Me 52 vota për, 5 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 15 i Komisionit funksional.

Amendamenti 16 është i Komisionit funksional,

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 17, propozim i deputetit Shaip Muja pa përkrahjen e Komisionit funksional.

A do arsyetim deputet, apo po shkojmë në votim?

(Ndërhyrje)

Do të thotë amendamenti 17 është propozim i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

Me 9 vota për, 45 kundër dhe 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 17.

Edhe amendamenti 18 është i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

Me 9 vota për, 44 kundër dhe 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti i 18 i propozuar nga deputeti Shaip Muja.

Amendamenti 19, është i Komisionit funksional,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 20

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 21

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 22

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 23

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 24

Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 25

“Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 26

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 27

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 28

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 29

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 30

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 31, është i propozim i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

Me 10 vota për, 44 kundër dhe 3 abstenime, nuk miratohet amendamenti 31 i propozuar nga deputeti Shaip Muja.,

Amendamenti 32, janë dy propozime: Propozimi i parë është i Komisionit funksional.

Votojmë, tash.

(Ndërhyrje)

Është, amendamenti 32!

(Ndërhyrje)

Po, por tash votuam! Shikoni! Ju lus, nuk e keni kërkuar fjalën me kohë!

Pra, konstatoj se me 51 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33, është i Komisionit funksional,

Kundër nuk ka, Abstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër, nuk ka,

Abstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër, nuk ka,

Abstenim, nuk ka,

Miratohet amendamenti 35.

Tash është amendamenti 36, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Deputet, nëse e do fjalën mund ta merr.

Atëherë, votojmë amendamentin 36, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Me 11 vota për, 40 kundër, 1 abstenim, nuk miratohet amendamenti 36 i propozuar nga deputeti Shaip Muja.

Edhe amendamenti 37 është i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e komisionit funksional. Deputet nëse e do fjalën mund ta merrësh.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Në këtë amendament unë kam kërkuar që të kufizohet numri i makinave të lojërave të fatit në Republikën e Kosovës.

Sipas disa të dhënave numërohen afër 6.000 makina të tilla në Republikën e Kosovës dhe në leximin e parë kam thënë që këto makina kanë me na u futë një ditë në Kuvend. Nëse ne nuk i restrikojmë sa makina duhet me i qitë standardet tona, sepse nuk ka standard as në Bashkimin Evropian, nuk ka as në Amerikë, mirëpo e qetë secili shtet sipas specifikës së vet. Dhe unë kam thënë që në 900 banorë të jetë një makinë që është përafërsisht me 2.200 makina në tërësi dhe nuk lejohen më shumë se 2.200 makina në tërësi të jenë prezente në Republikën e Kosovës. Në të kundërtën do të jenë 6.000 makina, 10.000 makina dhe do të mbushet Kosova me të tilla. Prandaj, unë i lus deputetët të reflektojnë pozitivisht dhe ta kuptojnë realisht situatën. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit, e ka fjalën deputetja, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Kryetar,

Sa i përket amendamentit 37, Komisioni ka vlerësuar se është vështirë i implementueshëm që numri i makinave që lojërave të fatit të jetë i kushtëzuar me numrin e banorëve. Janë të përcaktuara kriteret në këtë ligj, janë të përcaktuara kriteret për licencimin e automatëve dhe kriteret për licencime të tjera.

Unë dua të them edhe një gjë. Më erdhi shumë keq që këtu u thanë etiketime të ndryshme, vërtetë ne kemi qenë të pa përvojë në lojëra të fatit dhe e kemi ditë që është një e keqe që duhet rregulluar për atë edhe kemi angazhuar ekspertë të cilët e kanë dhënë kontributin e tyre në mënyrë që të mos të iu largohem atyre gjërave të cilat janë të rregulluara me kriteret e Bashkësisë Evropiane.

Ajo çka dua të them, unë i kam lajmëruar në mbledhje me kryetarët e komisioneve që ne do të vonohemi pak me këtë projektligj për shkak të angazhimit të ekspertëve që e njohin këtë fushë, dhe ne kemi bërë punën më të mundshme e maksimale. Nuk them që kemi qenë shumë të përvojë por kemi angazhuar njerëz që janë me përvojë për të na njoftua që mos të bëjnë gabime të mëdha në këtë lojë. Megjithatë në këtë Ligj për lojërat e fatit ne kemi punuar aq sa kemi mund, e ndoshta nuk është rregulluar gjithçka por besoj që shumëçka është rregulluar me ta.

KRYETARI: Faleminderit! Jo unë veç dua ta them një çështje, se në Gjermani që konsideroj do të duhet të jetë standard për të gjitha vendet e Evropës se të Bashkimit Evropian po se po janë të kushtëzuara ordinancat mjekësore, private me numrin e qytetarëve. Do të thotë edhe pse është ekonomi e lirë e tregut, është diçka që është e kufizuar me numrin e qytetarëve.

Ndoshta ky amendament që është thënë kështu, është dashtë të merret parasysh, por megjithatë ju si Komision e keni shqyrtuar këtë dhe ne duhet ta respektojmë atë që na e ka pru Komisioni.

Pra, e patëm 37, propozimi i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 16 vota për, 37 kundër, 7 abstenime, nuk miratohet amendamenti 37

Amendamenti 38, propozim i deputetit, Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional. A e do fjalën deputet? Urdhëro, e ke fjalën!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Me gjithë respektin për punën e Komisionit që janë lodhur kaq shumë, unë kur thash që nuk janë inpenju shumë në këtë ligj, pak më parë u miratuan nga ky Kuvend dy nene - neni 14 dhe neni 20, ku kërkohet licencimi i këtyre makinave të lojërave të fatit të bëhet nga një laborator ndërkombëtar. Dhe po i njëjti ligj është në nenin 68, do të thotë, është i njëjti vetëm është më i specifikuar teknikisht sipas standardeve që është laborator ndërkombëtar dhe Komisioni thotë nuk e përkrahi.

Prandaj, në 2 nenet e mëparshme është aprovuar që në këto lojëra duhet të licencohen nga një laborator ndërkombëtar jo vendor, sepse labore vendore të specializuara nuk ka në Kosovë dhe nuk mund të ketë kohë të gjatë, prandaj, unë kërkoj që Komisioni ta numëroj si lëshim teknikë dhe ta pranoj këtë si miratim faktik, sepse është në 2 nenet e mëparshme i miratuar ky në nenin 14 dhe në nenin 20, mund ta lexojë Komisioni dhe e shëf që në nenin 68 është e njëjta përmbajtje vetëm se është specifikimi teknik, laborator ndërkombëtarë i certifikuar dhe i pranuar nga Ministria e Financave dhe nga ATK-ja me këto standarde IZO, ICE 1720/20. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadergjonaj, e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë jam e obliguar vetëm ta them arsyetimin që ka dal nga Komisioni funksional dhe për të tjera le të vendosin deputetët.

Komisioni e ka vlerësuar të panevojshëm fiksimin e laboratorëve sipas standardeve të përmendura pasi që janë përcaktuar kushtet dhe standardet, përfshirë edhe vjetërsinë e tyre për licencimin e automatëve. Ky ka qenë arsyetimi i Komisionit funksional, kurse deputetët le ta japin mendimin e vet.

KRYETARI: Deputeti, Latif Gashi, e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht unë e kisha lutur edhe një herë zotin Muja që le të mundohet t'i arsyeton amendamentet e tij me fakte e mos të thotë Komisioni nuk i ka marrë parasysh edhe Komisioni nuk ka pasur qasje në këto amendamente të tij.

Ky është dëshmitarë vet që prezentë gjatë punës në grup të Komisionit edhe në Komision i kemi pas, përveç ekspertëve të huaj, edhe të gjithë ekspertë vendorë përfaqësues të institucioneve të ATK-së, Ministrisë së Financave, kështu që në lidhje me amendamentin 38 ky ka dashtë edhe standarde, ne e kemi rregulluar edhe këtë çështje me një amendament tjetër, kështu që besoj që ky ligj nuk është i përkryer, po nuk është ashtu siç ka dashtë zoti Muja dhe një farë mënyrë ka lidhur inati me kaluar kështu qysh po thotë dhe realisht nuk është. Faleminderit!

KRYETARI: Të lutem, vetëm për arsyetim të amendamenteve, por jo debate tjera. Le të mësohemi. Realisht për mua është i arsyeshëm amendamenti 38, megjithatë deputetët duhet ta vlerësojnë.

Pra amendamenti 38, propozim i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional, po thuhet edhe pse po më duket që është një kërkesë e arsyeshme. Megjithatë votojmë tash.

(Ndërhyrje)

Mirë, por vullneti i deputetëve është me votua si të donë.

Me 17 vota për, 36 vota kundër dhe 8 abstenime, nuk miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39. Propozim i deputetit, Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash:

Me 47 vota për, 11 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40, propozim i deputetit, Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

A e do fjalën? Fjalën e ka deputeti, Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Në këtë amendament prapë unë kam kërkuar që të rritet përkushtimi dhe kontrolli i shtetit karshi këtyre lojërave dhe çka kam kërkuar unë: Që këto lojëra në një bastore ose në një lokal ku luhen këto lojëra të jenë të gjitha të lidhura në një sistem transparent të raportimit financiar. Çdo gjë që luhet në atë moment të jetë e pasqyruar në mënyrë softuerike dhe të shihet në esencë edhe qarkullimi i atyre aparateve të cilat bëjnë lojë brenda.

Ministria e Financave është e vërtetë që e ka caktua një taksë, e cila merret në start, mirëpo ajo taksë mund të jetë fillestare ose më e ulët, ndërsa tatimi dhe mbledhja nga qarkullimi i atyre lokaleve duhet të jetë i taksuar dhe transparent.

Në ligj këtu thuhet “me libra”, duhet ata të referojnë me libra të shkruajnë çka të donë ata, dhe shumë keq është ajo. Kështu që, ne po kërkojmë një diçka që të futet në transparencë të plotë dhe nëse mendohet ndryshe, atëherë mundësia e abuzimit dhe e fshehjes së qarkullimit të fitimeve të këto lokale është jashtëzakonisht e madh, siç është duke ndodhur. Faleminderit!

KRYETARI: Latif Gashi, anëtar i Komisionit funksional.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht ne në grup punues edhe në Komision edhe këtë çështje e kemi shqyrtuar dhe arsyeya pse e kemi refuzuar është se zoti Muja thuat se në të gjitha rekomandimet e tij ju ka referua lojërave online të cilat në ligj janë të ndaluara.

Unë si anëtar i Komisionit, këtu duhet theksuar edhe mendimin edhe të ministrit të Financave, ne në grup punues dhe në Komision e kemi pa se Kosova nuk ka kapacitete, infrastrukturë njerëzore t'i monitoroj të gjitha këto lojëra, kështu që nëse ka kapacitete me i monitoruar. Është fjala për monitorim online, jo për lojëra online, unë jam për, por duke i përjashtuar lojërat online elektronike.

Unë i ftoj gjithë deputetë që të aprovet ky, me kusht që të përjashtohen lojërat online. Mirëpo duhet paraprakisht me ditë a kemi kapacitete e infrastrukturë njerëzore se është një kosto shumë e madhe buxhetore me bë monitorimin e tyre.

KRYETARI: Deputeti, Ardian Gjini, po bëjmë një ndryshim këtë herë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit kryetar!

Mendoj se është në rregull që kur bënë me u hedhë në votim një amendament deputetët me provua me ia mbush mendjen njëri tjetrit a me votua a jo dhe me i shprehë mendimet e veta. Është praktikë demokratike gjithkund, për amendamente diskutohet.

Ajo që po dua të them unë këtu, është se ideja si ide, nuk është e keqe që të gjitha lojërat e fatit të jenë të lidhura online dhe që tatimi të jetë i drejtpërdrejt, e të mos ketë abuzim.

Po mendimi im është që nëse një provizion të tillë e fusim në ligj tani kemi me dështua për ta implementuar saktë dhe dështimi për ta implementuar ka me çoroditur edhe më tepër sistemin e lojërave të fatit, dhe ka me ndodhë e njëjta gjë që ka ndodhë edhe me arka fiskale ku gjysmën e kemi të implementuar, gjysmën jo. Evazioni është rritur dhe janë dëmtua ata që paguajnë dhe po shpërblehen ata që nuk paguajnë.

Kështu që, jo pse është ideja e keqe, po mendoj se nuk duhet ta votojmë këtë provizion për shkak se është totalisht i paimplementueshëm në këtë fazë e edhe më tepër e çoroditë sistemin e lojërave të fatit, i fut gjysmën e bizneseve të lojërave të fatit nën tokë. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, nuk ka nevojë me sqarua! Edhe unë jam dakord me këtë që ke kërkuar ti. Arsyetimi është që s'ka kapacitete. Megjithatë ju lutem, se nuk kam dyshim që në këto lojëra ka të interesuar edhe brenda kësaj sale e jashtë kësaj sale, po ne po votojmë tash ashtu siç e kemi bindjen.

(Ndërhyrje)

Ne mund të themi çka domi, por mund të votojmë. Po evazion fiskal në Kosovë ka edhe shumë dhe këtë nuk mund ta bëjnë ata që s'kanë pushtet në këto farë lojëra. Dhe, pushtet kanë të gjithë nga pak.

Megjithatë po e votojmë amendamentin 40, të deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 25 vota për, 33 kundër dhe 6 abstenime, nuk kalon amendamenti 40 i deputetit Shaip Muja.

Amendamenti 41, propozim i deputetit, Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

A e do fjalën deputet. Jo! Atëherë, votojmë tash:

Me 10 vota për, 42 kundër dhe 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42, është i Komisionit funksional.

A ka kundër, nuk ka. Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 43.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 44.

Kundër, nuk ka, bstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 45, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Deputetë a e donë fjalën? Urdhëro!

SHAIP MUJA: Ky ligj është prapë tek raportimi në ATK të fitimeve që i gjenerojnë lojërat e fatit. Prandaj, unë kur i luta deputetët që të kuptojnë çka po domi me futë. Ky ligj nuk financohet nga Republika e Kosovës, ky ligj e financon vetveten por ne duhet ta kontrollojmë që të merr buxheti mjete nga ky ligj. Dhe ne nëse hezitojmë se kush do me u marrë me këtë biznes ky duhet me i plotësua standardet vet. Ne jemi legjislacion, ekzekutivi është monitorues dhe penalizues nëse nuk i respektojnë.

Prandaj unë jam duke u befasua kur thuhet që kjo i kushton shtetit, nuk i kushton absolut shtetit, përkundrazi shtetit i bie mjete financiare më shumë.

Dhe nëse ne e shohim që thuhet edhe në mënyrë me libra të raportohet duke shkruar çkado në libra, jemi në shekullin e kibernetikës e kur ne flasim me internet edhe me video konferenca e s'paskan mundësi t'i monitorojnë, ai që donë të bëjë këtë biznes ai duhet të financojë në këtë punë.

Prandaj, unë ju lusë që të reflektoni pozitivisht dhe ta miratoni si amendament. Në të kundërtën, unë që në fillim thash se interesi im është për procesverbal të mbetet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ne kemi vendos që çdo kund me pas standarde, veç këtu mos me pas standarde!

Është amendamenti 45, propozim i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 26 vota për, 30 kundër dhe 1 abstenim, nuk miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46, i Komisionit funksional.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 47 i ka ky propozime,

Propozimi i parë është i Komisionit funksional, votojmë tash:

Me 44 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 47, i Komisionit funksional.

Prezentë janë 71 deputetë,

Amendamenti 48, i Komisionit funksional,

Kundër nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet.

Amendamenti 49.

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 50.

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka.....

Urdhëro, fjalën e ka deputeti, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, amendamentin 50 këta e kanë nda në 2 amendamente: 50 dhe 51, që lidhet me nenin 80. Po dua me thënë atë mund ta rregullojë administrata, po çështja është tjetër çka po dua të them.

Komisioni me të drejtë e ka shtua një paragraf ku thotë: “Në rast se pronarët e aparateve brenda dy muajve nga data e sekuestrimit nuk i kryejnë obligimet tatimore në doganë, dogana do t’i shkatërroj aparatet në mbikëqyrjen doganore”.

Tash paragrafi 5. “Dogana e Kosovës, me kërkesë të pronarit të aparatit të sekuestruar mund ta zgjasë afatin e lartshënuar edhe për një kohë të arsyeshme, me qëllim që pronarit të aparatit t’i mundësohet kryerja e obligimeve tatimore”. Kjo është se cila është koha e arsyeshme, domethënë kjo prapë i lejohet që mund të keqpërdoret.

Prandaj, unë mendoj që në paragrafin 4 këta shumë mirë e kanë rregulluar afatin 2 mujor me i dhënë për me i krye obligimet deri te shkatërrimi i këtyre. Prandaj, 5-shi vetëm e lejon një mundësi, s’po dua të dyshoj tash ta quaj të korruptimit, por edhe lejon një mundësi të manipulimit - afatin e arsyeshëm.

KRYETARI: Pajtohem me këtë. Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit! E kam, për pse të shkatërrohet, të konfiskohet. Të konfiskon shteti edhe mund ta shtet mandej, pse të shkatërrohet. Vetëm këtë ndryshim e kam.

KRYETARI: Jo, jo , mendoj të mbetet kështu si është të shkatërrohet. Më së mirë se tani bëhet tregti me ta!

Votojmë amendamentin 50, të Komisionit funksional, votojmë tash:
Me 57 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 50.

Tani është fjala te amendamenti 51. Unë pajtohem me atë që e tha deputeti, ky duhet të mbetet siç ka qenë, pra mbetet te deputetët që të votojnë. Votojmë tash:
Me 12 vota për, 40 kundër dhe 3 abstenime, nuk miratohet amendamenti 51 i Komisionit funksional.

Dhe në fund kemi amendamentin 52, të Komisionit funksional.
Prezentë janë 70 deputetë dhe votojmë tash:
Me 57 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 52.

Dhe tani e votojmë ligjin në tërësi, votojmë tash:
Konstatoj se me 59 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për lojërat e fatit.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për fondet pensionale në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, kryetar!
Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin lidhur me fondet pensionale të Kosovës. E ka formuar grupin punues i cili ka mbajtur disa mbledhje radhazi për ta shikuar me kujdesin më të madh secilin nenë për të bërë amendamentimin dhe plotësim ndryshimet aty ku ka qenë e nevojshme për tu bërë këto ndryshime. Kuvendit ia ka ofruar raportin me amendamente, kështu që unë i kisha lutë gjithë deputetë që amendamentet të cilat i ka propozua Komisioni funksional t'i miratojnë. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit!
Projektligji ka 50 amendamente nga Komisioni funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Kundër, nuk ka, bstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Kundër, nuk ka, bstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Kundër, nuk ka...

(Ndërhyrje e sekretarit të Kuvendit: Kuorum nuk ka!)

Po, numëroni, sa janë?

Unë i lus kryetarët e grupeve parlamentare që të merren me deputetë!

Pauzë deri në ora 15:00.

- - -

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Elektronika po tregon se këtu janë prezentë 62 deputetë dhe ju lutem i hiqni kartelat e deputetëve që s'janë këtu.

(Ndërprerje e gjatë e incizimit)

Po vazhdojmë!

Pra, prezentë kemi 62 deputetë.

Sigurisht që nuk është në rregull që vërtetë shpesh po na ndodhë që mos ta kem numrin e caktuar për të votuar, dhe sigurisht që administrata e ka për obligim me ligj që ata që nuk janë prezentë...

(Ndërhyrje)

Po, ligji e përcakton, administrata duhet ta ketë parasysh këtë.

Votojmë për amendamentin 7 për Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për fondet pensioanle në Kosovë.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 46.

Amendamenti 47.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 47.

Amendamenti 48.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet, amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50.

Kundër, nuk ka, abstenim, nuk ka, miratohet amendamenti 50.

Dhe tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Prezentë kemi 63 deputetë dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për fondet pensionale në Kosovë. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës.

12. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike

A jeni dakord? Tash e kemi një votim formal, dhe kush është për? Mirë, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Veç kërkesat për diskutim kanë të bëjnë kryesisht me diçka që nuk është thënë mirë ose nuk është kërkuar mirë nga ana e vetë ministres për tërheqjen e këtij ligji.

Më lejoni të ju them që unë personalisht jam pajtuar me tërheqje këtë ligj edhe mendoj që Ministria duhet në përputhje me procedurat me i bë ndryshimet e nevojshme që donë edhe me e kthye prapë.

Ajo që nuk është korrekte fare është letra që ia ka dërgua kryetarit të Kuvendit ministria Kusari, më vjen keq që ajo nuk është këtu, edhe në të cilën thotë se: MTI kërkon tërheqjen e këtij projektligji për arsye të mospërfshirjes të disa propozimeve nga përfaqësuesit e USAID-it, të cilat propozime është dashtë të përfshihen nga ana e Komisionit për Zhvillim Ekonomikë, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Unë pata kërkesën e shumicës së anëtarëve të Komisionit të sqaroj këtë çështje dhe të ju them që komisioni ka punuar në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kërkesat që janë bërë për ndryshime nuk kanë qenë materie e Projektligjit po ligjit bazik, prandaj ne nuk kemi pas të drejtë me ndërhy aty dhe jemi plotësisht në përputhje me Kushtetutën. Ato që janë kërkuar janë në kundërshtim me nenin 79 të Kushtetutës, pra për nismat legislative dhe me procedurat e parapara të nenit 4 dhe 9 të Ligjit për nisma legislative.

Unë e kuptoj që lëshimet e tilla bëhen, kanë mundur të bëhen prej nivelit politik, po edhe unë s'i kam ditë këto procedura, po i mësoj, por është dashtë stafit atje me i pas parasysh këto. Dhe nuk është fare korrekte me u theksua që këto janë propozime, ose nisma, ose amendamente të USAID-it. Kemi pasur raste përpara që vetë ministria s'ka qenë korrekte me i përfshi, dhe ne i kemi kërkuar si komision këto propozime, ka qenë fjala për një ligj tjetër që ka qenë për një pako të ligjeve që na është dashtë me i qua shpejtë, dhe janë pajtua krejt komisioni me i shty, i kemi çua pa asnjë debat brenda dhe tash nuk është fare korrekte, do të kishte qenë mirë ministria këtu edhe me e sqarua mirë këtë pozicion. E pata për obligim me e sqarua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të japë fjalën, unë kërkoj edhe një herë, po më vjen keq tash publikisht që asnjë ministër a ministre e kabinetit qeveritar nuk ka të drejtë t'i drejtohet as kryetarit, as Kuvendit. Kuvendi komunikon me Qeverinë dhe kryeministrin. Do të thotë, ministrat duhet ta kenë të qartë këtë.

Materiali nga ministritë vjen përmes Qeverisë në Kuvend dhe Administrata edhe e Kuvendit duhet ta ketë parasysh për çdo kërkesë, çdo komunikim në këtë mënyrë duhet të kthehet prapa. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini, kryetari i Grupit të Aleancës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Një pjesë të asaj që desha ta them, e thatë ju. Ne kemi dëgjua këtu nganjëherë të na thuhet se me këtë ligj kemi punua edhe bashkë me zotin Bill, dikush tha me një ekspert të Las Vegas-it, tash po thuhet të USAID-it. Ne e dimë që kemi mbështetje nëpër ministri tona dhe është mirë që kemi mbështetje. Por kur Kuvendit i vijnë ligjet, ato nënshkruhen nga kryeministri i Kosovës dhe nga ministri i portfolies përkatëse prej nga na vijnë ligjet dhe ata e mbajnë përgjegjësinë.

Ne nuk kemi punë as me zotin Bill, as me ekspertët e Las Vegas-it, as me UASID-in. Ne kemi punë vetëm me ata që e nënshkruajnë ligjin përfundi.

Këtë desha me thanë, e mbështesim tërheqjen e ligjit ashtu kështu dua të them në fund të fundit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë i bashkohen kërkesës së kryetarit të Komisionit që kjo kërkesë e cila ka ardhur prej Ministrisë në fakt ka shumë mungesa. Atë mungesën të cilën ju e cekët, është një mungesë shumë evidente që kjo ministri ka komunikua në mënyrë jo të duhur, por janë edhe mungesat tjera.

Një ministri apo një ministre të referohet që nuk janë inkorporuar amendamentit USAID-it, është diçka e paprecedent. Se ministrja nuk është zëdhënëse e USAID-it, as nuk ka nevojë të fletë në emër të USAID-it.

USAID-i për ne është shumë i rëndësishëm. Është pjesë e punimeve të Komisionit dhe ne me shumë vëmendje i përcjellim ekspertizat e USAID-it. Por, si duket USAID-i i ka dhënë propozimet në Ministri, Ministria kanë harruar t'i shtinë propozimet e tyre, dhe atëherë ju k mbetur vetëm që të komunikojnë dhe të thonë: valla na jo, por ata të Komisionit kanë harruar me i shti.

Mendoj që duhet të shfrytëzohet ky rast, të kërkohet një seriozitet. Kjo nuk është aspak serioze, duhet të kërkohet seriozitet nëpunës. Duhet të përfshihen ato rekomandime të ekspertëve që janë të vlefshme për ne edhe në ministri dhe në komision, por jo faji i Ministrisë të hedhet në Komision dhe në asnjë mënyrë të bëhet zëdhënëse e askujt tjetër. Ju faleminderit!

Përndryshe, ajo që ka merituar amë u kthye, ka merituar, se është ligj i dobët edhe kërkoj nga Ministria dhe nga ministrive tjera që të kenë shumë kujdes kur t'i sjellin ligjet, t'i kontrollojnë përpara dhe mos të bien në pozitë që të kthehen ligjet prej Kuvendit.

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën. Le të përgatitet Arben Gashi!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se tërhiqja e këtij ligji nuk është e mirë, mirëpo ka edhe mundësi që të plotësohet me një afat sa më të shpejt sepse Kosova ka resurse turistike dhe mundësi për shërbime të tilla turistike që janë në nevojë për rritjen e buxhetit të Republikës së Kosovës dhe afirmimin e Kosovës përmes shpalosjes të projekteve turistike për të tjerët.

Prandaj, mendoj që duhet t'i jepet mundësi që të kthehet në Komision sa më shpejt, të plotësohet me amendamente plotësuese dhe jo më të kthehet nga fillimi në Qeveri.

KRYETARI: Kërkesa është me u kthye prapa. Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Unë veç e mora fjalën për me e potencuar një fakt se Rregullorja e punës i parasheh procedurat edhe për propozimin e amendamenteve dhe në këtë rast unë nuk mendoj që një organizatë ndërkombëtare mundet me bë amendamente ne procedura kuvendore. Dhe tërheqja e Ligjit për këtë arsye është shumë absurde.

Do të ishte mirë ndoshta që t'u sqarohet ministrave dhe ministres në fjalë që është edhe zëvendëskryeministre për çështje të tregtisë, ekonomisë dhe e këtyre çështjeve ekonomike që këto punë, nuk bëhen kështu. Ndoshta, nëse ka nevojë kryetar, mundemi edhe në emër të nën-komisionit po flas, Armendi është mbrapa atje, por po flas edhe në emër të Komisionit. Armendi ndoshta mundet me ua mbajt ministrave një trajnim për punë të procedimit të ligjeve dhe procedurat e amendamentimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Po ia japim fjalën Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Me të vërtetë si deputetë po flas. Unë kur e kam marrë këtë shkresë, personalisht e kam ndie veten keq për kolegët e mi që janë të gjithë anëtarë të atij komisioni se pikësëpari është fyerje për deputetët e atij komisioni funksional, sepse edhe me Ligj edhe me Kushtetutë deputeti nuk i nënshtrohet asnjë lloj detyrimi dhe nuk është detyrues as ndaj USAID-it as ndaj Qeverisë. Vendos i pavarur, i harmonizon amendamentet dhe është edhe në procedurat ligjdhënëse.

Prandaj, shkresa si e tillë, nuk i ka përmbushur kriteret as për t'u paraqitur sot në Kuvend, sepse paragrafi 5 i Rregullores thotë: Gjatë shqyrtimit në Kuvend të Projektligjit, Qeveria mund ta tërheqë projektligj.

Do me thënë, i ka parapri edhe fazës së leximit të dytë. Por kjo nuk është arsyeja. Ne po pajtohemi që po tërhiqet ky ose kërkesa të miratohet, por me të vërtetë pa dashur me hy në detaje, është fyerje për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për Komisionin funksional me iu drejtuar amë një këso lloj shkrese dhe kësi lloj shpjegimi. Prandaj, edhe ju si kryetar i Kuvendit dhe si Kryesi, nuk është dashur me e proceduar në këtë formë. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Ju faleminderit, kryetar!

Meqenëse jam anëtar i këtij Komisioni, kryetari i Komisionit i tha disa vërejtje, por edhe zonja Teuta Sahatqija i tha disa vërejtje të saj, por unë do t'i shtojë disa vërejtje për këtë tërheqje të këtij projektligji.

Ne si Komision, kemi qenë në grup punues dhe kam qenë udhëheqës i këtij grupi punues kemi i arritur që 22 amendamente me i shqyrtuar për këtë Projektligj dhe në dy mbledhje kemi kërkuar që ministrja të vjen që të na raportoj, a të mos e quaj raportim, por të na informojë se a ka ndonjë ndryshim për atë projektligj, dhe nuk ka ardhur. Ne në për dy mbledhje e kemi shtyrë pikën e rendit të ditës dhe me 7.03. kemi mbajtur mbledhjen për çka edhe mund ta keni procesverbalin shikoni, se ne e kemi shqyrtuar atë projektligj dhe e kemi përfunduar.

Nuk i kemi marrë parasysh asnjë ndryshim të Projektligjit që e ka dërguar ministrja ku thotë se USAID-i apo nuk i kemi marrë na parasysh vërejtjet e USAID-it. Kjo nuk është e vërtetë se ne nuk kemi të drejtë me hy në Ligjin bazik dhe e kemi përfundua, e sot është dashur me qenë, ministrja nuk është këtu për të na sqaruar ku ka qenë ky problem. Kjo nuk qëndron se ne nuk i kemi marrë vërejtjet e USAID-it.

Të gjitha vërejtjet që i kanë qua në ndryshimin e projektligjit, ne i kemi pasur parasysh dhe i kemi shqyrtuar në 22 amendamente. Ju faleminderit”

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sa për informim tuaj, do të thotë ministrja në fjalë ose ministres në fjalë i është kthyer komunikimi i parë dhe komunikimi i dytë është se përsëri i drejtohet kryetarit të Kuvendit, por përmes Kryeministrit. Do të thotë, kështu i është kthyer një herë dhe herën tjetër ka ardhur përmes kryeministrit.

Por, mendoj që të gjithë jeni pajtuar që të kthehet dhe ata pastaj t'i bëjnë përmirësimin që mendojnë t'i bëjnë, e ne pastaj i amendamentojmë.

Kush është për, që të kthehet ky ligj? Ju faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka. Atëherë, miratohet kërkesa për t'ju kthyer Qeverisë Ligji. Vazhdojmë tutje:

13. Shqyrtimi i planit hapësinor të zonës me interes të veçantë. “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, në Kleçkë dhe Divjakë”.

Komisioni Për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural, Mjedis dhe Planifikim hapësinor, ka shqyrtuar, ka shqyrtuar Projekt-planin hapësinor me interes të veçantë “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë” dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj, falën e ka kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani. Nahit. Urdhëro, Nait!

NAHIT HASANI: Ju faleminderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar amë 19.3. Planin hapësinor me interes të veçantë për Shtabin e Përgjithshëm UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë dhe e ka miratuar këtë dhe ka kërkuar që Kuvendi ta miratojë.

Mendoj se kemi mundësi mandej ta shqyrtojmë më shumë, por ta kalojmë këtë plan hapësinor fillimisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjala është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën?

(Ndërhyrje)

Kush? Nijaziu?! Atëherë, fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Ju faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar këtë plan dhe mendoj se si të tillë duhet ta mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Salih Morina e ka kërkuar fjalën.

SALIH MORINA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar këtë plan dhe ndoshta një çështje e cila do të ishte mirë të ngritët është çështja e pronave ku kryesisht ka të bëjë ëme pronën private dhe në këtë plan hapësinor nga Ministria nuk e kemi një pasqyrë reale, kur dihet se pronat private do të thotë krijojnë ndoshta dhe probleme ose mospajtime në atë se a është bërë vlerësimi i këtyre pronave private, kush e ka bërë vlerësimin dhe a janë pajtuar, do të thotë qytetarët e tyre zonave për çështjen e këtyre pronave private.

Prandaj, mbetet në të ardhmen, do të thotë Ministria e Planifikimit Hapësinor ta merr shumë më seriozisht këtë çështje në kuptimin asaj që ta rregullojë çështjen e pronës që kanë të bëjnë në këto tri zona, edhe pse e kemi vendimin e tri komunave që janë në kuadër të kësaj zonës të interesit, të cilat e kanë sjell në Ministrinë e Mjedisit dhe njëkohësisht janë paraqitur në këtë plan hapësinor, mirëpo kjo çështje mendoj që duhet të rregullohet më mirë dhe njëkohësisht mendoj që duhet të rregullohet në interes të qytetarëve të këtyre zonave.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështetë në parim këtë plan dhe shohim mundësinë e shqyrtimit të mëtutjeshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështetë shqyrtimin e Planit hapësinor të zonës me interes të veçantë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Kleçkë dhe në Divjakë.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën!

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re mbështet planin hapësinor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së? Nuk ka të lajmëruar.

Në emër të “6+”-shit? Nuk ka.

Atëherë, shkojmë për deputetët e lajmëruar. Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë

Tema e sotme që po diskutohet në kuvendin e Kosovës është e një rëndësie të veçantë dhe kërkon vëmendjen dhe kontributin e secilit prej nesh që përmes diskutimeve tona të bëjmë sa më efektive dhe të plotë këtë temë.

Askush nuk ka dilemë për rëndësinë që përmban në vete Plani hapësinor i zonës me interes të veçantë, “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë e Divjakë” dhe shqyrtimi i këtij plani të Qeverisë sot në Kuvendin e Kosovës.

Personalisht, e mbështes plotësisht angazhimin e Qeverisë për ta shpallur zonë të interesit të veçantë zonën në Malet e Berishës, Divjakën, Kleçkën e tjera, sepse ato e përfaqësojnë një zonë me kontribut të madh në luftën për lirinë e Kosovës.

Këto fshatra kanë qenë zemra e organizimit të UÇK-së, vendi ku janë themeluar dhe kanë qëndruar strukturat drejtuese të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe Drejtoria politike e saj, institucionet informative të luftës, mediat Kosova-press dhe Kosova e Lirë. Po ashtu, në këtë zonë kanë gjet strehë dhe shpëtim qindra e mijëra banorë civilë të zhvendosur nga anë të ndryshme të vendit, për të cilën është përkujdesur Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Lufta për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj civilëve është një vlerë tjetër e madhe dhe e bën këtë zonë të veçantë.

Aty kanë zbarkuar për herë të parë edhe trupat e miqve tanë NATO-s dhe janë zhvilluar takimet e para dhe takimet e shumta UÇK-NATO. Dhe, gjithsesi ky është, ky fakt është simbolikë e veçantë.

Për këto arsye edhe shumë vlera tjera, kjo zonë meriton kujdesin e shtetit. Por, gjatë trajtimit të kësaj zone duhet pasur kujdes edhe në trajtimin e banorëve të kësaj zone dhe tyre që kanë dhënë kontributin e jashtëzakonshëm gjatë luftës, duke bartur një barrë të madhe. Ata nuk duhet të ndjehen të harruar dhe të anashkaluar.

Andaj, efektet pozitive të trajtimit të kësaj zone, duhet patjetër t'i ndjejnë banorët e kësaj zone.

Përveç vlerave të mëdha historike, kjo zonë ka edhe vlera të shumta e të mëdha natyrore, të cilat me një investim të duhur do ta shndërronin atë në një pikë shumë të rëndësishme turistike, jo vetëm për qytetarët e Kosovës. Kjo do të ndikonte pozitivisht zhvillimin e kësaj zone dhe do të sillte shumë favore edhe qytetarëve të saj.

Të nderuar kolegë,

Duke pasur parasysh të gjitha këto, unë dua të prekë edhe një çështje me rëndësi, atë të komplekseve tjera memoriale në vendin tonë.

Këtu dua të përgëzoj Qeverinë për punët dhe angazhimin, që ka bërë rreth ndërtimit të Kompleksit Memorial të Jasharajve në Prekaz, i cili përfaqëson kryeveprën dhe kryemonumentin e luftës sonë për liri, duke u përgëzuar Qeveria për mbështetjen e ndërtimit të këtij monamenti, por kjo momentalisht nuk është punë e kryer. Ka edhe shumë për t'u bërë.

Andaj e kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që gjatë kohës së rishikimit të buxhetit, të shikojë mundësinë që të ndajë mjete tjera shtesë për të përsheptuar përfundimet e punimeve në Kompleksin më të rëndësishëm të UÇK-së, atë të Prekazit. Ky është obligimi ynë i vazhdueshëm për të bërë pjesën tonë të punës në nderim të veprës madhore të komandantit Adem Jashari, të familjes, fshatit dhe bashkëluftëtarëve të tij.

Në këtë kuadër e mbështes Qeverinë edhe për punët rreth përmbylljes së projektit të Memorialit në Reçak dhe mbështetjen që i ka dhënë projektit të Koshares, i cili pritet të fillojë sivjet.

Mbështetja nga Qeveria e projekteve të tilla monumentale është detyrë dhe obligim, që e kemi të gjithë ne ndaj këtyre vendeve dhe njerëzve që u bënë themel i lirisë dhe shtetit që po e ndërtojmë sot. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli, e ka fjalën!

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari ministër, të nderuar deputetë,

Unë fillimisht do të theksoj se Planin hapësinor për Kleçkë dhe Divjakë, në parim e përkrahi, mirëpo do të kisha dashur t'i theksoj nga dy-tri vërejtje apo sugjerime të mia.

Vërejtja e parë e imja ka të bëjë me dallimet ndërmjet qëllimit të Planit hapësinor dhe aktiviteteve të parapara për zbatimin e këtij plani, sepse në vetë planin thuhet se një prej qëllimeve kryesore të planit është mbrojtja e të gjitha objekteve me rëndësi të veçantë nga

lufta e UÇK-së, kurse si aktivitete të parapara për zbatimin e këtij plani janë disa aktivitete të tilla, që fare nuk kanë të bëjnë me këtë plan.

Kështu, për shembull, një aktivitet që parashihet është rritja e fondit të gjedhëve dhe përmirësimi i racës, për të cilin aktivitet janë paraparë 40.000 euro në këtë plan. Dhe, shtroj pyetjen se çka kanë të bëjnë gjedhët dhe përmirësimi i racës me zbatimin e planit?

Pastaj, një aktivitet tjetër, është paraparë ndërtimi i shkollave dhe ambulancave, i cili është në vlerë prej 300.000 eurove dhe prapë nuk mund ta ndërlidhi drejtpërsëdrejt me mbrojtjen e objekteve kulturore dhe objekteve tjera të kësaj hapësire të planifikuar.

Po ashtu, një aktivitet tjetër, është paraparë edhe grumbullimi i frutave të imët. Mirë, për këtë aktivitet janë paraparë mjete financiare në vlerë prej 3.000 euro, mirëpo prapë nuk mund ta ndërlidhi me qëllimin kryesor të planit.

Kurse, vërejtja ime e dytë ka të bëjë me disproporcionin ndërmjet aktiviteteve dhe lartësisë së shumës së paraparë për këto aktivitete, çka do të thotë, për disa aktivitete kemi të paraparë një shumë enorme, një shumë tejet të lartë në krahasim me atë çka mund të jetë aktivitet. Kështu, konkretisht mendoj për aktivitetin: hartimi i planit për menaxhimin e parkut. Do të thotë, të hartosh një plan sipas të cilit do të menaxhohet parku dhe për të, të parashihet vlera prej 200.000 euro, për mendimin tim ose është gabim në vetë shënimin e aktivitetit ose është një shumë jashtëzakonisht enorme, e madhe për një aktivitet të tillë.

Vërejtja ime tjetër, në këtë drejtim, ka të bëjë edhe me nënshkrimin e marrëveshjes. Parashihet që për nënshkrimin e marrëveshjes në mes të tri komunave, të cilat e përfshijnë këtë plan dhe atë komuna e Lipjanit, komuna e Drenasit dhe Malishevës, parashihet një vlerë prej 2.000 euro. A thua me çfarë lapsi do ta nënshkruajnë këtë marrëveshje, me ndonjë laps me penë të artë apo me çfarë lapsi?

Kurse, vërejtja ime e tretë, ka të bëjë me mosplanifikimin analitik të shpenzimeve për implementim, sepse thuhet që kostoja e planit do të jetë 3.500.000 euro, ndërsa sipas parallogarite, pritet që plani të jetë mbi, implementimi i planit të kushtojë mbi 14.000.000 euro, kurse në plan nuk i kemi të parapara në mënyrë analitike se si do të bëhen këto shpenzime.

Dhe, krejtësisht në fund, do të kisha komentuar një fjali, të cilën e kam hasur në këtë plan.

Në hyrje të këtij plani thuhet se si tërësi zonale konsiderohet pikë strategjike dhe nga Malet e Berishës rreth 75% e tërë territorit të Kosovës shihet me anë të syrit të lirë. Unë nuk besoj që ka ndonjë pikë të tillë në Kosovë, nga e cila mund të shihet 75% të territorit të Kosovës.

Prandaj, duke pas parasysh se kemi të bëjmë me një plan serioz, për të cilin do të investohen diku afro 15.000.000 euro, të ketë fjali të këtilla të ekgzagjeruara.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, mbase ata që e kanë bërë projektin, bën vaki e shohin!! Mirë po vazhdojmë. Deputetja Salë Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje ministra, ministër Hamza!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse jemi në pikën e fundit të rendit të ditës, dhe po e shoh se durimi veçse është në fund, por nuk mundem pa i thënë një 2-3 fjalë për këtë plan hapësinor dhe nuk mundem pa e përmendur se ndihem shumë mirë që mu ka dhënë mundësia të jap kontributin tim përmes votës për këtë plan hapësinor, sepse e vlen që kjo zonë e interesit veçantë Kleçkë e Divjakë, e cila shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, më në fund të jetësohet edhe të ketë qasje institucionale nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Më lejoni të citoj nga ky dokument edhe deklaratën e vizionit, ku thuhet se plani hapësinor të zona e interesit, Shtabi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kleçkë dhe Divjakë është park historik kulturor dhe me vlera natyrore i përkujtimin të luftës së popullit për çlirim në shërbim të edukimit, promovimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Unë mendoj se e veçanta e kësaj është se ky dokument vjen si një mirënjohje deri në palcë që do ta përjetojë populli i asaj ane, i cili e ka mbështet me të gjitha mjetet dhe mundësit e veta luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në çlirimin definitiv të saj.

Zona e Kleçkës dhe Divjakës i ka meritat dhe shquhet për veprimtarinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare në organizimin e forcave mbrojtëse ushtarake të Kosovës.

Vlen të përmendet se e tërë zona ishte në dispozicion të Shtabit të përgjithshëm dhe kjo është me rëndësi që brezat e ardhshëm duhet së pari të informohen me korrektësi, po e përsëris të informohen për veprimtarinë atdhetare e cila shquan këtë zonë në periudha të ndryshme historike jo vetëm nga lufta e fundit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe kjo pjesë duhet të fshihet në pjesët edukativo arsimore.

Nisur nga rëndësia historike, politike dhe shoqërore e luftës çlirimtare e popullit tonë të udhëhequr nga UÇK, dhe rëndësia shumëdimensionale e kësaj lufte që arriti ta orientojë potencialin e vetë ushtarak dhe politik në kahun e duhur, në drejtim të arritjes së lirisë, pavarësisë dhe demokracisë shtrohet domosdoshmëria që këto vlera të pazëvendësueshme të popullit tonë të prezantohen, të ruhen dhe të kultivohen në formë dhe trajtë institucionale dhe profesionale.

Në fund e mbështes këtë dokument dhe ju ftoj të nderuar deputetë që pas miratimit të këtij plani hapësinor të përcillet zbatimi i tij nga Komisioni në fjalë dhe të shihet se sa po arrihen synimet dhe objektivat e kësaj vlere kombëtare.

Shpresoj se kryetari i Komisionit do t'ia jap këtë detyrë me kënaqësi vetit, sepse ka qenë një pjesë e veprimtarisë së tij atdhetare që e ka zhvilluar edhe në atë zonë shumë të rëndësishme, është fjala për zotin Nait Hasani. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe deputetja e fundit për diskutim është Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Plani hapësinor i zonës në interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë, Divjakë” paraqet një dokument që ka rëndësinë historike, politike dhe shoqërore të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe rëndësia shumëdimensionale e kësaj lufte që arriti ta orientojë potencialin e vetë ushtarak dhe politik, nën drejtim të arritjes së lirisë dhe pavarësisë.

Është e domosdoshme që këto vlera të pazëvendësueshme të popullit dhe të vendit tonë të ruhen, të kultivohen dhe të prezantohen nga institucionet profesionale të Republikës së Kosovës.

Vlerat historike të territorit që e përkufizon këtë zonë të interesit të veçantë janë identifikuar me sakrificën dhe rezistencën e gjeneratave të hershme nga aktivistët e çështjes kombëtare, ku shquhet për liri edhe luftëtari Rifat Berisha dhe figura e ndritur, plakut të mençur dijetarit Tahir Berisha.

Vlerat kulmore të këtij territori identifikohen në tërë zonën. Këtu prehen të qetë eshtrat e heronjve dhe dëshmorëve të Ushtria Çlirimtare të Kosovës, si: Ismet Jashari – “komandant Kumanova”, Agim Qelaj, Sadik Shalaj, Ibrahim Mazreku dhe shumë e shumë dëshmorë të tjerë të lirisë.

Ata janë simbol kryesor i zonës së interesit të veçantë Kleçkë dhe Divjakë dhe po ashtu, në këtë zonë ka funksionuar Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Brigada 121 Kumanova, Spitali ushtarak, Drejtoria Politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Shërbimi informativ kombëtar, agjencia e lajmeve “Kosova-Press” dhe “Kosova e Lirë”.

Kjo zonë e ka edhe një rëndësi tjetër, e cila ka të bëjë me strehimin e mbi 80.000 civilëve që kanë qenë nën mbrojtjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pozita gjeografike e kësaj zone me interes të veçantë, shtabi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Kleçkë, Divjakë shtrihen në pjesën qendrore të Kosovës, në tri komuna: Malishevë, Drenas dhe Lipjan, që kanë lidhje rrugore të mirë me tërë territorin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, këto komuna, të cilat iu takon kjo zonë e interesit të veçantë, në aspektin e zhvillimit ekonomik hynë në radhën e komunave më të pazhvilluara të Kosovës dhe një nga zonat më të dëmtuara nga lufta e fundit.

Popullata që jeton në këtë zonë ka kushte të vështira për jetë, me një ekonomi të pazhvilluar, me një numër të madh të të papunëve dhe mungesë të shumëfish të infrastrukturës.

Aktivitetet prodhuese në këtë zonë, kryesisht zhvillohen përmes ekonomive familjare. Mendoj që Qeveria qendrore dhe ajo lokale duhet t'i mbështes financiarisht banorët në këtë zonë në ngritjen e kapaciteteve të tyre, në bujqësi, blegtori, bletari dhe rregullimin e infrastrukturës fizike. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet nxjerrjes së gurit gëlqeror që është një zeje tradicionale e banorëve lokalë, e cila zeje duhet të vihet në kontroll apo edhe të ndalohet për shkak të ndotjes së ambientit. Kapacitetet investive mund të jetë nga sektorët e ndryshëm si nga ai publik, privat, partneriteti publiko-privat, kreditë, donacionet, të cilat do të krijojnë përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve në arsim, në ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe infrastrukturën e nevojshme socio-teknike. Investimet do të ndikojnë në stabilizimin e migrameve dhe rritjen e interesimit të popullsisë për të jetuar dhe punuar në këtë zonë.

Në zonën e interesit të veçantë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë, Divjakë është një numër i madh i objekteve me rëndësi kulturo-historike dhe natyrore, të cilat janë nënshtruar rrezikut të shkatërrimit të tërësishëm. Prandaj, ky element konsiderohet si njëri ndër faktorët kryesor që duhet të ketë parasysh Qeveria. Po ashtu, nevojitet një menaxhim efikas jo vetëm për mbrojtje e ruajtje, por edhe për investime për plotësimin e nevojave të ndryshme të popullatës për promovimin e këtyre vlerave.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, pres nga Qeveria që pas miratimit të këtij plani hapësinor në Kuvend të fillojë të zbatojë synimet dhe objektivat për zonën e interesit të veçantë të parapara nga ana e ekspertëve profesional.

Dhe në fund dëshiroj t'i përshëndes të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e këtij plani. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë tani të lajmëruar për diskutim s'kemi më. Ishin tre, po i tërhoqën diskutimet.

Prezentë janë 63 deputetë!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 50 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Planin Hapësinor me interes të veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë".

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për transkriptim dhe lekturë e Kuvendit të Kosovës